



PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

Akte Ligjore dhe Nënligjore të Administratës Doganore

1999 - 2012

VELLIMI II

Ideuar, përpunuar, redaktuar dhe përgatitur për botim nga:

Ervina Domi

Borana Ajazi

Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Në hartimin e kësaj Përmbledhje Legjislacioni kanë kontribuar gjithashtu i gjithë stafi i Sektorit të legjislacionit dhe përafrimit me BE-në në Drejtorinë Juridike në DPD si dhe të gjitha strukturat e tjera me të cilat jemi konsultuar gjatë procesit të hartimit të kësaj Përmbledhje Legjislacioni.

Të nderuar lexues

Ndër vite Administrata Doganore Shqiptare e ka ndjerë nevojën e një përmbledhjeje zyrtare të akteve ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve. Adaptimi e ratifikimi i akteve të ndryshme ndërkombetare, miratimi i ligjit 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe i VKM nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i hapi rrugë padyshim zhvillimeve dhe vizioneve të reja në Administratën Doganore Shqiptare. Për këtë qëllim ndër vite kjo administratë e ka pasuruar fondin e saj të akteve nënligjore me akte të ndryshme të të gjitha niveleve.

Zhvillimet integruese apo dokumentet strategjike të Qeverisë Shqiptare, gjithashtu janë pasuar me një sërë iniciativash ligjore e nënligjore të cilat në thelb kanë patur dhe kanë për qëllim, harmonizimin dhe përditësimin e procedurave doganore me atë të vendeve të BE-së, adaptimin e praktikave me të mira, krijimin e lehtësirave për biznesin dhe uljen e barrierave ndaj tij, mundësimin e përmbushjes së misioneve të rëndësishme të Administratës Doganore ku padyshim theksin ashtu si edhe vetë vendet e BE-së e kemi vendosur në sigurinë kombëtare, në mbrojtjen e kufijve, sigurinë shëndetin dhe konsumatorin, pronësisë intelektuale, lirisë së lëvizjes etj.

Tërësia e këtyre akteve të shumtë në vite në mungesë të një përmbledhjeje të tyre e bënte të vështirë përdorimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Për këtë qëllim Administrata Doganore, përmes Drejtorisë Juridike ndërmori këtë iniciativë vërtetë ambicioze për të mundësuar këtë përmbledhje të Legjislacionit të Administratës Doganore.

Kërkuam të jemi ambicioz në pretendimin tonë në lidhje me këtë Përmbledhje për shkak se ambiciet të drejtojnë drejt suksesit dhe mundësojnë realizimin e standarteve të larta. Kërkesat e larta dhe të papërmbushura janë në vetvete më të vlefshme sesa kërkesat e ulëta tërësisht të përmbushura (J. V. Gëtë).

Përmbledhja e Legjislacionit që po prezantojmë pranë Jush, përmbledh aktet më të rëndësishme mbi të cilat bazohet veprimtaria doganore pa pretenduar apo absolutizuar prezencën dhe përmbajtjen e të gjitha akteteve të të gjitha niveleve të miratuara ndër vite.

Kjo përmbledhje është hartuar mbi bazën e nivelit hierarkik të akteve sipas Kushtetutës së Shqipërisë, duke filluar me Konventat Ndërkombetare në fushën doganore ku vendi ynë ka aderuar, me Marrevëshjet Ndërkombëtare, Marrevëshjet Bilaterale, aktet ligjore me shumicë të cilësuar, ligjet e thjeshta dhe aktet nënligjore të nivelit të dyte dhe të tretë.

Ky padyshim është vetëm hapi i parë duke i lënë rrugë në këtë mënyrë përditesimeve dhe përmiresimeve të vazhdueshme të saj.

Flamur GJYMISHKA

Drejtor i Pergjithshem

Mbi mënyrën e përdorimit të Përmbledhjes së Legjislacionit.

Përmbledhja e legjislacionit është krijuar në një mënyrë të tillë që të krijojë lehtësira maksimale në përdorimin e saj. Ajo përbëhet nga 5 volume të renditur e numra nga 1-5. Secili volum në fillimin e tij ka një pasqyrë të lëndës, përmes së cilës lexuesi mund të orientohet lehtësisht për të kërkuar aktin që ai dëshiron.

Gjithashtu duke qënë së Përmbledhja është e ndarë në seksione sipas llojit të akteve apo sipas institutive të së drejtës doganore në fillim të çdo sesioni specifik për lehtësi do të gjeni edhe një pasqyrë të lëndës vetëm për aktet brenda atij seksioni.

Kjo Përmbledhje Legjislacioni gjithashtu do të jetë e adaptuar edhe në një program specifik të përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i IT në DPD, bazuar në kërkesat specifike të Drejtorisë Juridike për mënyrën e funksionimit të saj.

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

Faqe

- **VELLIMI I**

- 1. Ligj**
Nr. 9590, datë 27.07.2006 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, ndërmjet Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. **1**
- 2. Ligj**
Nr. 9696, datë 21.03.2007 Marrëveshje për Amendimin dhe Zgjerimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore (CEFTA). **525**



LIGJ

Nr. 9590, datë 27.07.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:
Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare" .

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr .5010, datë 4.8.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJA E STABILIZIM ASOCIIMIT NDËRMJET KOMUNITETEVE EUROPIANE E SHTETEVE TË TYRE ANËTARE DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

MBRETËRIA E BELGJIKËS,
REPUBLIKA ÇEKE,
MBRETËRIA E DANIMARKËS,
REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË,
REPUBLIKA E ESTONISË,
REPUBLIKA HELENE,
MBRETËRIA E SPANJËS,
REPUBLIKA E FRANCËS,
IRLANDA,
REPUBLIKA E ITALISË,
REPUBLIKA E QIPROS,

REPUBLIKA E LETONISË,
REPUBLIKA E LITUANISË,
DUKATI I MADH I LUKSEMBURGUT,
REPUBLIKA E HUNGARISË,
REPUBLIKA E MALTËS,
MBRETËRIA E HOLLANDËS,
REPUBLIKA E AUSTRISË,
REPUBLIKA E POLONISË,
REPUBLIKA E PORTUGALISË,
REPUBLIKA E SLLOVENISË,
REPUBLIKA SLLOVAKE,
REPUBLIKA E FINLANDËS,
MBRETËRIA E SUEDISË,
MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,

Palët kontraktuese të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, si dhe të Traktatit të Bashkimit Evropian, referuar më poshtë si “Shtete Anëtare”,

dhe

KOMUNITETI EUROPIAN, KOMUNITETI EUROPIAN I ENERGIJË ATOMIKE,
referuar më poshtë si “Komuniteti”,

nga njëra anë, dhe

REPUBLIKA E SHQIPËRISË, referuar më poshtë si “Shqipëria”,

nga ana tjetër,

DUKE MARRË PARASYSH lidhjet e forta ndërmjet Palëve dhe vlerat që i bashkojnë, dëshirën e tyre për të forcuar këto lidhje dhe për të vendosur marrëdhënie të ngushta e të qëndrueshme, bazuar në reciprocitet dhe interesat e ndërsjellë, të cilat duhet t’i japin mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet – të vendosura më parë me Komunitetin nëpërmjet Marrëveshjes mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar e Ekonomik të vitit 1992 – me Komunitetin dhe Shtetet e tij Anëtare;

DUKE MARRË PARASYSH rëndësinë e kësaj Marrëveshjeje në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asocimit me vendet e Europës juglindore, për vendosjen dhe konsolidimin e një rendi të qëndrueshëm evropian bazuar në bashkëpunim, për të cilin Bashkimi Evropian është një shtyllë kryesore, si dhe në kuadër të Paktit të Stabilitetit;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të kontribuar me të gjitha mënyrat për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit, nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës së administratës publike, integritit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, veçanërisht në drejtësi dhe çështjet e brendshme dhe në forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumëpartiak me zgjedhje të lira e të ndershme;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të zbatuar plotësisht të gjitha parimet dhe dispozitat e Kushtetutës së OKB-së, të OSBE-së, veçanërisht ato të Aktit Final të Helsinkit,

dokumentet përfundimtare të Konferencave të Madridit dhe Vjenës, Kartën e Parisit për një Evropë të Re, dhe të Paktit të Stabilitetit për Evropën juglindore, në mënyrë që të kontribuojnë në stabilitetin rajonal dhe bashkëpunimin ndërmjet vendeve të rajonit;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj parimeve të ekonomisë së tregut të lirë dhe gatishmërinë e Komunitetit për të kontribuar për reformat ekonomike në Shqipëri;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve ndaj tregtisë së lirë, në përputhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga OBT-ja;

DUKE MARRË PARASYSH dëshirën e Palëve për të zhvilluar më tej një dialog politik të rregullt për çështje dypalëshe dhe ndërkombëtare me interes të ndërsjellë, përfshirë aspektet rajonale, duke pasur parasysh Politikën e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët të Bashkimit Evropian;

DUKE MARRË PARASYSH angazhimin e Palëve për të luftuar krimin e organizuar dhe për të forcuar bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit në bazë të deklaratës së nxjerrë nga Konferenca Evropiane më 20 tetor 2001;

ME BINDJEN që Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit krijon një klimë të re për marrëdhëniet ekonomike ndërmjet tyre dhe, mbi të gjitha, për zhvillimin e tregtisë dhe investimeve, që janë faktorë kryesorë për modernizimin dhe ristrukturimin ekonomik;

DUKE RIKUJTUAR angazhimin e Shqipërisë për të përafruar legjislacionin në sektorët përkatës me atë të Komunitetit dhe për ta zbatuar atë me efektivitet;

DUKE MARRË PARASYSH gatishmërinë e Komunitetit për të dhënë një mbështetje vendimtare për zbatimin e reformave dhe për të përdorur për këtë qëllim të gjitha instrumentet e disponueshme të bashkëpunimit dhe asistencës teknike, financiare e ekonomike mbi një bazë gjithëpërfshirëse shumëvjeçare për këtë përpjekje;

DUKE KONFIRMUAR që dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që përfshihen në fushën e veprimit të Pjesës III, Titulli IV të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian e angazhojnë Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën si Palë Kontraktuese të veçanta, dhe jo si pjesë të Komunitetit Evropian, derisa Mbretëria e Bashkuar ose Irlanda (sipas rastit) të njoftojë Shqipërinë se është angazhuar si pjesë e Komunitetit Evropian në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës, i aneksuar Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit themelues të Komunitetit Evropian. E njëjta gjë zbatohet edhe për Danimarkën, në përputhje me Protokollin mbi pozicionin e Danimarkës i aneksuar këtyre Traktateve;

DUKE RIKUJTUAR Samitin e Zagrebit, që bëri thirrje për konsolidim të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet vendeve të Procesit të Stabilizim-Asocimit dhe Bashkimit Evropian, dhe për rritjen e bashkëpunimit rajonal;

DUKE RIKUJTUAR që Samiti i Selanikut e përforcoi Procesin e Stabilizim-Asocimit si një kuadër politikash të Bashkimit Evropian në marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe nënvizoi perspektivën e integritetit të tyre në Bashkimin Evropian në bazë të përparimit të reformave dhe meritave individuale;

DUKE RIKUJTUAR Memorandumin e Mirëkuptimit për Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë, nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001, nëpërmjet të cilit Shqipëria, së bashku me vende të tjera të rajonit, u angazhua të negociojë një rrjet Marrëveshjesh dypalëshe për Tregtinë e Lirë, me qëllim rritjen e aftësisë së rajonit për të tërhequr investime dhe të perspektivës së integritetit të tij në ekonominë globale;

DUKE RIKUJTUAR gatishmërinë e Bashkimit Evropian për ta integruar Shqipërinë sa më plotësisht të jetë e mundur në rrjedhën e përgjithshme politike dhe ekonomike të Europës, si dhe statusin e saj si kandidat i mundshëm për anëtarësimin në BE në bazë të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe plotësimin e kriteve të përcaktuara nga Këshilli Evropian në qershor të vitit

1993, që janë kusht për zbatimin me sukses të kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht për sa i përket bashkëpunimit rajonal,

BIEN DAKORD SI VIJON:

NENI 1

1. Në këtë mënyrë është vendosur një Asociim ndërmjet Komunitetit dhe Shteteve të tij Anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërisë, nga ana tjetër.

2. Synimet e këtij Asociimi janë:

- të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetin e së drejtës;
 - dhënia e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit;
 - të sigurojë një strukturë të përshtatshëm për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve;
 - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit;
 - të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë;
- të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat të trajtuara në këtë Marrëveshje.

TITULLI I PARIME TË PËRGJITHSHME

NENI 2

Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 3

Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm koncesionesh të ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

NENI 4

Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, duke përfshirë një nivel të përshtatshëm koncesionesh të

ndërsjella lidhur me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht të atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet Palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal.

NENI 5

Palët pohojnë edhe njëherë rëndësinë që i japin luftës kundër terrorizmit dhe zbatimit të detyrimeve ndërkombëtare në këtë fushë.

NENI 6

Asociimi zbatohet në mënyrë progresive dhe realizohet plotësisht gjatë një periudhe transitore deri në dhjetë vjet maksimumi, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme.

Dy fazat nuk janë të aplikueshme nën Titullin IV të kësaj Marrëveshjeje (Lëvizja e Lirë e Mallrave), për të cilin në atë Titull të Marrëveshjes përcaktohet një kalendar specifik.

Qëllimi i kësaj ndarjeje në faza të njëpasnjëshme është që të bëhet një rishikim i hollësishëm afatmesëm i zbatimit të Marrëveshjes. Në fushën e përafritimit dhe zbatimit të ligjeve, synimi është që Shqipëria të përqendrohet gjatë fazës së parë në elementët themelorë të *acquis*, me tregues specifikë, ashtu siç përshkruhet në Titullin VI të kësaj Marrëveshjeje.

Këshilli i Stabilizim-Asocimit i krijuar sipas nenit 116 do të shqyrtojë rregullisht zbatimin e Marrëveshjes dhe realizimin e reformave ligjore, administrative, institucionale dhe ekonomike nga ana e Shqipërisë, duke marrë parasysh çfarë është thënë më sipër dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të parashtruara në këtë Marrëveshje.

Faza e parë fillon me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të vlerësojë përparimin e bërë nga Shqipëria, dhe do të vendosë nëse ky përparim ka qenë i mjaftueshëm për kalimin në fazën e dytë në mënyrë që të arrijë asociimin e plotë. Ai do të vendosë gjithashtu edhe për dispozita të veçanta që konsiderohen të nevojshme për t'u zbatuar në fazën e dytë.

NENI 7

Marrëveshja duhet të përputhet plotësisht dhe zbatohet në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së, në veçanti Nenin XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS) 1994 dhe Nenin V të GATS.

TITULLI II DIALOGU POLITIK

NENI 8

1. Dialogu politik ndërmjet Palëve zhvillohet më tej brenda kontekstit të kësaj Marrëveshjeje. Ai do të shoqërojë dhe konsolidojë marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe kontribuojë në vendosjen e lidhjeve të ngushta të solidaritetit dhe formave të reja të bashkëpunimit ndërmjet Palëve.

2. Dialogu politik ka për qëllim të nxisë veçanërisht: integrimin e plotë të Shqipërisë në bashkësinë e kombeve demokratike dhe afrimin gradual me Bashkimin Evropian;

një përputhje në rritje e pozicionimeve të Palëve për çështjet ndërkombëtare, gjithashtu nëpërmjet shkëmbimit të duhur të informacionit, dhe në veçanti, lidhur me ato çështje që pritet të kenë efekte të ndjeshme mbi Palët;

– bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë; pikëpamje të përbashkëta për sigurinë dhe stabilitetin në Evropë, duke përfshirë dhe bashkëpunimin në fushat që mbulohen nga Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët e Bashkimit Evropian.

3. Palët vlerësojnë që armëve të shkatërrimit në masë (ASHM) dhe i mjeteve për shpërndarjen e tyre, në drejtim të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë, përfaqëson një nga kërcënimet më serioze për stabilitetin dhe sigurinë ndërkombëtare. Për këtë arsye palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe të mjeteve për shpërndarjen e tyre, nëpërmjet respektimit të plotë dhe zbatimit në nivel kombëtar të detyrimeve të tyre ekzistuese, detyrime këto që rrjedhin nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare për çarmatimin dhe mospërhapjen, si dhe detyrime të tjera ndërkombëtare. Palët bien dakord, që kjo dispozitë përbën një element thelbësor të kësaj Marrëveshjeje dhe do të jetë pjesë e dialogut politik që shoqëron dhe konsolidon këta elementë.

Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe kontribuojnë kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe mjeteve të shpërndarjes së tyre:

–duke ndërmarrë hapa për të nënshkruar, ratifikuar, miratuar dhe zbatuar plotësisht të gjithë instrumentet e tjera përkatëse ndërkombëtare;

–duke vendosur një sistemi efikas kontrolli të eksportit kombëtar, që kontrollon eksportin ashtu edhe transitin e mallrave që lidhen me armët e shkatërrimit në masë (ASHM), përfshi kontrollin e qëllimit përfundimtar të ASHM-ve prodhuar nga teknologji me qëllime përdorimi të dyfishta; dhe që përmban sanksione efikase për mosrespektimin e kontrollit të eksporteve.

Dialogu politik mbi këtë çështje mund të zhvillohet në nivel rajonal.

NENI 9

1. Dialogu politik zhvillohet në Këshillin e Stabilizim-Asocimit, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për çdo çështje që Palët mund të dëshirojnë ta shtrojnë përpara tij.

2. Me kërkesë të Palëve, dialogu politik mund të zhvillohet edhe në formatet e mëposhtme: takime, kur është e nevojshme, të zyrtarëve të lartë që përfaqësojnë Shqipërinë, nga njëra anë, dhe Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit, nga ana tjetër;

–shfrytëzimi i plotë i të gjithë kanaleve diplomatike ndërmjet Palëve, përfshirë kontaktet e përshtatshme në vendet e treta dhe brenda Kombeve të Bashkuara, OSBE-së, Këshillit të Europës dhe forumeve të tjera ndërkombëtare;

çdo mjet tjetër që do të jepte një kontribut të vlefshëm për konsolidimin, zhvillimin dhe thellimin e këtij dialogu.

NENI 10

Dialogu politik në nivel parlamentar zhvillohet brenda kuadrit të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit ngritur në bazë të nenit 122.

NENI 11

Dialogu politik mund të zhvillohet brenda një kuadri shumëpalësh, dhe si dialog rajonal duke përfshirë vende të tjera të rajonit.

TITULLI III BASHKËPUNIMI RAJONAL

NENI 12

Në përputhje me angazhimet e saj për paqen dhe stabilitetin ndërkombëtar e rajonal, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, Shqipëria duhet të promovojë bashkëpunimin rajonal në mënyrë aktive. Programet e asistencës të Komunitetit Evropian mund të mbështesin projekte që përmbajnë dimension rajonal ose ndërkufitar, nëpërmjet programeve të tij për asistencë teknike.

Në rastet kur Shqipëria parashikon të përforcojë bashkëpunimin e saj me njërin nga vendet e përmendura në nenet 13 deri në 15 si më poshtë, ajo do të informojë dhe do të konsultohet me Komunitetin dhe Shtetet Anëtare të tij, në përputhje me dispozitat e Titullit X, Dispozitat Institucionale, të Përgjithshme dhe Përfundimtare.

Shqipëria rishikon Marrëveshjet dypalëshe ekzistuese me të gjitha vendet përkatëse, ose përfundon marrëveshje të reja, në mënyrë që të sigurojë përputhjen e tyre me parimet e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi Lehtësimin dhe Liberalizimin e Tregtisë nënshkruar në Bruksel më 27 qershor 2001.

NENI 13

Bashkëpunimi me vende tjera që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociim

Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të nisë negociatat me vendet që tashmë kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me qëllim nënshkrimin e konventave e konventave dypalëshe mbi bashkëpunimin rajonal, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit ndërmjet vendeve në fjalë.

Elementet kryesorë të këtyre konventave jenë:

dialogu politik;

–vendosja e një zone të tregtisë së lirë ndërmjet Palëve, në përputhje me dispozitat përkatëse të OBT-së;

–koncesione të ndërsjella lidhur me lëvizjen e punonjësve, vendosjen, ofrimin e shërbimeve, pagesat rrjedhëse dhe lëvizjen e kapitalit, si dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e personave në një nivel të barabartë me atë të kësaj Marrëveshjeje;

–dispozitat për bashkëpunimin në fusha të tjera të cilat trajtohen ose jo nga kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushën e Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme.

Këto konventa do të përmbajnë dispozita për krijimin e mekanizmave të duhur institucionalë.

Shqipëria i nënshkruan këto konventa brenda dy vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Gatishmëria e Shqipërisë për të nënshkruar konventa të tilla është kusht për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Shqipëria do të nisë negociatat të ngjashme me vendet e tjera të rajonit, pasi këto vende të kenë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi.

NENI 14

Bashkëpunimi me vendet e tjera që marrin pjesë në procesin e stabilizim-asocimit Shqipëria ndjek bashkëpunimin rajonal me vendet e tjera, që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asocimit, në disa ose të gjitha fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje, dhe veçanërisht në fushat me interes të përbashkët. Një bashkëpunim i tillë duhet të jetë gjithmonë në përputhje me parimet dhe objektivat e kësaj Marrëveshje.

NENI 15

Bashkëpunimi me vendet candidate për aderim në BE

1. Shqipëria mund të nxisë bashkëpunimin dhe të përfundojë një konventë për bashkëpunimin rajonal me cilindo vend kandidat për aderim në BE, në cilëndo nga fushat e bashkëpunimit që mbulon kjo Marrëveshje. Një konventë e tillë ka për synim futjen graduale të marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe këtij vendi drejt një linje të përbashkët me marrëdhëniet që ka ai vend në këtë fushë me Komunitetin Evropian dhe Shtetet Anëtare.

2. Shqipëria do të fillojë negociatat me Turqinë me synimin për të përfunduar, bazuar në avantazhe reciproke, një marrëveshje që vendos një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet të dy palëve në përputhje me Nenin XXIV të GATT (Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë), si dhe për të liberalizuar vendosjen dhe ofrimin e shërbimeve ndërmjet tyre në një nivel të barabartë me këtë marrëveshje në përputhje me Nenin V të GATS.

Këto negociata duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, me synimin për të përfunduar marrëveshjen e sipërpërmendur përpara fundit të periudhës transitore të përmendur në nenin 16(1).

TITULLI IV

LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

NENI 16

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me dispozitat e GATT 1994 dhe të OBT. Duke bërë këtë, ato marrin parasysh kërkesat specifike të parashtruara më poshtë.

2. Nomenklatura e Kombinuar e mallrave do të zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet të dyja Palëve.

3. Për çdo produkt, tarifa bazë mbi të cilin zbatohen reduktimet pasuese të vendosura në këtë Marrëveshje, është tarifa që faktikisht zbatohet erga omnes ditën para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

4. Tarifat e reduktuara që zbatohen nga Shqipëria, të llogaritura ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshje, rumbullakosen në numra të plotë duke përdorur parime aritmetike të zakonshme. Si rrjedhojë, të gjithë numrat që kanë 50 ose më pak pas presjes dhjetore, rumbullakosen në zbritje drejt numrit të plotë më të afërt, dhe të gjitha numrat që kanë më shumë se 50 pas presjes dhjetore, rumbullakosen në ngjitje të numrit të plotë më të afërt.

5. Nëse, pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, zbatohet ndonjë reduktim tatimor mbi bazën erga omnes, në veçanti reduktimet që rrjedhin prej negociatave për tarifat në OBT, tarifa të tilla të reduktuara zëvendësojnë tarifën bazë të përmendur në paragrafin 3, që nga data kur zbatohen reduktimet të tilla.

6. Komuniteti dhe Shqipëria do t'i komunikojnë njëri-tjetrit tarifat bazë përkatëse të tyre.

KAPITULLI I PRODUKTET INDUSTRIALE

NENI 17

1. Dispozitat e këtij Kapitulli janë të aplikueshme për produktet që e kanë origjinën në Komunitet ose Shqipëri, të renditura në Kapitujt 25 deri 97 të Nomenklaturës së Kombinuar, me përjashtim të produkteve të renditura në Shtojcën I. § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT 1994).
2. Tregtia ndërmjet Palëve të produkteve të përcaktuara nga Traktati themelues i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike do të zhvillohet në përputhje me dispozitat e atij Traktati.

NENI 18

1. Detyrimet doganore për importet drejt Komunitetit të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Kufizimet sasiore për importet drejt Komunitetit, dhe masat me efekt të njëjtë me to për produktet që e kanë origjinën në Shqipëri, shfuqizohen në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 19

1. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, përveç atyre të renditura në Shtojcën I, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Detyrimet doganore për importet drejt Shqipërisë të mallrave që e kanë origjinën në Komunitet, të cilat janë renditur në Shtojcën I, reduktohen në mënyrë progresive në përputhje me kalendarin e mëposhtëm:
 - në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 80% të detyrimit bazë;
 - më 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 60% të detyrimit bazë;
 - në 1 janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 40% të detyrimit bazë;
 - në 1 janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 20% të detyrimit bazë;
 - në 1 janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimi i importit reduktohet në masën 10% të detyrimit bazë;
 - në 1 janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, detyrimet e mbetura për importin shfuqizohen.
3. Kufizimet sasiore për importet drejt Shqipërisë së mallrave që e kanë origjinën në Komunitet dhe masat me efekt të barabartë me to, shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 20

Komuniteti dhe Shqipëria, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo detyrim që ka efekt të barabartë me detyrimet doganore për importet.

NENI 21

1. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë tarifatat doganore për eksportet dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to.
2. Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti dhe Shqipëria shfuqizojnë ndërmjet tyre të gjitha kufizimet sasiore për eksportet, dhe masat me efekt të njëjtë me to.

NENI 22

Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të reduktuar tarifatat doganore në tregtinë me Komunitetin më shpejt se sa parashikohet në nenin 19, në rast se situata ekonomike e përgjithshme e saj dhe situata e sektorit ekonomik në fjalë e lejojnë këtë. Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të analizojë situatën në këtë aspekt dhe do të japë rekomandimet e nevojshme.

NENI 23

Protokolli 1 parashtron rregullimet e zbatueshme për produktet e hekurit dhe çelikut të Kapitujve 72 dhe 73 të Nomenklaturës së Kombinuar.

KAPITULLI II BUJQËSIA DHE PESHKIMI

NENI 24 Përkufizim

1. Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e produkteve bujqësore dhe të peshkimit, që e kanë origjinën në Komunitet ose në Shqipëri.
2. Termi "produkte bujqësore dhe të peshkimit" u referohet produkteve të renditura në Kapitujt 1 deri 24 të Nomenklaturës së Kombinuar, si dhe produkteve të renditura në Shtojcën I, § I, (ii) të Marrëveshjes për bujqësinë (GATT, 1994)
3. Ky përkufizim përfshin peshkun dhe produktet e peshkimit të mbuluara nga kapitulli 3, titujt 1604 dhe 1605, dhe nëntitujt 0511 91, 2301 20 00 dhe 1902 20 10

NENI 25

Protokolli 2 parashtron rregullimet për tregtinë e produkteve bujqësore të përpunuara, që renditen aty.

NENI 26

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje, Komuniteti shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Shqipëri.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria shfuqizon të gjitha kufizimet sasiore, dhe masat me efekt të njëjtë me to, për importet e produkteve bujqësore dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitet.

NENI 27 Produktet bujqësore

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti shfuqizon detyrimet doganore dhe tarifatat me efekt të njëjtë me to për importet e produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Shqipëri, përveç atyre të titujve nr. 0102, 0201, 0202, 1701, 1702 dhe 2204 të Nomenklaturës së Kombinuara.
Për produktet e trajtuara në Kapitujt 7 dhe 8 të Nomenklaturës së Kombinuara, për të cilat Tarifa Doganore e Përbashkët parashikon zbatimin e tarifave doganore ad valorem dhe një tarifë doganore specifike, eliminimi zbatohet vetëm ndaj pjesës ad valorem të tarifës.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti zbaton hyrjen pa barra doganore për importet në Komunitet të produkteve që e kanë origjinën në Shqipëri të përfshira në titujt 1701 dhe 1702 të Nomenklaturës së Kombinuara, brenda kufirit të një kuote tarifore vjetore prej 1000 tonësh.
3. On Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria:
 - (a)shfuqizon detyrimet doganore të aplikueshme për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (a);
 - (b)redukon në mënyrë progresive detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (b) në përputhje me kalendarin e treguar për çdo produkt në atë Shtojcë;
 - (c)shfuqizon detyrimet doganore për importet e disa produkteve bujqësore që e kanë origjinën në Komunitet, të renditura në Shtojcën II (c) brenda kufirit të kuotës tarifore të paraqitur për produktet në fjalë.
4. Protokollin 3 parashtron rregullimet që zbatohen për verërat dhe pijet alkoolike të përmendura aty.

NENI 28 Produktet e peshkimit

1. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komuniteti heq të gjitha detyrimet doganore për importet e produkteve të peshkut dhe të peshkimit, përveç atyre të renditura në Shtojcën III që e kanë origjinën në Shqipëri. Produktet e renditura në Shtojcën III rregullohen nga dispozitat e paraqitura aty.
2. Që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria nuk zbaton asnjë detyrim importi ose tarifa me efekt të njëjtë me to, për produktet e peshkut dhe të peshkimit që e kanë origjinën në Komunitetin Evropian.

NENI 29

Duke marrë parasysh volumin e tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit ndërmjet Palëve, ndjeshmëri të veçanta të tyre, rregullat e politikave të përbashkëta të Komunitetit dhe politikave të Shqipërisë për bujqësinë dhe peshkimin, rolin e bujqësisë dhe peshkimit në ekonominë e Shqipërisë, si dhe pasojat e negociatave shumëpalëshe për tregtinë në kuadër të OBT-së, Komuniteti dhe Shqipëria do të shqyrtojnë në Këshillin e Stabilizim-Asocimit, jo më vonë se gjashtë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, produktet një nga një dhe mbi një bazë të ndërsjellë të rregullt dhe të përshtatshme, shqyrton gjithashtu mundësitë për t'i bërë koncesione të mëtejshme njëri-tjetrit me synim zbatimin e një liberalizimi më të madh të tregtisë së produkteve bujqësore dhe të peshkimit.

NENI 30

Dispozitat e këtij Kapitulli nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në aplikimin, mbi baza individuale, të masave më favorizuese të bëra prej njëres apo tjetres Palë.

NENI 31

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti nenet 38 dhe 43, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë dhe peshkimit, në rast se importet e produkteve që e kanë origjinën në njërin nga të dyja Palët, të cilat u nënshtrohen koncesioneve të dhëna sipas neneve 25, 27 dhe 28, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullatorë të brendshëm në Palën tjetër, të dyja Palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Në pritje të kësaj zgjidhjeje, Pala përkatëse mund të marrë masat që ajo i konsideron si të nevojshme.

KAPITULLI III DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

NENI 32

Dispozitat e këtij Kapitulli zbatohen për tregtinë e të gjitha produkteve ndërmjet Palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe këtu ose në Protokollin 1, 2 dhe 3.

NENI 33 Pezullimi

1. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe nuk rriten ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.
2. Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen kufizime sasiore të reja për importet ose eksportet, apo masa të reja me efekt të njëjtë me to, dhe as nuk bëhen kufizime të mëtejshme mbi ato ekzistuese në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

3. Pa cenuar koncesionet e bëra ë bazë të nenit 26, dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk kufizojnë në asnjë lloj mënyre ushtrimin e politikave bujqësore përkatëse të Shqipërisë dhe Komunitetit, ose marrjen e masave në kuadër të atyre politikave, për sa kohë që këto veprime nuk ndikojnë në regjimin e importeve në Shtojcat II dhe III.

NENI 34

Ndalimi i diskriminimit fiskal

1. Palët shmangin marrjen e masave ose shfuqizojnë praktikën me natyrë fiskale të brendshme, ose ato ekzistuese që shkaktojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi diskriminim ndërmjet produkteve të njëjës Palë, dhe produkteve të ngjashme që e kanë origjinën në territorin e Palës tjetër.
2. Produktet e eksportuara në territorin e njëjës nga Palët nuk mund të përfitojnë nga rimbursimi për tatimin e tërthortë të brendshëm që kalon shumën e tatimit të tërthortë të vendosur mbi to.

NENI 35

Dispozitat lidhur me shfuqizimin e tarifave doganore për importet zbatohen gjithashtu edhe për tarifatat doganore me natyrë fiskale.

NENI 36

Bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë, rregullimet ndërkufitare

1. Kjo Marrëveshje nuk pengon mbajtjen apo krijimin e bashkimeve doganore, zonave të tregtisë së lirë apo rregullimet për tregtinë kufitare, përveçse në rastet kur ato ndryshojnë rregullimet tregtare të parashikuara nga kjo Marrëveshje.
2. Gjatë periudhave transitorë të përcaktuara në nenin 19, kjo Marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e rregullimeve privilegjuese specifike që rregullojnë lëvizjen e mallrave, qoftë të parashtruara në marrëveshjet kufitare të përfunduara më parë ndërmjet një ose më shumë Shtetesh Anëtare dhe Shqipërisë, ose që kanë rrjedhur prej marrëveshjeve dypalëshe të përcaktuara në Titullin III, të përfunduara nga Shqipëria për të promovuar tregtinë rajonale.
3. Konsultimet ndërmjet Palëve zhvillohen në Këshillin e Stabilizim-Asocimit lidhur me marrëveshjet që përshkruhen në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dhe, sipas kërkesës, për çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me politikën e tyre përkatëse të tregtisë me vendet e treta. Veçanërisht në rastin e një vendi të tretë aderues në Komunitet, konsultime të tilla do të zhvillohen në mënyrë që të garantohet marrja parasysh e interesave të ndërsjella të Komunitetit dhe Shqipërisë të parashtruara në këtë Marrëveshje.

NENI 37

Dumpingu dhe Subvencionimi

1. Asnjëra nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk i pengon palët që të ndërmarrin veprime për mbrojtjen e tregtisë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni dhe nenit 38.
2. Nëse njëra nga Palët zbulon se në tregtinë me Palën tjetër po ndodh dumpingu dhe/ose subvencionim kundërvepruese, kjo palë mund të ndërmarrë masat e duhura ndaj kësaj praktike në përputhje me Marrëveshjen e OBT-së për Zbatimin e Nenit VI të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifatat dhe Tregtinë 1994 dhe Marrëveshjen e OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese dhe legjislacionin e saj të brendshëm lidhur me të.

NENI 38

Klauzola të përgjithshme për masat mbrojtëse

1. Dispozitat e Nenit XIX GATT 1994 dhe Marrëveshja e OBT-së për Masat Mbrojtëse zbatohen ndërmjet palëve.

2. Kur cilido produkt i njërës Palë që importohet në territorin e Palës tjetër në sasi të tilla dhe në kushte të tilla që shkaktojnë ose mund të shkaktojnë:

dëme serioze ndaj industrisë vendase të produkteve të ngjashme ose që janë drejtpërsëdrejti konkurruese, në territorin e Palës importuese; ose

–çrregullime serioze në cilindo sektor të ekonomisë apo vështirësi që mund të sjellin përkeqësim serioz të situatës ekonomike në një rajon të Palës importuese,

Pala importuese mund të marrë masat e përshtatshme sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat e parashtruara në këtë nen.

3. Masat mbrojtëse dypalëshe kundrejt importeve të Palës tjetër nuk duhet të kapërcejnë nivelin e nevojshëm për riparimin e vështirësive që kanë lindur, dhe normalisht duhet të konsistojë në pezullimin e reduktimit të mëtejshëm të çdo norme tarifore të aplikueshëm të parashikuar në këtë Marrëveshje për produktin përkatës, ose në rritjen e normës tarifore për atë produkt deri në një kufi maksimal që i korrespondon normës tarifore të statusit të Kombit Më Të Favorizuar (MFN) të aplikueshëm për të njëjtin produkt. Masa të tilla përmbajnë elementë të qartë që sjellin në mënyrë progresive eliminimin e tyre në fund të periudhës së vendosur si afat përfundimtar, dhe nuk merren për një periudhë më të gjatë se një vit. Në rrethana shumë të jashtëzakonshme mund të merren masa maksimumi për një periudhë deri në tre vjet. Asnjë masë mbrojtëse dypalëshe nuk zbatohet për importin e një produkti që më parë i është nënshtruar një mase të tillë, për një periudhë të paktën prej tre vjetësh që nga skadimi i masës.

4. Në rastet e përcaktuara në këtë nen, përpara marrjes së masave të parashikuara në të, ose në rastet kur aplikohet paragrafi 5 (b) i këtij neni, sapo të jetë e mundur, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, i japin Këshillit të Stabilizim-Asocimit të gjithë informacionin e përshtatshëm për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme nga të dy Palët.

5. Për zbatimin e paragrafëve të mësipërm aplikohen dispozitat e mëposhtme:

(a) Vështirësitë që lindin nga situata e përmendur në këtë nen i kalohen për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asocimit, i cili mund të marrë çfarëdolloj vendimi të nevojshëm për t'i dhënë fund këtyre vështirësive.

Në rast se Këshilli i Stabilizim-Asocimit ose Pala eksportuese, brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar për shqyrtim Këshillit të Stabilizim-Asocimit, nuk ka marrë një vendim për t'i dhënë fund këtyre vështirësive, ose kur nuk është arritur ndonjë zgjidhje tjetër e kënaqshme, Pala importuese mund të miratojë masat e duhura për të zgjidhur problemin në përputhje me këtë nen. Në përzgjedhjen e masave mbrojtëse u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negative në funksionimin e rregullimeve të vendosura në këtë Marrëveshje. Masat mbrojtëse të zbatuara në përputhje me Nenin XIX GATT dhe Marrëveshjen e OBT-së për Masat Mbrojtëse ruajnë nivelin/hapësirën e preferencave të ofruara nga kjo Marrëveshje.

(b) Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informacionin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Pala përkatëse, në situatat e përcaktuara në këtë nen, mund të aplikojë menjëherë masa të përkohshme të nevojshme për të trajtuar situatën dhe informon njëherësh Palën tjetër për këtë.

Masat mbrojtëse i njoftohen menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asocimit dhe do ti nënshtrohen konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti me synimin për të përcaktuar një kalendar veprimesh për anulimin e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

6. Në rast se Komuniteti ose Shqipëria ia nënshton importet e produkteve që rrezikojnë të shkaktojnë vështirësitë e përmendura në këtë nen, një procedure administrative që ka për qëllim sigurimin e shpejtë të informacionit për tendencën e rrjedhave tregtare, informon Palën tjetër.

NENI 39

Klauzola e pamjaftueshmërisë

1. Kur pajtueshmëria me dispozitat e këtij Titulli sjell:

(a)një pamjaftueshmëri serioze, ose një rrezik për pamjaftueshmëri, artikujve ushqimorë ose produkteve të tjerë thelbësorë për Palën eksportuese; ose

(b)rieksportimin në një vend të tretë të një produkti ndaj të cilit Pala eksportuese ruan kufizime sasiore për eksportin, tarifa, ose masa për eksportin që kanë efekt të njëjtë, dhe kur situatat e përmendura më sipër shkaktojnë, ose mund të shkaktojnë vështirësi të mëdha për Palën eksportuese, kjo Palë mund të marrë masat e duhura në përputhje me kushtet dhe me procedurat e vendosura në këtë nen.

2. Në përzgjedhjen e masave u duhet dhënë përparësi atyre që ndikojnë më pak negativisht në funksionimin e rregullimeve të kësaj Marrëveshjeje. Këto masa nuk zbatohen në mënyrë të atillë që të përbëjnë diskriminim arbitrar e të pajustificueshëm, kur mbizotërojnë të njëjtat kushte, ose një kufizim i tërthortë për tregtinë dhe eliminohen kur kushtet nuk e justifikojnë më mbajtjen e tyre.

3. Përpara marrjes së masave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni ose, sapo të jetë e mundur, në rastet kur zbatohet paragrafi 4 i këtij neni, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, do t'i japin Këshillit të Stabilizim-Asocimit të gjithë informacionin përkatës, me qëllim për të kërkuar një zgjidhje të pranueshme për Palët. Palët brenda Këshillit të Stabilizim-Asocimit, mund të bien dakord për mjetet e nevojshme për t'i dhënë fund vështirësive. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda tridhjetë ditëve pasi çështja i është kaluar Këshillit të Stabilizim-Asocimit, Pala eksportuese mund të zbatojë masat e përmendura në këtë nen për eksportimin e produktit përkatës.

4. Kur rrethanat e jashtëzakonshme dhe shumë serioze që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë të pamundur informimin ose shqyrtimin paraprak, sipas rastit, Komuniteti ose Shqipëria cilado qoftë e interesuar, mund të zbatojnë sa më parë masa parandaluese të nevojshme për të trajtuar situatën dhe të informojnë Palën tjetër menjëherë për këtë.

5. Çdo masë e zbatuar sipas këtij neni i njoftohet menjëherë Këshillit të Stabilizim-Asocimit dhe i nënshtrohet konsultimeve periodike brenda këtij organi, në veçanti për të përcaktuar një kalendar veprimesh për eliminim e tyre sapo ta lejojnë rrethanat.

NENI 40

Monopolet shtetërore

Shqipëria do të përshtatë në mënyrë progresive të gjitha monopolet shtetërore me karakter tregtar për tu siguruar, që nga fundi i vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të mos ekzistojnë diskriminime ndërmjet qytetarëve të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë lidhur me kushtet sipas të cilave sigurohen dhe tregtohen mallrat. Këshilli i Stabilizim-Asocimit informohet për masat e miratuara për arritjen e këtij objektivi.

NENI 41

Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Marrëveshjeje, Protokollin 4 parashtron rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 42 Kufizimet e autorizuara

Kjo Marrëveshje nuk përjashton ndalimet apo kufizimet e importeve, eksporteve ose mallrave transit të justifikuar në bazë të moralit publik, politikave publike, ose sigurisë publike; mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve; mbrojtjes së thesareve kombëtare me vlerë artistike, historike ose arkeologjike, ose mbrojtjes së pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare, ose të rregullave lidhur me arin dhe argjendin. Megjithatë, ndalime ose kufizime të tilla nuk përbëjnë diskriminim arbitrar ose kufizim të tërthortë në tregtinë ndërmjet Palëve.

NENI 43

1. Palët bien dakord që bashkëpunimi administrativ është i domosdoshëm për zbatimin dhe kontrollin e trajtimit të privilegjuar të dhënë sipas këtij Titulli dhe nënvizojnë angazhimin e tyre për të luftuar parregullsitë dhe mashtrimin në dogana dhe çështje që lidhen me to.

2. Kur njëra Palë, në bazë të informacionit objektiv, ka konstatuar mungesën e bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsi apo mashtrim sipas këtij Titulli, Pala e prekur mund të pezullojë përkohësisht trajtimin privilegjuar të produktit/produkteve përkatës në përputhje me këtë nen.

3. Për qëllimet e këtij neni, mungesa e bashkëpunimit administrativ do të thotë, përveç të tjerash:

(a) mosrespektimi i përsëritur i detyrimeve për të verifikuar statusin e origjinës së produktit/produkteve përkatës;

(b) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme për të kryer dhe/ose komunikuar rezultatet e një verifikimi pasues për vërtetësinë e origjinës;

(c) refuzim i përsëritur ose vonesa të panevojshme në marrjen e autorizimit për kryerjen e misionëve të bashkëpunimit administrativ për të verifikuar vërtetësinë e dokumenteve ose saktësinë e informacionit të nevojshëm për dhënien e trajtimit preferencial në fjalë.

Për qëllimet e këtij neni, konstatimi i parregullsive ose mashtrimit mund të bëhet, përveç të tjerash, kur ka një rritje të shpejtë, pa shpjegime të kënaqshme, të importeve të mallrave, që tejkalon nivelin e zakonshëm të prodhimit dhe kapacitetin eksportues të Palës tjetër, dhe që lidhet me informacionet objektive që kanë të bëjnë me parregullsitë ose mashtrimet.

4. Zbatimi i pezullimit të përkohshëm u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

(a) Pala që ka bërë një konstatim, mbi bazën e informacionit objektiv, të mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose parregullsive ose mashtrimit, njofton, pa vonesa të panevojshme, Komitetin e Stabilizim-Asocimit për konstatimin e saj së bashku me informacionin objektiv dhe fillon konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asocimit, në bazë të gjithë informacioneve përkatëse dhe konstatimeve objektive, me synim arritjen e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja Palët.

(b) Në rast se Palët kanë filluar konsultimet pranë Komitetit të Stabilizim-Asocimit si më sipër dhe kanë dështuar të bien dakord për një zgjidhje të pranueshme brenda tri muajsh pas njoftimit, Pala e interesuar mund të pezullojë përkohësisht trajtimin preferencial përkatës të produktit/produkteve përkatëse. Pezullimi i përkohshëm do të njoftohet Komitetit të Stabilizim-Asocimit pa vonesa të tepruara.

(c)Pezullimet e përkohshme në bazë të këtij neni kufizohen deri në atë që masë është e nevojshme për të mbrojtur interesat financiare të Palës së interesuar. Ato nuk zgjasin për më shumë se gjashtë muaj, periudhë e cila mund të rinovohet. Pezullimet e përkohshme i njoftohen Komitetit të Stabilizim-Asocimit menjëherë pas miratimit të tyre. Ato u nënshtrohen konsultimeve periodike pranë Komitetit të Stabilizim-Asocimit, veçanërisht me synimin për t'i përfunduar ato sapo të mos ketë më kushte për zbatimin e këtyre pezullimeve.

5. Njëkohësisht me njoftimin e Komitetit të Stabilizim-Asocimit sipas paragrafit 4a) të këtij neni, Pala e interesuar duhet të publikojë një njoftim për importuesit në Fletoren e saj Zyrtare. Njoftimi për importuesit duhet të tregojë se në bazë të informacionit objektiv, për produktin përkatës është bërë një konstatim i mungesës së bashkëpunimit administrativ dhe/ose i parregullsive ose mashtrimeve.

NENI 44

Në rast gabimi të bërë nga autoritetet kompetente gjatë menaxhimit të duhur të sistemit privilegjuës të eksportit dhe në veçanti gjatë zbatimit të dispozitave të protokollit të kësaj marrëveshjeje në lidhje me përkufizimin e origjinës së produkteve dhe metodave të bashkëpunimit administrativ, kur ky gabim çon në pasoja lidhur me tarifatat e importit, pala kontraktuese që përballet me këto pasoja mund t'i kërkojë Këshillit të Stabilizim-Asocimit shqyrtimin e mundësive për miratimin e të gjitha masave të duhura që synojnë zgjidhjen e situatës.

NENI 45

Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje bëhet pa cenuar aplikimin e dispozitave të së drejtës Komunitare për Ishujt Kanarie.

TITULLI V LËVIZJA E PUNONJESVE, NDËRMARRJE, OFRIMI I SHËRBIMEVE, KAPITALI KAPITULLI I LËVIZJA E PUNONJËSVE

NENI 46

1. Në përputhje me kushtet dhe modalitetet e zbatueshme në çdo Shtet Anëtar:
 - trajtimi i akorduar punonjësve që janë shtetas shqiptarë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar nuk përmban asnjë formë diskriminimi bazuar në kombësi, për sa u përket kushteve të punës, shpërblimit apo shkarkimit nga puna, krahasuar këto me shtetasit e tij;
 - bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët rezidentë të ligjshëm të një punonjësi të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar, me përjashtim të punonjësve sezonalë dhe të punonjësve që i nënshtrohen marrëveshjet dypalëshe nën përcaktimin e nenit 47, në rast se nuk parashikohet ndryshe nga marrëveshjet e tilla, gëzojnë akses në tregun e punës së Shtetit Anëtar përkatës, gjatë periudhës së qëndrimit të autorizuar për punësim të punonjësit.
2. Shqipëria, në përputhje me kushtet dhe modalitetet në atë vend, u akordon të njëjtin trajtim siç përcaktohet në paragrafin 1 punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe janë

ligjërisht të punësuar në territorin e saj, ashtu si edhe bashkëshortit/bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre që janë rezidentë të ligjshëm në atë vend.

NENI 47

1. Duke marrë parasysh situatën e tregun e punës në Shtetet Anëtare, në varësi të legjislacionit të tyre dhe në pajtueshmëri me rregullat në fuqi në Shtetet Anëtare në fushën e lëvizjes së punonjësve:

lehtësirat ekzistuese të aksesave për punësim për shtetasit shqiptarë të akorduara nga Shtetet Anëtare, me anë të marrëveshjeve dypalëshe, duhet të ruhen dhe nëse është e mundur të përmirësohen;

–Shtetet e tjera Anëtare shikojnë mundësitë e realizimit të marrëveshjeve të tilla të ngjashme.

2. Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të shikojë mundësinë për përmirësime të tjera, duke përfshirë lehtësira për akses në trajnimet profesionale, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi në Shtetet Anëtare, dhe duke marrë parasysh situatën në tregun e punës në Shtetet Anëtare dhe në Komunitet.

NENI 48

1. Do të vendosen rregulla për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty. Për këtë qëllim, një vendim i Këshillit të Stabilizim-Asocimit, i cili nuk duhet të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje dypalëshe ku këto të fundit parashikojnë një trajtim më të favorshëm, do të vendosin dispozitat e mëposhtme:

–të gjitha periudhat e sigurimeve, punësimit apo qëndrimit të përfunduara nga punonjës të tillë në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të mblidhen bashkë për qëllimin e dhënies së pensioneve dhe pagave vjetore në lidhje me pleqërinë, paaftësinë fizike dhe vdekjen dhe për qëllim përkujdesjeje shëndetësore për këtë kategori punonjësish dhe familjarët e tyre;

–pensionet ose pagesat vjetore në lidhje me pleqërinë, vdekjen, aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale, ose invaliditeti që shkaktohet nga puna, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuuese, transferohen pa pengesë në masën e aplikuar sipas legjislacionit të Shtetit ose Shteteve Anëtare debitor;

–punonjësit në fjalë marrin asistencë financiare për pjesëtarët e familjeve të tyre siç përcaktohet më sipër;

2. Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërisht të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1.

KAPITULLI II

NDËRMARRJE

NENI 49

Për qëllimet e kësaj Marrëveshje:

(a)"Shoqëri Komunitare" ose "shoqëri shqiptare" nënkupton përkatësisht një shoqëri të themeluar në bazë të legjislacionit, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, dhe që ka zyrat e saj ose administratën qendrore apo vendin parësor të biznesit të regjistruara përkatësisht në territorin e Komunitet ose të Shqipërisë.

Megjithatë, në rast se shoqëria, e krijuar në përputhje me legjislacionin, përkatësisht të një Shteti Anëtar ose të Shqipërisë, ka vetëm zyrat e saja të regjistruara në përkatësisht në territorin e Komunitetit ose të Shqipërisë, atëherë shoqëria konsiderohet si një shoqëri përkatësisht Komunitare ose shqiptare, n.q.s veprimtaritë e saj vendosin një lidhje të vazhdueshme dhe të vërteta me ekonominë përkatësisht të një prej Shteteve Anëtare ose të Shqipërisë.

(b)"Filial" të një shoqërie nënkupton një shoqëri e cila kontrollohet efektivisht nga kompania e parë.

(c)"Degë" e një shoqërie nënkupton një vend biznesi i cili nuk gëzon personalitet juridik dhe që ka pamjen e vazhdimësisë, si një shtrirje të shoqërisë mëmë, që ka një menaxhim dhe është e pajisur materialisht për të negociuar çështje biznesi me Palët e treta, kështu që këto të fundit, ndonëse janë në dijeni se në rast nevojë do të ekzistojë një lidhje juridike me organin mëmë, zyra qendrore e së cilës ndodhet jashtë vendit, nuk janë të detyruara të bashkëpunojnë direkt me një organ të tillë mëmë, por mund të përfundojnë veprimtaritë e biznesit në vendin e biznesit që përbën shtrirjen e shoqërisë mëmë.

(d)"Ndërmarrje" nënkupton:

(i)për sa u përket shtetasve, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar dhe për të krijuar sipërmarrje, veçanërisht shoqëri, të cilat faktikisht kontrollohen prej tyre. Vetë-punësimi dhe sipërmarrjet tregtare nga shtetasit nuk shtrihen në kërkimin apo pranimin e punësimit në tregun e punës ose të akordojnë të drejtën e aksesit në tregun e punës të një pale tjetër. Dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen mbi personat të cilët nuk janë ekskluzivisht të vetë-punësuar;

(ii)për sa u përket shoqërive Komunitare dhe shqiptare, të drejtën për të ndjekur veprimtari ekonomike nëpërmjet ngritjes së filialeve dhe degëve përkatësisht në Shqipëri ose Komunitet.

(e) "Veprimtari" nënkupton ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

(f)"Veprimtari ekonomike" në parim përfshin veprimtaritë me një karakter industrial, tregtar dhe profesional, si dhe veprimtaritë artizanale.

(g)"Shtetas Komunitar" dhe "shtetas shqiptar" nënkuptojnë përkatësisht një person fizik i cili është shtetas i një prej Shteteve Anëtare ose i Shqipërisë.

(h)Për sa i përket transportit detar ndërkombëtar, duke përfshirë veprime intermodale që përfshijnë një transport transit me anë të detit,, shtetasit e Shtetit Anëtar ose të Shqipërisë të vendosur jashtë Komunitetit ose Shqipërisë përkatësisht, ashtu si dhe kompanitë detare të vendosura jashtë Komunitetit ose Shqipërisë dhe të kontrolluara nga shtetas të një Shteti Anëtar apo shtetas të Shqipërisë respektivisht, jenë gjithashtu përfitues të dispozitave të këtij Kapitulli dhe të Kapitullit III, në qoftë se mjetet e tyre të lundrimit janë regjistruar në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri përkatësisht, në përputhje me legjislacionet e tyre përkatës.

(i)"Shërbime financiare" nënkuptojnë ato veprimtari të përshkruara në Shtojcën IV. Këshilli i Stabilizim-Asocimit mund të zgjerojë ose ndryshojë fushën e zbatimit të kësaj Shtojce.

NENI 50

1. Shqipëria lehtëson në ngritjen e veprimtarive, nga shoqëri dhe shtetas Komunitarë, në territorin e saj. Për këtë qëllim, ajo garanton me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

(i)për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar shoqërive të saj ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë, dhe;

(ii)për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive Komunitare në Shqipëri, pas vendosjes së tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar degëve dhe shoqërive të saj ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, cilido qoftë më i mirë.

2. Palët nuk miratojnë asnjë rregull apo masa të reja të cilat sjellin diskriminim për sa i përket ndërmarrjeve të shoqërive Komunitare ose shqiptare në territorin e tyre ose në lidhje me veprimtaritë e këtyre shoqërive, pas vendosjes, në krahasim me shoqëritë e tyre.

3. Komuniteti dhe vendet e tij Anëtare garantojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje:

(i)për sa i përket vendosjes së shoqërive shqiptare, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare shoqërive të tyre ose shoqërive të një vendi të tretë, cilido të jetë më i mirë; dhe etter;

(ii)për sa u përket veprimtarive të filialeve dhe degëve të shoqërive shqiptare, të vendosura në territorin e tyre, trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Shtetet Anëtare degëve dhe shoqërive të tyre ose të një filiali dhe dege të një shoqërie të një vendi të tretë, të vendosura në territorin e tyre, cilido të jetë më i mirë.

4. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asocimit vendos modalitetet për shtrirjen e dispozitave të mësipërme në lidhje me ndërmarrjet e shtetasve të të

dyja Palëve të kësaj Marrëveshjeje për të filluar veprimtari ekonomike si persona të vetë-punësuar.

5. Pavarësisht nga parashikimet e këtij Neni:

(a) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje gëzojnë të drejtën për të përdorur dhe marrë me qira pasuri të patundshme në Shqipëri;

(b) Filialet dhe degët e shoqërive Komunitare gëzojnë gjithashtu të drejtën për të fituar dhe gëzuar të drejta pronësie mbi pasuritë e patundshme ashtu si shoqëritë shqiptare, si edhe për sa u përket të mirave publike me interes të përbashkët, aty kur këto të drejta konsiderohen të nevojshme për kryerjen e veprimtarive ekonomike për të cilat ato janë themeluar, duke përfshirë burimet natyrore, tokat bujqësore, pyjet, toka pyjore. Shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të vendosë modalitetet për shtrirjen e të drejtave sipas këtij paragrafi dhe në sektorët e përfshiruar.

NENI 51

1. Në përputhje me dispozitat e nenit 50, me përjashtim të shërbimeve financiare të përshkruara në Shtojcën IV, secila Palë mund të rregullojë ngritjen dhe veprimtarinë e kompanive dhe shtetasve në territorin e saj, për sa kohë që këto rregulla nuk krijojnë diskriminim për shoqëritë dhe shtetasit e Palës tjetër në krahasim me shtetasit dhe shoqëritë e saj.

2. Për sa u përket shërbimeve financiare, pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, njëra Palë nuk ndalohet që të marrë masa për arsye kujdesi paraprak, përfshirë mbrojtjen e investitorëve, depozituesve, personave të siguruar ose personave të cilët kanë detyrime financiare për të shlyer tek një ofrues i shërbimeve financiare, ose për të siguruar integritetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Masa të tilla nuk përdoren si një mënyrë për të shmangur detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Në këtë Marrëveshje asgjë nuk interpretohet në mënyrë të atillë që të detyrojë një Palë për të bërë publike informacione lidhur me punët dhe llogaritë e klientëve të veçantë ose informacione konfidenciale që disponojnë entet publike.

NENI 52

1. Pa cenuar Marrëveshjen Shumëpalëshe për Vendosjen e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit dispozitat e këtij Kapitulli nuk zbatohen për shërbimet e transportit ajror, shërbimet e transportit në ujërat e brendshme dhe shërbimet detare të kabotazhit.

2. Këshilli i Stabilizim-Asocimit mund të bëjë rekomandime për përmirësimin e ndërmarrjeve dhe veprimtarive në zonat e trajtuara nga paragrafi 1.

NENI 53

1. Dispozitat e nenit 50 dhe 51 nuk përjashtojnë zbatimin nga një Palë të rregullave të veçanta lidhur me vendosjen dhe veprimtarinë në territorin e saj të degëve të kompanive të një Pale tjetër jo të krijuara në territorin e Palës së parë, të cilat justifikohen me dallime legjislative ose teknike ndërmjet këtyre degëve krahasuar këto me degët e shoqërive të vendosura në territorin e saj ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

2. Trajtimi i diferencuar nuk kalon përtej masës që shihet e nevojshme si rrjedhojë e këtyre dallimeve legislative dhe teknike, ose për sa u përket shërbimeve financiare, për arsye kujdesi paraprak.

NENI 54

Në mënyrë që të lehtësojë shtetasit e Komunitetit dhe shtetasit shqiptarë për të filluar dhe ndjekur veprimtari profesionale të përshtatshme përkatësisht në Shqipëri dhe në vendet e Komunitetit, Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të shqyrtojë se cilat janë hapat e nevojshëm për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve. Këshilli mund të marrë të gjithë masat e nevojshme për këtë qëllim.

NENI 55

1. Një kompani Komunitare ose një kompani shqiptare e vendosur në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit përkatësisht gëzon të drejtën të punësojë, ose të ketë të punësuar nëpërmjet një prej filialeve ose degëve të saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi në vendin pritës të vendosjes së kompanisë, përkatësisht në territorin e Shqipërisë ose të Komunitetit, punonjës të cilët janë përkatësisht shtetas të Shteteve Anëtare dhe të Shqipërisë, me kusht që të jenë personel kyç siç përcaktohet në paragrafin 2 dhe që janë të punësuar ekskluzivisht nga kompani, filiale ose degë. Leja e punës dhe e qëndrimit e këtyre punonjësve mbulon vetëm periudhën e punësimit.

2. Personeli kyç i kompanive të sipërpërmendura, referuar më poshtë si “organizata”, janë “të transferuar brenda-kompanisë” siç përcaktohet në pikën c) të këtij paragrafi në kategoritë e mëposhtme, me kusht që organizata të jetë një person juridik dhe që personat e interesuar të kenë qenë të punësuar prej saj ose partnerë me të (por jo aksionarë me shumicën e aksioneve), të paktën gjatë atij viti që paraprin një lëvizje e tillë:

(a) Personat që punojnë në një pozicion drejtues në një organizatë, të cilët drejtojnë kryesisht menaxhimin e ndërmarrjes, dhe që mbikëqyren në mënyrë të përgjithshme ose marrin udhëzime kryesisht nga bordi i drejtorëve ose i aksionarëve të biznesit ose ekuivalentëve të tyre, duke përfshirë këtu:

- drejtimin e ndërmarrjes ose të një departamenti apo nënndarjeje të saj;
- mbikëqyrjen dhe kontrollin e punës së nëpunësve të tjerë si të mbikëqyrësve, specialistëve ose menaxherëve;
- kompetencës që personalisht të të punësojë dhe shkarkojë, ose të rekomandojë rekrutimin, shkarkimin ose veprime të tjera në lidhje me personelin;

(b) Persona të punësuar në një organizatë, të cilët zotërojnë njohuri të veçanta që janë thelbësore në shërbimet e ndërmarrjes, mjetet kërkimore, teknika ose menaxhim. Vlerësimi i njohurive të tilla mund të pasqyrojë, përveç njohurive specifike të cilat lidhen me ndërmarrjen, një nivel të lartë kualifikimi që i referohet një lloj pune ose tregtie ku nevojiten njohuri teknike të veçanta, përfshirë edhe anëtarësimin në një profesion të akredituar;

(c) Një "i transferuar brenda-kompanisë" përkufizohet si person fizik i punësuar brenda një organizate në territorin e një Pale, dhe i cili përkohësisht është transferuar në kontekst e vazhdimin të veprimtarive ekonomike në territorin e Palës tjetër; organizata përkatës duhet të ketë vendin parësor të biznesit të saj në territorin e një Palë dhe transferimi të ndodhë në një ndërmarrje (degë, filial) të asaj organizate, e cila ndjek me efikasitet veprimtari ekonomike të ngjashme në territorin e Palës tjetër.

3. Hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në territorin e Komunitetit ose Shqipërisë, përkatësisht i shtetasve shqiptarë ose Komunitarë, lejohet, atëherë kur këta përfaqësues të kompanive janë persona të punësuar në një pozicion drejtues, të përcaktuar në paragrafin 2(a) më sipër, brenda një kompanie dhe janë përgjegjës për ngritjen e një filiali Komunitar, ose dege të një kompanie shqiptare, ose të një filiali shqiptar ose degë të një kompanie Komunitare përkatësisht në një Shtet Anëtar ose në Shqipëri, atëherë kur:

këta përfaqësues nuk janë të angazhuar në shitjet e drejtpërdrejta apo në ofrimin e shërbimeve, dhe

kompania ka vendin parësor të biznesit të saj, përkatësisht jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, dhe nuk ka përfaqësues, zyrë, degë ose filiale të tjera, përkatësisht në atë Shtet Anëtar ose në Shqipëri.

NENI 56

Gjatë pesë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të zbatojë, mbi bazë kalimtare, masa të cilat devijojnë nga dispozitat e këtij Kapitulli, për sa i përket ndërmarrjeve të kompanive Komunitare dhe shtetasve të industrive të caktuara të cilat:

janë në proces ristrukturimi, ose janë duke u përballur me vështirësi serioze, veçanërisht ku këto sjellin probleme sociale të rënda në Shqipëri, ose

përballen me humbjen ose reduktimin drastik të tregut të zotëruar nga kompanitë ose shtetasit shqiptarë, në një sektor të caktuar ose industri në Shqipëri, ose

–janë industri të cilat po krijohen rishtas në Shqipëri.

Masa të tilla:

(i) pushojnë së vepruari jo më vonë se shtatë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje;

(ii) duhet të jenë të arsyeshme dhe të nevojshme për të përmirësuar situatën, dhe

(iii) nuk sjellin diskriminim ndaj aktiviteteve të kompanive ose shtetasve Komunitare të vendosura tashmë në Shqipëri në kohën e fillimit të një mase të dhënë, në krahasim me kompanitë ose shtetasit shqiptarë.

Në hartimin dhe zbatimin e masave të tilla, Shqipëria u akordon trajtim të privilegjuar kompanive dhe shtetasve Komunitare kurdoherë që është e mundur, dhe në asnjë rast trajtim më pak të favorshëm se sa ai që i është akorduar kompanive dhe shtetasve të cilido vendi të tretë. Para se të miratojë masa të tilla, Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asocimit dhe i vë në zbatim vetëm pas përfundimit të një periudhe një mujore, pasi është njoftuar Këshilli i Stabilizim-Asocimit për masat konkrete që do të zbatojë Shqipëria, me përjashtim të rasteve kur rreziku i dëmeve të riparueshme kërkon marrjen e masave urgjente, rast në të cilin Shqipëria konsultohet me Këshillin e Stabilizim-Asocimit menjëherë pas marrjes së këtyre masave.

Me përfundimin e vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria mund të paraqesë ose mbajë masa të tilla vetëm me autorizimin e Këshillit të Stabilizim-Asocimit dhe sipas kushteve të përcaktuara nga ky i fundit.

KAPITULLI III OFRIMI I SHËRBIMEVE

NENI 57

1. Palët angazhohen, në përputhje me dispozitat e mëposhtme që të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të lejuar në mënyrë progresive ofrimin e shërbimeve nga kompanitë ose shtetasit

Komunitarë ose shqiptarë, të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit për cilin synohet shërbimi.

2. Në përputhje me procesin e liberalizimit të përmendur në paragrafin 1, Palët lejojnë lëvizjen e përkohshme të personave fizikë të cilët japin shërbime ose që janë punësuar nga afruesi i shërbimeve si personel kyç, siç përcaktohet në nenin 55 , përfshirë personat fizikë të cilët janë përfaqësues të një kompani Komunitare ose shqiptare apo të një shtetasi Komunitar ose shqiptar dhe të cilët kërkojnë hyrje të përkohshme për të negociuar shitjen e shërbimeve ose lidhjen e marrëveshjeve për shitjen e shërbimeve për afruesin e shërbimeve në fjalë, ku këta përfaqësues nuk merren vetë me shitje të drejtpërdrejta për publikun e gjerë ose me ofrimin e shërbimeve.

3. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të marrë masat e nevojshme për të zbatuar në mënyrë progresive dispozitat në paragrafin 1. Do të merret parasysh progresi i arritur nga Palët në përafrimin e legjislacionit të tyre.

NENI 58

1. Palët nuk ndërmarrin masa ose veprime të tilla, që i bëjnë kushtet për ofrimin e shërbimeve nga shtetasit ose shoqëritë Komunitare ose shqiptare të cilët janë vendosur në një Palë të ndryshme nga ajo e personit të cilit i drejtohet shërbimi, më kufizuese krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes.

2. Nëse një prej Palëve është e mendimit se masat e zbatuara nga Pala tjetër pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes çojnë në një situatë e cila kufizon në mënyrë më të ndjeshme ofrimin e shërbimeve krahasuar këto me situatën ekzistuese ditën hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Pala e parë mund t'i kërkojë Palës tjetër që të konsultohet.

NENI 59

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve të transportit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, aplikohen dispozitat e mëposhtme:

1. Lidhur me transportin e brendshëm tokësor, Protokollin 5 parashtrohet rregullat e aplikueshme në marrëdhëniet ndërmjet Palëve për të siguruar, sidomos trafik rrugor transit të pakufizuar përmes Shqipërisë dhe Komunitetit në tërësi, zbatimin efektiv të parimit të mos-diskriminimit dhe harmonizimit progresiv të legjislacionit shqiptar për transportin me atë Komunitar.

2. Lidhur me transportin ndërkombëtar detar, Palët angazhohen të zbatojnë me efektivitet parimin e lejimit të aksesit të pakufizuar në treg dhe trafik mbi baza tregtare, si edhe të respektojnë detyrimet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e standardeve të sigurisë, sigurimit dhe të mjedisit.

Palët konfirmojnë angazhimin e tyre për një mjedis të lirë konkurrues, si një veçori thelbësore në transportin detar ndërkombëtar.

3. Në zbatimin e parimeve të paragrafit 2, Palët 2:

(a) nuk do të paraqesin klauzola për ngarkesa të përbashkëta në marrëveshjet e ardhshme dypalëshe me vendet e treta;

(b) shfuqizojnë, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha masat e njëanshme si dhe pengesat administrative, teknike dhe të tjera të cilat mund të kenë efekte kufizuese apo diskriminuese në ofrimin e lirë të shërbimeve në transportin detar ndërkombëtar.

(c) secila Palë nuk duhet të ofrojë përveç të tjerash, një trajtim jo më pak të favorshëm për anijet e zotëruara nga shtetas ose shoqëri të Palës tjetër, krahasuar kjo me trajtimin e dhënë ndaj anijeve të Palës në fjalë, për sa i përket aksesit në porte të hapura për tregtinë ndërkombëtare, përdorimit

të infrastrukturës dhe shërbimeve ndihmëse detare në porte, ashtu si dhe tarifave dhe taksave, lehtësirave doganore e caktimin e vendeve të ankorimit dhe të lehtësirave për ngarkim-shkarkim.

4. Me qëllim sigurimin e një zhvillimi të bashkërenduar dhe liberalizim progresiv të transportit ndërmjet Palëve të përshtatur sipas nevojave tregtare të përbashkëta, kushtet për aksesin e ndërsjellë në tregun e transportit ajror do të trajtohen në marrëveshje të veçanta të cilat do të negociohen ndërmjet Palëve.

5. Para se të bëhet përfundimi i marrëveshjes së përmendur në paragrafin 4, Palët nuk marrin asnjë masë ose veprim që është më kufizues ose diskriminues krahasuar këto me situatën ekzistuese para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6. Shqipëria do të përshtatë legjislacionin e saj, duke përfshirë gjithashtu rregullat administrative, teknike dhe të tjera, me ato Komunitare ekzistuese në çdo kohë, në fushën e transportit ajror, detar dhe tokësor të brendshëm për aq kohë sa kjo u shërben qëllimeve të liberalizimit dhe aksesit të ndërsjellë në tregjet e Palëve dhe lehtëson lëvizjen e pasagjerëve dhe të mallrave.

7. Bazuar në progresin e përbashkët në arritjen e objektivave të këtij Kapitulli, Këshilli i Stabilizim-Asocimit shqyrton mënyrat për krijimin e kushteve të nevojshme për përmirësimin e lirisë në ofrimin e shërbimeve në transportin ajror dhe tokësor të brendshëm.

KAPITULLI IV PAGESAT RRJEDHESE DHE LEVIZJA E KAPITALIT NENI 60

Palët angazhohen të autorizojnë, në monedha të këmbyeshme lirshëm, çdo pagesë apo transfertë në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e Nenit VIII të Neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar.

NENI 61

1. Në lidhje me transaksionet e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave, që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit lidhur me investime të drejtpërdrejta të kryera nga kompani të krijuara në përputhje me legjislacionin e vendit pritës, dhe me investime të kryera në përputhje me dispozitat e Kapitullit II të Titullit V, si dhe likuidimin ose riatdhesimin e këtyre investimeve dhe të çdo përfitimi që rrjedh prej tyre.

2. Në lidhje me transaksionet në e kapitalit dhe llogaritë financiare të bilancit të pagesave, nga hyrja në fuqi të Marrëveshjes, Palët sigurojnë lëvizjen e lirë të kapitalit për sa u përket kredive që lidhen me transaksionet tregtare ose me sigurimin e shërbimeve ku merr pjesë një rezident i një prej Palëve, dhe të huave financiare e kredive, me afat maturimi më të gjatë se një vit.

Që nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria autorizon, duke shfrytëzuar në mënyrë maksimale dhe të përshtatshme procedurat dhe kuadrin ligjor, blerjen e pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, me përjashtim të kufizimeve të parashikuara në Kalendarin e Shqipërisë për Angazhime Specifike sipas Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë për Shërbime (GATS). Brenda shtatë vitesh nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria në mënyrë progresive do të përafrojë legjislacionin e saj lidhur me të drejtën e blerjes së pasurive të patundshme në Shqipëri nga shtetas të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian për t'iu siguruar trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai që u sigurohet shtetasve shqiptarë. Pesë vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asocimit do të shqyrtojë modalitetet për eliminimin progresive të këtyre kufizimeve.

Palët gjithashtu do të sigurojnë, që nga viti i pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, lëvizjen e lirë të kapitalit për investimet në letrat me vlerë e huat financiare dhe kreditë me një afat maturimi më të shkurtër se një vit.

3. Pa cenuar paragrafin 1, Palët nuk do të paraqesin kufizime të reja në lëvizjen e kapitalit dhe pagesave rrjedhëse ndërmjet rezidentëve të Komunitetit dhe Shqipërisë, dhe nuk do t'i bëjnë marrëveshjet ekzistuese më tepër kufizuese.

4. Pa cenuar dispozitat e nenit 60 dhe as të këtij neni, në rrethana të jashtëzakonshme, kur lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë shkaktojnë ose kërcënojnë të shkaktojnë vështirësi serioze për funksionimin e politikave të kursit të këmbimit ose politikave monetare në Komunitet ose Shqipëri, Komuniteti dhe Shqipëria përkatësisht, mund të marrin masa mbrojtëse lidhur me lëvizjet e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se një vit në qoftë se masa të tilla janë më se të nevojshme.

5. Në dispozitat e mësipërme asgjë nuk duhet interpretuar si kufizim i të drejtave të operatorëve ekonomikë të Palëve për të përfituar nga një trajtim më i favorshëm që mund të parashikohet në ndonjë marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ekzistuese, pjesë e së cilës janë Palët e kësaj Marrëveshjeje.

6. Palët konsultohen ndërmjet tyre për të lehtësuar lëvizjen e kapitalit ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, në mënyrë që të promovohen objektivat e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 62

1. Gjatë tri viteve të para që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Palët marrin masa që lejojnë krijimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e mëtejshëm gradual të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e lirë të kapitalit.

2. Në përfundim të vitit të tretë që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Stabilizim-Asocimit përcakton modalitetet për zbatimin e plotë të rregullave të Komunitetit për lëvizjen e kapitalit.

KAPITULLI V DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 63

1. Dispozitat e këtij Titulli zbatohen duke iu nënshtuar kufizimeve për arsye të politikave publike, sigurisë publike ose shëndetit publik.

2. Ato nuk zbatohen për veprimtari të cilat kanë lidhje, edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar në territorin e secilës prej Palëve.

NENI 64

Për qëllimin e këtij Titulli, në këtë Marrëveshje asgjë nuk ndalon Palët të zbatojnë ligjet dhe aktet e tyre nënligjore për sa i përket hyrjes dhe qëndrimit, punësimit, kushteve të punës, vendosjes së personave fizikë dhe ofrimit të shërbimeve, me kusht që, duke vepruar në këtë mënyrë, ata nuk i zbatojnë këto masa në mënyrë të tillë që të anulojnë ose të dëmtojnë përfitimet e secilës prej Palëve sipas kushteve të një dispozite të veçantë të kësaj Marrëveshjeje. Kjo dispozitë nuk cenon zbatimin e nenit 63.

NENI 65

Kompanitë të cilat kontrollohen dhe janë ekskluzivisht nën pronësinë e përbashkët të shtetasve ose kompanive shqiptare dhe të shtetasve ose kompanive Komunitare, janë gjithashtu subjekt i dispozitave të këtij Titulli..

NENI 66

1. Trajtimi i Kombit më të Favorizuar, i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij Titulli nuk zbatohet mbi avantazhet e tatimeve që Palët sigurojnë ose do të sigurojnë në të ardhmen në bazë të marrëveshjeve që kanë për qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë ose rregullime të tjera tatimesh.
2. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet të interpretohen si masa që parandalojnë miratimin ose imponimin nga Palët, të masave të cilat synojnë parandalimin e shmangieve ose evazionin e tatimeve në vijim të dispozitave tarifore të marrëveshjeve për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe formave të tjera tatimore ose legjislacionin e brendshëm fiskal.
3. Asnjë prej dispozitave të këtij Titulli nuk duhet interpretuar si masa që parandalojnë Shtetet Anëtare ose Shqipërinë të zbatojnë dispozitat përkatëse të legjislacioneve të tyre fiskalë, për dallimin e taksapaguesve të cilët nuk gjenden në situata të njëjta, sidomos në lidhje me vendin e tyre të qëndrimit.

NENI 67

1. Palët përpiqen kurdo të jetë e mundur, të shmangin vendosjen e masave kufizuese, përfshirë masat për kufizimin e importeve, për të mbrojtur bilancin e pagesave. Pala e cila miraton masa të tilla duhet t'i paraqesë sa më shpejt të jetë e mundur Palës tjetër një kalendar për heqjen e tyre.
2. Në rastin kur një ose më shumë Shtete Anëtare apo Shqipëria gjenden në një situatë tejet të vështirë të bilancit të pagesave, ose pranë një rreziku të afërt, Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, në përputhje me kushtet e vendosura nga Marrëveshja e OBT-së, miratojnë masa kufizuese, përfshirë masa mbi importet, të cilat duhet të jenë për një kohë të kufizuar dhe nuk mund të masat veçanërisht të nevojshme për rregullimin e situatës së bilancit të pagesave. Komuniteti ose Shqipëria, sipas rastit, informon menjëherë Palën tjetër.
3. Asnjë masë kufizuese nuk zbatohet për transfertat lidhur me investimet, dhe sidomos lidhur me riatdhesimin e shumave të investuara ose të rinvestuara apo çdo lloj të ardhurash që rrjedhin nga to.

NENI 68

Dispozitat e këtij Titulli përshtaten progresivisht, veçanërisht në kuadër të kërkesave që vijnë nga Neni V i Marrëveshjes së Përgjithshme për Tregtinë në Shërbime (GATS).

NENI 69

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë zbatimin prej secilës Palë të masave të nevojshme për të parandaluar shmangien e masave lidhur me aksesin e vendeve të treta në tregun e tyre nëpërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

TITULLI VI PËRAFRIMI I LEGJISLACIONIT, IMPONIMI I LIGJEVE DHE RREGULLAT E KONKURRENCËS

NENI 70

1. Palët njohin rëndësinë e përafimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij me efektivitet. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me acquis e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm të zbatohet dhe imponohet si duhet.
2. Ky përafim fillon në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes dhe do të shtrihet gradualisht në tërë elementët e acquis të Komunitetit të përmendura në këtë Marrëveshje brenda periudhës tranzitore të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje.
3. Gjatë fazës së parë të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Marrëveshjeje, përafimi do të përqendrohet në elementët thelbësorë të acquis së Tregut të Brendshëm ashtu si dhe në fusha të tjera të rëndësishme si konkurrenca, të drejtat mbi pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, prokurimi publik, standardet dhe certifikimi, shërbimet financiare, transporti detar dhe tokësor – duke i kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë dhe standardeve mjedisore si dhe aspekteve sociale –, ligji për kompanitë tregtare, kontabiliteti, mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e të dhënave, shëndeti dhe siguria në punë dhe mundësi të barabarta. Gjatë fazës së dytë, Shqipëria përqendrohet në pjesët e mbetura të acquis.
Përafimi kryhet në bazë të një programi, për të cilin do të bihet dakord, ndërmjet Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe Shqipërisë.
4. Shqipëria, në pajtim me Komisionin e Komuniteteve Evropiane, do të përcaktojë modalitetet për monitorimin e zbatimit të veprimeve që ndërmerren për përafimin e legjislacionit dhe imponimin e ligjeve.

NENI 71

Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike

1. Dispozitat në vijim nuk përputhen me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojnë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë:
(i) të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e marra nga grupe sipërmarrjesh dhe praktikatat e koordinuara ndërmjet sipërmarrjeve të cilat kanë si objektiv të tyre ose pasojë, parandalimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës;
(ii) abuzimi me pozicionin dominues, nga një ose më shumë sipërmarrje, në territoret e Komunitetit apo të Shqipërisë si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;
(iii) çdo ndihmë shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.
2. Praktikatat në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.
3. Palët sigurojnë që një institucioni publik dhe funksionalisht të pavarur t'i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (i) dhe (ii) të këtij Neni, lidhur me sipërmarrjet private dhe publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta.
4. Shqipëria do të ngrëjë një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të paragrafit 1 (iii) të këtij neni brenda katër vjetësh, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Ky autoritet do të ketë veç të tjerash, kompetenca për të autorizuar skema të ndihmës shtetërore dhe grande ndihme individuale në

përputhje me paragrafin 2 të këtij Neni, si dhe kompetenca për të urdhëruar rikthimin e ndihmës shtetërore të dhënë në mënyrë të paligjshme.

5. Secila prej Palëve garanton transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke i paraqitur, veç të tjerash Palës tjetër një raport të rregullt vjetor, ose i njëjtë me të, duke ndjekur metodologjinë dhe paraqitjen e sondazhit të Komunitet për ndihmën shtetërore. Me kërkesë të njërës Palë, Pala tjetër do t'i japë informacione për çështje të veçanta të ndihmës publike.

6. Shqipëria harton një inventar gjithëpërfshirës të skemave të ndihmës të krijuara para ngritjes së autoritetit të përmendur në paragrafin 4, dhe i drejton këto skema ndihme në përputhje me kriteret e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda një periudhe jo më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

7. Me qëllim zbatimit e dispozitave të paragrafit 1 (iii), Palët pranojnë që gjatë dhjetë viteve të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, çdo ndihmë publike e dhënë nga Shqipëria vlerësohet duke marrë parasysh faktin se ajo konsiderohet si një zonë e njëjtë me zonat e përshkruara në Nenin 87 (3)(a) të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian.

Brenda pesë viteve që prej hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit të Komuniteteve Evropiane shifrat e PBB-së së saj për frymë të harmonizuar me nivelin NUTS II. Më pas, autoriteti i përmendur në paragrafin 4 dhe Komisioni i Komuniteteve Evropiane vlerëson bashkërisht kriteret për pranueshmërinë e zonave të Shqipërisë si dhe intensitetin maksimal të ndihmës në lidhje me to, në mënyrë që të hartohet harta rajonale e ndihmave në bazë të direktivave përkatëse të Komunitetit.

8. Në lidhje me prohimet e përmendura në Kapitullin II të Titullit IV:

–paragrafi 1 (iii) nuk zbatohet;

–çdo praktikë në kundërshtim me paragrafin 1(i) vlerësohet sipas kriterëve të vendosura nga Komuniteti në bazë të Neneve 36 dhe 37 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve specifike të Komunitetit të miratuara mbi këtë bazë.

9. Në qoftë se një nga Palët është e mendimit se një praktikë e veçantë nuk përputhet me termat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, ajo mund të marrë masat e nevojshme pas konsultimeve të bëra me Këshillin e Stabilizim-Asocimit ose tridhjetë ditë pune pas kërkesës për konsultim. Asgjë në këtë nen nuk cenon ose ndikon në ndonjë mënyrë për marrjen, nga secila prej Palëve, të masave antidumping ose të masave kundërvepruese në përputhje me nenet përkatëse të GATT 1994 dhe Marrëveshjes së OBT-së për Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese apo legjislacionit të brendshëm përkatës.

NENI 72

Sipërmarrjet publike

Brenda vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria zbaton, për sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet të cilave iu janë akorduar të drejta të veçanta dhe ekskluzive, parimet e parashikuara në Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, duke iu referuar veçanërisht nenit 86.

Të drejtat e veçanta të sipërmarrjeve publike gjatë periudhës transitore nuk përfshijnë mundësinë e vendosjes së kufizimeve sasiore, ose masave me efekt të njëjtë, mbi importet nga Komuniteti në Shqipëri.

NENI 73

Pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, Palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asocimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.
4. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asocimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

NENI 74 Kontratat publike

Palët konsiderojnë si një objektiv të dëshirueshëm liberalizimin e kontratave publike në bazë të parimit të mos-diskriminimit dhe reciprocitetit, veçanërisht në kontekstin e OBT-së.

Kompanive shqiptare, edhe nëse nuk janë vendosur në Komunitet, u jepet e drejta për të marrë pjesë për akordim kontrate në Komunitet sipas rregullave të prokurimit të Komunitetit, duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive komunitare, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e mësipërme zbatohen gjithashtu në kontratat e shërbimeve publike, sapo qeveria shqiptare të ketë miratuar legjislacionin duke vendosur rregullat komunitare për këtë fushë. Komuniteti shqyrton periodikisht nëse Shqipëria ka miratuar vërtetë këtë legjislacion.

Kompanitë komunitare që nuk janë vendosur në Shqipëri gëzojnë të drejtën e fitimit të kontratës në Shqipëri në bazë të Ligjit shqiptar për Prokurimin Publik duke mos marrë një trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë shoqërive shqiptare, jo më vonë se katër vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Këshilli i Stabilizim-Asocimit shqyrton periodikisht mundësinë që Shqipëria të nisë lejimin për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës në Shqipëri të gjitha kompanive komunitare. Shoqëritë komunitare të vendosura në Shqipëri sipas dispozitave të Kapitullit II të Titullit V, me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, gëzojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e fitimit të kontratës duke mos marrë trajtim më pak të favorshëm se ai i dhënë kompanive shqiptare.

Në lidhje me ndërmarrjet, veprimtaritë, dhënien e shërbimeve ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë, si dhe punësimin dhe lëvizjen e punonjësve me qëllim përmbushjen e kontratave publike, aplikohen dispozitat e neneve 46 deri në 69.

NENI 75 Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i përputhshmërisë

1. Shqipëria merr masat e nevojshme për siguruar gradualisht përputhshmërinë me rregulloret teknike të Komunitetit dhe procedurave evropiane të vlerësimit të standardizimit, metrologjisë, akreditimit dhe përputhshmërisë.

2. Për këtë qëllim, Palët do të fillojnë në një fazë të hershme:

nxitjen e përdorimit të rregulloreve teknike të Komunitetit, standardeve evropiane dhe procedurave të vlerësimit të përputhshmërisë,

dhënien e asistencës për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës së cilësisë: standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe vlerësimin e përputhshmërisë;

nxitjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në veprimtarinë e organizatave që kanë të bëjnë me standardet, vlerësimin e përputhshmërisë, metrologjinë dhe funksione të ngjashme (p.sh. CEN, CENELEC, ETSI, EA, WELMEC, EUROMET etj).

përfundimin e Protokolleve Evropiane të Vlerësimit të Përputhshmërisë, aty ku shihet e arsyeshme, menjëherë pasi kuadri ligjor dhe procedurat shqiptare të jenë përafuar „në masë të mjaftueshme me ato komunitare dhe të ekzistojë ekspertiza e përshtatshme.

NENI 76

Mbrojtja e konsumatorit

Palët do të bashkëpunojnë për përafrimin e standardeve për mbrojtjen e konsumatorëve në Shqipëri me standardet komunitare. Mbrojtja e efektshme e konsumatorit është e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të ekonomisë së tregut, mbrojtje e cila varet nga zhvillimi i një infrastrukture administrative për të siguruar mbikëqyrjen e tregut dhe zbatimin e ligjeve në këtë fushë.

Për këtë qëllim, dhe në kuadër të interesave të tyre të përbashkëta, Palët do të inkurajojnë dhe garantojnë:

një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën komunitare;

harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri me atë ekzistues në Komunitet;

–mbrojtje efektive ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit, dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;

–monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe garantimin e aksesit tek drejtësia në rast mosmarrëveshesh.

NENI 77

Kushtet e punës dhe mundësitë të barabarta

Shqipëria do të harmonizojë në mënyrë progresive legjislacionin e saj me atë të Komunitetit në fushën e kushteve të punës, veçanërisht të shëndetit dhe sigurisë në punë, dhe mundësive të barabarta.

TITULLI VII

LIRIA, DREJTESIA DHE SIGURIA

HYRJE

NENI 78

Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës

Në bashkëpunimin e tyre në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme Palët i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi synon veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të imponimit të ligjeve duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

NENI 79

Mbrojtja e të dhënave personale

Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin për të dhënat personale me të drejtën komunitare, dhe me legjislacionin tjetër evropian dhe ndërkombëtar mbi privatësinë. Shqipëria krijon organe mbikëqyrës të pavarur me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë efektive imponimin e legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale. Palët do të bashkëpunojnë për të arritur këtë qëllim.

BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LËVIZJES SË PERSONAVE

NENI 80

Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e vizave, kontrollit të kufijve, azilit dhe migracionit dhe të ngrenë një kuadër bashkëpunimi përfshirë atë në nivel rajonal, në këto fusha, duke marrë parasysh dhe duke përdorur plotësisht nismat e tjera ekzistuese në këtë fushë siç mund të jetë e përshtatshme.

Bashkëpunimi në çështjet të sipërpërmendura bazohet në konsultimet e ndërsjella dhe bashkërendimin e ngushtë ndërmjet Palëve dhe duhet të përfshijë asistencë teknike dhe administrative për:

- shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin dhe praktikën;
- hartimin e legjislacionit;
- rritjen e efikasitetit të institucioneve;
- trajnimin e personelit;
- sigurinë e dokumenteve të udhëtimit dhe zbulimin e dokumenteve false;
- menaxhimin e kufijve.

- Bashkëpunimi përqendrohet veçanërisht:

– në fushën e azilit për zbatimin e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të Nju Jorkut të vitit 1967 për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve;

– në fushën e migracionit të ligjshëm, për rregullat e pranimit dhe të drejtat dhe statusin e personave të pranuar. Lidhur me migracionin Palët bien dakord për një trajtim të drejtë të

shtetasve të vendeve të tjera të cilët janë rezidentë të ligjshëm në territoret e tyre dhe për të promovuar politika integrimi që synojnë të bëjnë të drejtat dhe detyrimet e tyre të krahasueshme me ato të shtetasve të vetë.

NENI 81

Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm; ripranimi

Palët bashkëpunojnë për të parandaluar dhe frenuar imigrimin e paligjshëm. Për këtë qëllim, Palët, sipas kërkesës dhe pa formalitete të mëtejshme, bien dakord që Shqipëria dhe Shtetet Anëtare:

do të ripranojnë çdo shtetas të tyre që qëndron në mënyrë të paligjshme në territoret e tyre;
do të ripranojnë çdo shtetas të vendeve të treta dhe çdo person pa shtetësi që qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e tyre dhe që ka hyrë në territorin e Shqipërisë nëpërmjet një Shteti Anëtar, ose prej tij, apo që ka hyrë në territorin e një Shteti Anëtar nëpërmjet Shqipërisë, ose prej saj.

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipëria pajisin shtetasit e tyre me dokumente të përshtatshëm identifikimi dhe do t'u sigurojnë atyre lehtësirat administrative për këtë qëllim.

Procedura të veçanta për qëllimet e ripranimit të shtetasve, shtetasve të vendeve të treta dhe personave pa shtetësi janë përcaktuar në kuadrin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Shqipërisë mbi ripranimin e personave rezidentë pa autorizim, të nënshkruar më 14 prill 2005.

Shqipëria pranon të përfundojë marrëveshjet për ripranim me vendet e procesit të Stabilizim-Asocimit dhe merr përsipër të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin fleksibël dhe të shpejtë të të gjitha marrëveshjeve të ripranimit referuara në këtë nen.

Këshilli i Stabilizim-Asocimit ndërmerr përpjekje të tjera të përbashkëta që mund të bëhen për të parandaluar dhe frenuar imigracionin e paligjshëm, duke përfshirë rrjetet e trafikimit dhe të migrimit të paligjshëm.

BASHKËPUNIMI NE LUFTEN KUNDER PASTRIMIT TE PARAVE DHE DROGAVE TE PALIGJSHME

NENI 82

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit

1. Palët bashkëpunojnë ngushtësisht me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e parave nga veprimtaritë kriminale në përgjithësi dhe veprat penale të drogës në veçanti, si edhe për financimin e terrorizmit.

2. Bashkëpunimi në këtë fushë mund të përfshijë asistencë teknike dhe administrative me qëllim që të zhvillohet zbatimi i akteve normative, dhe funksionimi efikas i standardeve të përshtatshme dhe mekanizmave për luftën kundër pastrimit të parave e financimit të terrorizmit të njëjtë me ato që përdoren nga Komuniteti e forumet ndërkombëtare në këtë fushë, veçanërisht Grupi i Përbashkët për Veprimin Financiar .

NENI 83

Bashkëpunimi kundër drogave të paligjshme

1. Brenda mundësive dhe kompetencave të tyre, Palët bashkëpunojnë për të siguruar një qëndrim të balancuar dhe të integruar në drejtim të problemeve të drogës. Politikat dhe veprimet në lidhje me drogën do të përdoren për pakësimin e trafikimit, kërkesës për droga të paligjshme e furnizimit me to, si dhe për të ushtruar një kontroll më të efektshëm pas njoftimeve paralajmëruese.

2. Palët bien dakord mbi metodat e nevojshme të bashkëpunimit për arritjen e këtyre objektivave. Veprimet bazohen në parime përgjithësisht të pranuar, në përputhje me Strategjinë e BE-së për Drogën.

NENI 84

Bashkëpunimi kundër terrorizmit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë për të parandaluar dhe eliminuar aktet terroriste dhe financimet e tyre, veçanërisht ato që përfshijnë veprimtaritë ndërkufitare, që janë në përputhje me konventat ndërkombëtare ku ato bëjnë pjesë, si dhe me ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse.:

–në kuadër të zbatimit të plotë të Rezolutës 1373 të Këshillit të Sigurimit dhe rezolutave të tjera përkatëse të OKB-së, instrumenteve dhe konventave ndërkombëtare;

–nëpërmjet shkëmbimit të informacionit për grupet terroriste dhe rrjeteve të tyre mbështetëse, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë të brendshme;

–nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës në lidhje me mjetet dhe metodat për të luftuar terrorizmin si dhe në fushën teknike dhe të trajnimit, dhe përmes shkëmbimit të eksperiencës për parandalimin e terrorizmit.

Bashkëpunimi në çështjet penale

NENI 85

Parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme

Palët bashkëpunojnë në luftën dhe parandalimin e veprimtarive kriminale dhe të paligjshme, të organizuara ose jo, të tilla si:

kontrabanda dhe trafikimi i qenieve njerëzore;

aktivitete ekonomike të paligjshme, dhe në veçanti falsifikimi i monedhave, transaksionet e paligjshme me prodhime të tilla si mjetet industriale, materiale radioaktive dhe transaksione që kanë lidhje me prodhime të paligjshme ose të falsifikuara;

korrupsioni, si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik, veçanërisht kur ka të bëjë me praktika administrative jo-transparente;

mashtrimi fiskal;

trafikimi i paligjshëm i drogave dhe lëndëve psikotrope;

kontrabanda;

trafikimi i paligjshëm i armëve;

falsifikimi i dokumenteve;

trafikimi i paligjshëm i makinave;

krimi kibernetike

Do të nxitet bashkëpunimi rajonal dhe respektimi i standardeve të njohura ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar.

TITULLI VIII

POLITIKAT E BASHKËPUNIMIT

NENI 86

Komuniteti dhe Shqipëria do të vendosin një bashkëpunim të ngushtë për të kontribuar në potencialin e zhvillimit dhe rritjes së Shqipërisë. Një bashkëpunim i tillë do të forcojë lidhjet ekonomike ekzistuese në një bazë sa më të gjerë, për përfitimin e të dyja palëve.

Do të hartohen politika dhe masa të tjera të hartuara për të sjellë zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm në Shqipëri. Këto politika duhet të sigurojnë që çështjet e mjedisit të jenë të përfshira që nga fillimi dhe të lidhura me kërkesat për zhvillimin e harmonizuar social.

Politikat e bashkëpunimit do të integrohen në një kuadër rajonal bashkëpunimi. Kujdes i veçantë duhet t'u kushtohet masave që mund të nxisin bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje të saj duke përfshirë Shtetet Anëtare, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Këshilli i Stabilizim-Asocimit mund të përcaktojë përparësitë ndërmjet dhe brenda politikave të bashkëpunimit të përshkruara në vijim.

NENI 87

Politikat ekonomike dhe tregtare

Komuniteti dhe Shqipëria do të lehtësojnë procesin e reformave ekonomike nëpërmjet bashkëpunimit për të përmirësuar mirëkuptimin e bazave të ekonomive të tyre përkatëse, si dhe formulimin dhe zbatimin e politikave ekonomike në ekonominë e tregut.

Me kërkesë të autoriteteve Shqiptare, Komuniteti mund të japë asistencë që synon mbështetjen e përpjekjeve të Shqipërisë për ndërtimin e një ekonomie funksionale tregu, si dhe për të përafuar gradualisht politikat e saj me politikat stabilizuese të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Bashkëpunimi ka si synim gjithashtu forcimin e shtetit të së drejtës në fushën e biznesit nëpërmjet një kuadri ligjor tregtar jo-diskriminues dhe të qëndrueshëm.

Bashkëpunimi në këtë fushë përfshin shkëmbim joformal të informacionit në lidhje me parimet dhe funksionimin e Bashkimit Evropian Ekonomik dhe Monetar.

NENI 88

Bashkëpunimi statistikor

Bashkëpunimi midis Palëve përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e statistikave. Ai synon veçanërisht zhvillimin e një sistemi statistikor efikas dhe të qëndrueshëm, të aftë për të siguruar të dhëna të krahasueshme, të besueshme, objektive dhe të sakta, që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar procesin e tranzicionit dhe reformës në Shqipëri. Ky sistem duhet gjithashtu të mundësojë Institutin Shqiptar të Statistikës për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve vendas dhe ndërkombëtarë (si të administratës publike ashtu dhe sektorit privat). Sistemi statistikor duhet të respektojë parimet themelore të statistikave të nxjerra nga OKB-ja dhe Kodi Statistikor Evropian i Praktikës dhe parashikimet e së drejtës Statistike Evropiane, dhe duhet të zhvillohet drejt acquis e Komunitetit.

NENI 89

Veprimtaritë bankare, sigurimet dhe shërbime të tjera financiare

Bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Komunitetit do të përqendrohet në fusha prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushat e veprimeve bankare, sigurimeve dhe shërbimeve financiare. Palët bashkëpunojnë me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një kuadri të përshtatshëm për nxitjen e sektorëve të shërbimeve bankare, sigurimeve dhe atyre financiare në Shqipëri.

NENI 90

Bashkëpunimi për auditimin dhe kontrollin financiar

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli i Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuar botërisht si edhe me praktikatat më të mira të BE-së.

NENI 91

Nxitja dhe mbrojtja e investimeve

Bashkëpunimi mes Palëve, në kuadër të përmbushjes së kompetencave përkatëse në fushën e nxitjes dhe mbrojtjes së investimeve, ka si synim krijimin e një klime të favorshme për investimet private, vendase dhe të huaja, e cila është thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike dhe industriale të Shqipërisë.

NENI 92

Bashkëpunimi industrial

Bashkëpunimi ka si synim të nxisë modernizimin dhe ristrukturimin e industrisë shqiptare dhe sektorëve të veçantë, ashtu si edhe bashkëpunimin industrial midis operatorëve ekonomikë, me synim forcimin e sektorit privat në kushte të cilat sigurojnë mbrojtjen e mjedisit. Iniciativat e bashkëpunimit industrial do të reflektojnë përparësitë e përcaktuara nga të dy Palët. Ata do të marrin në konsideratë aspektet rajonale të zhvillimit industrial, duke nxitur partneritetet ndërkombëtare kur është e përshtatshme. Iniciativat duhet të synojnë në mënyrë të veçantë ngritjen e një kuadri të përshtatshëm për sipërmarrjet, përmirësimin e menaxhimit dhe ekspertizës, dhe promovimin e tregjeve, transparencës së tregut dhe mjedisit të biznesit. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë acquis e Komunitetit në fushën e politikave industriale.

NENI 93

Ndërmarrjet e vogla e të mesme

Bashkëpunimi mes Palëve synon forcimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME-ve) të sektorit privat dhe merr parasysh fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e SME-ve, si edhe parimet e përfshira në Kartën Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla.

NENI 94

Turizmi

Bashkëpunimi mes Palëve në fushën e turizmit kryesisht do të synojë përmirësimin e përcjelljes së informacionit mbi turizmin (nëpërmjet rrjeteve ndërkombëtare, bazave të të dhënave) dhe transferimin e ekspertizës (nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimeve, seminareve). Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë pjesën e duhur nga acquis e Komunitetit që lidhet me këtë sektor. Bashkëpunimi mund të integrohet në një kuadër rajonal bashkëpunimi.

NENI 95

Bujqësia dhe sektori agro-industrial

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në sferat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e bujqësisë. Bashkëpunimi do të ketë si synim veçanërisht modernizimin dhe ristrukturimin e bujqësisë shqiptare dhe sektorit agro-industrial, si dhe mbështetjen për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar dhe praktikave me rregullat dhe standardet komunitare.

NENI 96

Peshkimi

Palët do të shqyrtojnë mundësinë e identifikimit të fushave me përfitim të ndërsjellë dhe interes të përbashkët në sektorin e peshkimit. Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e peshkimit, duke përfshirë respektimin e detyrimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me rregullat e menaxhimit të Organizatës Ndërkombëtare dhe Rajonale të Peshkimit dhe ruajtjen e burimeve të peshkimit.

NENI 97

Doganat

Palët do të vendosin një bashkëpunim në këtë fushë me synim garantimin e përputhjes me dispozitat që do të miratohen në fushën e tregtisë, dhe për të arritur përafrimin e sistemit doganor shqiptar me atë të Komunitetit, duke ndihmuar kështu në hapjen e rrugës për marrjen e masave liberalizuese të planifikuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit dhe për përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar për doganat me atë të acquis.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushat e doganave.

Protokolli 6 vendos rregullat e asistencës të ndërsjellë administrative mes Palëve në fushën e doganave.

NENI 98

Tatimet

Palët vendosin bashkëpunim në fushën e tatimeve duke përfshirë masat që synojnë forcimin e reformave të mëtejshme në sistemin fiskal dhe në ristrukturimin e administratës së tatimeve me synimin që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe në luftën kundër evazionit fiskal.

Bashkëpunimi do të marrë parasysh në mënyrën e duhur fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë aspekt, Palët njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të të dhënave

ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet imponimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin e taksave. Për më tepër, Palët konsultohen me njëra-tjetrën, qysh nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, me synim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë me qëllim që të sigurohet një trajtim i barabartë në fushën e tatimit të biznesit.

NENI 99 Bashkëpunimi social

Palët bashkëpunojnë për të lehtësuar reformat e politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integritit. Bashkëpunimi synon të mbështesë përshtatjen e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale, dhe përfshin përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë, ashtu si dhe përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë për punëtorët, duke ju referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në Komunitet. Bashkëpunimi merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

NENI 100 Arsimi dhe trajnimi

Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe trajnimit profesional në Shqipëri, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e objektivave të Deklaratës së Bolonjës.

Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që aksesin në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Shqipëri të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, ngjyrës, origjinës etnike ose fesë.

Programet dhe instrumentet përkatës të Komunitetit do të kontribuojnë për rritjen e nivelit të strukturave dhe veprimtarive arsimore dhe trajnuese në Shqipëri.

Bashkëpunimi do të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

NENI 101 Bashkëpunimi kulturor

Palët marrin përsipër të nxisin bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim shërben, veç të tjerash për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellët dhe vlerësimin midis individëve, komuniteteve dhe popujve. Palët marrin gjithashtu përsipër të nxisin shumëllojshmërinë kulturore, veçanërisht në kuadrin e Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen dhe nxitjen e larmisë të shprehjeve kulturore.

NENI 102 Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale

Palët bashkëpunojnë për të zhvilluar industrinë audio-vizive në Evropë, dhe për të përkrahur bashkëprodhimin në fushat e kinemasë dhe televizionit.

Bashkëpunimi mund të përfshijë, veç të tjerash programet dhe lehtësirat për trajnimin e gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias, ashtu si edhe asistencën teknike ndaj medias publike dhe private, me qëllim përfundimin e pavarësisë së tyre, profesionalizmin dhe lidhjeve me medien evropiane.

Shqipëria do t'i përafrojë politikat e saj mbi rregullimin e aspekteve të përmbajtjes së transmetimeve ndërkufitare me ato të KE-së, dhe do të harmonizojë legjislacionin e saj me acquis e BE-së. Shqipëria do t'i kushtojë kujdes të veçantë përvetësimit të së drejtës së pronësisë intelektuale për programet dhe transmetimin me satelit, frekuenca tokësore dhe kablo.

NENI 103

Shoqëria e informacionit

Bashkëpunimi do të përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për shoqërinë e informacionit. Ai do të mbështesë kryesisht orientimin gradual të politikave dhe legjislacionit të Shqipërisë për këtë sektor me ato të Komunitetit.

Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu për të zhvilluar më tej Shoqërinë e Informacionit në Shqipëri. Objektivat globale do të përgatisin shoqërinë në tërësi për epokën digjitale, duke tërhequr investimet dhe duke siguruar aftësinë e rrjeteve dhe shërbimeve për përdorimin e informacionit.

NENI 104

Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik

Bashkëpunimi do të përqendrohet së pari në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në këtë fushë.

Palët do të forcojnë, në veçanti bashkëpunimin në fushat e rrjeteve të komunikimit elektronik e shërbimeve të lidhura me to, me objektivin përfundimtar të miratimit nga Shqipëria të acquis të Komunitetit në këto sektorë një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 105

Informacioni dhe komunikimi

Komuniteti dhe Shqipëria do të marrin masat e nevojshme për të nxitur shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit. Përparësi do u jepet programeve që synojnë dhënien e informacionit bazë lidhur me Komunitetin për publikun e gjerë dhe dhënies së informacioneve më të specializuara për rrethet profesionale në Shqipëri.

NENI 106

Transporti

Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e transportit.

Bashkëpunimi mund të synojë, veçanërisht në ristrukturimin dhe modernizimin e metodave shqiptare të transportit, duke përmirësuar lëvizjen e lirë të pasagjerëve dhe mallrave, duke zgjeruar mundësinë për në tregun dhe mjetet e transporteve, duke përfshirë portet dhe aeroportet, duke mbështetur zhvillimin e infrastrukturave multi-modale në lidhje me rrjetet kryesore Trans-Evropiane, në veçanti për të forcuar dukshëm lidhjet rajonale, duke arritur standardet operative të krahasueshme me ato të Komunitetit, duke zhvilluar një sistem transporti në Shqipëri në pajtim

dhe të përafuar me atë të Komunitetit, si edhe duke përmirësuar mbrojtjen e mjedisit të transportit.

NENI 107 Energjia

Bashkëpunimi do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e energjisë, duke përfshirë, sipas rastit, aspektet e sigurisë bërthamore. Ky bashkëpunim do të pasqyrojë parimet e ekonomisë së tregut dhe bazohet në Traktatin ,të nënshkruar, rajonal të Komunitetit për Energjinë me synim integrimin gradual të Shqipërisë në tregjet Evropiane të energjisë.

NENI 108 Mjedisi

Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit për fushën e mjedisit.

NENI 109 Bashkëpunimi në kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik

Palët do të inkurajojnë bashkëpunimin në kërkimet civile shkencore dhe zhvillimin teknologjik mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë dhe duke marrë parasysh burimet e disponueshme, aksesin e duhur në programet e tyre përkatëse, të kushtëzuara këto nga nivelet e përshtatshme të mbrojtjes efikase të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare .

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik.

Bashkëpunimi do të zbatohet në bazë të marrëveshjeve specifike që do të negociohen dhe përfundohen në bazë të procedurave të miratuara nga secila Palë.

NENI 110 Zhvillimi rajonal dhe lokal

Palët do të përipiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe interrajonal.

Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me acquis e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

NENI 111 Administrata publike

Bashkëpunimi do të synojë mundësimin e zhvillimit të një administrate publike efçente dhe të përgjegjshme në Shqipëri, e cila mbështet në veçanti vënien në zbatim të shtetit të së drejtës funksionimin e duhur të institucioneve shtetërore për të mirën e popullsisë shqiptare në tërësi dhe të zhvillimit normal të marrëdhënieve mes BE-së dhe Shqipërisë.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të përqendrohet kryesisht në ndërtimin e institucioneve, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e procedurave transparente dhe të paanshme të rekrutimit, menaxhimit e burimeve njerëzore, zhvillimin e karrierës në shërbimin publik, trajnimin e vazhdueshëm dhe promovimin e etikës në administratën publike dhe qeverisjes elektronike. Bashkëpunimi përfshin si administratën qendrore, ashtu dhe atë vendore.

TITULLI IX BASHKEPUNIMI FINANCIAR

NENI 112

Për të arritur objektivat e kësaj Marrëveshjeje dhe në përputhje me nenet 3, 113 dhe 115, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma Komunitare varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asocimit, Partneriteteve Evropiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Ndihma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

NENI 113

Asistenca financiare, në formën e grandeve, duhet të trajtohet nga masat operacionale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit të treguesve shumë vjeçare të caktuar nga Komuniteti pas konsultimeve me Shqipërinë.

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përfrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.

NENI 114

Me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Komuniteti, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim,, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së.

NENI 115

Me qëllim që të realizohet përdorimi sa më optimal të burimeve ekzistuese, Palët garantojnë që kontributet e Komunitetit të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

TITULLI X DISPOZITAT INSTITUCIONALE, TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

NENI 116

Me anë të kësaj Marrëveshjeje krijohet një Këshill i Stabilizim Asocimit, i cili mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e Marrëveshjes. Këshilli mblidhet në një nivel të përshtatshëm në intervale të rregullta kohe dhe kur ta kërkojnë rrethanat. Ai shqyrton çështjet më të rëndësishme që dalin në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe ato çështje dypalëshe ose ndërkombëtare me interes të përbashkët.

NENI 117

Këshilli i Stabilizim Asocimit përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarë të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, nga njëra anë, dhe anëtarë të Qeverisë së Shqipërisë, nga ana tjetër.

Këshilli i Stabilizim Asocimit vendos rregulloren e brendshme të tij.

Anëtarët e Këshillit të Stabilizim Asocimit mund të përfaqësohen, në përputhje me kushtet e parashikuara në rregulloren e brendshme.

Këshilli i Stabilizim Asocimit kryesohet me rotacion nga një përfaqësues i Komunitetit Evropian dhe një përfaqësues i Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregulloren e brendshme.

Banka Evropiane e Investimeve merr pjesë, si vëzhguese gjatë punimeve të Këshillit të Stabilizim Asocimit, për çështjet që lidhen me të.

NENI 118

Këshilli i Stabilizim Asocimit, me qëllim arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje, ka kompetencën për të marrë vendime brenda objektit të Marrëveshjes, për çështjet e parashikuara në të. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat do të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. Këshilli i Stabilizim Asocimit mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Ai harton vendimet dhe rekomandimet e tij me marrëveshje mes Palëve.

NENI 119

Palët do t'i paraqesin Këshillit të Stabilizim Asocimit çdo mosmarrëveshje që lidhet me zbatimin ose interpretimin e kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Stabilizim Asocimit mund ta zgjidhë mosmarrëveshjen nëpërmjet një vendimi detyrues.

NENI 120

Këshilli i Stabilizim Asocimit asistohet gjatë zbatimit të detyrave të tij nga Komiteti i Stabilizim Asocimit, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Bashkimit Evropian e përfaqësues të Komisionit të Komunitetit Evropian, nga njëra anë, dhe përfaqësues të Shqipërisë, nga ana tjetër. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asocimit vendos detyrat e Komitetit të Stabilizim Asocimit, të cilat përfshijnë përgatitjen e takimeve të Këshillit të Stabilizim Asocimit, dhe vendos për mënyrën e funksionimit të Komitetit

Këshilli i Stabilizim Asocimit mund t'i delegojë Komitetit të Stabilizim Asocimit cilëndo kompetencë të tij. Në këtë rast Komiteti i Stabilizim Asocimit merr vendimet e tij duke ju përmbajtur kushteve të parashikuara në nenin 117.

Këshilli i Stabilizim Asocimit mund të vendosë të ngrejë komitete ose organe të tjera të veçanta, që mund ta ndihmojë atë në kryerjen e detyrave të tij. Në rregulloren e tij të brendshme, Këshilli i Stabilizim Asocimit vendos përbërjen dhe detyrat e komiteteve apo organeve të tilla dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

NENI 121

Komiteti i Stabilizim Asocimit mund të krijojë nën-komitete.

Para përfundimit të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, Komiteti i Stabilizim Asocimit do të krijojë nën-komitetet e nevojshme për zbatimin e duhur të Marrëveshjes. Gjatë vendimmarrjes për krijimin e këtyre nën komiteteve dhe përcaktimit të termave të tyre të referencës, Komiteti i Stabilizim Asocimit merr parasysh në mënyrën e duhur rëndësinë e trajtimit të çështjeve të migrimit, veçanërisht në lidhje me zbatimin e dispozitave të neneve 80 dhe 81 të kësaj Marrëveshjeje dhe monitorimin e Planit të Veprimit të BE-së për Shqipërinë dhe rajonin fqinj.

NENI 122

Vendoset krijimi i Komitetit Parlamentar për Stabilizim Asociimin. Ky Komitet është forumi i Anëtarëve të Kuvendit Shqiptar dhe Parlamentit Evropian për të diskutuar dhe shkëmbyer mendimet e tyre. Ai mbledhet në intervale kohore që vendosen nga ai vetë.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin përbëhet nga anëtarë të Parlamentit Evropian, nga njëra anë, dhe anëtarë të Kuvendit shqiptar, nga ana tjetër.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin e vendos vetë rregulloren e brendshme.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim Asociimin kryesohet me rotacion nga Parlamenti Evropian dhe Parlamenti Shqiptar, sipas dispozitave që do të parashikohen nga rregullorja e brendshme.

NENI 123

Brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, çdo Palë merr përsipër t'u sigurojë personave fizikë dhe juridikë të Palës tjetër, pa i diskriminuar në krahasim me shtetasit e vet, të drejtën për të mbrojtur të drejtat individuale dhe të drejtat e tyre të pronës tek organet kompetente gjyqësore dhe administrative të secilës prej Palëve.

NENI 124

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk pengon një Palë të marrë masa:

të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të parandaluar publikimin e informacionit në kundërshtim me interesat thelbësorë të sigurisë;

të cilat lidhen me prodhimin ose tregtimin e armëve, municioneve ose materialeve luftarake, ose me kërkimin shkencor, zhvillimin ose prodhimin e domosdoshëm për çështjet e mbrojtjes, me kusht që këto masa të mos dëmtojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me prodhimet që nuk destinohen për qëllime specifike ushtarake;

të cilat ajo i konsideron thelbësore për sigurinë e saj, në rastin e trazirave serioze të brendshme që cenojnë ruajtjen e rendit dhe të ligjeve, në kohë lufte ose tensioni ndërkombëtar serioz që përbën një kërcënim lufte, ose me qëllim që të përmbushë detyrimet që ka pranuar për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

NENI 125

Në fushat që mbulon kjo Marrëveshje dhe pa cenuar asnjë dispozitë të veçantë të saj: Rregullimet e zbatuara nga Shqipëria në lidhje me Komunitetin nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes Shteteve Anëtare, qytetarëve të tyre, kompanive ose firmave;

Rregullimet e zbatuara nga Komuniteti në lidhje me Shqipërinë nuk duhet të jenë burim diskriminimi mes qytetarëve, kompanive dhe firmave shqiptare.

Dispozitat e paragrafit 1 nuk cenojnë të drejtën e Palëve për të zbatuar dispozitat përkatëse të legjislacionit të tyre fiskal për taksapaguesit, të cilët nuk gjenden në të njëjtën situatë për sa i përket vendbanimit të tyre.

NENI 126

Palët do të marrin të gjitha masat specifike ose të përgjithshme që duhen për të përmbushur detyrimet e dala nga kjo Marrëveshje. Ato do të kujdesen që objektivat e parashikuara në këtë Marrëveshje të përmbushen.

Nëse një nga Palët mendon se Pala tjetër ka dështuar në përmbushjen e një prej detyrimeve të kësaj Marrëveshje, ajo mund të marrë masat e duhura. Para se të veprojë në këtë mënyrë, me përjashtim të rasteve tepër urgjente, ajo i paraqet Këshillit të Stabilizim Asocimit një material me informacionin përkatës për një ekzaminim të plotë të situatës, me synim kërkimin e një zgjidhjeje të pranueshme për Palët.

Gjatë përzgjedhjes së masave, përparësi u jepet detyrimit atyre që cenojnë më pak funksionimin e kësaj Marrëveshje. Këto masa i bëhen të ditura menjëherë Këshillit të Stabilizim Asocimit dhe bëhen objekt konsultimesh në Këshillin e Stabilizim Asocimit, nëse këtë e kërkon Pala tjetër.

NENI 127

Palët bien dakord që të konsultohen, sa më shpejt që të jetë e mundur nëpërmjet kanaleve përkatëse, me kërkesë të njërit prej Palëve, për të diskutuar çdo çështje që ka të bëjë me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe aspekte të tjera relevante të marrëdhënieve ndërmjet Palëve.

Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë aspak dhe nuk cenojnë nenet 31, 37, 38, 39 dhe 43.

NENI 128

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat e siguruara nëpërmjet marrëveshjeve ekzistuese ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër, deri atëherë kur të realizohen, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, të drejta të barasvlershme të individëve dhe operatorëve ekonomikë

NENI 129

Protokollet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 dhe Shtojca I deri në VI përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programet e Komunitetit, të nënshkruar më 22 nëntor 2004ⁱ dhe Shtojca e saj janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje. Rishikimi i parashikuar në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje Kuadër kryhet nga Këshilli i Stabilizim Asocimit, që ka kompetencën të ndryshojë Marrëveshjen Kuadër nëse është e nevojshme.

NENI 130

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pakufizuar.

Secila Palë mund ta denoncojë këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër. Kjo Marrëveshje shfuqizohet gjashtë muaj pas datës së këtij njoftimi.

NENI 131

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi “Palët” nënkupton Komunitetin, ose Shtetet Anëtare të tij, ose Komunitetin dhe Shtetet Anëtare, në përputhje me kompetencat përkatëse të tyre, nga njëra anë, dhe Shqipërinë, nga ana tjetër.

NENI 132

Kjo Marrëveshje zbatohet në territoret ku zbatohen Traktatet themeluese të Komunitetit Evropian dhe të Komunitetit Evropian për Energjinë Atomike, sipas kushteve të parashikuara në këto Traktate, nga njëra anë, dhe në territorin e Shqipërisë, nga ana tjetër.

NENI 133

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian do të jetë visari i Marrëveshjes.

NENI 134

Kjo Marrëveshje hartohet në dublikatë në të gjitha gjuhët zyrtare të Palëve në tekste njëllorj autentike.

NENI 135

Palët e ratifikojnë ose miratojnë këtë Marrëveshje në bazë të procedurave të veta. Instrumentet e ratifikimit dhe miratimit depozitohen tek Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkimit Evropian. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose miratimit.

NENI 136
Marrëveshja e përkohshme

Në rastin kur në pritje të përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e disa pjesëve të Marrëveshjes, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me lëvizjen e lirë të mallrave ashtu dhe dispozitat përkatëse për Transportin, zbatohen në bazë të Marrëveshjeve të Përkohshme midis Komunitetit dhe Shqipërisë, Palët bien dakord, që në rrethana të tilla, për të përmbushur dispozitat e Titullit IV, nenit 40, 71, 72, 73 dhe 74 të kësaj Marrëveshjeje, Protokollet 1, 2, 3, 4 dhe 6, dhe dispozitat përkatëse të Protokollit 5 të kësaj Marrëveshjeje, fjalët “data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje” nënkuptojnë datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përkohshme në lidhje me detyrimet e parashikuara në dispozitat e sipërpërmendura.

NENI 137

Prej datës së hyrjes së saj në fuqi, kjo Marrëveshje do të zëvendësojë Marrëveshjen ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik, të nënshkruar në Bruksel më 11 maj 1992. Kjo nuk do të prekë asnjë të drejtë, detyrim apo situatë ligjore të palëve, të krijuara nëpërmjet ekzekutimit të asaj Marrëveshjeje.

LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca I - Koncesione Tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit
Shtojca II (a) - Tarifat koncesionare shqiptare për prodhimet primare bujqësore të prodhuara në komunitet (Përmendur Nenit 27(3)(a))
Shtojca II (b) - Tarifat e koncesioneve Shqiptare për produktet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet (referuar Nenit 27(3)(b))
Shtojca II (c) - Tarifat koncesionare Shqiptare për produktet bazë bujqësore të prodhuara në komunitet (referuar Nenit 27(3)(c))
Shtojca III Tarifat koncesionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar
Shtojca IV – (Neni 49) – Vendosija: Shërbimet financiare
Shtojca V (Neni 73) – Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare

SHTOJCA I

TARIFAT E KONÇESIONEVE SHQIPTARE PËR PRODHIMET INDUSTRIALE TË KOMUNITETIT (NENI 19)

TARIFAT DOGANORE DO TË REDUKTOHEN SI MË POSHTË:

- Në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifa doganore e importit do të reduktohet në masën 80% të taksës baze.
- Në datën 1 janar të vitit të parë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifa doganore e importit do të reduktohet në masën 60% të taksës bazë.
- Në datën 1 Janar të vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifa doganore e importit do të reduktohet në masën 40% të taksës bazë.
- Në datën 1 Janar të vitit të tretë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifa doganore e importit do të reduktohet në masën 20% të taksës bazë.
- Në datën 1 Janar të vitit të katërt pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifa doganore e importit do të reduktohet në masën 10% të taksës bazë.
- Në datën 1 Janar të vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, tarifat e mbetura të importit do të anulohen.

| | |
|------------|--|
| HS 8+ | Përshkrimi i prodhimeve |
| 2501 00 91 | - - - - Kripë e përshtatshme për konsum njerëzor |
| 2523 | Çimento Portland, çimento oksidalumini, çimento skoriesh, çimento supersulfati dhe çimento të ngjashme hidraulike, nëse janë ose jo të ngjyrosur apo në formën e klinkerit.: |
| 2710 11 25 | - - - - - Të tjera |
| 2710 11 41 | - - - - - Me një numër oktanësh (RON) më pak se 95 |
| 2710 11 70 | - - - - - Lëndë djegëse karburant të tipit jet |
| | - - - - - Vajguri |

| | |
|------------|--|
| 2710 19 21 | - - - - -Lëndë djegëse jet |
| 2710 19 25 | - - - - - Të tjera |
| 2710 19 29 | - - - - - Të tjera |
| | - - - - -Gazoilët |
| 2710 19 31 | - - - - - Për të përshkruar një proces specifik |
| 2710 19 35 | - - - - -Për të përshkruar një transformim kimik nëpërmjet një procesi ndryshe nga ato të specifikuara në nënkreun 2710 1931 |
| | - - - - -Për qëllime të tjera: |
| 2710 19 41 | - - - - - Me një përmbajtje sulfuri jo më tepër se 0,05% ndaj peshës |
| 2710 19 45 | - - - - -Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 0,05% ndaj peshës por jo më tepër se 0,02 ndaj peshës |
| 2710 19 49 | - - - - - Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 0,2% ndaj peshës |
| 2710 19 69 | - - - - - Me një përmbajtje sulfuri më tepër se 2.8% ndaj peshës |
| 2713 12 00 | -- E kalcinuar |
| 2713 20 00 | - Bitum nafte |
| 2713 90 | - Mbetje të tjera prej vajrave të naftës apo prej vajrave të fituar prej mineraleve bituminoze: |
| 2713 90 10 | - - Për prodhimin e produkteve në kreut Nr 2803 |
| 2713 90 90 | - - Të tjera |
| 3103 10 10 | - - Që përmbajnë më shumë se 35% ndaj peshës prej pentaoksid difosfori. |
| 3103 10 90 | - - Te tjera |
| 3304 91 00 | - - Pudrat, nëse janë apo jo të kompresuara |
| 3304 99 00 | - - Të tjera |
| 3305 10 00 | - Shampot |
| 3305 30 00 | - Llaqet e flokëve |

| | |
|------------|---|
| 3305 90 10 | - - Locionet e flokëve |
| 3305 90 90 | - - Të tjera |
| 3306 10 00 | - Pastat e dhëmbëve |
| 3307 10 00 | - Përgatitjet para rrojës, rrojës dhe pas rrojës |
| 3307 20 00 | - Deodorantet personale dhe ato kundër djersës |
| 3401 11 00 | - - Për përdorim tualeti (përfshire produktet mjekësore) |
| 3401 19 00 | - - Të tjera |
| 3401 20 10 | - - Fetëza, vafera, apo pluhura |
| 3401 20 90 | - - Të tjera |
| 3402 20 20 | - - Preparatet me veprim sipërfaqësor |
| 3402 20 90 | --Preparatet për larje dhe preparatet për pastrim |
| 3402 90 10 | - Preparatet me veprim sipërfaqësor |
| 3405 20 00 | - Lustruesit, kremrat dhe preparate të ngjashme për mirëmbajtjen e mobilierive prej druri apo punëve të tjera prej druri. |
| 3405 30 00 | - Llustrosësit dhe preparate të ngjashme për karrocëritë, përveçse llustrosësve metalikë |
| 3405 90 90 | - - Të tjera |
| 3923 10 00 | - Kutitë, kasat, sëndyqet dhe artikuj të ngjashëm. |
| | - Thasët dhe çantat (përfshirë konet) |
| 3923 21 00 | - - Prej polimereve të etilenit |
| 3923 29 | - - Prej plastikëve të tjera |
| 3923 29 10 | - - -Prej polivinil kloridi |
| 3923 29 90 | - - -Të tjera |
| 3924 | Pajisjet e tavolinës, të kuzhinës, artikuj të tjerë shtëpiakë dhe artikuj të tualetit, prej plastike: |

| | |
|------------|---|
| 3924 10 00 | - Artikuj të tavolinës dhe të kuzhinës |
| 3924 90 | - Të tjera: |
| | - - Prej celuloze të rigjeneruar: |
| 3924 90 11 | - - - Sfungjerët |
| 3924 90 19 | - - -Të tjera |
| 3924 90 90 | - - Të tjera |
| 3925 10 00 | - Rezervuarët, depozitat dhe kontenierë të ngjashëm të një kapaciteti më tepër se 300 litra |
| 3926 | Artikuj të tjerë prej plastike dhe artikuj prej materialeve të tjera të krerëve nr. 3901 deri 3914: |
| | - Goma të riveshura: |
| 4012 11 00 | - - Të një lloji përdorur në autovetura(përfshirë “station wagon”) dhe makinat e garave |
| 4012 12 00 | - -Të një lloji përdorur në autobusë dhe kamionë |
| 4012 13 90 | - - - Të tjera |
| 4012 20 90 | - - Të tjera |
| 4012 90 20 | - - Gomat e mëdha apo goma jastëk |
| 6401 10 | - Veshjet e këmbëve me një majë mbrojtëse metalike: |
| 6401 10 10 | - -Me syprinat prej gome |
| 6401 10 90 | - - Me syprina prej plastike |
| | - Veshje të tjera këmbë |
| 6401 91 | - - Që e mbulojnë gjurin |
| 6401 91 10 | - - - Me syprinat prej gome |
| 6401 91 90 | - - - - Me syprina prej plastike |
| 6401 92 | - - Që mbulojnë kavigjen, por nuk mbulojnë gjurin: |
| 6401 92 10 | - - - Me syprinat prej gome |

| | |
|------------|---|
| 6401 92 90 | - - - Me syprina prej plastike |
| 6401 99 | - - Të tjera: |
| 6401 99 10 | - - - Me syprinat prej gome |
| 6401 99 90 | - - - - Me syprina prej plastike |
| 6402 99 50 | - - - - Shapka dhe veshje të tjera këmbësh për brenda në shtëpi |
| 6404 19 90 | - - - Të tjera |
| 6404 20 | - Veshje të këmbëve me shuallin e jashtëm prej lëkure apo prej lëkure të ripunuar: |
| 6404 20 10 | - - Shapka dhe veshje të tjera këmbësh për brenda në shtëpi |
| 6404 20 90 | - - Te tjera |
| 6405 | Veshje të tjera këmbë: |
| 6405 10 | - Me syprinën prej lëkure apo prej lëkure të ripunuar: |
| 6405 10 10 | - - Me shollën e jashtme prej druri apo tape |
| 6405 10 90 | - - - Me shollën e jashtme prej materialeve të tjera |
| 6405 20 | - Me syprinën prej material tekstili: |
| 6405 20 10 | - - Me shollën e jashtme prej druri apo tape |
| | - - Me shollën e jashtme prej materialeve të tjera |
| 6405 20 91 | - - - Shapka dhe veshje të tjera këmbësh për brenda në shtëpi |
| 6405 20 99 | - - - Të tjera |
| 6405 90 | - Të tjera: |
| 6405 90 10 | - - Me shollën e jashtme prej gome, plastike, lëkure apo lëkure të ripunuar |
| 6405 90 90 | - - Me shollën e jashtme prej materialeve të tjera |
| 6406 | Pjesët e veshjeve të këmbëve (përfshirë syprinën nëse është apo jo e ngjitur tek shualli përveç shuallit të jashtëm); shualli i brendshëm i lëvizshëm, mbushje të takave dhe artikuj të ngjashëm; gjunjakët, mbajtëse kërcinjsh dhe artikuj të ngjashëm, dhe pjesët e tyre: |

| | |
|------------|--|
| 640610 | - Syprinat dhe pjesët prej tyre, përveç pajandrave: |
| | - - Prej lëkure: |
| 6406 10 11 | - - - Syprinat |
| 6406 10 19 | - - - Pjesë të syprinave |
| 6406 10 90 | - - Prej materialeve të tjera |
| 6904 | Tullat ndërtuese qeramike, blloqet e dyshemeve, pllaka mbështetëse apo mbushëse dhe të ngjashmet e tyre: |
| 6904 10 00 | - Tullat ndërtuese |
| 6904 90 00 | - Të tjera |
| 6905 | Pllaka çatie, pllaka për oxhaqe, mbulesa të tubit të tymit, deflektorë, ornamente arkitekturale dhe mallra të tjera qeramike ndërtimore: |
| 6905 10 00 | - Pllaka çatie |
| 6905 90 00 | - Të tjera |
| 6907 | Pllaka dhe kalldrëme qeramike të paglazuruara, pllaka dyshemeje e muresh qeramike të paglazuruara; kube mozaikësh dhe të ngjashmet e tyre qeramike të paglazuruara, nëse janë apo jo me bazament : |
| 6908 | Pllaka e kalldrëme qeramike të glazuruara, pllaka për dyshemenë dhe për muret të glazuruara, nëse janë apo jo në bazament : |
| 7213 10 00 | - Qe përmbajnë dhëmbëzime, brazda, flinxha apo deformime të tjera të prodhuara prej procesit të petëzimit (ECSC) |
| 7213 91 10 | - - - Te një lloji të përdorur për përforcimin e betonit (ECSC) |
| 7213 91 20 | - - - Te një lloji të përdorur për tasat e rrotave (ECSC) |
| | - - - Te tjera : |
| 7213 91 41 | - - - - Qe përmbajnë ndaj peshës 0,06 % apo me pak karbon (ECSC) |
| 7213 91 49 | - - - - Qe përmbajnë ndaj peshës me shume se 0,06 % por me pak se 0,25 % karbon (ECSC) |
| 7213 91 70 | - - - - Qe përmbajnë ndaj peshës 0,25 % apo me shume por jo me shume se 0,75 % karbon |

| | |
|------------|--|
| | (ECSC) |
| 7212 91 90 | - - - - Qe përmbajnë ndaj peshës me shume se 0,75 % karbon (ECSC) |
| 7213 99 | - - Te tjera : |
| 7213 99 10 | - - - Qe përmbajnë ndaj peshës me pak se 0,25 % karbon (ECSC) |
| 7214 10 00 | - Të farkëtuara |
| 7214 20 00 | - Qe përmbajnë dhëmbëzime, brazda, flaxha apo deformime te tjera te prodhuara gjate procesit te petëzimit apo te përdredhura pas petëzimit |
| 7214 91 10 | - - - Qe përmbajnë ndaj peshës me pak se 0,25 % karbon (ECSC) |
| 7214 91 90 | - - - Qe përmbajnë ndaj peshës 0,25 % apo me shume karbon (ECSC) |
| 7214 99 | - - Te tjera : |
| | - - - Qe përmbajnë ndaj peshës me pak se 0,25 % karbon : |
| 7214 99 10 | - - - - Te një lloji te përdorur zakonisht për përforcimin e betonit (ECSC) |
| | - - - - Te tjera, te seksionit kryq rrethor me diametër me mase : |
| 7214 99 31 | - - - - - 80 mm apo me shume (ECSC) |
| 7214 99 39 | - - - - - Me pak se 80 mm (ECSC) |
| 7214 99 50 | - - - - - Te tjera (ECSC) |
| | - - - Qe përmbajnë ndaj peshës 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon : |
| | - - - - Te seksionit kryq rrethor me diametër me mase : |
| 7214 99 71 | - - - - - 80 mm apo me shume (ECSC) |
| 7214 99 79 | - - - - - Me pak se 80 mm (ECSC) |
| 7214 99 80 | - - - - Të tjera |
| 7214 99 90 | - - - Që përmban me peshë 0.6% ose me shumë karbon |
| 7306 60 31 | - - - - Nuk e kalon 2 mm |
| 7306 60 39 | - - - - E kalon 2 mm |

| | |
|---------------|---|
| 7306 60 90 | - - - Te seksioneve te tjera : |
| 7306 90 00 | - Te tjera |
| 7326 90 97 00 | - - -Te tjera |
| 7408 11 00 | - - Prej te cilëve dimensiononi kryq seksional maksimal e kalon te 6 mm |
| 7408 19 | - - Te tjera : |
| 7408 19 10 | - - - Prej te cilëve dimensiononi maksimal kryq seksional i tejkalon 0,5 mm |
| 7408 19 90 | - - - Prej te cilëve dimensiononi maksimal kryq seksional nuk i kalon 0,5 mm |
| 7413 00 91 | - - Prej bakri te rafinuar |
| 8544 | Telat e izoluar (përfshi te smaltuar ose te anodizuara) kabllot e izoluar (përfshi kabllot koaksiale) dhe përcjellës te tjerë elektrike te izoluar, te përshtatur ose jo me lidhëse; kabllot me fibra optike, te bere nga fibra individuale me lëvozhgë, nëse janë te montuara ose jo me përcjellëse elektrike ose te përshtatur me lidhëse : |
| | - Telat e mbështjella: |
| 854411 | - - Prej bakri : |
| 8544 11 10 | - - - Te llakuara apo te emaluara |
| 8544 11 90 | - - - Te tjera |
| 8544 19 | - - Te tjerë : |
| 8544 19 10 | - - - Te llakuara apo te emaluara |
| 8544 19 90 | - - - Te tjera |
| 8544 20 00 | - Përcjellëset elektrike te kabullit koaksial dhe te tjerë koaksiale |
| 8544 59 10 | - - - Tela dhe kabllot, me tela përcjellës individual te një diametri me tepër se 0,51 mm |
| | - - - Te tjera : |
| 8544 59 20 | - - - - Për një voltazh prej 1 000 V |
| 8544 59 80 | - - - - Për një voltazh me tepër se 80V por me pak se 1000 V |
| 8544 60 | - Përcjellëset e tjerë elektrike, për një tension qe e kalon 1,000 V : |

| | |
|------------|--|
| 8544 60 10 | - - Me përcjellës bakri |
| 8544 60 90 | - - Me përcjellës te tjera |
| 9403 30 | - Mobilie prej druri te një lloji te përdorura ne zyra : |
| | - - Jo me shume se 80 cm te larta : |
| 9403 30 11 | - - - Tavolinat e punës |
| 9403 30 19 | - - - Te tjera |
| | - - Me shume se 80 cm te larta : |
| 9403 30 91 | - - - Rafta me dyer, kanata apo derëza; kabinete te dosjeve, te indeksit te kartave dhe te tjera |
| 9403 30 99 | - - - Te tjera |
| 9403 40 | - Mobilie prej druri te një lloji te përdorura ne kuzhine : |
| 9403 40 10 | - - Komplekse kuzhine te përshtatura |
| 9403 40 90 | - - Te tjera |
| 9403 60 30 | - - Mobilie prej druri te një lloji te përdorur ne dyqane |

SHTOJCA II(a)

TARIFAT KONCENSIONARE SHQIPTARE PËR PRODHIMET
PRIMARE BUJQESORE TË PRODHUARA NE KOMUNITET
(përmendur nenit 27(3)(a))

të përjashtuara nga tarifat doganore për sasi të pakufizuara, që nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes

| kodiii hs | përshkrimi |
|------------|--|
| 0101.10.10 | - - kuajt (1) |
| 0101.10.90 | - - te tjera |
| 0102.10.10 | - - vica (gjedhet femra qe nuk kane pjelle) |
| 0102.10.30 | - - lopët |

| | |
|------------|---|
| 0102.10.90 | -- te tjera |
| 0102.90.29 | ---- te tjera |
| 0103.10.00 | - kafshe te racës se pastër (2) |
| 0103.91.10 | --- te llojit shtëpiak |
| 0103.91.90 | --- te tjera |
| 0103.92.11 | ---- dosa qe kane pjelle te paktën një here, te një peshe jo me pak se 160 kg |
| 0103.92.19 | ---- te tjera |
| 0103.92.90 | --- te tjera |
| 0104.10.10 | -- te racës se pastër |
| 0104.10.30 | --- qengja (deri ne një vjeç) |
| 0104.10.80 | --- te tjera |
| 0104.20.10 | -- te racës se pastër (1) |
| 0104.20.90 | -- te tjera |
| 0105.11.11 | ---- kllaçka |
| 0105.11.19 | ---- te tjera |
| 0105.11.91 | ---- kllaçka |
| 0105.11.99 | ---- te tjera |
| 0105.12.00 | -- gjela dhe pula deti |
| 0105.19.20 | --- pata |
| 0105.19.90 | --- rosa dhe shpendë Indie |
| 0105.92.00 | -- shpendë te llojit gallus domesticus, me peshe jo me shume se 2 000 g |
| 0106.11.00 | -- primatët |
| 0106.19.10 | --- lepujt shtëpiake |
| 0106.19.90 | --- te tjera |

| | |
|------------|--|
| 0106.20.00 | - zvarraniket (përfshirë gjarpërinjtë dhe breshkat detare) |
| 0106.31.00 | - - shpendët grabitqare |
| 0106.32.00 | - - psittaciformes (duke përfshirë papagallët, papagall trupvogël, macaws dhe cockatoos) |
| 0106.39.10 | - - - pëllumbat |
| 0106.39.90 | - - - te tjera |
| 0106.90.00 | - te tjera |
| 0205.00.11 | - - i freskët apo i ftohte |
| 0205.00.19 | - - i ngrire |
| 0205.00.20 | - - i freskët apo i ftohte |
| 0205.00.80 | - - i ngrire |
| 0205.00.90 | - i gomareve, mushkave apo hibridit të gomaricës me kalin |
| 0206.10.10 | - - për prodhimin e produkteve farmaceutike |
| 0206.29.10 | - - - për prodhimin e produkteve farmaceutike |
| 0206.30.00 | - i ftohte |
| 0206.41.00 | - - melci : |
| 0206.80.10 | - - për prodhimin e produkteve farmaceutike |
| 0206.90.10 | - - për prodhimin e produkteve farmaceutike |
| 0404.10.02 | - - - - - jo më tepër se 1,5 % |
| 0404.10.04 | - - - - - më tepër se 1,5 % por jo më tepër se 27 % |
| 0404.10.06 | - - - - - më tepër se 27 % |
| 0404.10.12 | - - - - - jo më tepër se 1,5 % |
| 0404.10.14 | - - - - - më tepër se 1,5 % por jo më tepër se 27 % |
| 0404.10.16 | - - - - - më tepër se 27 % |
| 0407.00.11 | - - - te gjelave të detit apo te patave |

| | |
|------------|---|
| 0407.00.19 | - - - te tjera |
| 0410.00.00 | produkte te ngrënshme me origjine prej kafshëve, te papërfshira dhe te paspecifikuara diku tjetër. |
| 0504.00.00 | te brendshmet, fshikëzat dhe stomakët e kafshëve (përveç atyre te peshkut), te plota dhe pjese prej tyre, te freskëta, te ftohta, te ngrira, te kripura, ne ujë me kripe, te thara apo te tymosura. |
| 0601.10.10 | - - hyacinths |
| 0601.10.20 | - - narcise |
| 0601.10.30 | - - tulipanet |
| 0601.10.40 | - - gladiolat |
| 0601.10.90 | - - te tjera |
| 0601.20.10 | - - rrënjët dhe bimët cikore |
| 0601.20.30 | - - orkitet, hyacinths, narcisë dhe tulipanë |
| 0601.20.90 | - - te tjera |
| 0602.10.90 | - - te tjera |
| 0602.20.90 | - - te tjera |
| 0602.30.00 | - beronjat dhe azalë, te shartuara apo jo |
| 0602.40.10 | - - as me gonxhe as te shartuara |
| 0602.40.90 | - - me gonxhe apo te shartuara |
| 0602.90.10 | - - spore kërpudhash |
| 0602.90.20 | - - bimët e ananasit |
| 0602.90.30 | - - bimët e luleshtrydheve dhe te zarzavateve |
| 0602.90.41 | - - - - - pemët e pyllit |
| 0602.90.45 | - - - - - prerje te rrënjëzuara dhe bimët e reja |
| 0602.90.49 | - - - - - te tjera |

| | |
|------------|--|
| 0602.90.51 | - - - - - bimët pereniale (qe rrojnë për me shume se 2 vjet) |
| 0602.90.59 | - - - - - te tjera |
| 0602.90.70 | - - - - prerje te rrënjëzuar dhe bimët e reja, duke përjashtuar kaktusin |
| 0602.90.91 | - - - - - bimët qe çelin lule, me gonxhe apo me lule, duke përjashtuar kaktusin |
| 0602.90.99 | - - - - - te tjera |
| 0701.10.00 | - fara |
| 0703.20.00 | - hudhra |
| 0705.21.00 | - - cikore witloof (<i>cichorium intbus</i> var. <i>foliosum</i>) |
| 0706.90.30 | - - rrepa (<i>cochlearia armoracia</i>) |
| 0709.51.00 | - - kërpudha te llojit <i>agaricus</i> |
| 0709.59.10 | - - - chanterelles |
| 0709.59.30 | - - - kërpudha flap |
| 0709.59.90 | - - - te tjera |
| 0711.51.00 | - - kërpudha te llojit <i>agaricus</i> |
| 0711.90.10 | - - - fruta te llojit <i>capsicum</i> apo te llojit <i>pimenta</i> , duke përjashtuar specat |
| 0711.90.50 | - - - qepe |
| 0711.90.80 | - - - te tjera |
| 0712.31.00 | - - kërpudha te llojit <i>agaricus</i> |
| 0712.32.00 | - - wood ears (<i>auricularia</i> spp.) |
| 0712.33.00 | - - jelly fungi (<i>tremella</i> spp.) |
| 0712.39.00 | - - te tjera |
| 0713.10.10 | - - për mbjellje |
| 0713.33.10 | - - - për mbjellje |
| 0713.40.00 | - thjerrëza |

| | |
|------------|--|
| 0713.50.00 | - bathe (vicia faba var. major) e bathe kuajsh (vicia faba var. equina,vicia faba var. minor) |
| 0713.90.00 | - - te tjera |
| 0713.90.10 | - - për mbjellje |
| 0713.90.90 | - - te tjera |
| 0714.10.10 | - - sfera te miellit dhe te bollgurit |
| 0714.10.91 | - - - te një lloji te përdorur për konsum njerëzor, ne paketime vendosur për shitje me pakice me një përmbajtje neto jo me tepër se 28 kg, ose te freskëta dhe te plota ose pa lëkurë dhe te ngrira, nëse janë apo jo ne feteza |
| 0714.10.99 | - - - te tjera |
| 0714.20.10 | - - te freskëta, te plota, te destinuara për konsum njerëzor |
| 0714.20.90 | - - te tjera |
| 0714.90.11 | - - - te një lloji te përdorur për konsum njerëzor, ne paketime te vendosur për shitje me pakice me një përmbajtje neto jo me tepër se 28 kg, ose te freskëta dhe te plota ose pa lëkurë dhe te ngrira, nëse janë apo jo ne feteza |
| 0714.90.19 | - - - te tjera |
| 0714.90.90 | - - te tjera |
| 0801.22.00 | - - pa guaske |
| 0802.11.10 | - - - te hidhura |
| 0802.11.90 | - - - te tjera |
| 0802.12.10 | - - - te hidhura |
| 0802.12.90 | - - - te tjera |
| 0802.90.20 | - - arra, areca, cola dhe amerikane |
| 0802.90.50 | - - arrat e pishës |
| 0802.90.60 | - - arrat macadamia |
| 0803.00.90 | - te thara |
| 0804.40.00 | - avokado ☀ |

| | |
|------------|---|
| 0805.40.00 | - grejpfruit ☀ |
| 0805.90.00 | - te tjera |
| 0806.20.11 | - - - rrush pa fara |
- f) "çmimi ex-work" do të thotë çmimi i paguar për produktin ex-work tek prodhuesit e produktit në Komunitet ose në Shqipëri në të cilët ndërmerret procesi apo puna përfundimtare, që siguron çmimin që përfshin vlerën e të gjithë materialeve të përdorura, minus taksat e brendshme të cilat janë, ose mund të jenë ripaguar kur produkti i përfutur eksportohet;
- g) "vlera e materialeve" do të thotë vlera doganore në kohën e importimit të materialeve të përdorura jo origjinuese, ose, nëse kjo nuk është e njohur dhe nuk mund të përcaktohet, çmimi i parë i përcaktuar i paguar për materialet në Komunitet dhe Shqipëri;

- h) "vlera e materialeve origjinuese" do të thotë vlera e materialeve të tilla siç është përcaktuar në nënparagrafin (g) të aplikuara mutatis mutandis;
- i) "vlera shitesë" merret nga çmimi ex-work minus vlerën doganore të secilit nga materialet e përfshira, të krijuar në Palën tjetër Kontraktuese ose, kur vlera doganore nuk është e njohur ose nuk mund të jetë e vërtetuar, çmimi i parë i vërtetuar i paguar për materialet në Komunitet ose në Shqipëri.
- j) "kapituj" dhe "krerët" do të thotë kapitujt dhe krerët (kodet katër-shifrore) të përdorura në nomenklaturë të cilat përbëjnë Përshkrimin e Harmonizuar të Mallrave dhe Sistemin e Kodeve, referuar në këtë protokoll si "Sistemi i Harmonizuar" ose "HS";
- k) "i klasifikuar" i referohet klasifikimit të një produkti ose materiali nën një kre të veçantë;
- l) "dërgesa" do të thotë produkte që janë dërguar në mënyrë të njëkohshme nga një eksportues të një marrës ose të shoqëruara me një dokument të vetëm transporti që mbulon transportimin e tyre nga një eksportues të një marrës ose, në mungesë të një dokumenti të tillë, nga një faturë e vetme;
- m) "territore" përfshijnë ujërat territoriale.

TITULLI II

PËRKUFIZIMI I KONCEPTIT "PRODUKTE ORIGJINUESE"

NENI 2

Kërkesa të përgjithshme

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si origjinuese në Komunitet:

- (a) produktet tërësisht të përfituara në Komunitet në përputhje me kuptimin e Nenit 5;
- (b) produkte të përfituar në Komunitet që përfshijnë materiale që nuk kanë qenë tërësisht të përfituara atje, me kusht që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo procese të mjaftueshme në Komunitet në përputhje me Nenin 6;

2. Për qëllime të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, produktet e mëposhtme do të konsiderohen si origjinuese në Shqipëri:

- (a) produktet tërësisht të përfituara në Komunitet në përputhje me kuptimin e Nenit 5;
- (b) produkte të përfituar në Komunitet që përfshijnë materiale që nuk kanë qenë tërësisht të përfituara atje, me kusht që materiale të tilla kanë kaluar në punime apo procese të mjaftueshme në Komunitet në përputhje me Nenin 6;

NENI 3

Kumulimi Bilateral i Origjinës në Komunitet

Materialet origjinuese në Shqipëri do të konsiderohen si materiale origjinuese në Komunitet kur përfshihen në një produkt të përfutuar atje.

Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar punime apo procese të mjaftueshme, me kusht që t'i jenë nënshtruar punimeve apo proceseve përtej atyre që u referohet Neni 7 (1).

NENI 4

Kumulimi Bilateral i Origjinës në Shqipëri

Materialet origjinuese në Komunitet do të konsiderohen si materiale origjinuese në Shqipëri kur përfshihen në një produkt të përfutuar atje.

Nuk është e nevojshme që materiale të tilla të kenë kaluar punime apo procese të mjaftueshme, me kusht që t'i jenë nënshtruar punimeve apo proceseve përtej atyre që u referohet Neni 7 (1).

NENI 5

Produkte tërësisht të përfuturara

1. Produktet e mëposhtme do të konsiderohen si tërësisht të përfuturara në Komunitet ose në Shqipëri:

- (a) produkte minerale të nxjerra nga shtresat e tyre tokësore dhe nëntoka ujore e detit;
- (b) produktet bimore të korrura atje;
- (c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;
- (d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;
- (e) produkte të përfuturara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;
- (f) produkte të peshkimit ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të Komunitetit ose Shqipërisë nga barkat e tyre;
- (g) produkte të prodhuara në bordet e anijeve të tyre fabrikë ekskluzivisht nga produktet e referuara në nënparagrafin (f);
- (h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, që përshtaten vetëm për mbulimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për ritrajtim ose që përdoren si mbetje;
- (i) mbetje dhe skrape të rezultuara nga operacionet e përpunimit të kryera atje;
- (j) produkte të nxjerra nga shtresat ose nënshtresat tokësore në ujërat detare, jashtë ujërave të tyre territoriale, me kusht që ato kanë të drejtën vetëm këto shtresa apo nënshtresa;
- (k) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuar në nënparagrafin (a) deri (j).

2. Termi “barkat e tyre” dhe “anijet e tyre fabrike” në paragrafin 1(f) dhe (g) do të aplikohen vetëm për barkat dhe anijet fabrikë:

- (a) të cilat janë të regjistruara ose të mbajtura në Shtetet Anëtare ose në Shqipëri;

- (b) të cilat lundrojnë nën flamurin e Shteteve Anëtare ose në Shqipëri;
- (c) të cilat janë në pronësi të mbi të paktën 50 për qind nga nënshtetasit e Shteteve Anëtare ose Shqipërisë, ose nga një kompani me zyrat e saj kryesore në një nga këto shtete, menaxheri apo menaxheret e të cilëve, Kryetari i Bordit të Drejtorëve ose Bordi Supërvizor dhe shumica e anëtareve të bordeve të tilla janë nënshtetas të Shteteve Anëtare ose Shqipërisë dhe të cilët, në shtesë, në rastin e bashkëpronësisë ose kompanive të kufizuara, të paktën gjysma e kapitalit i përket këtyre shteteve ose institucioneve publike apo nënshtetasve të Shteteve të mësipërme;
- (d) e të cilit pronarët dhe zyrtarët janë nënshtetas të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë; dhe
- (e) e të cilit të paktën 75 për qind e ekuipazhit janë nënshtetas të Shteteve Anëtare ose Shqipërisë .

NENI 6

Produkte të punuar ose të përpunuar në masë të mjaftueshme

1. Për qëllime të Nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfituara konsiderohen të punuara ose kaluara në proces të mjaftueshëm kur kushtet e vendosura në listën e Aneksit II janë plotësuar.

Kushtet e referuara në paragrafin e mësipërm, për të gjithë produktet që mbulon kjo Marrëveshje, punimi ose përpunimi nën të cilat do të kalojnë materialet jo origjinuese të përdorura për prodhim dhe do të aplikohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Përkatësisht nëse një produkt i cili ka kërkuar statusin e origjinës duke plotësuar kushtet e vendosura në listë, është përdorur në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e aplikueshme ndaj një produkti në të cilin ai është bashkuar nuk aplikohen në të, dhe nuk do të merren parasysh materialet jo origjinuese të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet jo origjinuese të cilat, sipas kushteve të vendosura në listë, nuk do të përdoren në prodhimin e një produkti, mund edhe të përdoren, pasi të sigurohet që :

- (a) vlera e tyre totale nuk i kalon 10 për qind të çmimit ex-works të produktit;
- (b) ndonjë nga përqindjet e dhëna në listë për maksimumin e vlerës së materialeve jo origjinuese nuk tejkalohen përmes aplikimit të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk do të aplikohet për produktet që rrjedhin nga Kapitulli 50 deri në 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 do të aplikohen si objekt i dispozitave të Nenit 7.

NENI 7

Operacionet e punimeve ose përpunimeve të pamjaftueshme

1. Pa paragjykuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtëm do të konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin e origjinës së produktit, nëse janë plotësuar ose jo kërkesat e Nenit 5:

- (a) kryerja e operacioneve për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;
- (b) thyerjet dhe bashkimet e paketimeve;
- (c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, njollave apo mbetjeve të tjera;
- (d) hekurosja ose presimi i tekstileve;
- (e) operacionet e thjeshta të lyerjeve apo shkëlqimit;
- (f) tharja, zbardhimi i pjesshëm ose i përgjithshëm, shkëlqimi dhe ndriçimi i farërave dhe orizit;
- (g) operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit;
- (h) qërimi, pastrimi i pjesës së brendshme të frutave, perimeve dhe arrave;
- (i) ndarjet, bluarjet ose prerjet e thjeshta;
- (j) heqja e pjesëve mbuluese, mbrojtja nga dëmtuesit e jashtëm, përzgjedhjet, klasifikimi, përshkallëzimet dhe matjet (duke përfshirë vendosjen e pjesëve të artikujve);
- (k) thjesht vendosjet në shishe, kanoçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, sirtarë, fiksimi në to i letrave ose mbështjellësve si dhe të gjithë operacionet e tjera të paketimit të thjeshtë;
- (l) fiksimi ose printimi i markave, etiketave, logove si dhe i shenjave të tjera të dallueshme mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;
- (m) përzierje e thjeshtë e produkteve, nëse po ose jo i llojeve të ndryshme;
- (n) bashkimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përfunduar një material të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;
- (o) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafët nga (a) në (n);
- (p)therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet që kryhen në Komunitet ose në Shqipëri në një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku, në rastet kur përcaktohet se punimet ose proceset mbi të cilat ka kaluar produkti, janë të pamjaftueshme brenda kuptimit të paragrafit 1.

NENI 8

Njësia e Kualifikimit

1. Njësia e Kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij Protokolli do të jetë produkti i veçantë i cili konsiderohet si njësi bazë kur për përcaktimin e klasifikimit përdoret nomenklatura e Sistemit të Harmonizuar.

Përkatësisht, procedohet si më poshtë:

- (a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar nën termat e Sistemit të Harmonizuar në një kre të vetëm, e tëra përbën njësinë e klasifikimit;
- (b) kur një dërgesë përfaqëson një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin kre të Sistemit të Harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht në rastin e aplikimit të dispozitave të këtij Protokolli.

2. Kur, nën Rregullin e Përgjithshëm 5 të Sistemit të Harmonizuar, paketimi përfshihet bashkë me produktin për qëllime klasifikimi, ai do të përfshihet për qëllim të përcaktimit të origjinës.

NENI 9

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet të lidhura me një pjese pajisjeje, makine, aparati apo mjeti, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose nuk janë të ndara dukshëm në faturë, do të konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit në fjalë.

NENI 10

Kompletet

Kompletet, sipas përcaktimit në Rregullin e Përgjithshëm 3 të Sistemit të Harmonizuar, do të konsiderohen si origjinuese kur të gjithë produktet përbërës janë origjinues. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte origjinuese dhe jo origjinuese, kompleti si i tërë do të konsiderohet si origjinues, me kusht që vlera e produkteve jo origjinuese të mos kalojë 15 për qind të çmimit “ex work” të kompletit.

NENI 11

Elementët neutrale

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është origjinues, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e zërave të mëposhtme të cilët mund të jenë përdorur gjatë prodhimit të tij:

- (a) energjia elektrike dhe karburanti;
- (b) toka dhe pajisjet;
- (c) makineritë dhe veglat;
- (d) mallrat të cilat nuk hyjnë dhe të cilat nuk synohen të përfshihen në përbërjen finale të produktit.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

NENI 12

Parimet e territorialitetit

1. Kushtet për përfitim të statusit origjinues të përcaktuar në Titullin II, duhet të plotësohen pa ndërprerje nga Komuniteti ose nga Shqipëria.

2. Nëse, kur mallrat e eksportuara origjinuese nga Komuniteti ose nga Shqipëria në një vend tjetër kthehen, ato duhet të konsiderohen si jo origjinuese, ndryshe kjo gjë duhet demonstruar me qëllim që autoritetet doganore të binden se:

- (a) mallrat e kthyer janë të njëjta me ato që janë eksportuar; dhe
- (b) ato nuk kanë kaluar në ndonjë proces tjetër përtej atyre të nevojshme për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës që kanë ndënjur në atë vend ose gjatë eksportimit.

3. Përftimi i statusit origjinës në përputhje me kushtet e përcaktuara në Titullin II nuk do të ndikohen nga punime apo përpunime të kryera jashtë Komunitetit ose Shqipërisë ndaj materialeve të eksportuara nga Komuniteti ose Shqipëria dhe ri-importuar atje, duke siguruar që :

(a) materialet në fjalë janë plotësisht të përfuara në Komunitet ose Shqipëri ose mbi to janë kryer punime apo përpunime përtej operacioneve të pamjaftueshme të listuara në Nenin 7 përpara se të jenë të eksportuara ; dhe

(b) të demonstrohet për të bindur autoritetet doganore që:

(i) mallrat e ri-importuara kanë qenë përfuar nga punime apo procese të materialeve të eksportuara; dhe

(ii) vlera totale e shtuar e përfuar jashtë Komunitetit ose Shqipërisë sipas zbatimit të dispozitave të këtij Neni, nuk kalon 10 % të çmimit “ex work” të produktit përfundimtar për të cilin është kërkuar statusi origjinës .

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përfitimin e statusit origjinës përcaktuar në Titullin II nuk do të zbatohen për punime apo procese të bëra jashtë Komunitetit ose Shqipërisë. Në rastet kur, në listën e Aneksit II, rregulli i përcaktuar që ka të bëjë me vlerën maksimale të të gjithë materialeve të bashkangjitura jo origjinuese, zbatohet në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve të bashkangjitura jo origjinuese në territorin e Palës përkatëse së interesuar, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përfuar jashtë Komunitetit ose Shqipërisë sipas zbatimit të dispozitave të këtij Neni, nuk duhet të tejkalojë përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafit 3 dhe 4, “vlera totale e shtuar” do të merret në kuptimin e të gjithë kostove të bëra jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, përfshi dhe vlerën e materialeve të bashkangjitura atje.

6. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen ndaj produkteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e Aneksit II dhe të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohen vlerat e përgjithshme të përcaktuara në Nenin 6 (2).

7. Dispozitat e paragrafit 3 dhe 4 nuk do të zbatohen për produktet e kapitujve nga 50 ne 63 të Sistemit të Harmonizuar.

8. Për ndonjë lloj punimi apo procesi që është objekt i dispozitave të këtij Neni dhe është kryer jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, duhet proceduar me marrëveshje të proceduara jashtë Komunitetit ose Shqipërisë, ose marrëveshje të ngjashme.

NENI 13

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i siguruar në Marrëveshje aplikohet vetëm për produktet, që plotësojnë kërkesat e këtij Protokoll, të cilat janë transportuar drejtpërsëdrejti mes Komunitetit dhe Shqipërisë. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjerë dhe, nëse paraqitet e nevojshme, lëvizje transit ose magazinim i përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të mbeten nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të

vendit transit ose të magazinimit dhe nuk kryejnë operacione të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacion tjetër me synim për t'i mbajtur ato në kushte të mira.

Produktet origjinuese mund të transportohen me nënkalime përmes territorit përveç se ndryshe nga ato të Komunitetit ose Shqipërisë.

2. Të dhënat që vërtetojnë se kushtet e vendosura në paragrafin 1 janë plotësuar tërësisht duhet ti jepen autoriteteve doganore të vendit importues, të cilat duhet të përfshijnë:

- (a) një dokument të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit transit: ose
- (b) një certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit:
 - (i) duke dhënë një përshkrim të saktë të produkteve;
 - (ii) duke paraqitur datat e shkarkimit dhe ngarkimit të produkteve dhe, nëse është e zbatueshme, emrat e anijeve, ose llojet e tjera të transportit të përdorur; si dhe
 - (iii) një vërtetim të kushteve nën të cilat ka qëndruar produkti në vendin transit:
- (c) nëse nuk mundësohen këto dokumente, ndonjë dokument tjetër thelbësor.

NENI 14

Ekspozitat

1. Produktet origjinuese, të dërguara për ekspozim në një vend tjetër të ndryshëm nga Komuniteti ose Shqipëria do të përfitojnë në lidhje me këtë importim, nga dispozitat e Marrëveshjes, pasi të ketë siguruar autoritetet doganore që:

- (a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga Komuniteti ose Shqipëria në vendin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;
- (b) produktet janë shitur ose në të kundërt i janë vënë në dispozicion nga ky eksportues personit në Komunitet ose Shqipëri;
- (c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas tij në shtetin në të cilin ato janë dërguar për ekspozim; dhe
- (d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Vërtetimi i origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V dhe të jetë depozituar pranë autoriteteve doganore të vendit importues në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur paraqitet e nevojshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e ekspozimit të produkteve.

3. Paragrafi 1 do të aplikohet për çdo lloj ekspozimi, prezantimi të thjeshtë apo panairi publik tregtar, industrial, bujqësor, ose për mjete udhëtimi apo transportimi, të cilët nuk duhet të jenë të organizuara për qëllime private në dyqane apo biznese me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilëve produktet i nënshtrohen kontrollit doganor.

TITULLI IV
TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI
NENI 15

Ndalimi i tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga, tarifat doganore

1. Materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e një produkti origjinës në Komunitet ose në Shqipëri, për të cilat vërtetimi i origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e Titullit V nuk do të jenë subjekt, në Komunitet ose Shqipëri, subjekt tërheqjeje prej, ose përjashtimi nga, detyrimet doganore të çdo lloji.
2. Ndalimi në paragrafin 1 do të aplikohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, anulimi i borxheve ose jo-pagesave, pjesore ose tërësore, të detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera më të njëjtin efekt, të aplikueshme në Komunitet ose në Shqipëri, për materialet e përdorura në prodhim, ku rimbursimet, anulimet e borxheve ose mos-pagimet e tilla aplikohen, shprehimisht ose me efekt, kur produktet e përfuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim shtëpiak atje.
3. Eksportuesi i produkteve mbuluar nga vërtetimi i origjinës duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se asnjë tërheqje nuk është bërë në lidhje me materialet jo origjinuese të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera më të njëjtin efekt të aplikueshme në të tilla materiale aktualisht kanë qenë paguar.
4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 3, gjithashtu do të aplikohen në përputhje me paketimin brenda kuptimit të Nenit 8(2), aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, brenda kuptimit të Nenit 9 dhe produktet në një komplet, brenda kuptimit të Nenit 10, kur përbërës të tillë nuk janë origjinës.
5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 4, do të aplikohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet Marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes.
6. Pavarësisht nga paragrafi 1, Shqipëria mund të aplikojë rregullimet për tërheqje prej, ose përjashtime nga, tarifat doganore ose detyrime të tjera më të njëjtin efekt, të aplikueshme në materialet e përdorura në prodhimin e produkteve origjinuese, subjekt i dispozitave të mëposhtme:
 - (a) një normë 5 për qind e ngarkesës doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga Kapitulli 25 deri 49 dhe nga 64 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më të ulëta siç është në fuqi në Shqipëri;
 - (b) një normë 10 për qind e ngarkesës doganore do të mbahet për produktet e përfshira nga Kapitulli 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar, ose norma të tilla më të ulëta siç është në fuqi në Shqipëri.

7. Dispozitat e këtij Neni do të aplikohen nga 1 Janari 2003. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen deri më 31 dhjetor 2005 dhe mund të rishikohen me marrëveshje të përbashkët.

TITULLI V
VËRTETIMI I ORIGJINËS
NENI 16

Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet origjinuese në Komunitet, gjatë importimit në Shqipëri, dhe produktet origjinuese në Shqipëri me importimin në Komunitet, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje me paraqitjen ose të:

- (a) një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1, një formë e së cilës tregohet në Aneksin III; ose
- (b) në rastet e specifikuara në Nenin 21(1), të një deklaratë, teksti i të cilës parashikohet në Aneksin IV, dhënë nga eksportuesi në një faturë, një notë dërguese ose dokument tjetër tregtar i cili përshkruan produktet përkatëse në detaje të mjaftueshme për t'u identifikuar (që këtej e me tutje do të quhet « deklaratë faturë »)

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet origjinuese në kuptimin e këtij Protokolli, përsa i takon rasteve të specifikuara në Nenin 26, do të përfitojnë nga kjo Marrëveshje, pa qenë e nevojshme të depozitohen ndonjë nga dokumentet e përmendur më sipër.

NENI 17

Procedurat për lëshimin e një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1

1. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në aplikimin e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do të plotësojnë të dyja dokumentet, certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe formën e aplikimit, një shembull i së cilës tregohet në Aneksin III. Këta formularë do të plotësohen në një nga gjuhët në të cilat është hartuar kjo Marrëveshje dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato do të plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një kuti të rezervuar për këtë qëllim pa lënë ndonjë rresht bosh. Kur kutia nuk është e plotësuar tërësisht, një vijë horizontale duhet të hiqet poshtë vijës së fundit së përshkrimit, përmes hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 do të përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues ku certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore të një Shteti Anëtar ose Shqipërisë nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen me origjinë në Komunitet ose në Shqipëri dhe plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

5. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 do të ndërmarrin masa apo hapa të nevojshëm për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokollit. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo evidencë apo të ndërmarrin ndonjë inspektim të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshëm. Autoritetet doganore në lëshimin e certifikatave të tilla gjithashtu do të sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë të plotësuar përkatësisht. Në veçanti, ata do të kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa fallco.

6.Data e lëshimit të një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të tregohet në Kutinë 11 të certifikatës.

7.Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të lëshohet nga autoritetet doganore dhe do të bëhet e vlefshme për eksportuesin sa më shpejt që eksportimi aktual të jetë kryer ose siguruar.

NENI 18

Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 të lëshuara aposteriori

1. Pavarësisht nga Neni 17(7), një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 mund përjashtimisht të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve iu referohet, nëse:

(a)ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

(b)është demonstruar pranë autoriteteve doganore që një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 është lëshuar por nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet, dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

3.Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 aposteriori vetëm pasi të jetë verifikuar së informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

4. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar aposteriori duhet të mbyllet me një nga frazat e mëposhtme:

"NACHTRÄGLICH AUSGESTELLT", "DELIVRE A POSTERIORI",

"RILASCIATO A POSTERIORI", "AFGEGEVEN A POSTERIORI",

"ISSUED RETROSPECTIVELY", "UDSTEDT EFTERFØLGENDE",

"ΕΚΔΟΘΕΝ ΕΚ ΤΩΝ ΥΣΤΕΡΩΝ", "EXPEDIDO A POSTERIORI",

"EMITIDO A POSTERIORI", "ANNETTU JÄLKIKÄTEEN",

"UTFÄRDAT I EFTERHAND", "D O P O L N I T E L N O I Z D A D E N O"

"NAKNADNO IZDANO"

5.Mbyllja referuar paragrafit 4 do të vendoset në kutinë "vërejtje" të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

NENI 19

Lëshimi i Duplikatit të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1

1.Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilat e kanë lëshuar atë për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të mbyllet me një nga fjalët e mëposhtme;

"DUPLIKAT", "DUPLICATA", "DUPLICATO", "DUPLICAAT", "DUPLICATE", "ΑΝΤΙΓΡΑΦΟ", "DUPLICADO", "SEGUNDA VIA", "KAKSOISKAPPALE", "D U P L I K A T" "DUPLIKAT"

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 do të vendoset në kutinë "Vërejtje" të dublikatës të certifikatës të qarkullimit të mallrave EUR.1.

4. Dublikata e cila duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të certifikatës origjinale të qarkullimit të mallrave EUR, do të ketë fuqi dhe nga ajo datë.

NENI 20

Lëshimi i certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës të lëshuar ose bërë më parë

Kur produktet origjinuese janë vendosur nën kontrollin e një zyre doganore në Komunitet ose Shqipëri, do të jetë e mundur të zëvendësohet me vërtetimin origjinal të origjinës me një ose më shumë certifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku brenda Komunitetit ose Shqipërisë. Zëvendësimi i certifikatës/ave të qarkullimit të mallrave EUR.1 do të lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë të vendosura këto produkte.

NENI 21

Kushtet për lëshimin e një Deklarate Faturë

1. Një deklaratë faturë, siç i referohet në Nenin 16(1) (b) mund të përgatitet:

(a) nga një eksportues i aprovuar në kuptimin e Nenit 22, ose

(b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte origjinuese vlera totale e të cilave nuk i kalon 6 000 Euro .

2. Një deklaratë faturë mund të lëshohet nëse produktet në fjalë konsiderohen si produkte origjinuese në Komunitet ose Shqipëri dhe plotëson të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokolli.

3. Eksportuesi që përgatit një deklaratë faturë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinës të produkteve në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

4. Një deklaratë faturë duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar, ose printuar mbi faturën, notën shpërndarëse ose ndonjë dokument tjetër tregtar, teksti i së cilës jepet në Aneksin IV, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë Aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit vendas të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë në germa kapitale.

5. Një deklaratë faturë duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportues i aprovuar në kuptimin e Nenit 22, nuk do t'i kërkohet të nënshkruajë deklarata të tilla duke siguruar që u paraqet autoriteteve doganore të vendit eksportues një deklaratë me shkrim ku ai pranon të gjitha përgjegjësitë për një deklaratë faturë e cila e identifikon atë me ç'ka është nënshkruar me shkrim dore prej tij.

6. Një deklaratë faturë mund të bëhet nga një eksportues kur produktet me të cilat ai ka lidhje eksportohen, ose mbas eksportimit me kusht që ai është paraqitur në vendin importues jo më vonë se dy vjet mbas importimit të produkteve të cilave ai i referohet.

NENI 22

Eksportuesi i aprovuar

1. Autoritetet doganore të vendit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues, këtu e më pas të referuar si "eksportuesi i aprovuar", që bën dërgesa të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje, të lëshojë deklaratë fature, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij Protokolli.

2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të aprovuar, kur ata e gjykojnë të përshtatshme

3. Autoritetet doganore do t'i japin eksportuesit të aprovuar një numër autorizimi doganor i cili do të shfaqet në deklaratën faturë.

4. Autoritetet doganore do të kontrollojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi i aprovuar.

5. Autoritetet doganore mund të tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata mund ta bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron garancitë referuar paragrafit 1, si dhe nuk plotëson kërkesat referuar paragrafit 2, ose në të kundërt kryen përdorim jo korrekt të autorizimit.

NENI 23

Vlefshmëria e vërtetimit të origjinës

1. Vërtetimi i origjinës do të jetë i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në vendin eksportues, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të vendit importues.

2. Vërtetimi i origjinës të cilat janë depozituar pranë autoriteteve doganore të vendit importues pas datës së fundit për paraqitje, e specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim zbatimin e trajtimit preferencial, kur nuk është arritur depozitimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare, shkaktuar nga rrethana të jashtëzakonshme.

3. Në rastet e tjera të depozitimeve shumë të vonuara, autoritetet doganore të vendit importues mund ta pranojnë vërtetimin e origjinës kur produktet janë depozituar përpara datës përfundimtare.

NENI 24

Paraqitja e vërtetimit të origjinës

- Vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të vendit

importues në përputhje të plotë me procedurat që aplikohen në atë vend. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të vërtetimit të origjinës dhe gjithashtu mund të kërkojnë deklaratën e importit që duhet t'i bashkëngjitet një deklarami nga importuesi që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

NENI 25

Importi me dërgesë të parë

- Kur, me kërkesën e importuesit dhe me kushtet e parashtruara nga autoritetet

doganore të vendit importues, produktet e ndara ose jo të grupuara në kuptimin e Rregullit të Përgjithshëm 2(a) të Sistemit të Harmonizuar, që është në Seksionin XVI dhe XVII apo në Krerët Nr. 7308 dhe 9406, janë importuar me dërgesë të parë, një vërtetim i origjinës për të tilla produkte duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të dërgesës së parë.

NENI 26

Përfshirjet nga *Vërtetimi i origjinës*

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privat tek personat privat ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve do të pranohen si produkte origjinuese pa kërkuar paraqitjen e vërtetimit të origjinës, nëse sigurohet se këto produkte nuk janë importuar për qëllime tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e këtij Protokollit dhe aty ku nuk ka dyshim të vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarinimin doganor CN22/CN23 ose në një fletë të veçantë letre që do t'i aneksohet atij dokumenti.

2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari ose familjarët e tyre nuk do të konsiderohen si importe për qëllime tregtie nëse nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.

3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojnë 500 Euro në rastin e pakove të vogla ose 1 200 Euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve.

NENI 27

Dokumentet Mbështetëse

Dokumentet referuar në Nenin 17(3) dhe 21(3) që përdoren për qëllime vërtetimi se produktet e shoqëruara me një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose një deklaratë faturë, mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Komunitet ose në Shqipëri dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të këtij Protokoll, si dhe mund të konsistojnë midis të tjerave si të mëposhtmet:

- (a) evidencë direkte e proceseve të kryera nga eksportuesi ose ofruesi për të përfituar produktet në fjalë, që mbahen për shembull në llogaritë ose në librat e kontabilitetit të tij të brendshëm;
- (b) dokumentet që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;
- (c) dokumentet që vërtetojnë punimet ose proceset e prodhimit të materialeve në Komunitet ose në Shqipëri, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri, ku këto dokumente janë përdorur në përputhje me ligjin vendas;
- (d) certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose deklarata faturë që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në Komunitet ose në Shqipëri në përputhje me këtë Protokoll.

NENI 28

Ruajtja e vërtetimit të origjinës dhe e dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet t'i mbajë dokumentet referuar në Nenin 17 (3) për të paktën tre vjet.
2. Eksportuesi që bën një deklaratë faturë duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate si dhe dokumentet referuar në Nenin 21 (3).
3. Autoritetet doganore të vendit eksportues që lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit referuar në Nenin 17(2).
4. Autoritetet doganore të vendit importues duhet të mbajnë për të paktën tre vjet certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë që iu paraqiten atyre.

NENI 29

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mospërputhje të vogla në deklaratimet e bëra në vërtetimin e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve

për importimin e produkteve, kjo nuk do të sjellë pavlefshmërinë e vërtetimit të origjinës nëse është evidentuar se ky dokument i korrespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme të tilla si gabime gjatë shtypjes në vërtetimin e origjinës nuk do të bëhen shkas që ky dokument të anulohet, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklaramit të bërë në atë dokument.

NENI 30

Sasitë e shprehura në Euro

1. Në zbatim të dispozitave të Nenit 21(1)(b) dhe Nenit 26(3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër veç euros, sasia në monedhën kombëtare të Shteteve Anëtare ose Shqipërisë, ekuivalente me shumat e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit nga secila Palë.

2. Një dërgesë malli duhet të përfitojë nga dispozitat e Nenit 21(1)(b) dhe Nenit 26(3), duke ju referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së fiksuar nga Komuniteti ose Shqipëria.

3. Shumat për t'u përdorur në çdo lloj monedhe kombëtare duhet të jenë të barabarta me këtë monedhë të shumës së shprehur në euro si në ditën e parë të punës së muajit tetor. Shuma do t'i komunikohen Komisionit të Komunitetit Evropian më 15 tetor dhe do të aplikohen nga 1 janari i vitit pasues. Komisioni i Komunitetit Evropian do të njoftojë Shqipërinë mbi shumat përkatëse.

4. Shqipëria mund të rumbullakosë më lart ose më poshtë shumën që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një shume të shprehur në euro. Sasia e rumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga sasia e rezultuar prej konvertimit me më shumë se 5%. Shqipëria mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës së saj kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së axhustimeve vjetore, sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume, përpara rumbullakosjes, rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në këtë vlerë ekuivalente.

5. Shumat e shprehura në euro duhet të rishikohen nga Komiteti i Stabilizim Asocimit me kërkesë të Komunitetit ose Shqipërisë. Kur të kryejë këtë rishikim, Komiteti i Stabilizim Asocimit duhet të konsiderojë dëshirën për t'u mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma reale. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumat e shprehura në euro.

TITULLI VI

RREGULLIME PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

NENI 31

Asistenca Reciproke

1. Autoritetet doganore të Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë duhet t'i sigurojnë njëra-tjetrës nëpërmjet Komisionit të Komunitetit Evropian kopje të llojit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për të vërtetuar këto certifikata dhe deklarata faturë.

2. Me qëllim që të sigurohet aplikimi i duhur i këtij Protokoll, Komuniteti dhe Shqipëria duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose të deklaratave faturë, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

NENI 32

Verifikimi i vërtetimit të origjinës

1. Verifikimet e duhura të vërtetimit të origjinës duhet të kryhen me metodën e zgjedhjes së rastit ose sa herë që autoritetet doganore të vendit importues kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tillë, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij Protokoll.
2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit importues duhet t'ia kthejnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë, në rast se është paraqitur, ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të vendit eksportues, duke u dhënë, atëherë kur është e nevojshme, arsyet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili thotë se informacioni i dhënë mbi vërtetimin e origjinës është jo korrekt, duhet t'i bashkëngjitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.
3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të vendit eksportues. Për këtë qëllim, ato duhet të kenë të drejtën të thërrasin për çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.
4. Në rast se autoritetet doganore të vendit importues vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet respektive, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, vetëm në rastet e marrjes së ndonjë masë kujdesi kur gjykohet e nevojshme.
5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejtë që të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë kur dokumentet janë origjinale dhe kur produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte që janë origjinuese në Komunitet ose Shqipëri si dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij Protokoll. Aty ku dispozitat e kumulimit në përputhje me nenin 3 dhe 4 të tij Protokoll janë aplikuar dhe në lidhje me Nenin 17.3 përgjigja do të përfshijë një kopje (kopje) të certifikatës (certifikatave) së qarkullimit të mallrave ose deklaratë (deklaratave) faturës në të cilën është mbështetur.
6. Në rast se për një dyshim të arsyeshëm, nuk ka përgjigje brenda dhjetë muajve nga data e kërkesës së verifikimit, ose në qoftë se përgjigja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të hetimit, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, duhet të refuzojnë dhënien e preferencave.

NENI 33

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e procedurave të Nenit 32, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore

përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ose kur ato ngrenë një çështje lidhur me interpretimin e këtij Protokollit, ato duhet t'i paraqiten Komitetit të Stabilizim Asocimit.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të vendit importues duhet të respektojnë legjislacionin e vendit importues.

NENI 34

Gjobat

Gjobat duhet të vendosen mbi çdo person që fsheh, ose shkakton fshehjen e një dokumenti që përmban informacion jo korrekt për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

NENI 35

Zonat e lira

1. Komuniteti dhe Shqipëria do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara që janë objekt i vërtetimit të origjinës, dhe që gjatë transportit përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Në kuptimin e një përjashtimi nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet origjinuese në Komunitet ose Shqipëri, importohen në një zonë të lirë me një vërtetim origjine dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikate të re EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij Protokollit.

TITULLI VII

CEUTA DHE MELILLA

NENI 36

Zbatueshmëria e Protokollit

1. Termi “Komunitet” i përdorur në Nenin 2 nuk përfshin Ceuta dhe Melilla.

2. Produktet origjinuese në Shqipëri kur importohen në Ceuta dhe Melilla do të përfitojnë në të gjitha drejtimet të njëjtin regjim doganor si ai që aplikohet për produktet me origjinë në territoret doganore të Komunitetit sipas Protokollit 2 të Aktit të Anëtarësimit të Mbretërisë së Spanjës dhe Republikës Portugeze në Komunitetin Evropian. Shqipëria do t'ju akordojë produkteve të importuara që përfshihen në këtë Marrëveshje dhe me origjinë në Ceuta dhe Melilla të njëjtin regjim doganor që aplikon edhe për produktet e importuara dhe origjinuese nga Komuniteti.

3 Për qëllimin e aplikimit të paragrafit 2, në lidhje me produktet origjinuese në Ceuta dhe Melilla, ky Protokoll do të aplikohet *mutatis mutandis* subjekt i kushteve specifike të parashikuara në Nenin 37.

NENI 37

Kushtet specifike

1. Duke patur parasysh se ato janë transportuar drejtë për së drejti në përputhje me dispozitat e nenit 13, sa më poshtë do të konsiderohet se :

(1) Produkte origjinuese ne CEUTA dhe MELILLA:

(a) produkte të përfituara tërësisht në CEUTA dhe MELILLA;

(b) produkte të përfituara në CEUTA dhe MELILLA në prodhimin e

të cilave janë përdorur produkte të tjera nga ato të përmendura në paragrafin (a), me kusht që:

i. produktet që thamë kanë kaluar një punë ose përpunim të mjaftueshëm, sipas kuptimit të nenit 6, të këtij protokollit, ose që

ii. këto produkte janë origjinuar në Shqipëri ose në Komunitet sipas kuptimit të këtij protokollit, me kusht që ato ti jenë nënshtruar punimit ose përpunimit i cili shkon më tej se punimi ose përpunimi i pamjaftueshëm që përmendet në nenin 7.1.

(2) Produktet me origjine në Shqipëri:

(a) produkte të përfituara tërësisht në Shqipëri;

(b) produkte të përfituara në Shqipëri në prodhimin e të cilave janë përdorur produkte të tjera nga ato të përmendura në paragrafin (a), me kusht që:

(i) produktet që thamë kanë kaluar një punë ose përpunim të mjaftueshëm, sipas kuptimit të nenit 6, të këtij protokollit, ose që

(ii) këto produkte janë origjinuar në CEUTA dhe MELILLA ose në Komunitet sipas kuptimit të këtij protokollit, me kusht që ato ti jenë nënshtruar punimit ose përpunimit i cili shkon më tej se punimi ose përpunimi i pamjaftueshëm që përmendet në nenin 7.1.

3. CEUTA dhe MELILLA do të konsiderohen si një territor i vetëm

4. Eksportuesit ose përfaqësuesi i tij i autorizuar do të hyjnë “Shqipëria” dhe “CEUTA dhe MELILLA” në kutinë 2 të certifikatës EUR.1 të qarkullimit të mallrave ose me deklaratat faturë. Në shtesë, në rastin e produkteve origjinuese ne CEUTA dhe MELILLA, kjo do të paraqitet në kutinë 4 të certifikata. 1 të qarkullimit të mallrave ose në deklaratat faturë.

5. Autoritetet doganore spanjolle do të jenë përgjegjëse për zbatueshmërinë e këtij protokollit në CEUTA dhe MELILLA.

TITULLI VII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 38

Amendimet e Protokollit

Këshilli i Stabilizim Asocimit mund të vendosë për të amenduar dispozita të këtij Protokollit.

SHTOJCA I,

SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË SHTOJCEN II

Shënim 1:

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6 të këtij Protokollit.

Shënim 2:

2.1. Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përftuar. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në Sistemin e Harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo Kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para një rregull specifikohet në kolonën 3 ose 4. Ku, në disa raste, hyrja në kolonën e parë parapritet nga një "ex" kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2. Ku shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose një numër Kapitulli jepet dhe përshkrimi i produkteve në kolonën 2 prej këtej jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën Sistemin e Harmonizuar klasifikohen në krerët e Kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3. Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të mbuluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4. Kur, për një hyrje në dy kolonat e para, një rregull specifikohet në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, që të aplikojë ose rregullin e vendosur në kolonën 3, ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjinë në kolonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënim 3:

3.1. Dispozitat e Nenit 6, përta i përket produkteve që kanë marrë statusin origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, duhet të aplikohen, pa patur parasysh nëse statusi është marrë brenda në fabrikën ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrike në Shqipëri ose në Komunitet.

Shembull:

Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve jo origjinuese të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit "ex-works" është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kadhër" të kreut ex 7224.

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në Shqipëri nga një lende e parë jo origjinuese, ky çelik ka marrë tashmë statusin origjinës sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi

mund të llogaritet atëherë si origjinës në vlerën e llogaritur për motorin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një tjetër në Shqipëri. Vlera e lëndës së parë jo-origjinuese në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve jo origjinuese të përdorura.

3.2. Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose të përpunimit, si dhe kryerja e më shumë pune apo përpunimi gjithashtu i jep statusin origjinës; në të kundërt, kryerja e më pak pune apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin origjinës. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material jo origjinës, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm.

3.3. Pa paragjykim për Shënimin 3.2, kur një rregull thotë se “materialet e çdo kreu” mund të përdoren, materialet e të njëjtit kre si produkti mund të përdoren, por ato janë subjekt, sidoqoftë, i ndonjë kufizimi specifik, i cili gjithashtu mund të përmbahet në rregull.

Sidoqoftë, shprehja “prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut Nr...” do të thotë që vetëm materiale të klasifikuara në të njëjtin kre si dhe produkti dhe të një përshkrimi të ndryshëm nga ai i produktit sikurse i dhënë në kolonën 2 të listës, mund të përdoren.

3.4. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që një ose më shumë materiale mund të përdoren. Ai nuk kërkon që të gjitha materialet të përdoren.

Shembull:

Rregulli për fabrikate të krerëve 5208 deri 5212 thotë se fibrat natyrale mund të përdoren dhe se materialet kimike, ndërmjet materialeve të tjera, gjithashtu mund të përdoren. Kjo nuk do të thotë që të dyja duhet të përdoren; është e mundur të përdoret njëra, ose tjetra, ose që të dyja.

3.5. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt duhet të prodhohet nga një material i veçantë, ky kusht duket se nuk parandalon përdorimin e materialeve të tjera, sepse, për shkak të natyrës së tyre, nuk mund të kënaqin rregullin. (shiko gjithashtu Shënimin 6.2 më poshtë në lidhje me tekstilet)

Shembull:

Rregulli për ushqimet e përgatitura në kreun 1904, i cili në mënyrë specifike përjashton përdorimin e drithërave dhe derivateve të tyre, nuk parandalon përdorimin e kripërave minerale, e kimikateve dhe shtesave të tjera, të cilat nuk janë prodhime nga drithërat.

Megjithatë, kjo nuk aplikohet tek produktet, të cilat edhe pse nuk mund të prodhohen nga materiale të veçanta të specifikuara në listë, mund të prodhohen nga një material i së njëjtës natyrë në një stad më të hershëm të prodhimit.

Shembull:

Në rastin e një artikulli veshjeje të ex Kapitulli 62, i përbërë nga materiale jo të thurura, në rast se përdorimi i vetëm i fillit joorigjinues lejohet për këtë lloj artikulli, nuk është e mundur të fillosh nga pëlhure jo e thurur – edhe nëse pëlhurat jo të thurura normalisht nuk mund të bëhen prej filli. Në raste të tilla, materiali fillestar duhet të jetë në një stad përpara të qenit fill, pra në gjendjen fibër.

3.6. Kur, në një rregull në listë, jepen dy përqindje për vlerën maksimale të materialeve jo origjinuese që mund të përdoren, atëherë këto përqindje mund të mos shtohen së bashku. Me fjalë

të tjera, vlera maksimale e të gjitha materialeve jo origjinuese të përdorura nuk mund kurrë të kalojë përqindjen më të lartë të dhënë. Për më tepër, përqindjet individuale nuk duhet të tejkalohen, në lidhje me materialet e veçanta për të cilat ato aplikohen.

Shënim 4:

4.1. Termi "fibra natyrale" përdoret në listë për t'ju referuar fibrave të tjera nga ato artificiale ose sintetike. Kufizohet për statet përpara se të ndodhë tjerja, duke përfshirë mbetjet dhe, nëse nuk specifikohet ndryshe, përfshin fibrat të cilat janë përdredhur, krehur ose përpunuar ndryshe, por që nuk janë kthyer në fill.

4.2. Termi "fibra natyrale" përfshin qimen e kalit të kreut Nr. 0503, mëndafshin e krerëve Nr. 5002 dhe Nr. 5003, po ashtu si dhe fibrat e leshit dhe qime të imët ose të ashpër kafshe të krerëve Nr. 5101 deri Nr. 5105, fibra pambuku të krerëve Nr. 5201 deri Nr. 5203, si dhe fibra të tjerë vegjetale të krerëve Nr. 5301 deri Nr. 5305.

4.3. Termit "pulpë tekstili", "materiale kimike" dhe "materiale për prodhim letre" përdoren në listë për të përshkruar materialet, e paklasifikuara në Kapitujt 50 deri 63, të cilat mund të përdoren për të prodhuar fibra ose fije artificiale, sintetike ose letre.

4.4. Termi "fibra kryesore të bëra nga njeriu" përdoret në listë për t'ju referuar filamenteve artificiale apo sintetike, fibrave zëvendësuese ose mbetjeve, të krerëve Nr. 5501 deri Nr. 5507.

Shënim 5:

5.1. Aty ku, për një produkt të dhënë në listë, i referohet këtij Shënimi, kushtet e vendosura në Kolonën 3 nuk duhet të aplikohen për ndonjë material bazë tekstili të përdorur në prodhimin e këtij produkti dhe të cilat, të marra së bashku, përfaqësojnë 10% ose më pak të peshës totale të materialeve bazë tekstile të përdorura. (Shiko gjithashtu Shënimet 5.3 dhe 5.4 me poshtë)

5.2. Sidoqoftë, toleranca e përmendur në Shënimin 5.1 mund të aplikohet vetëm tek produktet e përziera, të cilat janë bërë nga dy ose më shumë materiale tekstili bazë.

Materialet tekstile bazë, jepen si më poshtë :

-mëndafsh,

-lesh,

-qime kafshe e ashpër,

-qime kafshe e hollë,

-qime kali,

-pambuk,

-materiale për prodhim letre dhe letër,

-fije liri,

-fije kërpi,

-jute dhe fibra të tjera tekstili,

-sisal dhe fibra të tjera të gjinisë "Agave",

-fibra nga arra kokosi, abakë, ramie dhe fibra të tjera vegjetale tekstile,

- filamente sintetike të bëra nga njeriu,
- filamente artificiale të bëra nga njeriu,
- filamente përcjellëse rryme,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polipropileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliesteri,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliamidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliakrilonitrili,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej poliimidi,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej politetrafluoroetileni,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polifenileni sulfid,
- fibra sintetike të bëra nga njeriu prej polivinilkloridi,
- fibra të tjera sintetike të bëra nga njeriu,
- fibra artificiale të bëra nga njeriu prej viskoze,
- fibra të tjera artificiale të bëra nga njeriu,
- fill i bere nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej polieteri, i përdredhur ose jo,
- fill i bërë nga poliuretani, i segmentuar me segmente fleksibel prej poliesteri, i përdredhur ose jo,
- produkte të kreut Nr. 5605 (fill i metalizuar), që përmban një rrip të përbërë prej shtrese alumini ose një mbulëse prej filmi plastik, mbuluar ose jo prej pluhuri alumini, me një gjerësi që nuk kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi me ngjyra ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik,
- produkte të tjera të kreut Nr. 5605.

Shembull:

Një fill, i kreut Nr. 5205, i bërë nga fibra pambuku të kreut Nr. 5203 dhe fibra sintetike të kreut Nr. 5506, është një fill i përzier. Për këtë arsye, fibrat sintetike jo origjinuese, të cilat nuk plotësojnë rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike ose pulpë tekstili) mund të përdoren deri 10% ndaj peshës të fillit.

Shembull:

Një copë pëlhurë leshi e kreut Nr. 5112, e bërë prej filli leshi të kreut Nr. 5107 dhe filli sintetik prej fibrash të kreut Nr. 5509, është një pëlhurë e përzier. Për këtë arsye, filli sintetik i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga materialet kimike pulpë tekstili), ose filli i leshit, i cili nuk plotëson rregullat e origjinës (të cilat kërkojnë prodhim nga fije natyrale, jo të përdredhura apo tjerra, ose të përgatitura ndryshe për fill), ose një kombinim i të dyjave, mund të përdoret, në rast se pesha e tyre totale nuk e kalon 10% të pëlhurës.

Shembull:

Pëlhurë tekstile, xhufke, e kreut Nr. 5802, e bërë prej filli pambuku të kreut Nr. 5205 dhe pëlhurë pambuku të kreut Nr. 5210, është vetëm një produkt i përzier në rast se pëlhura e pambukut është në vetvete një pëlhurë e përzier, e prodhuar nga filli të klasifikuara në dy krerë të ndryshëm, ose në rast se filli i pambukut i përdorur është vetë një përzierje.

Shembull:

Nëse pëlhura tekstile, xhufkë në fjalë do të ishte e përberë nga fill pambuku i kreut Nr. 5205 dhe pëlhurë sintetike e kreut Nr. 5407, atëherë, në mënyrë të dukshme, fijet e përdorura janë dy materiale bazë tekstili të veçanta dhe pëlhura tekstile xhufkë është, mbi këto baza, një produkt i përzier.

5.3. Në rastin e produkteve që përfshijnë “fill të bërë nga poliuretani i segmentuar me segmente fleksibel të polieterit, të përdredhur ose jo”, kjo tolerancë është 20% në lidhje me këtë fill.

5.4. Në rastin e produkteve që përfshijnë “rrip i përberë nga një shtrese alumini ose nga një shtresë prej filmi plastik, të mbuluar ose jo me pluhur alumini, me një gjerësi që nuk e kalon 5 mm, i palosur nëpërmjet një adezivi ndërmjet dy shtresave të një filmi plastik, kjo tolerancë është 30% në lidhje me këtë rrip.

Shënim 6:

6.1. Ku në listë, i referohesh këtij shënimi, materialet tekstile (me përjashtim të linjave dhe interlinjave), të cilat nuk plotësojnë rregullin e vendosur në listë në kolonën 3 për produktin në fjalë, mund të përdoren, me kusht që ato janë klasifikuar në një kre ndryshe nga ai i produktit dhe që vlera e tyre të mos kalojë 8% të çmimit “ex-works” të produktit.

6.2. Pa paragjykuar Shënimin 6.3, materialet, të cilat nuk janë klasifikuar brenda Kapitujve 50 deri 63, mund të përdoren lirshëm në prodhimin e produkteve tekstile, përmbajnë apo jo tekstile.

Shembull:

Në rast së një rregull në listë thotë që, për një lloj të veçante tekstili (të tilla si pantallonat) duhet përdorur fill, kjo nuk parandalon përdorimin e gjërave metalike, të tilla si butonat, për arsye se butonat nuk janë të klasifikuar në kapitujt 50 deri 63. Për të njëjtën arsye, nuk parandalohet përdorimi i zinxhirëve, edhe pse zinxhirët normalisht përmbajnë tekstil.

6.3. Kur një rregull përqindjeje aplikohet, vlera e materialeve të cilat nuk klasifikohen brenda Kapitujve 50 deri 63, duhet të merren parasysh kur llogaritet vlera e materialeve jo origjinuese të përfshira.

Shënim 7:

7.1. Për qëllimet e kërërve Nr. ex . 2707, Nr. 2713 deri Nr. 2715,. ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, “proceset specifike” janë si më poshtë:

- (a) distilim në vakum;
- (b) ri-distilim nga një proces shumë i plotë fraksionimi 18;
- (c) ndarja;
- (d) riformimi;
- (e) përftimi me ndihmën e solventeve selektive

(f) procesi që përfshin të gjitha operacionet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

(g) polimerizimi;

(h) alkilizimi;

(i) izomerizimi.

7.2. Për qëllimet e krerëve Nr. 2710, 2711 dhe 2712, "proceset specifike" janë si më poshtë:

(a) distilim në vakum

(b) ri-distilim nga një proces shumë i plotë fraksionim 19;

(c) ndarja;

(d) riformimi;

(e) ekstraktimi me ndihmën e solventeve selektive;

(f) procesi që përfshin të gjitha veprimet e mëposhtme: përpunimi me acid sulfurik të përqendruar, me anhidrit oleum ose sulfurik; neutralizimi me agjente alkaline; çngjyrimi dhe pasurimi me dhe aktiv natyral, me dhe aktiv, me qymyr ose boksid aktiv;

(g) polimerizimi;

(h) alkilizimi;

(ij) izomerizimi;

(k) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut Nr. ex 2710, desulfurizimi me hidrogjen, i cili rezulton nga një pakësim prej së paku 85 % të përmbajtjes së sulfurit të produkteve të përpunuara (Metoda ASTM D 1266-59 T);

(l) në lidhje vetëm me produktet e kreut Nr. 2710, deparafinimi nga një proces tjetër nga filtrimi;

(m) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të kreut Nr. ex 2710, trajtimi me hidrogjen, në një presion prej më shumë se 20 bar dhe një temperaturë prej më shumë se 250 °C, me përdorimin e një katalizatori, tjetër nga sjellja e desulfurizimit, kur hidrogjeni përbën një element aktiv në një reaksion kimik. Trajtimi i mëtejshëm me hidrogjen i vajrave lubrifikante të kreut Nr. ex 2710 (p.sh. hidrombarimi ose çngjyrimi), me qëllim që, në mënyrë më specifike, të përmirësohet ngjyra ose stabiliteti; ky trajtim nuk duhet sidoqoftë të konsiderohet një proces specifik;

(n) në lidhje vetëm me vajrat për karburante të kreut Nr. ex 2710, distilim atmosferik, në kushte kur më pak se 30 %, sipas volumit, e këtyre produkteve distilohet, duke përfshirë humbjet, në 300 °C, me metodën ASTM D 86;

(o) në lidhje vetëm me vajrat e rënda të tjera nga vajrat e gazrave dhe vajrat për karburante të kreut Nr. ex 2710, trajtim me anë të shkarkesave fshirëse të tensionit të lartë.

(p) në lidhje me prodhimet e papërpunuara (të tjera përveç xhelit të naftës, ozokerite, dyllit linjit ose dyllë torfë, dyllit të parafinës, që përmban si peshë në më pak se 0.75% të vajit) vetëm të kreut ex. 2712, çvajimin nga kristalizimi fraksional.

7.3. Për qëllimet e krerëve Nr. ex 2707, 2713 deri 2715, ex 2901, ex 2902 dhe ex 3403, operacione të thjeshta, të tilla si pastrimi, dekantimi, çkripëzimi, ndarja e ujërave, filtrimi, ngjyrimi, vendosja e markës, përftimi i përmbajtjes sulfure si rezultat i përzierjes të produkteve me përmbajtes të ndryshme sulfuri, ose çdo lloj kombinimi të këtyre operacioneve ose operacioneve të ngjashme, nuk japin origjinë .

SHTOJCA II

Lista e operacioneve të përpunimit ose proceseve që kërkohet t'i nënshtrohen mallrat jo-origjinuese, në mënyrë që produkti përfundimtar të përfitojë statusin e origjinës

Produktet e përfshira në këtë listë ndoshta jo të gjithë janë të mbuluara nga kjo Marrëveshje. Kjo e bën të domosdoshme konsultimin me pjesët e tjera të marrëveshjes.

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|----------------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| Kapitulli 1 | Kafshët e gjalla | Të gjitha kafshët e kapitullit 1 të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 2 | Mishi dhe të brendshmet e ngrënshme të mishit | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitujve 1 dhe 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 3 | Peshku e kafshët guaskore të nënujshme, molusqet e kafshët e tjera jovertebrore ujore | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Ex Kapitulli 4 | Produktet bulmetore; vezët e zogjve; mjaltë natyral; produkte të ngrënshme me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër, përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|----------------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 0403 | Dhallë, qumësht e krem i prerë, kos, kefir e qumësht e krem tjetër të fermentuara ose të acidifikuara, nëse janë ose jo të koncentruara ose që përmbajnë sheqer shtesë ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose lëndë aromatizuese ose që përmbajnë fruta, arra ose kakao shtesë | Prodhime në të cilat : - Të gjitha materialet e Kapitullit 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese - Të gjitha lëngjet e frutave (përjashtuar ato të ananasit, qitros ose greipfrutit) të kreut 2009 të përdorur janë origjinuese - vlera e çdo materiali të përdorur të Kapitullit 17 nuk kalon vlerën prej 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| Ex Kapitulli 5 | Produktet me origjinë prej kafshëve, të papërfshira dhe të paspecifikuara diku tjetër; përveç | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 5 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 0502 | Qime dhe lesh të derrave të përgatitur, derrave të tredhur ose derrave të egër | Pastrimi, disifektimi, ndarja dhe drejtimi i qimeve dhe leshit | |
| Kapitulli 6 | Pemët dhe bimët e tjera, të gjalla; zhardhokët, rrënjët dhe të ngjashmet me to; lulet e prera dhe gjethnajat zbukuruese | Prodhime në të cilat : - të gjitha materialet e Kapitullit 6 të përdorur janë tërësisht origjinuese - vlera e çdo materiali të përdorur nuk kalon vlerën prej 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|----------------|--|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| Kapitulli 7 | Zarzatet e ngrënshme dhe rrënjët dhe tuberët përkatës | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 7 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| Kapitulli 8 | Frutat dhe arrat e ngrënshme; lëkurat e agrumeve ose të pjeprave | Prodhime në të cilat : - të gjitha frutat dhe arrat të përdorur janë tërësisht origjinuese - vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon vlerën prej 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 9 | Kafe, çaj, mate dhe erëza, përveç: | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e kapitullit 9 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 0901 | Kafe, nëse është ose jo e pjekur ose e dekafezuar; lëvoret e lëkurat e kafesë; zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe në çdo porcion | Prodhime prej materialeve të çdo kreu | |
| 0902 | Çaj, nëse është ose jo i aromatizuar | Prodhime prej materialeve të çdo kreu | |
| ex 0910 | Përzierje të erëzave | Prodhime prej materialeve të çdo kreu | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| Kapitulli 10 | Drithërat | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 10 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 11 | Produktet e industrisë bluajtëse; malt; niseshte; inuline; gluteni i grurit, përveç | Prodhime në të cilat të gjitha drithërat, zarzavatet e ngrënshme, rrënjët e tuberët e Kreut 0714 ose fruta të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 1106 | Miell, kokrriza e pluhur i zarzavateve të thara leguminoze të kreut Nr. 0713 | Tharja dhe bluarja e zarzavateve leguminoze të kreut 0708 | |
| Kapitulli 12 | Farat vajore e frutat me përmbajtje vajore; kokrra, fara e fruta të përziera; bimët industriale ose medicinale; kashta e tagjia | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 12 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1301 | Lac; gomë natyrale, rrëshirat, gomërrëshirat e oleorrëshirat (për shembull, balsamet) | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të kreut 1301 të përdorur nuk mund të kalojë 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo originës, i cili u jep statusin e originës | |
|---------------------|---|--|-----------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1302 | Lëngje e ekstrakte vegjetale; substancë pektike, pektinatet e pektatet; agaragar e lëndë të tjera ngjitëse e trashëse, nëse janë ose jo të modifikuara, të rrjedhura nga produktet vegjetale : | | |
| | - Ngjitëse dhe trashësa, të modifikuara ose të rrjedhura nga produktet vegjetale | Prodhime nga ngjitëset dhe trashësat e pamodifikuar | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat vlera të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 14 | Materialet vegjetale që përdoren për thurje; produktet vegjetale të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime në të cilat të gjitha materialet të Kapitullit 14 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 1 5 | Vajra e dhjamna prej kafshëve ose vegjetale e produktet e ndarjes së tyre; yndyra të përgatitura të ngrënshme; dyllët prej kafshëve ose vegjetale, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 1501 | Dhjam derri (përfshirë sallon) e dhjami i shpendëve, ndryshe nga ai i kreut 0209 ose 1503 : | | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| | - Dhjamna prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0203, 0206 ose 0207 ose kockave të kreut 0506 | |
| | -Të tjera | Prodhime prej mishi ose të brendshmeve të ngrënshme të dërrit të kreut 0203 ose 0206 ose mishit ose të brendshmeve të ngrënshme të shpendëve të kreut 0207 | |
| 1502 | Dhjami i gjedhëve, deleve ose dhive, ndryshe nga ato të kreut 1503 | | |
| | - Dhjamna prej kockave ose mbetjeve | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të krerëve 0201, 0202, 0204 ose 0206 ose kockave të kreut 0506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1504 | Dhjamna e vajra dhe fraksionet e tyre, të peshkut ose të sisorëve detare, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht: | | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|----------------|--|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| | - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1504 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur duhet të jenë tërësisht origjinuese | |
| ex 1505 | Lanolinë e rafinuar | Prodhime prej vajrave të leshit të papërpunuar të kreut 1505 | |
| 1506 | Dhjamna e vajra të tjera me origjinë prej kafshëve e fraksionet e tyre, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo të modifikuara kimikisht : | | |
| | - Fraksione solide | Prodhime nga materiale të çdo kreu, përfshirë materiale të tjera të kreut 1506 | |
| | - Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1507 deri 1515 | Vajra vegjetale e fraksionet e tij : | | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| | - Soje, kikiriku, palme, kopre, thelb palme, babasu, vaj tungu e oitika, dyllë mërsinë e japonez, fraksionet e vajit të jacobës e vajra për përdorime teknike e industriale të ndryshme nga prodhimet e ushqimit për konsum njerëzor | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| | - Fraksionet solide, përjashtuar ato të vajit jacobë | Prodhime prej materialeve të tjera të kreut 1507 deri 1515 | |
| | -Të tjera | Prodhime në të cilat të gjitha materialet vegjetale të përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 1516 | Yndyra me origjinë prej kafshëve ose vegjetale dhe vajra dhe fraksionet e tyre, tërësisht ose pjesërisht të hidrogjenizuara, të intersterifikuara, të riesterifikuara ose të elaidinifikuara, nëse janë ose jo të rafinuara, por jo më tej të përgatitura | Prodhime në të cilat : - të gjitha materialet e Kapitullit 2 të përdorur janë tërësisht origjinuese - të gjithë materialet vegjetale të përdorur janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1517 | Margarinë; përzierjet ose përgatitjet e ngrënshme të vajrave e dhjamërave vegjetale ose prej kafshëve ose vajra ose të fraksioneve të yndyrave ose vajrave të ndryshme të këtij Kapitulli, të ndryshme nga yndyrat ose vajrat e ngrënshme ose të fraksioneve të tyre të kreut 1516 | Prodhime në të cilat : - të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 4 të përdorur janë tërësisht origjinuese - të gjithë materialet bimore të përdorur janë tërësisht origjinuese. Megjithatë, materialet e krerëve 1507, 1508, 1511 dhe 1513 mund të përdoren | |
| Kapitulli 16 | Ushqimet e përgatitura prej mishit, prej peshkut ose prej krustaceve, prej molusqeve ose prej kafshëve të tjera jovertebrore ujore | Prodhime: - prej kafshëve të Kapitullit 1, dhe/ose - në të cilët të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex Kapitulli 17 | Sheqernat dhe ëmbëlsirat prej sheqeri, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 1701 | Sheqer i prodhuar nga kallam sheqeri ose nga panxhar sheqeri e saharoza kimikisht e pastër, në gjendje të ngurtë, të aromatizuar ose lëndë ngjyruese | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1702 | Sheqerëra të tjera, përfshirë laktozen, maltozën, glukozën e fruktozën kimikisht të pastra, në gjendje të ngurtë; shurupet e sheqerit që nuk përmbajnë lëndë aromatizuese e ngjyruese shtesë; mjaltë artificial, nëse është ose jo i përzier me mjaltë natyral; karamel : | | |
| | - Maltoza dhe fruktoza të pastra kimikisht | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përfshirë materiale të tjera të kreut 1702 | |
| | - Sheqerëra të tjera në forma të ngurta, të aromatizuara ose të ngjyrosura | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| | -Të tjera | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e përdorur janë origjinuese | |
| ex 1703 | Melasat e rezultuara nga ekstradimi ose rafinimi i sheqerit, të aromatizuara ose të ngjyrosura | Prodhime në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|--------------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1704 | Ëmbëlsirat prej sheqerit (përfshirë çokollatën e bardhë), që nuk përmbajnë kakao | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| Kapitulli 18 | Kakao e përgatitjet prej kakaos | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali te Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1901 | Ekstrakt malti; përgatitjet ushqimore prej miellit, kokrrizave, niseshtesë ose ekstraktit të maltit, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë kakao ndaj peshës me pak së 40% të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të paspecifikuara e të papërfshira diku tjetër; përgatitjet ushqimore të mallrave të krerëve Nr.0401 deri 0404, që nuk përmbajnë kakao ose që përmbajnë kakao ndaj peshës më pak së 5 % të llogaritur mbi një bazë totalisht të çyndyrosur, të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | | |
| | - Ekstrakt malti | Prodhime prej drithërave të Kapitullit 10 | |
| | -Të tjera | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1902 | Brumërat, nëse janë ose jo të gatuar ose të mbushur (me mish ose me substanca të tjera) ose të përgatitur ndryshe, të tilla si spageti, makarona, makarona petë, lasanjë, gnocchi, ravioli, kaneloni; couscous nëse janë ose jo të përgatitur : | | |
| | - Me përmbajtje 20% ose me pak sipas peshës të mishit, të brendshmeve të mishit, peshkut, krustanceve ose molusqeve | Prodhime në të cilat të gjithë drithërat e nënproduktet e tyre (përfshirë miellin durum e nënproduktet e tij) të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| | - Me përmbajtje më shumë se 20% sipas peshës të mishit, të brendshmeve të mishit, peshkut, krustanceve ose molusqeve | Prodhime në të cilat : - të gjitha drithërat dhe nënproduktet (përveç miellit durum dhe nënprodukteve të tij) të përdorura janë tërësisht origjinuese, dhe - të gjitha materialet e Kapitullit 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 1903 | Tapioka e zëvendësuesit e tij përgatitur nga niseshteja, në formën e fetëzave, kokrrave, margaritarëve, topthash ose në forma të ngjashme | Prodhime prej materialeve të çdo kapitulli, përveç niseshtesë së patates të kreut 1108 | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 1904 | Ushqimet e përgatitura fituar prej bymimit ose pjekjes së drithërave ose të produkteve të tyre (p.sh. fetëza drithi); drithërat (ndryshe nga misri (si drithë)) në formë kokrre ose në formë fetëzash ose kokrra të punuara ndryshe (përveç miellit e kokrrizave të miellit), të paragatuara ose të përgatitura ndryshe, të papërfshira ose të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime : - prej materialeve të çdo kreu, përveç atyre të kreut 1806, - në të cilat të gjithë drithërat e miellrat (përveç miellit durum e nënprodukteve të tij e misrit zea indurata) të përdorur janë tërësisht origjinuese, dhe - në të cilën vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 1905 | Bukë, torta, kek, biskota e produkte të tjera të furrtarit, nëse përmbajnë ose jo kakao; nafore, hapet (kapsulat) bosh të një lloji të përshtatshëm për qëllime farmaceutike, vaferet me shtresa, letër orizi e produkte të ngjashme | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atyre të Kapitullit 11 | |
| ex Kapitulli 20 | Përgatitje prej zrazavateve, frutave, arrave ose pjesëve të tjera të bimëve, përveç : | Prodhime në të cilat të gjithë frutat, arrat ose zrazavatet e përdorura janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|------------------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 2001 | Yams, panxhar e pjesë të tjera të ngrënshme të ngjashme të bimëve, me përmbajtje 5% ose më shumë sipas peshës të niseshtesë, të përgatitura ose të ruajtura në uthull ose në acid acetik | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit | |
| ex 2004 dhe 2005 | Patate në formë mielli, mielli të trashë ose ciflash, të përgatitura ose të ruajtura ndryshe nga në uthull ose në acid acetik | Prodhime prej materialeve të çdo kreu përveç atij të produktit | |
| 2006 | Zarzavate, fruta, arra, lëkura frutash e pjesë të tjera të bimëve, të ruajtura në sheqer (të thara, të sheqerosura ose të kristalizuara) | Prodhime në të cilën vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 2007 | Reçelet, peltet e frutave, marmelatat, pure frutash ose arrash e brumë frutash ose arra, që janë përgatitje të gatuar, nëse përmbajnë ose jo sheqer ose lëndë të tjera ëmbëltuese shtesë | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 2008 | - Arra, që nuk përmbajnë sheqer ose aromatikë shtesë | Prodhime në të cilat vlera e arrave dhe vajrave bimore origjinuese të kreut 0801, 0802 dhe 1202 deri 1207 të përdorur e kalon 60% të çmimit ex-works të produktit | |
| | - Gjalpë kikiriku; përzierje të bazuara në drithëra; zemra palme; misër (drithë) | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| | - Të tjera, përveç frutave dhe arrave të gatuar ndryshe nga me avull ose vlim me ujë, duke mos përmbajtur sheqer shtesë, të ngrira | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| 2009 | Lëngje frutash (përfshirë mushtin e rrushit) e lëngje zarzavatesh, të pafermentuara e që nuk përmbajnë lëndë alkoolike shtesë, nëse përmbajnë sheqer ose lëndë të tjera ëmbëltuese shtesë | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex Kapitulli 21 | Përgatitje të ndryshme të ngrënshme, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 2101 | Ekstrakte, esenca e koncentrate, të kafesë, çajit ose matëse dhe përgatitjet me bazë të këtyre produkteve ose me bazë të kafesë, çajit ose matëse; çikore e pjekur e zëvendësuesit e tjerë të pjekur të kafesë, dhe ekstraktet, esencat dhe koncentratet prej tyre | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilat të gjitha çikoret e përdorura janë tërësisht origjinuese | |
| 2103 | Salcat e përgatitjet prej tyre; erëza të përziera e aromatizues të përzier; miell e kokrriza mielli mustarde e mustarde të përgatitur : | | |
| | - Salcat e përgatitjet prej tyre; erëza të përziera e aromatizues të përzierë | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit . Megjithatë miell e kokrriza mielli mustardë dhe mustardë e përgatitur mund të përdoren | |
| | - Miell mustarde dhe ushqim dhe mustardë e përgatitur | Prodhime prej materiale të çdo kreu | |
| ex 2104 | Supat e lëngjet e mishit si dhe përgatitjet prej tyre | Prodhime prej materiale të çdo kreu përveç zrazaveve të përgatitura ose të ruajtura të kreut 2002 deri 2005 | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------------------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 2106 | Përgatitje ushqimore të papërfshira e të paspecifikuara diku tjetër | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, dhe - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 2 2 | Pijet, alkoolet dhe uthulla; përveç : | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, - në të cilat i gjithë rrushi ose çdo nënprodukt rrushi i përdorur janë origjinuese | |
| 2202 | Ujërat, përfshirë ujërat minerale e ujërat e gazuar, që përmbajnë sheqer ose lëndë të tjera ëmbëltuese ose aromatizuese, shtesë, e pije të tjera jo-alkoolike, pa përfshirë lëngun e frutave ose të zarzavateve të kreut Nr. 2009 | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit, - në të cilat vlera e çdo materiali të Kapitullit 17 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit, dhe - në të cilat çdo lëng frutash të përdorur (përveç lëngjeve të ananasit, qitros dhe greitfrutit) janë origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------------------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 2207 | Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% vol ose më e lartë; alkool etilik e alkoole të tjera, të denaturuara, të çdo lloj force | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe - në të cilët i gjithë rrushi ose nënprodukt nga rrushi të përdorur janë tërësisht origjinës ose në qoftë se të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkoolike mund të përdoren në një kufi deri 5% sipas volumit | |
| 2208 | Alkool etilik jo i denaturuar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol; pije alkoolike, likere e alkoole të tjera | Prodhime: - prej materialeve të çdo kreu, përveç kreut 2207 ose 2208, dhe - në të cilët i gjithë rrushi ose nënprodukt nga rrushi të përdorur janë tërësisht origjinës ose në qoftë se të gjitha materialet e tjera të përdorura janë tashmë origjinuese, pije alkoolike mund të përdoren në një kufi deri 5% sipas volumit | |
| ex Kapitulli 2 3 | Mbetjet e kthimet nga industritë ushqimore; tagjia e përgatitur për kafshët; përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 2301 | Ushqim balene, miell, ushqim dhe toptha prej peshku ose krustacesh, molusqesh e kafshëve të tjera jovertebrore ujore, të papërshtatshme për konsum njerëzor | Prodhime në të cilat të gjitha materialet e Kapitujve 2 dhe 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 2303 | Mbetjet prej prodhimeve të niseshtesë së mistrit (përfshirë lëngjet e koncentruar së tepërmi), me përmbajtje proteine të llogaritur ndaj produktit të thatë që kalon 40% ndaj peshës. | Prodhime në të cilat të gjitha misrat e përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| ex 2306 | Vaj i trashë dhe mbetje të tjera të forta, përfituar nga përpunimi i vajit të ullirit, që përmban më shumë se 3% vaj ulliri. | Prodhime në të cilat të gjithë ullinjtë e përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 2309 | Përgatitjet e një lloji të përdorur në ushqimin e kafshëve | Prodhime në të cilat : - të gjithë drithërat, sheqeri ose melasat, mishi ose qumështi i përdorur janë tashmë origjinuese, dhe - të gjitha materialet e Kapitullit 3 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------------------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex Kapitulli 2 4 | Duhani dhe zëvendësuesit e përpunuar të duhanit; përveç: | Prodhime në të cilat të gjithë materialet e Kapitullit 24 të përdorur janë tërësisht origjinuese | |
| 2402 | Puro, cigare e cigarillos, prej duhanit ose prej zëvendësuesve të duhanit | Prodhime në të cilat të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur janë origjinuese | |
| ex 2403 | Duhan për pirje | Prodhime në të cilat të paktën 70% sipas peshës së duhanit të papërpunuar ose mbetjeve të duhanit të kreut 2401 të përdorur janë origjinuese | |
| ex Kapitulli 2 5 | Kripërat; sulfuret; oksidet e gurët, materialet suvatuese, gëlqere e çimento; përveç : | Prodhime me materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 2504 | Grafit natyral kristalin, me përmbajtje karbon të pasuruar, pastruar dhe bazë (natyral) | Pasurimi i karbonit në grafit, pastrimi e bluarja e grafitëve kristalin të papërpunuar | |
| ex 2515 | Mermer, thjesht i prerë, nga sharrimi ose ndryshe, në blloqe ose pllaka në formë drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), të një trashësie që nuk kalon 25 cm | Prerje, me sharrë ose ndryshe, të mermerit (edhe në se tashmë është i prerë) me një trashësi që kalon 25 cm | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 2516 | Granit, porfir, bazalt, shkëmbinj të ranor e gurë të tjerë monumentale dhe ndërtime, të prera thjesht, nga sharrimi ose ndryshe, në blloqe ose pllaka në formë drejtkëndëshe (përfshirë edhe katrorin), të një trashësie që nuk kalon 25 cm | Prerje, me sharre ose ndryshe, të mermerit (edhe në së tashme është i prerë) me një trashësi që kalon 25 cm | |
| ex 2518 | Dolomitë të kalçinuara | Kalçinimi i dolomitëve të pakalçinuar | |
| ex 2519 | Karbonit magnezi natyral i bluar (magnezite), në kontejnerë hermetikë të mbyllur, dhe okside magnezi, nëse janë ose jo të pastra, të ndryshëm nga magnezi i shkrirë ose magnezi i vjetruar (sintered) | Prodhime prej materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit Megjithatë, karbonit i magnezit natyral (magnezitet) mund të përdoret | |
| ex 2520 | Gipse në mënyrë speciale përgatitur për dentiste | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 2524 | Fibra natyrale asbesti | Prodhime prej koncentratit asbesti | |
| ex 2525 | Pluhur mike | Bluarje të mikes ose të mbetjeve të mikes | |
| ex 2530 | Bojëra dheu, të kalçinuar ose pluhurëzuar | Kalçinimi ose bluarja e bojërave të dheut | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| Kapitulli 26 | Xehedorët, zgjyra dhe hiri | Prodhime me materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex Kapitulli 27 | Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale e produktet e distilimit të tyre; substancat bituminoze; dyllët minerale, përveç : | Prodhime prej materiale të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 2707 | Vajra në të cilat pesha e përbërësve aromatike kalon ato joaromatike, duke qenë vajra të ngjashëm me ato minerale përftuar nga distilimi në temperatura të larta të katranit të qymyrit; prej të cilës më shumë se 65% të volumit distilohet në një temperaturë deri në 250°C (përfshirë përzierjet e naftës spirit e benzolit), për përdorim si lëndë djegëse për energji ose për ngrohje | Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 2709 | Vajra të papërpunuara të përfituara prej mineraleve bituminoze | Distilim shkatërrues i materialeve bituminoze | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 2710 | Vajrat e naftës e vajra të fituara prej materialeve bituminoze, ndryshe nga bruto; përgatitje të paspecifikuara ose të papërfshira diku tjetër, që përmbajnë ndaj peshës 70% ose më shumë vajra naftë ose vajra të fituara nga materialet bituminoze, këto vajra duhet të jenë përbërësit bazë të përgatitjes | <p>Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (2) ose</p> <p>Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit</p> | |
| 2711 | Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike | <p>Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (2)</p> <p>ose</p> <p>Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit</p> | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 2712 | Xhelatinë naftë; dyllë parafine, dyllë, mikrokristaline prej naftës, dyllë i lëngshëm, ozokerit, dyllë linjiti, dyllë torfe, dyllë të tjera minerale, e produkte të ngjashme fituar nga sinteza ose nga procese të tjera, nëse janë ose jo të ngjyrosur | Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (2) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 2713 | Koks naftë, bitum naftë e mbetje të tjera të vajrave të naftës ose të vajrave të fituar prej materialeve bituminoze | Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 2714 | Bitum e asfalt natyral; rreshpe bituminoze ose rreshpe naftë e rërë katrani; asfaltitet e gurët asfaltik | <p>Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1)</p> <p>ose</p> <p>Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kreu me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit</p> | |
| 2715 | Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyral, në bitumin natyral, në bitumin e naftës, në katranin mineral ose në terpentinën e katranit mineral (psh, mastiçet bituminoze, bitum i lëngëzuar) | <p>Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1)</p> <p>ose</p> <p>Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kreu me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit</p> | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|-----------------|--|---|--|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex Kapitulli 28 | Kimikate inorganike; përbërjet organike ose inorganike të metaleve të çmuar, të metaleve të rrallë, të elementëve radioaktivë ose të izotopeve, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 20% të çmimit ex-works të produktit | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit |
| ex 2805 | “Mischmetall” | Prodhime me trajtim elektrolitik ose termik në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 2811 | Trioksid sulfuri | Prodhime prej dyoksidit të squfurit | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit |
| ex 2833 | Sulfat alumini | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 2840 | Perbonat sodiumi | Prodhime prej disodium tetraborate pentahydrate | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------------------|---|--|--|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex Kapitulli 2 9 | Kimikate organike, përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 20% të çmimit ex-works të produktit | Prodhime në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 40% të çmimit ex-works të produktit |
| ex 2901 | Hidrokarbonet aciklike, për përdorim si lëndë djegëse fuqie ose për ngrohje | Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1) ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|---|---|--|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 2902 | Ciklanet dhe ciclenet (të ndryshme nga azulenet), benzen, toluol, ksilol për përdorim si lëndë djegëse fuqie ose për ngrohje | Operacione të rafinimit dhe/ose një ose më shumë procese specifike (1) Ose Operacione të tjera në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, materialet e klasifikuara në të njëjtin kreu me atë të produktit mund të përdoren me kusht që vlera e tyre e përgjithshme nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex Kapitulli 9 5 | Lodrat, pajisjet e lojërave dhe ato sportive; pjesët dhe plotësuesit e tyre; përveç : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| 9503 | Lodra të tjera; modele me përmasa (“shkalle”) të zvogëluara e modele të rikrijuara të ngjashëm, që punojnë ose jo; rebuset e të gjitha llojeve | Prodhim: - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|------------------------|---|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 9506 | Shkopinjte e golfit dhe pjesët e tyre | Prodhim në të cilat të gjitha materialet e përdorur janë klasifikuar brenda një kreu të ndryshëm nga ai i produktit. Megjithatë, blloqe në forma të forta për prodhimin e kokave të shkopinjve të golfit mund të përdoren | |
| ex Kapitulli 9 6 | Artikujt të ndryshëm të prodhuar; përjashtuar me : | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 9601 dhe ex 9602 | Artikuj të gdhendur prej materiale kafshësh, zarzavatesh ose mineralesh | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |
| ex 9603 | Fshesat, furçat (përveç prej shqope e si këto), fshirësit e dyshemese mekanike për të operuar me dore, të pa motorizuara; fshirësit e pluhurave me pende e ato me fitila; xhufkat e nyejt | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9605 | Grup mallrash për udhëtime, të përdorura për tualet personal, për qepje ose për pastrimin e kepuceve ose të rrobave | Çdo njësi në këtë asortiment duhet të kënaqë rregullin i cili do të aplikohet në këtë rast nëse ai nuk do të ishte përfshirë në këtë asortiment. Megjithatë, artikujt jo origjinues mund të trupëzohen por vlera totale tyre nuk kalon 15% të çmimit ex-works të asortimentit. | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo origjinës, i cili u jep statusin e origjinës | |
|---------|--|--|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| 9606 | Butonat, mbërthyerit me shtypje, sustat e komçat, format e butonave e pjesë të tjera të këtyre artikujve; vrimat e butonave | Prodhim : - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |
| 9608 | Penat me maje të rrumbullaket; penat e shënuesit me maje të mbushur e të tjerë me maje poroze; stilografët, penatstilograf e pena të tjera; lapsat kopjative; lapsat rrëshqitës; mbajtësit e lapsave e stilolapsave e mbajtës të ngjashëm; pjesët (përfshirë kapaket e kapësit) e artikujve të sipër përshkruar, përveç atyre të kreut Nr.9609 | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit Megjithatë majat e penës dhe majat- pike të penës të klasifikuara në të njëjtin kre me atë të produktit mund të përdoren | |
| 9612 | Shiritat për makinat e shkrimit ose shirita të ngjashëm, të bojatisur ose të përgatitur ndryshe për dhënie e impresionove, nëse janë ose jo në rrotka ose në bobina; tamponët e bojës, nëse janë ose jo me boje, me ose pa kuti | Prodhim : - prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit , dhe - në të cilat vlera e të gjitha materialeve të përdorur nuk kalon 50% të çmimit ex-works të produktit | |

| Kodi HS | Përshkrimi i produktit | Punimi ose përpunimi i kryer mbi materialet jo originës, i cili u jep statusin e originës | |
|--------------|--|---|--------|
| (1) | (2) | (3) | or (4) |
| ex 9613 | Çakmakët me ndezës piezoelektrik | Prodhim në të cilat vlera e të gjitha materialeve të kreut 9613 të përdorur nuk kalon 30% të çmimit ex-works të produktit | |
| ex 9614 | Çibukët dhe llullat | Prodhim prej blloqe në forma të forta | |
| Kapitulli 97 | Veprat e artit, copat e mbledhura nga koleksionistët dhe antikat | Prodhime prej materialeve të çdo kreu, përveç atij të produktit | |

SHTOJCA III

MODELE PER ÇERTIFIKATEN E QARKULLIMIT TË MALLRAVE EUR.1 DHE APLIKIMI PER NJE ÇERTIFIKATE LEVIZJEJE EUR.1

Udhëzime për shtypjen e formularit të aplikimit

1. Secili formular duhet të ketë përmasa 210 x 297 mm, është e pranueshme 5 mm me pak ose 8 mm me shume gjatësi është e lejueshme. Letra e përdorur duhet të jete e bardhe, e madhësisë për shkrim, të mos përmbajë material letre mekanik dhe pesha të mos jete nën 25 g/m². Ajo duhet të në sfond një model të shtypur në ngjyrë të gjelbër duke e bërë të dallueshme me sy çdo lloj falsifikimi me mjete kimike ose mekanike.

2. Autoritete kompetente të Shteteve Anëtare të Komunitetit dhe të Shqipërisë mund të kenë të drejtën për të shtypur vetë këta formularë ose mund të shtypen për ta nga printerë të aprovuar. Në rastin e fundit, çdo formular duhet të përfshijë një rekomandim për një miratim të tillë. Secili formular duhet të mbajë emrin dhe adresën e printerit ose një shenjë dalluese me anë të së cilës mund të identifikohet. Ajo duhet të ketë gjithashtu një numër serie, të shtypur ose jo, prej së cilës mund të identifikohet.

ÇERTIFIKATË E QARKULLIMIT TË MALLRAVE

| | |
|--|---|
| 1. Eksportuesi (Emër, adresa e plotë, shteti) | EUR.1 Nr. A 000.000 |
| | Para se të plotësohet formulari shih shënimet e bëra në pjesën e pasme të tij. |
| 2. Certifikata përdoret për tregtimin preferencial midis | |
| 3. Marrësi i ngarkesës (Emri, adresa e plotë, shteti) (Fakultativ) | Dhe (Vendos shteti, grupin e shteteve ose territorin e përkatës) |

| | | |
|---|---|---|
| | 4. Shteti, shtetet ose territori të cilët konsiderohen si origjina e mallit | 5. Shteti, shtetet ose territori të cilët janë destinacioni |
| 6. Detajet e transportimit (Fakultativ) | 7. Vërejtjet | |
| 8. Numri i artikujve; Marka dhe numrat; Numri dhe lloji i paketimit ¹ ; Përshkrimi i mallit | 9. Pesha bruto (kg) ose njësi të tjera mase (litër, m ³ , etj.) | 10. Faturat (Fakultativ) |
| 11. Nënshkrimi i doganës Deklarata e vërtetuar Dokumenti eksportimit ² Formulari..... Nr Nga Zyra e doganës Shteti ose territori që bën lëshimin Vula Vendi dhe data (Firma) | 12. DEKLARATA NGA EKSPORTUESI Unë, nënshkruesi, deklaroj se mallrat e përshkruara më sipër i përmbushin kushtet e kërkuara për lëshimin e kësaj certifikate. Vendi dhe data (Firma) | |
| 13. KERKESE PER VERIFIKIM, ndaj | | 14. REZULTATI I VERIFIKIMIT |

| | |
|--|---|
| | <p>Verifikimet e kryera treguan që kjo certifikatë(1)</p> <p>ishte lëshuar nga zyra doganore të përcaktuara dhe që informacioni që përmbahej aty ishte i saktë.</p> <p>Nuk plotëson kërkesat si vërtetësia dhe saktësia (shih shënimet bashkangjitur).</p> <p>.....</p> <p>(Vendi dhe data)</p> <p style="text-align: right;">Vula</p> <p>.....</p> <p>(Firma)</p> <p>_____</p> <p>(1) vendos X në kutinë e duhur</p> |
| <p>Kërkohet verifikimi i vërtetësisë dhe saktësisë të kësaj certifikate</p> <p>.....</p> <p>(Vendi dhe data)</p> <p style="text-align: right;">Vula</p> <p>.....</p> | |

| | |
|-----------------|--|
| (Nënshkruesi) | |
|-----------------|--|

¹ Nëse mallrat nuk janë të paketuara, tregoni numrin e artikujve dhe gjendjen

² Të plotësohet vetëm nëse e kërkon nga vendi ose territori që e eksporton

SHËNIME

1. Certifikata nuk duhet të përmbajë vende të fshira apo fjalë të shkruara njëra mbi tjetrën. Çdo modifikim duhet të bëhet duke fshirë të dhënat e gabuara dhe duke shtuar çdo korrigjim të nevojshëm. Çdo modifikim i tillë duhet të fillohet nga personi i cili e ka plotësuar certifikatën dhe të nënshkruhet nga autoritetet doganore të vendit apo territorit që e ka lëshuar.

2. Nuk duhet të ketë asnjë hapësirë midis fjalive që shkruhen në certifikatë dhe çdo pikë duhet të paraprihet nga një numër përkatës. Duhet të hiqet një vizë horizontale menjëherë poshtë fjalisë së fundit. Në çdo hapësirë të papërdorur duhet të hiqen viza të tjera në një mënyrë të tillë që çdo shtesë të jetë e pamundur për tu bërë.

3. Mallrat duhet të përshkruhen në përputhje me praktikën tregtare dhe me detaje të mjaftueshme, që të jetë e mundur identifikimi i tyre.

Teksti i deklaratës se faturës

Deklarata a faturës, teksti te cilës është dhënë me poshtë, duhet të behet në përputhje me shënimet e bëra. Megjithatë, nuk është e nevojshme që shënimet të riprodhohen.

Versioni Spanjoll

El exportador de los productos incluidos en el presente documento (autorización aduanera n° ...(i)) declara que, salvo indicación en sentido contrario, estos productos gozan de un origen preferencial ...(ii).

Versioni Çek

Vývozce výrobků uvedených v tomto dokumentu (číslo povolení ...(1)) prohlašuje, že kromě zřetelně označených, mají tyto výrobky preferenční původ v ...(2).

Versioni Danez

Eksportøren af varer, der er omfattet af nærværende dokument, (toldmyndighedernes tilladelse nr. ...(1)), erklærer, at varerne, medmindre andet tydeligt er angivet, har præferenceoprindelse i ...(2).

Versioni Gjerman

Der Ausführer (Ermächtigter Ausführer; Beëilligungs-Nr. ...(1)) der Æaren, auf die sich dieses Handelspapier bezieht, erklärt, dass diese Æaren, soëeit nicht anderes angegeben, präferenzbegünstigte ...(2) Ursprungsæaren sind.

Versioni Estonez

Käesoleva dokumendiga hõlmatud toodete eksportija (tolliameti kinnitus nr. ...(1)) deklareerib, et need tooted on ...(2) sooduspäritoluga, välja arvatud juhul kui on selgelt näidatud teisiti.

Versioni Grek

Ο εξαγωγέας των προϊόντων που καλύπτονται από το παρόν έγγραφο (άδεια τελωνείου υπ' αριθ. ...(1)) δηλώνει ότι, εκτός εάν δηλώνεται σαφώς άλλως, τα προϊόντα αυτά είναι προτιμησιακής καταγωγής ...(2).

Versioni Anglez

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No ...(1)) declares that, except ãhere otherëise clearly indicated, these products are of ...(2) preferential origin.

Versioni Francez

L'exportateur des produits couverts par le présent document (autorisation douanière n° ...(1)) déclare que, sauf indication claire du contraire, ces produits ont l'origine préférentielle ... (2).

Versioni Italian

L'esportatore delle merci contemplate nel presente documento (autorizzazione doganale n. ...(1)) dichiara che, salvo indicazione contraria, le merci sono di origine preferenziale ...(2).

Versioni Letonez

Eksportētājs produktiem, kuri ietverti šajā dokumentā (muitas pilnvara Nr. ...(1)), deklarē, ka, izņemot tur, kur ir citādi skaidri noteikts, šiem produktiem ir priekšrocību izcelsme no ...(2).

Versioni Lituanez

Šiame dokumente išvardintų prekių eksportuotojas (muitinės liudijimo Nr. ...(1)) deklaruoja, kad, jeigu kitaip nenurodyta, tai yra ...(2) preferencinės kilmės prekės.

Versioni Hungarez

A jelen okmányban szereplő áruk exportőre (vámfelhatalmazási szám: ...(1)) kijelentem, hogy eltérő jelzés hiányában az áruk kedvezményes ...(2) származásúak.

Versioni Maltez

L-esportatur tal-prodotti koperti b'dan id-dokument (aëtorizzazzjoni tad-dëana nru. ...(1)) jiddikjara li, hlief fejn indikat b'mod çar li mhux hekk, daën il-prodotti huma ta' oriġini preferenzjali ...(2).

Versioni Hollandez

De exporteur van de goederen ëaarop dit document van toepassing is (douanevergunning nr. ...(1)), verklaart dat, behoudens uitdrukkelijke andersluidende vermelding, deze goederen van preferentiële ... oorsprong zijn (2).

Versioni Polak

Eksporter produktöë objętych tym dokumentem (upoëaznienie ëładz celnych nr. ...(1)) deklaruje, że z ëyjątkiem gdzie jest to ëyraźnie określone, produkty te mają ...(2) preferencyjne pochodzenie.

Versioni Portugez

O abaixo assinado, exportador dos produtos cobertos pelo presente documento (autorização aduaneira n.º. ...(1)), declara que, salvo expressamente indicado em contrário, estes produtos são de origem preferencial ...(2).

Versioni Slloven

Izvoznik blaga, zajetega s tem dokumentom (pooblastilo carinskih organov št. ...(1)) izjavlja, da, razen če ni drugače jasno navedeno, ima to blago preferencialno ...(2) poreklo.

Versioni Sllovak

Vývozca výrobkov uvedených v tomto dokumente (číslo povolenia ... (1)) vyhlasuje, že okrem zreteľne označených, majú tieto výrobky preferenčný pôvod v ... (2).

Versioni Finlandez

Tässä asiakirjassa mainittujen tuotteiden viejä (tullin lupa n:o ... (1)) ilmoittaa, että nämä tuotteet ovat, ellei toisin ole selvästi merkitty, etuuskohteluun oikeutettuja ... alkuperätuotteita (2).

Versioni Suedez

Exportören av de varor som omfattas av detta dokument (tullmyndighetens tillstånd nr. ... (1)) försäkrar att dessa varor, om inte annat tydligt markerats, har förmånsberättigande ... ursprung (2).

Versioni Shqiptar

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr. ... (i)) deklaron që, përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë preferenciale ... (ii).

.....
(iii)

(Vendi dhe data)

.....
(iv)

(Firma e eksportuesit, si edhe emri i personit që nënshkruan deklaratën duhet të paraqiten me germa shtypi të qarta)

(i) Kur lëshohet një faturë nga një eksportues i autorizuar, numri i autorizimit të eksportuesit me licence duhet të shënohet në vendin e caktuar për këtë e qëllim. Në rast se fatura nuk është hartuar nga një eksportues i licencuar, fjalët në kllapa hiqen ose vendi lihet bosh.

(ii) Të tregohet origjina e produkteve. Kur fatura ka lidhje, plotësisht apo pjesërisht, me produktet që i përkasin Seutës dhe Melilës, eksportuesi duhet t'i përfshijë ato qartë në dokument, ku deklarata të tregohet me simbolin 'CM'.

(iii) Këto informacione mund të përjashtohen nëse tashmë janë të përfshira në dokument.

(iv) Në rastet kur eksportuesit nuk i kërkohet të firmosë, përjashtimi i firmës së tij do të nënkuptojë gjithashtu edhe përjashtimin e emrit të nënshkruesit/eksportuesit.

DEKLARATA NE LIDHJE ME PROTOKOLLIN 4

DEKLARATE E PERBASHKET

Ne lidhje me Principatën e Andorës

1. Prodhime që e kanë origjinën në Principatën e Andorës të Kapitullit 25 deri në 97 të Sistemit të Harmonizuar pranohen nga Shqipëria si të Komunitetit në përputhje me këtë Marrëveshje.
2. Protokolle 4 do të zbatohet mutatis mutandis me qëllim që të përcaktohet statusi i origjinës së prodhimeve të sipër përmendur.

DEKLARATE E PERBASHKET

Ne lidhje me Republikën e San Marinos

1. Prodhime që e kanë origjinën në Republikën e San Marinos pranohen nga Shqipëria si të Komunitetit në përputhje me thelbin e kësaj Marrëveshjeje.
2. Protokolle 4 do të zbatohet mutatis mutandis për të përcaktuar statusin e origjinës së prodhimeve të sipër përmendur.

PROTOKOLLI 5 MBI TRANSPORTIN TOKESOR

NENI 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Protokolle është nxitja e bashkëpunimit midis Palëve në lidhje me transportin tokësor dhe në veçanti në lidhje me trafikun e transitit, dhe sigurimi për këtë qëllim që transporti midis dhe nëpërmjet territoreve të Palëve, të zhvillohet në mënyrë të koordinuar me anë të zbatimit të plotë dhe të ndërvarur të të gjitha dispozitave të këtij Protokolle.

NENI 2

Fusha e veprimit

1. Bashkëpunimi do të mbulojë transportin tokësor dhe veçanërisht sektorin e rrugëve, hekurudhor dhe transportin e kombinuar, si dhe do të përfshijë infrastrukturën e nevojshme.
2. Në këtë kontekst, fusha e veprimit të këtij Protokolle do të mbulojë në veçanti:
 - infrastrukturën e transportit në territorin e njëjës prej Palëve në masën e nevojshme, për të arritur objektivin e këtij Protokolle,
 - aksesin në treg në fushën e transportit rrugor, bazuar në parimin e reciprocitetit,

- masa thelbësore mbështetëse ligjore dhe administrative, duke përfshirë masa tregtare, tatimore, sociale dhe teknike,
- bashkëpunim në zhvillimin e një sistemi transporti, i cili përmbush nevojat mjedisore,
- një shkëmbim të rregullt të informacionit mbi zhvillimin e politikave të transportit të Palëve, ne veçanti për infrastrukturën e transportit.

NENI 3

Përkufizimet

Për qëllime të këtij Protokollit, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) Trafiku transitit i Komunitetit: transporti, nga një transportues i vendosur në Komunitet, i mallrave në transit nëpërmjet territorit shqiptar në rrugën drejt ose nga një Shtet Anëtar i Komunitetit;
- b) Trafiku transitit shqiptar: transporti, nga një transportues i vendosur në Shqipëri, i mallrave në transit nga Shqipëria nëpërmjet territorit të Komunitetit dhe të destinuara për një vend të tretë, ose të mallrave nga një vend i tretë të destinuara për Shqipërinë;
- c) Transport i kombinuar: transporti i mallrave, ku kamioni, rimorkioja, gjysmë-rimorkioja, me ose pa njësi traktori, një mjet shkëmbimi ose kontejneri për 6 metra ose më shumë, përdor rrugën në fazën e parë ose të fundit të udhëtimit dhe në fazën tjetër, rrugën ujore hekurudhore ose tokësore apo shërbime detare, ku ky seksion i tejkalon 100 kilometra në vijë të drejtë dhe bën rrugën e transportit fillestar ose përfundimtar të udhëtimit;
 - midis pikës ku ngarkohen mallrat dhe stacionit hekurudhor të ngarkimit më të afërt, të përshtatshëm për fazën e parë, dhe midis stacionit hekurudhor të shkarkimit më të afërt të përshtatshëm dhe pikës ku mallrat shkarkohen për fazën e fundit, ose
 - brenda një rrezeje që nuk i tejkalon 150 km në vijë të drejtë nga porti i brendshëm i rrugës ujore ose porti detar i ngarkimit apo shkarkimit.

INFRASTRUKTURA

NENI 4

Dispozita të Përgjithshme

Palët Kontraktuese bien dakord të adoptojnë masa reciprokisht të koordinuara për të zhvilluar një rrjet infrastrukturor transporti multimodal, si një mjet të rëndësishëm të zgjidhjes së problemeve që prekin ngarkesën e mallrave nëpër Shqipëri, në veçanti në Korridorin VIII Mbarë-Evropian, aksin Veri-Jug dhe lidhjet në Zonën e Transportit Mbarë-Evropian Adriatik/Jon.

NENI 5

Planifikimi

Zhvillimi i një rrjeti transporti rajonal të multimodal në territorin shqiptar, i cili i shërben interesave të rajonit të Shqipërisë dhe Europës Juglindore, që mbulon rrugën kryesore dhe rrugët hekurudhore, rrugët e brendshme ujore, portet tokësore, portet, aeroportet dhe tipe të tjera të rëndësishme të rrjetit, paraqet interes të veçantë për Komunitetin dhe për Shqipërinë. Ky rrjet është përcaktuar në një Memorandum Mirëkuptimi për zhvillimin e rrjetit infrastrukturor bazë të transportit për Evropën Juglindore, i cili u nënshkrua nga ministrat e rajonit dhe Komisioni Evropian në qershor 2004. Zhvillimi i rrjetit dhe përzgjedhja e prioriteteve do të kryhet nga Komiteti Orientues, i përbërë prej përfaqësuesve nga secili prej vendeve nënshkruese.

NENI 6

Aspektet financiare

Komuniteti mund të japë kontribut financiar, sipas nenit [112] të Marrëveshjes, në lidhje me punimet e nevojshme infrastrukturore të referuara në nenin 5. Ky kontribut financiar mund të marrë formën e kredisë nga Banka e Investimeve Evropiane dhe çdo formë tjetër financimi që mund të sigurojë burime të mëtejshme shtesë.

Me qëllim përshpejtimin e punës, Komisioni do të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura për të stimuluar përdorimin e burimeve shtese, të tilla si investimet nga disa Shtete Anëtare mbi baza dypalëshe ose nga fondet publike apo private.

TRANSPORTI HEKURUDHOR DHE I KOMBINUAR

NENI 7

Dispozita të Përgjithshme

Palët do të adoptojnë masa reciprokisht të koordinuara të nevojshme për zhvillimin dhe promovimin e transportit hekurudhor dhe të kombinuar, si një mjet për të siguruar që në të ardhmen një sasi e madhe e transporteve të tyre dypalëshe dhe transitit përmes Shqipërisë, të kryhet në kushte të sigurta mjedisore.

NENI 8

Aspekte të veçanta në lidhje me infrastrukturën

Si pjesë e modernizimit të hekurudhave shqiptare, do të merren hapat e nevojshme për të përshtatur sistemin për transportin e kombinuar, në veçanti në lidhje me zhvillimin ose ndërtimin e terminaleve, përmasat dhe kapacitetet e tunelit, të cilat kërkojnë investime thelbësore.

NENI 9

Masa mbështetëse

Palët do të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të nxitur zhvillimin e transportit të kombinuar.

Qëllimi i marrjes së këtyre masave do të jetë:

- për të nxitur përdorim e transportit të kombinuar nga përdoruesit dhe dërguesit,
- për ta bërë transportin të kombinuar konkurrues me transportin rrugor, veçanërisht nëpërmjet mbështetjes financiare të Komunitetit ose Shqipërisë në kontekstin e legjislacionit të tyre përkatës,
- për të nxitur përdorimin e transportit të kombinuar në distanca të largëta dhe në veçanti për të nxitur përdorimin e mjeteve të shkëmbimit, kontejnerëve dhe transportit të pashoqëruar në përgjithësi,
- për të përmirësuar shpejtësinë dhe besueshmërinë e transportit të kombinuar dhe në veçanti:
 - për të rritur frekuencat e mjeteve shoqëruese të transportit në përputhje me nevojat e dërguesve dhe përdoruesve,
 - për të shkurtuar kohën e pritjes në terminale dhe për të rritur produktivitetin e tyre,
 - për të eliminuar në mënyrë të përshtatshme të gjitha pengesave nga rrugët hyrëse, me qëllim që të përmirësohet aksesin në transportin e kombinuar,
 - për të harmonizuar, sipas nevojës, peshat, dimensionet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve të specializuara, veçanërisht për të siguruar përputhshmërinë e nevojshme të standardeve matëse dhe për të marrë masa të koordinuara në lidhje me urdhërimin dhe vënien në shërbim të pajisjeve, siç kërkohet nga niveli i trafikut,
- dhe, në përgjithësi, për të marrë çdo mase tjetër të nevojshme.

NENI 10

Roli i sektorit hekurudhor

Në lidhje me kompetencat respektive të Shteteve dhe hekurudhave, Palët, për sa i përket transportit të pasagjerëve dhe mallrave, do të rekomandojnë që sektorët e tyre hekurudhorë:

- të forcojnë bashkëpunimin, qoftë dypalësh, shumëpalësh ose brenda organizatave hekurudhore ndërkombëtare, në të gjitha fushat, veçanërisht për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të transportit,

-të përpiqen të krijojnë një sistem të përbashkët të organizimit të hekurudhave në mënyrë që të nxiten dërguesit për dërgimin e ngarkesës me linjë hekurudhore sesa me linjë rrugore, veçanërisht për qëllime transiti, mbi bazat e një konkurrence e ndershme dhe nga ana tjetër duke i lënë përdoruesit liri zgjedhjeje në këtë çështje,

-të përgatisë pjesëmarrjen e Shqipërisë në zbatimin dhe evoluimin e ardhshëm të *acquis* e Komunitetit në lidhje me zhvillimin e sektorit hekurudhor.

TRANSPORTI RRUGOR

NENI 11

Dispozita të Përgjithshme

Në lidhje me aksesin e ndërsjellët në tregjet e transportit, Palët, pa cenuar paragrafin 2, fillimisht bien dakord të ruajnë regjimin që buron nga marrëveshjet dypalëshe ose instrumente të tjera ekzistuese ndërkombëtare dypalëshe të lidhura midis çdo Shteti Anëtar të Komunitetit dhe Shqipërisë, ose kur nuk ka marrëveshje apo instrumente të tilla, t'i përmbahen regjimit që buron nga situata *de facto* në vitin 1991.

Megjithatë, ndërsa pritet konkluzioni i një marrëveshjeje midis Komunitetit dhe Shqipërisë mbi aksesin në tregun e transportit rrugor, siç parashikohet në nenin 12 dhe mbi tatinin rrugor, siç parashikohet në nenin 13.2, Shqipëria do të bashkëpunojë me Shtetet Anëtare të Komunitetit për të amenduar këto marrëveshje dypalëshe, me qëllim që t'ia përshtatë këtij Protokollit.

Palët bien dakord që t'i japin akses të pakufizuar trafikut transit të Komunitetit përmes Shqipërisë dhe në trafikun transit shqiptar përmes Komunitetit, me efekt nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse, si rezultat i të drejtave të dhëna sipas paragrafit 2, trafiku transit nga transportuesit e Komunitetit rritet në një shkallë të tillë që shkakton ose rrezikon shkaktimin e një dëmi serioz në infrastrukturën rrugore dhe/ose në rrjedhshmërinë e trafikut në akset rrugore të përmendura në nenin 5, dhe problemet që lindin në të njëjtat rrethana në territorin e Komunitetit afër kufijve shqiptarë, çështja do të paraqitet në Këshillin e Stabilizim Asocimit në përputhje me nenin [118] të Marrëveshjes. Palët mund të propozojnë masa të jashtëzakonshme, të përkohshme, jodiskriminuese, sipas nevojës, për të kufizuar ose lehtësuar këtë dëm.

Nëse Komuniteti Evropian krijon rregulla që synojnë uljen e ndotjes së shkaktuar nga automjetet e rënda të mallrave të regjistruara në Bashkimin Evropian dhe për të përmirësuar sigurinë e trafikut, një regjim i ngjashëm do të zbatohet për automjetet e rënda të mallrave të regjistruara në Shqipëri që dëshirojnë të qarkullojnë përmes territorit të Komunitetit. Këshilli i Stabilizim Asocimit do të vendosë në lidhje me modalitetet e nevojshme.

Palët do të frenohen në marrjen e masave një palese që mund të çojnë në diskriminimin e bërë për mjetet e transportit ose automjetet që i përkasin Komunitetit apo Shqipërisë. Çdo Palë Kontraktuese do të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të lehtësuar transportin rrugor në ose përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

NENI 12

Aksesi në treg

Palët, si çështje prioritare, do të ndërmarrin të punojnë së bashku për të kërkuar, secila prej tyre duke qenë e nënshtruar ndaj rregullave të tyre të brendshme,

- veprime që kanë të ngjarë të favorizojnë zhvillimin e një sistemi transporti, i cili përmbush nevojat e Palëve Kontraktuese, dhe që është në përputhje, nga njëra anë, me përfundimin e tregut të brendshëm të Komunitetit dhe zbatimin e politikës së përbashkët të transportit, dhe nga ana tjetër, me politikën ekonomike dhe të transportit të Shqipërisë,

- një sistem përcaktues për rregullimin e aksesit në tregun e transportit rrugor në të ardhmen midis Palëve Kontraktuese, bazuar në parimin e reciprocitetit.

NENI 13

Tatimi, tarifa dhe detyrime të tjera

Palët pranojnë që tatimi i automjeteve rrugore, tarifrat dhe detyrimet e tjera nga secila palë nuk duhet të jenë diskriminuese.

Palët do të hyjnë në bisedime me qëllim arritjen e një marrëveshjeje mbi tatimin rrugor, sa më parë që të jetë e mundur, mbi bazën e rregullave të miratuara nga Komuniteti në lidhje me këtë çështje. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë, në veçanti, sigurimi i lëvizjes së lirë të trafikut ndërkufitar, për të eliminuar në mënyrë progresive ndryshimet midis sistemeve të tatimit rrugor të zbatuara nga Palët dhe devijimet e konkurrencës që lindin nga këto ndryshime.

Gjatë konkluzionit të bisedimeve të përmendura në paragrafin 2, Palët do të eliminojnë dallimin midis transportuesve të Komunitetit ose të Shqipërisë, kur vënë taksa ose detyrime për qarkullimin dhe/apo zotërimin e mjeteve të rënda për transport mallrash, si edhe taksa apo detyrime të vëna për operacionet transportuese në territorin e Palëve. Shqipëria, nëse kërkohet, ndërmerr të njoftojë Komisionin e Komuniteteve Evropiane në lidhje me sasinë e taksave, taksave rrugore dhe tarifave që zbaton ajo, si dhe metodën e llogaritjes së tyre.

Deri në përfundimin e marrëveshjeve të përmendura në paragrafin 2 dhe në nenin 12, çdo ndryshim i propozuar pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për ndryshimet fiskale, tarifa ose detyrime të tjera, duke përfshirë sistemet për mbledhjen e tyre, që mund të zbatohet për trafikun transit të Komunitetit përmes Shqipërisë, do të nënshtrohet një procedure paraprake konsultimi.

NENI 14

Peshat dhe dimensionet

Shqipëria pranon që automjetet rrugore të cilat janë në përputhje me standardet e Komunitetit në lidhje me peshat dhe dimensionet, mund të qarkullojnë lirisht dhe pa pengesa në rrugët e mbuluara nga neni 5. Gjatë një periudhe gjashtë mujore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, automjetet rrugore të cilat nuk janë në përputhje me standardet ekzistuese shqiptare mund të bëhen subjekt i një takse të veçantë jo-diskriminuese, e cila reflekton dëmin e shkaktuar nga pesha shtesë.

Nga fundi i vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të përpiqet të harmonizojë rregulloret dhe standardet e saj ekzistuese për ndërtimin e rrugëve me legjislacionin dominues në Komunitet, dhe do të bëjë përpjekje maksimale për përmirësimin e rrugëve ekzistuese të mbuluara nga neni 5 në ato rregullore dhe standarde të reja brenda kohës së propozuar, brenda mundësive të saj financiare.

NENI 15

Mjedisi

Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, Palët do të përpiqen të paraqesin standarde mbi emetimet e gazta dhe grimcore dhe nivelet e zhurmave për automjetet e rënda të mallrave, të cilat sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje.

Me qëllim sigurimin e një informacioni të qartë për industrinë dhe nxitjen e kërkimit, programimit dhe prodhimit të koordinuar, do të shmangen standardet e veçanta kombëtare në këtë fushë.

Automjetet të cilat përmbushin standardet e parashtruara nga marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë lidhje edhe me mjedisin, mund të operojnë pa kufizime të mëtejshme në territorin e Palëve.

Për qëllim të paraqitjes së standardeve të reja, Palët do të punojnë së bashku për arritjen e objektivave të lartpërmendura.

NENI 16

Aspektet sociale

Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin e saj mbi trajnimin e personelit të transportit rrugor, veçanërisht në lidhje me transportimin e mallrave të rrezikshme, sipas standardeve të KE-së.

Shqipëria, si Palë Kontraktuese e Marrëveshjes Evropiane mbi skuadrat ndërkombëtar të transportit rrugor (ERTA), dhe Komuniteti do të koordinojnë optimalisht politikat e tyre në lidhje me kohën e lëvizjes së automjeteve, ndërprerjeve dhe periudhave të pushimit për shoferët dhe përbërjen e skuadrës, në lidhje me zhvillimin e ardhshëm të legjislacionit social në këtë fushë.

Palët do të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e legjislacionit social në fushën e transportit rrugor.

Palët do të sigurojnë barazvlefshmërinë e ligjeve të tyre përkatëse që kanë të bëjnë me pranimin në profesionin e operatorit të transportit rrugor, me qëllim njohjen e tyre të ndërsjellët.

NENI 17

Dispozita në lidhje me trafikun

Palët do të grumbullojnë përvojën e nevojshme dhe do të përpiqen të harmonizojnë legjislacionin e tyre në mënyrë që të përmirësojnë lëvizjen e trafikut gjatë periudhave më të ngarkuara (fundjava, festa zyrtare, sezon turistik).

Në përgjithësi, palët do të nxisin paraqitjen, zhvillimin dhe koordinimin e sistemit të informacionit të trafikut rrugor.

Ato do të përpiqen të harmonizojnë legjislacionin e tyre mbi transportimin e mallrave të dëmtueshme, kafshëve të gjalla dhe substancave të rrezikshme.

Palët gjithashtu do të përpiqen të harmonizojnë asistencën teknike, që do t'i sigurohet shoferëve shpërndarjen e informacionit kryesor në lidhje me trafikun dhe çështje të tjera që shqetësojnë turistët, dhe shërbime emergjence duke përfshirë shërbime ambulance.

NENI 18

Siguria rrugore

Nga fundi i vitit të pestë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin e saj me atë të Komunitetit, në lidhje me sigurinë rrugore, veçanërisht për sa i përket transportit të mallrave të rrezikshme.

Shqipëria, si Palë Kontraktuese e Marrëveshjes Evropiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme nëpërmjet Sistemit Rrugor (ADR) dhe Komuniteti do të koordinojnë optimalisht politikatat e tyre në lidhje me transportimin e mallrave të rrezikshme.

Palët do të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e legjislacionit të sigurisë rrugore, veçanërisht në lidhje me patentat dhe masat për pakësimin e aksidenteve rrugore.

THJESHTIMI I FORMALITETEVE

Neni 19

Thjeshtimi i formaliteteve

Palët bien dakord që të thjeshtojnë lëvizjen e mallrave me rrugë hekurudhore dhe transporti, qoftë bilateral ose në transit.

Palët bien dakord të fillojnë bisedime, me synim përfundimin e një marrëveshjeje mbi lehtësimin e kontrolleve dhe formaliteteve në lidhje me transportin e mallrave.

Palët bien dakord, në shkallën e nevojshme , të ndërmarrin masa të përbashkëta dhe të nxisin adoptimit e masave të mëtejshme thjeshtuese.

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 20

Zgjerimi i fushës së veprimit

Nëse njëra prej Palëve vendos, mbi bazën e përvojës në zbatimin e këtij Protokollit, që masa të tjera të cilat nuk hyjnë në fushën e veprimit të Protokollit, janë në interes të një politike transporti të koordinuar Evropiane dhe në veçanti mund të ndihmojnë të zgjidhin problemin e trafikut transit në këtë aspekt, ajo Palë do t'i paraqesë Palës tjetër sugjerimet e nevojshme.

NENI 21

Zbatimi

1. Bashkëpunimi midis Palëve do të kryhet brenda kuadrit të një Nënkomiteti të veçantë që do të krijohet në përputhje me nenin 121 të Marrëveshjes.
2. Ky Nënkomitet, në veçanti:
 - a) do të hartojë plane në lidhje me bashkëpunimin për transportin hekurudhor dhe të kombinuar, kërkimin mbi transportin dhe mjedisin;
 - b) do të analizojë zbatimin e vendimeve që përmbahen në Protokollin e tanishëm dhe do t'i rekomandojë Komitetit të Stabilizim Asocimit zgjidhjet e përshtatshme për probleme që mund të lindin;
 - c) dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të ndërmarrë një vlerësim të situatës për sa i përket përmirësimeve në infrastrukturë dhe pasojave të transitit të lirë;
 - d) do të koordinojë monitorimin, parashikimin dhe punë të tjera statistikore në lidhje me transportin ndërkombëtar dhe në veçanti me trafikun transit.

DEKLARATE E PERBASHKET

1. Komuniteti dhe Shqipëria vërejnë që nivelet e emetimeve të gazta dhe zhurma, aktualisht të pranuar në Komitetet për qëllime të miratimit të tipit të automjetit të rëndë të mallrave nga 01.01.2001,1 janë si më poshtë:

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Qëndrueshëm Evropian (ESC) dhe testi i Reagimit të Ngarkesës Evropiane (ELR):

| | | Masa e monoksidit të karbonit | Masa e hidrokarboneve | Masa e oksideve të nitrogenit | Masat e materialeve grimcore | Tymi |
|---------|----------|-------------------------------|-----------------------|-------------------------------|------------------------------|-----------------|
| | | (Co) g/kwh | (HC) g/kwh | (Nox) g/kwh | (PT) g/kwh | m ⁻¹ |
| Radha A | Euro III | 2.1 | 0.66 | 5.0 | 0.10 0.13 ^(a) | 0.8 |

| | | Masa e monoksidit të karbonit | Masa e hidrokarboneve që nuk kanë përmbajtje metani | Masa e metanit | Masa e oksideve të nitrogenit | Masa e materialeve grimcore |
|---------|----------|-------------------------------|---|------------------------------|-------------------------------|-----------------------------|
| | | (Co) g/kwh | (NMHC) g/kwh | (CH ₄) (b) g/kwh | (NOx) g/kwh | (PT) (c) g/kwh |
| Radha A | Euro III | 5.45 | 0.78 | 1.6 | 5.0 | 0.16 0.21 (a) |

^(a) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min⁻¹

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Përkohshëm Evropian

^(a) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min⁻¹

^(b) Vetëm për motorët me gaz natyror

^(c) E pazbatueshme për motorët e furnizuar me gaz.

2. Në të ardhmen, Komuniteti dhe Shqipëria do të përpiqen të pakësojnë emetimet e automjeteve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne të kontrollit të emetimit të automjeteve kombinuar me cilësinë e përmirësuar të karburantit të motorit.

PROTOKOLLI 6

MBI NDIHMEN E NDERSJELLTE ADMINISTRATIVE

NE ÇESHTJET DOGANORE

NENI 1

Përkufizimet

Për qëllime të këtij Protokollit:

- (a) “legjislacioni doganor” do të nënkuptojë çdo dispozitë ligjore ose rregullatorë të zbatueshme në territoret e Palëve Kontraktuese, që qeverisin importin, eksportin dhe transitin e mallrave dhe vendosjen e tyre sipas çdo regjimi ose procedure tjetër doganore, duke përfshirë masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit;
- (b) “autoriteti kërkues” do të nënkuptojë një autoritet administrativ kompetent, i cili është caktuar nga një Palë Kontraktuese për këtë qëllim dhe që bën një kërkesë për ndihmë në bazë të këtij Protokollit;
- (c) “autoriteti i kërkuar” do të nënkuptojë një autoritet administrativ kompetent i cili është caktuar nga një Palë Kontraktuese për këtë qëllim, dhe që merr një kërkesë për ndihmë në bazë të këtij Protokollit;
- (d) “të dhëna personale” do të nënkuptojnë të gjithë informacionin në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;
- (e) “veprim në shkelje të legjislacionit doganor” do të nënkuptojë çdo shkelje ose orvatje për shkelje të legjislacionit doganor.

NENI 2

Fusha e veprimit

1. Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra tjetrën në fushat brenda kompetencave të tyre, në mënyrën dhe sipas kushteve të parashtruara në këtë Protokoll, për të siguruar zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, veçanërisht duke parandaluar, hetuar dhe luftuar veprimet që shkelin atë legjislacioni.
2. Ndihma në çështjet doganore, siç parashikohet në këtë Protokoll, do të zbatohet ndaj çdo autoriteti administrativ të Palëve Kontraktuese, i cili është kompetent për zbatimin e këtij Protokoll. Ajo nuk do të cenojë rregullat që përcaktojnë ndihmën e ndërsjellët në lidhje me çështjet penale. Gjithashtu, nuk do të mbulojë informacionin e përfshirë nga kompetencat e ushtruara me kërkesë të autoritetit gjyqësor, përveçse kur komunikimi i këtij informacioni është autorizuar nga ai autoritet.
3. Ndihma për të kompensuar tatimet, taksat ose gjobat nuk mbulohet nga ky Protokoll.

NENI 3

Ndihma sipas kërkesës

1. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do t'i japë atij të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili mund t'i japë mundësinë autoriteti kërkues të sigurohet se legjislacioni doganor është zbatuar në mënyrën e duhur, duke përfshirë informacione në lidhje me aktivitetet e vërejtura ose të planifikuara që janë ose mund të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor.
2. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar do ta informojë atë:
 - (a) nëse mallrat e eksportuara nga territori i njëjës prej Palëve Kontraktuese janë importuar ashtu siç duhet në territorin e Palës tjetër, duke specifikuar sipas nevojës, procedurën doganore të zbatuar për mallrat;
 - (b) nëse mallrat e importuara në territorin e njëjës prej Palëve Kontraktuese janë eksportuar ashtu siç duhet nga territori i Palës tjetër, duke specifikuar sipas nevojës, procedurën doganore të zbatuar për mallrat.
3. Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, brenda kuadrit të dispozitave të tij ligjore ose rregullatorë, do të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të siguruar mbikëqyrje speciale të:
 - (a) personave fizikë ose juridikë në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qenë të përfshirë në veprime që shkelin legjislacionin doganor;

(b) vendet ku stoqet e mallrave kanë qenë ose mund të mblidhen në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se synohet të përdoren në veprime që shkelin legjislacionin doganor;

(c) mjete transporti që përdoren ose mund të përdoren në mënyrë të tillë që ka arsye të besohet se synohen të përdoren në veprime që shkelin legjislacionin doganor.

NENI 4

Asistenca e paparashikuar

Palët Kontraktuese do të ndihmojnë njëra tjetrën, me iniciativën e tyre dhe në përputhje me dispozitat e tyre ligjore ose rregullatorë, nëse e konsiderojnë të nevojshme për zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, veçanërisht duke siguruar informacion të përfutur në lidhje me:

aktivitetet që janë ose kanë të ngjarë të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor, dhe që mund të paraqesin interes për Palën tjetër Kontraktuese;

-mjete ose metoda të tjera të përdorura për kryerjen e veprimeve në shkelje të legjislacionit doganor;

-mallra të njohura që janë objekt i veprimeve në shkelje të legjislacionit doganor;

-persona fizikë ose juridikë në lidhje me të cilët ka arsye të besohet se janë ose kanë qenë të përfshirë për veprime në shkelje të legjislacionit doganor;

-mjete transporti në lidhje me të cilat ka arsye të besohet se kanë qenë, janë ose mund të përdoren për veprime në shkelje të legjislacionit doganor.

NENI 5

Dorëzimi, Njoftimi

Me kërkesë të autoritetit kërkues, autoriteti i kërkuar, në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatorë të zbatueshme për këtë të fundit, do të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që:

- të dorëzojë çdo dokument ose

- të njoftojë në lidhje me çdo vendim;

që buron nga autoriteti kërkues dhe që hyn brenda fushës së veprimit të këtij Protokoll, ndaj një marrësi që banon ose është vendosur në territorin e autoritetit të kërkuar.

Kërkesat për dërgimin e dokumenteve ose njoftimin e vendimeve do të bëhen me shkrim në një gjuhë zyrtare të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet.

NENI 6

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për ndihmë

1. Kërkesat, sipas këtij Protokolli, do të bëhen me shkrim. Ato do të shoqërohen nga dokumentet e nevojshme për të siguruar përputhshmëri me kërkesën. Kur kërkohen për shkak të urgjencës së situatës, mund të pranohen kërkesa gojore, megjithatë ato duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.

2. Sipas paragrafit 1, kërkesat do të përfshijnë informacionet e mëposhtme:

(a) autoritetin kërkuar;

(b) masën e kërkuar

(c) objektin dhe arsyen e kërkesës;

(d) dispozitat ligjore ose rregullatorë dhe elementë të tjerë ligjorë të përfshirë;

(e) të dhëna sa më të sakta dhe të plota në lidhje me personat fizikë ose juridikë, të cilët janë subjekt hetimi;

(f) një përmbledhje të fakteve përkatëse dhe të hetimeve të kryera.

3. Kërkesat do të dorëzohen në gjuhën zyrtare të autoritetit të kërkuar ose në një gjuhë të pranueshme për atë autoritet. Kjo kërkesë nuk do të zbatohet për dokumentet që shoqërojnë kërkesën sipas paragrafit 1.

4. Nëse një kërkesë nuk i përmbush kërkesat formale të parashtruara më sipër, mund të kërkohet korrigjimi ose përfundimi i saj; ndërkohë mund të urdhërohen masa parandaluese.

NENI 7

Ekzekutimi i kërkesave

1. Me qëllim që t'i përmbahet kërkesës për ndihmë, autoriteti i kërkuar do të procedojë, brenda kufijve të kompetencave të tij dhe burimeve në dispozicion, si të ishte duke vepruar në llogarinë e tij ose me kërkesë të autoriteteve të tjera të po asaj Pale Kontraktuese, duke dhënë informacion tashmë në zotërim, duke kryer hetimet e duhura ose duke u kujdesur për kryerjen e tyre. Kjo dispozitë do të zbatohet gjithashtu për çdo autoritet tjetër tek i cili është adresuar kërkesa nga autoriteti i kërkuar, kur ky i fundit nuk mund të veprojë vetë.

2. Kërkesat për ndihmë do të ekzekutohen në përputhje me dispozitat ligjore ose rregullatorë të Palës Kontraktuese të kërkuar.

3. Zyrtarët e autorizuar të një Pale Kontraktuese, me aprovim të Palës tjetër Kontraktuese të përfshirë, dhe duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara nga kjo e fundit, mund të jenë të pranishëm për të përftuar në zyrat e autoritetit të kërkuar ose të çdo autoriteti tjetër të interesuar në përputhje me paragrafin 1, informacion në lidhje me aktivitetet që janë ose mund të jenë veprime në shkelje të legjislacionit doganor, për të cilat autoriteti i kërkuar ka nevojë, për qëllime të këtij Protokolli.

4. Zyrtarët e autorizuar të një Pale Kontraktuese të përfshirë, me aprovim të Palës tjetër Kontraktuese të përfshirë, dhe duke ju nënshtruar kushteve të parashtruara nga kjo e fundit, mund të jenë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin e kësaj të fundit.

NENI 8

Formulari në të cilin duhet komunikuar informacioni

1. Autoriteti i kërkuar do t'i komunikojë me shkrim rezultatet e hetimeve autoritetit kërkues, së bashku me dokumentet përkatëse, kopje të vërtetuara ose dokumente të tjera.

2. Ky informacion mund të jetë i kompjuterizuar.

3. Dokumentet origjinale do të transmetohen, sipas kërkesës, vetëm në rastet kur kopjet e vërtetuara do të ishin të pamjaftueshme. Këto dokumente origjinale do të kthehen në rastin më të parë.

NENI 9

Përjashtime për detyrimin për sigurimin e ndihmës

1. Ndhimja mund të refuzohet ose mund të jetë subjekt ndaj përmbushjes së disa kushteve ose kërkesave në rastet kur një Palë është e mendimit se ndihma sipas këtij Protokolli:

(a) ka të ngjarë të cenoni sovranitetin e Shqipërisë ose atë të një Shteti Anëtar, të cilit i është kërkuar të sigurojë ndihmë sipas këtij protokolli; ose

(b) ka të ngjarë të cenoi politikën publike, sigurimin ose interesa të tjera thelbësore, veçanërisht në rastet e referuara sipas nenit 10 (2); ose

(c) shkelin një sekret industrial, tregtar ose profesional.

2. Autoriteti i kërkuar mund ta shtyjë ndihmën bazuar në arsyen që ajo do të ndërhynte në hetimet, ndjekjen penale ose procedimin e mëtejshëm. Në këtë rast, autoriteti i kërkuar do të

konsultohet me autoritetin kërkues për të vendosur nëse mund të jepet ndihma, duke qenë e nënshtruar ndaj këtyre kushteve, siç mund të kërkohet nga autoriteti i kërkuar.

3. Kur autoriteti kërkues kërkon ndihmë, të cilën do të ishte e pamundur ta siguronte vetë, këtë fakt do ta theksojë në kërkesën e tij. Më pas autoriteti i kërkuar do të vendosë si t'i përgjigjet kësaj kërkesë.

4. Për rastet e referuara në paragrafët 1 dhe 2, vendimi i autoritetit të kërkuar dhe arsyet përkatëse duhet t'i komunikohen pa vonesë autoritetit kërkues.

NENI 10

Shkëmbimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme sipas këtij Protokolli do të jetë i një natyre konfidenciale ose të rezervuar, në varësi të rregullave të zbatueshme në secilën prej Palëve Kontraktuese. Ky do të mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe do të gëzojë mbrojtjen që jepet për informacion të ngjashëm, sipas ligjeve përkatëse të Palës Kontraktuese që e ka marrë atë, dhe dispozitave korresponduese që zbatohen ndaj autoriteteve të Komunitetit.

2. Të dhënat personale mund të shkëmbehen vetëm kur Pala Kontraktuese, e cila mund t'i marrë ato, ndërmerr t'i mbrojë këto të dhëna në të paktën një mënyrë të barazvlefshme me mënyrën e zbatueshme për raste të veçantë për Palën Kontraktuese që i siguron këto të dhëna. Për këtë qëllim, Palët Kontraktuese do t'i komunikojnë njëra tjetrës informacion në lidhje me rregullat e tyre të zbatueshme, duke përfshirë sipas nevojës, dispozita ligjore në fuqi në Shtetet Anëtare të Komunitetit.

3. Përdorimi i informacionit të përftuar sipas këtij Protokolli, në procedimet gjyqësore ose administrative të filluara në lidhje me veprimet që shkelin legjislacionin doganor, konsiderohet të bëhet për qëllime të këtij Protokolli. Për këtë arsye, Palët Kontraktuese, në procesverbalet, raportet dhe dëshmitë e tyre e në procedimet dhe akuzat e paraqitura në gjyq, mund të përdorin si provë informacionin e përftuar dhe dokumentet e konsultuara, në përputhje me dispozitat e këtij Protokolli. Autoriteti kompetent që ka dhënë këtë informacion ose ka dhënë akses për ato dokumente do të njoftohet në lidhje me këtë përdorim.

4. Informacioni i përftuar do të përdoret vetëm për qëllime të këtij Protokolli. Kur njëra prej Palëve Kontraktuese dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, ajo do të marrë miratim paraprak me shkrim nga autoriteti, i cili ka siguruar informacionin. Ky përdorim më pas do të jetë subjekt ndaj kufizimeve të parashtruara nga ai autoritet.

NENI 11

Ekspertët dhe dëshmitarët

Një zyrtar i një autoriteti të kërkuar mund të jetë i autorizuar të paraqitet, brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert ose dëshmitar në procedimet gjyqësore ose administrative në lidhje me çështje të mbuluara nga ky Protokoll dhe të krijojë të tilla objekte, dokumente ose kopje të vërtetuara, siç mund të nevojitet për procedimet. Kërkesa për paraqitje mund të tregojë specifikisht se para cilit autoritet gjyqësor ose administrativ, do të duhet të paraqitet zyrtari, dhe mbi cilat çështje e në bazë të cilës së drejtë ose kualifikimi, do të pyetet ai zyrtar.

NENI 12

Shpenzimet e ndihmës

Palët Kontraktuese do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet ndaj njëra tjetrës për rimbursimin e shpenzimeve të shkaktuara sipas këtij Protokoll, përveçse, për shpenzimet e bëra për ekspertët dhe dëshmitarët dhe për përkthyesit me shkrim dhe me gojë, të cilët nuk janë punonjës të shërbimit publik.

NENI 13

Zbatimi

1. Zbatimi i këtij Protokoll do t'i besohet nga njëra anë autoriteteve doganore të Shqipërisë dhe nga ana tjetër shërbimeve kompetente të Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare, si të shihet e arsyeshme. Ato do të vendosin në lidhje me të gjitha masat dhe rregullimet praktike të nevojshme për zbatimin e saj, duke marrë në konsideratë rregullat në fuqi, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Ato mund t'i rekomandojnë organeve kompetente amendime, që çmojnë se duhet t'i bëhen këtij Protokoll.

2. Palët Kontraktuese do të konsultohen me njëra tjetrën dhe më pas do të informojnë njëra tjetrën në lidhje me rregullat e detajuara të zbatimit, të cilat adoptohen në përputhje me dispozitat e këtij Protokoll.

NENI 14

Marrëveshje të tjera

1. Duke marrë në konsideratë kompetencat përkatëse të Komunitetit Evropian dhe të Shteteve Anëtare, dispozitat e këtij Protokoll:

- nuk do të cenojnë detyrimet e Palëve Kontraktuese të përcaktuar sipas çdo marrëveshjeje apo konventash të tjera ndërkombëtare;

- do të çmohen si plotësuese ndaj marrëveshjeve për ndihmë të ndërsjellët, të cilat kanë qenë ose mund të lidhen midis Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë; dhe

- nuk do të cenojnë dispozitat e Komunitetit që përcaktojnë komunikimin midis shërbimeve kompetente të Komisionit të Komuniteteve Evropiane dhe autoriteteve doganore të Shteteve Anëtare për çdo informacion të përftuar sipas këtij Protokolli, i cili mund të ishte me interes për Komunitetin.

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, dispozitat e këtij Protokolli do të kenë precedencë mbi dispozitat e çdo marrëveshjeje dypalëshe për ndihmë të ndërsjellët, që ka qenë ose mund të lidhet midis Shteteve Anëtare dhe Shqipërisë, në rastet kur dispozitat e kësaj të fundit nuk janë në përputhje me ato të këtij Protokolli.

2. Në lidhje me çështjet mbi zbatueshmërinë e këtij Protokolli, Palët Kontraktuese do të konsultohen me njëra tjetrën për ta zgjidhur çështjen në kuadër të Komitetit të Stabilizim Asocimit, të krijuar sipas nenit 120 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

AKTI PËRFUNDIMTAR

Të plotfuqishmit e:

MBRETËRIA E BELGIKËS,

REPUBLIKA ÇEKE,

MBRETËRIA E DANIMARKËS,

REPUBLIKA FEDERALE E GJERMANISË,

REPUBLIKA E ESTONISË,

REPUBLIKA HELENE,

MBRETËRIA E SPANJËS,

REPUBLIKA E FRANCËS,

IRLANDA,

REPUBLIKA E ITALISË,

REPUBLIKA E QIPROS,

REPUBLIKA E LETONISË,

REPUBLIKA E LITUANISË,

DUKATI I MADH I LUKSEMBURGUT,

REPUBLIKA E HUNGARISË,
REPUBLIKA E MALTËS,
MBRETËRIA E HOLLANDËS,
REPUBLIKA E AUSTRISË,
REPUBLIKA E POLONISË,
REPUBLIKA E PORTUGALISË,
REPUBLIKA E SLLOVENISË,
REPUBLIKA E SLLOVAKE,
REPUBLIKA E FINLANDËS,
MBRETËRIA E SUEDISË,
MBRETËRIA E BASHKUAR E BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT,

Palët kontraktuese të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, si dhe të Traktatit të Bashkimit Evropian, referuar më poshtë si “Shtete Anëtare”, dhe

KOMUNITETI EUROPIAN, KOMUNITETI EUROPIAN I ENERGIJË ATOMIKE, referuar më poshtë si “Komuniteti”, nga njëra anë, dhe REPUBLIKA E SHQIPËRISË, referuar më poshtë si “Shqipëria”, nga ana tjetër, mbledhur në Luksemburg më 12 qershor të vitit 2006 për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, ndërmjet Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Shqipërisë nga ana tjetër, referuar më poshtë si ‘Marrëveshja’, miratuan tekstet e mëposhtme: Marrëveshja dhe Shtojcat e saj I deri në V, konkretisht:
Shtojca I - Koncesione Tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të Komunitetit
Shtojca II (a) - Tarifat koncesionare shqiptare për prodhimet primare bujqësore të prodhuara në komunitet (Përmendur Neni 27(3)(a))
Shtojca II (b) - Tarifat e koncesioneve Shqiptare për produktet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet (referuar Neni 27(3)(b))
Shtojca II (c) - Tarifat koncesionare Shqiptare për produktet bazë bujqësore të prodhuara në komunitet (referuar Neni 27(3)(c))
Shtojca III Tarifat koncesionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar
Shtojca IV – (Neni 49) – Vendosja: Shërbimet financiare
Shtojca V (Neni 73) – Të drejtat e Pronësisë Intelektuale, Industriale dhe Tregtare dhe protokollet e mëposhtme:
Protokolli 1 mbi prodhimet e hekurit dhe çelikut

Protokolli 2 mbi tregtinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit në sektorin e produkteve bujqësore të përpunuara

Protokolli 3 mbi konçensionet preferenciale reciproke për disa lloje vere, njohja reciproke dhe kontrolli i verërave, pijeve alkoolike dhe emrat e verërave të aromatizuara

Protokolli 4 përkufizimi i konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ

Protokolli 5 mbi transportin tokësor

Protokolli 6 mbi ndihmën e ndërsjellët administrative në çështje doganore

Të plotfuqishmit e Vendeve anëtare dhe Komunitetit dhe të plotfuqishmit e Republikës Shqipërisë, miratuan tekstet e deklaratave të përbashkëta të renditura më poshtë dhe bashkëlidhur këtij Akti Përfundimtar:

Deklaratë e Përbashkët për nenet 22 dhe 29 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 41 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 46 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 48 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 61 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 73 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 80 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për nenin 126 të Marrëveshjes

Deklaratë e Përbashkët për migracionin e ligjshëm, lirinë e lëvizjes dhe të drejtat e punëtorëve.

Deklaratë e Përbashkët për Principatën e Andorës në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

Deklaratë e Përbashkët për Republikën e San Marinos në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

Deklaratë e Përbashkët në lidhje me Protokollin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Të plotfuqishmit e Republikës së Shqipërisë e morën parasysh Deklaratën e Komunitetit më poshtë dhe bashkëlidhur këtij Akti Përfundimtar:

Deklaratë e Komunitetit në lidhje me masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti në bazë të Rregullores (EC) No 2007/2000.

DEKLARATË E PËRBASHKËT

Deklaratë e përbashkët për nenet 22 dhe 29 të Marrëveshjes

Palët deklarojnë se gjatë zbatimit të neneve 22 dhe 29 ata do të shqyrtojnë, në Këshillin e Stabilizim Asocimit, ndikimin e cilësdo marrëveshjeje preferenciale të negociuar nga Shqipëria me vendet e treta (me përjashtim të vendeve që përfshihen në Procesin e Stabilizim Asocimit dhe vendet fqinje të cilët nuk janë anëtare të BE-së). Ky shqyrtim do të mundësojë rregullimin e koncesioneve shqiptare dhënë Komunitetit Evropian, nëse Shqipëria do të ofronte koncesione më të mira në masë të ndjeshme kundrejt këtyre vendeve.

Deklaratë e përbashkët për nenin 41 të Marrëveshjes

1. Komuniteti deklaron gatishmërinë e tij të shqyrtojë në Këshillin e Stabilizim Asocimit, çështjen e pjesëmarrjes së Shqipërisë në kumulimin diagonal të rregullave të origjinës menjëherë sa të krijohen kushtet ekonomike dhe tregtare ashtu si edhe kushtet që garantojnë kumulimin diagonal.

2. Duke pasur parasysh këtë, Shqipëria deklaron gatishmërinë e saj për të krijuar zonat e tregtisë së lirë veçanërisht me vendet e tjera që përfshihen në Procesin e Stabilizim Asocimit të Bashkimit Evropian.

Deklaratë e përbashkët për nenin 46 të Marrëveshjes

Është kuptuar që nocioni “fëmijë” është përkufizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit përkatës pritës.

Deklaratë e përbashkët për nenin 48 të Marrëveshjes

Është kuptuar që nocioni “anëtarët e familjes së tyre” është përkufizuar në përputhje me legjislacionin kombëtar të vendit përkatës pritës.

Deklaratë e përbashkët për nenin 61 të Marrëveshjes

Palët bien dakord që dispozitat e parashtruara në nenin 61 nuk do të interpretohen për të ndaluar kufizimet proporcionale dhe jodiskriminuese për blerjen e pasuri të paluajtshme bazuar në interesin e përgjithshëm, dhe as nuk ndikojnë në rregullat e Palëve që rregullojnë sistemin e pronësisë mbi pronën, me përjashtim të specifikuar.

Është kuptuar që blerja e pasurive të paluajtshme nga nënshtetasit shqiptare lejohet në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në përputhje me të drejtën e zbatueshme Komunitare, duke iu nënshtruar përjashtimeve specifike të përcaktuara dhe të zbatuara në përputhje me legjislacionet e zbatueshme kombëtare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

Deklaratë e përbashkët për nenin 73 të Marrëveshjes

Palët bien dakord që për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, pronësia intelektuale, industriale dhe tregtare përfshin veçanërisht të drejtën e autorit, duke përfshirë në mënyrë të veçantë të drejtën e autorit për programet kompjuterike dhe të drejtat shoqëruese, të drejtat e bazave të të dhënave, patentat, dizenjot industriale, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, topografinë e treguesve

geografikë të rretheve të integruar, duke përfshirë titullin e origjinës, ashtu si edhe mbrojtjen kundër konkurrencës së pandershme siç përmendet në nenin 10a të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe mbrojtjen e informacionit të padeklaruar mbi ekspertizën.

Deklaratë e përbashkët për nenin 80 të Marrëveshjes

Palët janë të vetëdijshme për rëndësinë që populli dhe Qeveria e Shqipërisë i kushtojnë perspektivës së liberalizimit të regjimit të vizave. Ndërkohë, progresi varet zbatimi nga Shqipëria i reformave më të rëndësishme në fusha siç është forcimi i shtetit të së drejtës, lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe emigracionit të paligjshëm, forcimi i kapaciteteve administrative në kontrollin kufitar dhe sigurinë e dokumenteve.

Deklaratë e përbashkët për nenin 126 të Marrëveshjes

1. Për qëllimet e interpretimit dhe zbatimit praktik të Marrëveshjes, Palët bien dakord që rastet tepër urgjente të përmendura në nenin 126 të Marrëveshjes janë ato raste kur ka shkelje materiale të Marrëveshjes nga njëra nga të dy Palët. Shkelje materiale të Marrëveshjes përbën:

- mosnjohja e Marrëveshjes e pasanksionuar në rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare dhe

- shkelje e elementëve thelbësore të Marrëveshjes të parashikuara në nenin 2

2. Palët bien dakord që “masat e duhura” të përmendura në nenin 126 janë masat e marra në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Nëse një Palë merr një masë në një rast tepër urgjent sipas nenit 126, Pala tjetër mund të përdorë procedurën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Deklaratë e përbashkët për migracionin e ligjshëm, lirinë e lëvizjes dhe të drejtat e punëtorëve.

Rinovimi ose refuzimi i lejeqëndrimit përcaktohet nga legjislacioni i secilit Shtet Anëtar dhe Marrëveshjeve dypalëshe dhe Konventave në fuqi ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve Anëtare.

Deklaratë e Përbashkët për Principatën e Andorës

në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Principatën e Andorës që renditen në Kapitujt 25 deri në 97 të Sistemit të Kombinuar, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Protokollin 4 zbatohet mutatis mutandis për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklaratë e Përbashkët për Republikën e San Marinos

në lidhje me Protokollin 4 të kësaj Marrëveshjeje

1. Produktet me origjinë në Republikën e San Marinos, pranohen nga Shqipëria si produkte origjinuese në Komunitet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Protokollin 4 zbatohet mutatis mutandis për qëllimin e përcaktimit të statusit origjinues të produkteve të lartpërmendura.

Deklarate e Përbashkët për Protokollin 5 të Marrëveshjes

1. Komuniteti dhe Shqipëria vërejnë që nivelet e emetimeve të gazta dhe zhurma, aktualisht të pranuar në Komunitet për qëllime të miratimit të tipit të automjetit të rëndë të mallrave nga 01.01.2001,1 janë si më poshtë:

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Qëndrueshëm Evropian (ESC) dhe testi i Reagimit të Ngarkesës Evropiane (ELR):

| | | Masa e monoksidit të të karbonit | Masa e hidrokarboneve | Masa e oksideve të nitrogenit | Masat e materialeve grimcore | Tymi |
|---------|----------|----------------------------------|-----------------------|-------------------------------|------------------------------|-----------------|
| | | (Co) g/këh | (HC) g/këh | (Nox) g/këh | (PT) g/këh | m ⁻¹ |
| Radha A | Euro III | 2.1 | 0.66 | 5.0 | 0.10 0.13 (a) | 0.8 |

(b) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min⁻¹

Vlerat më të ulëta të matura për Ciklin e Përkohshëm Evropian

| | | Masa e monoksidit të karbonit | Masa e hidrokarboneve që nuk kanë përmbajtje me tani | Masa e metanit | Masa e oksideve të nitrogenit |
|--|--|-------------------------------|--|----------------|-------------------------------|
| | | | | | |

| | | (Co) g/kwh | (NMHC) g/kwh | (CH4) (b) g/kwh | (NOx) g/kwh |
|---------|----------|------------|--------------|--------------------|-------------|
| Radha A | Euro III | 5.45 | 0.78 | 1.6 | 5.0 |

(c) Për motorët që kanë një volum lëvizjeje jo më pak se 0,75 dm³ për cilindër dhe një shpejtësi fuqie më shumë sesa 3000 min²¹

(d) Vetëm për motorët me gaz natyror

(f) E pazbatueshme për motorët e furnizuar me gaz.

2. Në të ardhmen, Komuniteti dhe Shqipëria do të përpiqen të pakësojnë emetimet e automjeteve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë moderne të kontrollit të emetimit të automjeteve kombinuar me cilësinë e përmirësuar të karburantit të motorit.

DEKLARATË E KOMUNITETIT

Deklaratë e Komunitetit në lidhje me masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti në bazë të Rregullores (EC) No 2007/2000.

Duke marrë në konsideratë masat e veçanta tregtare që sigurohen nga Komuniteti Evropian për vendet pjesëmarrëse ose ato të lidhura me Procesin e Stabilizim Asocimit, duke përfshirë Shqipërinë, në bazë të Rregullores (EC) Nr. 2007/2000, Komuniteti Evropian deklaron se:

- në zbatim të nenit 30 të kësaj Marrëveshjeje, zbatohen ato masa unilaterale të tregtisë autonome të cilat janë më të favorshme si shtesë e koncesioneve tregtare kontraktuale të ofruara nga Komuniteti në këtë Marrëveshje për aq kohë sa Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 2007/2000 e ndryshuar zbatohet;

- veçanërisht për produktet e mbuluara nga Kapitulli 7 dhe 8 i Nomenklaturës së Kombinuar, për të cilën Tarifa e Përbashkët Doganore parashikon aplikimin e tarifave doganore ad valorem dhe një tarifë doganore specifike, ky reduktim zbatohet gjithashtu në tarifat doganore specifike në derogim të dispozitës përkatëse të nenit 27.1 të kësaj Marrëveshjeje



LIGJ

Nr. 9696, Date 21.03.2007

MARRËVESHJE PËR AMENDIMIN DHE ZGJERIMIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EVROPËS QENDRORE

Preambulë

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (këtu e më tutje të quajtura “Palët”),

Duke pasur parasysh qëllimin e palëve legjitime për të aderuar në Bashkimin Evropian,

Duke njohur kontributin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (këtu e më tutje te referuar si “CEFTA”) për të përmirësuar gatishmërinë e Palëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian siç dëshmohet nga aderimi më 1 maj 2004 i Republikës Çeke, Republikës së Hungarisë, Republikës së Polonisë, Republikës Sllovaqe dhe Republikës së Sllovenisë dhe aderimi iardhshëm i Republikës së Bullgarisë dhe Rumanisë;

Të bindur për domosdoshmërinë për të amenduar CEFTA-n, me qëllim për të kontribuar në procesin e integritit në Evropë nëpërmjet hapjes së CEFTA-s për të gjitha palët që janë të gatshme për të zbatuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

Duke pasur parasysh Deklaratën e Kryeministrave të CEFTA-s, të bërë më 29 Nëntor 2005 në Zagreb;

Duke pasur parasysh Deklaratën e Kryeministrave të palëve, të bërë më 6 prill 2006 në Bukuresht,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Aderimi

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Moldavisë, Republika e Malit të Zi, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, këtu aderojnë në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore sipas

amendimit të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje dhe e zbatojnë atë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Neni 2 Palët

Referencat në marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, sipas amendimit të nenit 3 të kësaj marrëveshjeje, palët e saj do të kuptohen të përfshijnë palët në këtë marrëveshje.

Neni 3 Amendimi i CEFTA-s

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, bërë në Krakov më 21 dhjetor 1992, dhe amenduar nga Marrëveshja që amendon marrëveshjen e tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, bërë në Berno, më 11 shtator 1995 dhe Marrëveshja që amendon marrëveshjen e tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, bërë në Bled më 4 korrik 2003, amendohet. Versioni i konsoliduar i tekstit të marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, i amenduar, (këtu quhet “CEFTA 2006”) bashkëngjitet si aneksi 1 në këtë marrëveshje.

Neni 4 Hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje është subjekt i ratifikimit, pranimit ose aprovimit në përputhje me kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen tek Depozituesi.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi më 1 maj 2007, me kusht që të gjitha palët, përveç Republikës së Bullgarisë dhe Rumanisë të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose aprovimit tek Depozituesi deri më 31 mars 2007.
3. Nëse marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi për të gjitha palët në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, ajo hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.
4. Për secilën palë që depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimit ose aprovimit pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit apo aprovimit, marrëveshja hyn në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës në të cilën ajo depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.
5. Marrëveshjet bilaterale të renditura në aneksin 2 shfuqizohen në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje për Palët e interesuara.
6. Palët e përmendura në paragrafin 4 do të ruajnë të gjitha preferencat e parashikuara nga marrëveshjet e tyre përkatëse dypalëshe të tregtisë së lirë derisa kjo marrëveshje të hyjë në fuqi për secilën.

7. Nëse e lejojnë kërkesat kushtetuese, secila palë mund të zbatojë përkohësisht këtë marrëveshje. Zbatimi i përkohshëm i kësaj marrëveshjeje në bazë të këtij paragrafi i njoftohet Depozituesit.

NË DËSHMI TË DHËNË KËTU, palët nënshkruese të autorizuar me fuqi të plotë, e kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Bukuresht më nëntëmbëdhjetë dhjetor 2006 në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze, e cila do të depozitohet tek Depozituesi i marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qendrore, i cili u transmeton kopje të vërtetuara të gjitha Palëve.

| | |
|-----------------------------|------------------------------|
| PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË | PËR REPUBLIKËN E MOLDAVISË |
| PËR BOSNJË DHE HERCEGOVINËN | PËR REPUBLIKËN E MALIT TË ZI |
| PËR REPUBLIKËN E BULLGARISË | PËR RUMANINË |
| PËR REPUBLIKËN E KROACISË | PËR REPUBLIKËN E SERBISË |
| PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË | |

Për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën Nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara

ANEKSI 1 I

MARRËVESHJES PËR AMENDIMIN DHE ZGJERIMIN E MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË TË EUROPËS QENDRORE

Versioni i konsoliduar i

Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

(CEFTA 2006) PREAMBULË

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në emër të Kosovës në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (këtu e më tutje të quajtura “Palët”),

Duke riafirmuar angazhimin e tyre për demokracinë pluraliste të bazuar në shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore;

Duke riafirmuar angazhimin e tyre për parimet e ekonomisë së tregut, që përbëjnë bazën për

marrëdhëniet e tyre ekonomike;

Duke pasur parasysh deklaratën e Vishegradit të 15 shkurtit 1991, deklaratën e Krakovit të 6 tetorit 1991, deklaratën e Poznanit të 25 nëntorit 1994 dhe deklaratën e Zagrebit të 29 nëntorit 2005 të pranuar si rezultatet e mbledhjeve të përfaqësuesve të lartë të Palëve të CEFTA-s;

Duke riafirmuar angazhimin e tyre për Aktin Final të Konferencës mbi sigurinë dhe bashkëpunimin në Evropë, Kartën e Parisit, dhe veçanërisht parimet që gjenden në dokumentin final të Konferencës së Bonit mbi Bashkëpunimin Ekonomik në Evropë;

Duke pasur parasysh parimet që gjenden në Memorandumin e Mirëkuptimit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë më 27 qershor 2001 të adoptuar nga palët nën kujdesin e Paktit të Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore dhe rrjetin përkatës të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë të lidhura ndërmjet tyre;

Duke shprehur gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin për të kërkuar mënyra dhe mjete për të fuqizuar procesin e integrimit ekonomik në Evropë;

Të vendosur për këtë qëllim për të eliminuar pengesat për tregtinë e tyre reciproke, në përputhje me dispozitat e marrëveshjes së Marrakeshit që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (këtu e me tutje të quajtur "OBT"), dhe për të vendosur gradualisht marrëdhënie më të ngushta ekonomike;

Me dëshirën për të krijuar kushte të favorshme për zhvillimin dhe diversifikimin e tregtisë ndërmjet palëve dhe për nxitjen e bashkëpunimit tregtar dhe ekonomik në fushat me interes të përbashkët në bazë të barazisë, përfitimit reciprok, mos-diskriminimit dhe të drejtës ndërkombëtare;

Të bindur që kjo marrëveshje do të nxisë intensifikimin e marrëdhënieve ekonomike të përfitimit reciprok ndërmjet palëve dhe të kontribuojë në procesin e integrimit në Evropë;

Me dëshirën për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të secilës palë me Bashkimin Evropian dhe integrimin në sistemin tregtar shumëpalësh;

Të vendosur për të zhvilluar marrëdhëniet e tyre reciproke tregtare në përputhje me rregullat dhe disiplinat e OBT-së, pavarësisht nëse ata janë apo jo anëtarë të OBT-së;

Duke konsideruar që asnjë dispozitë e kësaj marrëveshjeje nuk mund të interpretohet sikur i përjashton palët nga detyrimet e tyre në marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, veçanërisht të OBT-së,

Kanë vendosur sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objektivat

1. Palët do të krijojnë një zonë të tregtisë së lirë në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje

dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat përkatëse të OBT-së. Zona e tregtisë së lirë do të krijohet gjatë një periudhe transitore që do të përfundojë jo më vonë se 31 dhjetori 2010.

2. Objektivat e kësaj marrëveshjeje janë të:

- a. Konsolidojë në një marrëveshje të vetme nivelin ekzistues të liberalizimit të tregtisë të arritur nëpërmjet rritjes të marrëveshjeve bilaterale të tregtisë së lirë tashmë të lidhura ndërmjet palëve;
- b. Përmirësojë më tej kushtet për nxitjen e investimeve, duke përfshirë investimet e huaja direkte;
- c. Zgjerojë tregtinë e mallrave, shërbimeve dhe të forcojë investimet me anë të rregullave të drejta, të qarta, të qëndrueshme dhe të parashikueshme;
- d. Eliminonjë barrierat dhe deformimet e tregtisë dhe të lehtësojë lëvizjen e mallrave në transit dhe lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet territoreve të palëve;
- e. Sigurojë kushte të drejta të konkurrencës që ndikojnë në tregtinë dhe investimet e huaja dhe hapë gradualisht tregjet e prokurimit publik të palëve;
- f. Sigurojë mbrojtjen e përshtatshme të të drejtave të pronësisë intelektuale në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- g. Sigurojë procedura efektive për zbatimin dhe aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe
- h. Kontribuojë kështu për zhvillimin e harmonizuar dhe zgjerimin e tregtisë botërore.

KAPITULLI I

DETYRIME TË PËRGJITHSHME TË ZBATUESHME NË TREGTINË E TË GJITHË MALLRAVE

Neni 2

Tarifat doganore bazë

1. Nomenklatura e kombinuar e mallrave (këtu e me tutje quhet “NK”) do të zbatohet për klasifikimin e mallrave në tregtinë ndërmjet Palëve që mbulohen nga kjo marrëveshje.
2. Për çdo produkt, tarifa doganore bazë që do të aplikohet dhe që do t’i nënshtrohet reduktimeve të mëvonshme të përcaktuar në këtë marrëveshje, do të jetë tarifa doganore që aplikohet aktualisht në tregtinë ndërmjet palëve, në ditën që i paraprin hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.
3. Palët do t’i komunikojnë njëra-tjetrës tarifën e tyre doganore respektive bazë.
4. Nëse, pas datës së nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, çdo reduktim tarifor që zbatohet në tarifën doganore bazë, të përcaktuar në paragrafin 2, veçanërisht reduktimet që ndjekin parimin *erga omnes* për tarifën që rezultojnë nga marrëveshja tarifore e përfunduar si rezultat i anëtarësimit në OBT ose si rezultat i negociatave tarifore në kuadrin e OBT-së, këto tarifa të reduktuara do të zëvendësojnë tarifën bazë, referuar në paragrafin 2 të këtij neni, që nga data kur këto reduktime janë zbatuar.
5. Tarifat e reduktuara të llogaritura në përputhje me paragrafët 2 dhe 4 të këtij neni do të zbatohen të rrumbullakosura deri në shifrën e pare dhjetore. Pala që nuk përdor presjen e parë dhjetore do të rrumbullakosë tarifën tek të gjithë numrat duke përdorur parimet e zakonshme aritmetike. Kështu, të gjitha shifrat që kanë 50 ose më pak pas presjes dhjetore do të rrumbullakosen tek numri më i vogël i afërt i plotë dhe të gjitha shifrat që kanë më shumë se 50 pas presjes dhjetore rrumbullakosen tek numrin më i madh i afërt i plotë.

Neni 3 Kufizimet sasiore

1. Të gjitha kufizimet sasiore për importet dhe eksportet dhe masat që kanë efekt të njëjtë do të shfuqizohen në tregtinë ndërmjet palëve në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.
2. Asnjë kufizim i ri sasior mbi importet dhe eksportet dhe masa që kanë efekt të njëjtë me to nuk do të vendosen në tregtinë ndërmjet palëve që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 4 Tarifat doganore mbi eksportet

1. Palët do të eliminojnë të gjitha tarifat doganore për eksportet, pagesat që kanë efekt të njëjtë, dhe tarifat e eksportit të një natyre fiskale në tregtinë ndërmjet palëve, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.
2. Asnjë tarifë e re doganore për eksportet, detyrime me efekt të njëjtë, dhe tarifa eksporti të një natyre fiskale nuk do të vendoset në tregtinë ndërmjet Palëve që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Neni 5 Tarifat doganore mbi importet: pezullimi

Asnjë tarifë e re doganore mbi importet, detyrime me efekt të njëjtë dhe asnjë tarifë importi e një natyre fiskale nuk do të vendosen, dhe as ato që zbatohen nuk do të rriten në tregtinë ndërmjet palëve që nga dita para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 6 Pagesat doganore

Nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje, palët do të eliminojnë pagesat doganore në kundërshtim me nenin VIII-të të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë 1994 (këtu e me tutje referuar "GATT") në tregtinë e tyre reciproke dhe çdo detyrim tjetër të ngjashme.

KAPITULLI II PRODUKTET INDUSTRIALE

Neni 7 Fusha

Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen për të gjitha produktet industriale origjinuese tek palët. Për qellim kësaj marrëveshjeje, termi „produkte industriale“ nënkupton produktet që përfshihen në kapitujt 25 deri 97 të NK, me përjashtim të produkteve të listuara në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 8

Tarifat doganore mbi importet: Eliminimi

1. Palët do të eliminojnë të gjitha tarifatat doganore për importet, të gjitha detyrimet me efekt të njëjtë, dhe të gjitha tarifatat e importit të një natyre fiskale në tregtinë ndërmjet palëve në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, për të gjithë produktet të tjera nga ata që janë objekt i koncesioneve bilaterale të listuara në aneksin
2. Për produktet e listuara në aneksin 2 tarifatat doganore për importet, të gjitha detyrimet me efekt të njëjtë, dhe të gjitha tarifatat e importit të një natyre fiskale në tregtinë ndërmjet palëve do të reduktohen gradualisht dhe do të eliminohen brenda një periudhe transitore që përfundon më 31 dhjetor 2008, në përputhje me afatet e përcaktuara në atë aneks.

KAPITULLI III PRODUKTET BUJQËSORE

Neni 9

Fusha

Dispozitat e këtij kapitulli do të zbatohen për produktet bujqësore origjinuese tek palët. Për qëllime të kësaj marrëveshjeje, termi „produkte bujqësore“ nënkupton produktet që përfshihen në kapitujt 1 deri 24 të NK dhe të gjithë produktet e listuara në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

Tarifat doganore mbi importet

1. Tarifatat doganore mbi importet, të gjitha detyrimet që kanë efekt të njëjtë, dhe të gjitha tarifatat e tjera të një natyre fiskale mbi produktet e përcaktuara në aneksin 3 të kësaj marrëveshjeje do të reduktohen ose do të eliminohen në përputhje me afatet e përcaktuara në atë aneks.
2. Palët do të zbatojnë tarifën e kombit më të favorizuar (këtu e më tutje të quajtur „MFN“) për importet e produkteve të listuara në aneksin 3 nëse kjo është më e ulët se tarifatat doganore preferenciale të përcaktuara në aneksin 3.
3. Palët do të shqyrtojnë në Komitetin e Përbashkët mundësitë e dhënies njëra-tjetres së koncesioneve të mëtejshme jo më vonë se 1 maji 2009.

Neni 11

Koncesionet dhe politikat bujqësore

1. Pa cenuar koncesionet e dhëna në përputhje me nenin 10, dispozitat e këtij kapitulli nuk do të kufizojnë në asnjë mënyrë ndjekjen e politikave përkatëse bujqësore të palëve ose marrjen e çdo mase në bazë të këtyre politikave, duke përfshirë zbatimin e marrëveshjeve në kuadrin e OBT-së.
2. Palët do të njoftojnë menjëherë Komitetin e Përbashkët për ndryshimet në politikat e tyre përkatëse bujqësore të ndjekura ose masat zbatuara, që mund të ndikojnë kushtet e tregtisë bujqësore ndërmjet tyre siç parashikohet në këtë marrëveshje. Me kërkesë të një palë do të mbahen konsultime të menjëhershme për të shqyrtuar situatën.
3. Pavarësisht nga neni 21, paragrafi 2, të gjitha palët do të kufizohen në përdorimin e subvencione në eksporte dhe do të eliminojnë çdo subvencion ekzistues të tillë, në tregtinë e tyre reciproke.

Neni 12

Masat sanitare dhe fitosanitare

1. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me zbatimin e masave sanitare dhe fitosanitare rregullohen nga Marrëveshja e OBT-së për zbatimin e masave sanitare dhe fitosanitare.
2. Palët do të bashkëpunojnë në fushën e masave sanitare dhe fitosanitare, duke përfshirë çështjet veterinarë, me qëllim zbatimin e rregulloreve përkatëse në një mënyrë jo-diskriminuese. Secila palë, me kërkesë të një palë tjetër, jep informacion për masat sanitare dhe fitosanitare.
3. Palët, sipas rastit, do të fillojnë negociata për të lidhur marrëveshje për harmonizimin ose njohjen reciproke në këto çështje në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së OBT-së për zbatimin e masave sanitare dhe fitosanitare dhe marrëveshjet e tjera përkatëse ndërkombëtare.
4. Çdo çështje që rrjedh nga zbatimi i këtij neni trajtohet në pajtim me dispozitat e nenit 42.

KAPITULLI IV BARRIERAT TEKNIKE NË TREGTI

Neni 13

Barrierat teknike në tregti

1. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me zbatimin e barrierave teknike në tregti rregullohen nga marrëveshja e OBT-së për barrierat teknike në tregti, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë nen.
2. Palët marrin përsipër të identifikojnë dhe eliminojnë barrierat teknike të panevojshme ekzistuese në tregti brenda kuptimit të marrëveshjes së OBT-së për barrierat teknike në tregti.

Komiteti i Përbashkët, ose një komitet i veçantë për barrierat teknike në çështjet e tregtisë, që mund të ngrihet në përputhje me nenin 41, paragrafi 5, do të mbikëqyrë procesin e eliminimit të barrierave të panevojshme teknike në tregti.

3.a Palët marrin përsipër të mos vendosin barrierat e reja të panevojshme teknike në tregti. Ato do të bashkëpunojnë, në Komitetin e Përbashkët, ose në një komitet të veçantë për barrierat teknike për çështjet e tregtisë për të lehtësuar dhe harmonizuar rregulloret teknike, standardet dhe procedurat e detyrueshme të vlerësimit të konformitetit me qëllim eliminimin e barrierave teknike në tregti.

b. Palët do të informojnë Komitetin e Përbashkët, ose një komitet të veçantë për barrierat teknike në çështjet e tregtisë, për çdo projekt tekst për një rregullore të re teknike (duke përfshirë çdo procedurë të detyrueshme për vlerësimin e konformitetit) ose standard, të paktën nëntëdhjetë ditë para aprovimit të tij, përveç rasteve urgjente të përmendura në marrëveshjen e OBT-së për barrierat teknike në tregti. Nëse një palë propozon transpozimin e një rregulloreje teknike ose standardi teknik ndërkombëtar ose evropian, perioda përkatëse është tridhjetë ditë.

c. Palët inkurajohen fuqimisht, pa paragjykuar marrëveshjen e OBT-së për barrierat teknike në tregti, të harmonizojnë rregulloret e tyre teknike, standardet dhe procedurat për vlerësimin e konformitetit me ato të Komunitetit Evropian, përveç se kur përdorimi i tyre do të ishte një mjet i paefektshëm dhe i papërshtatshëm për përmbushjen e objektivit legjitim të ndjekur nga palët.

4. Palët marrin përsipër të hyjnë në negociata për të lidhur marrëveshje shumëpalëshe për harmonizimin e rregulloreve të tyre teknike dhe standardeve dhe njohjen reciproke të procedurave të vlerësimit të konformitetit në përputhje me dispozitat përkatëse të marrëveshjes së OBT-së për barrierat teknike në tregti dhe marrëveshje të tjera përkatëse ndërkombëtare para datës 31 dhjetor 2010.

5. Nëse një palë mendon që një palë tjetër ka miratuar ose është në procesin e miratimit të një mase të re që përbën një barrierë të panevojshme në tregti, pala e interesuar do të njoftojë Komitetin e Përbashkët, ose një komitet të veçantë për barrierat teknike në çështjet e tregtisë, i cili do të vendosë për veprimin që duhet ndërmarrë.

6. Çdo çështje që do të dalë gjatë zbatimit të këtij neni do të trajtohet në përputhje me dispozitat e nenit 42 të kësaj marrëveshjeje.

KAPITULLI V DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A. — Rregulla funksionale

Neni 14

Rregullat e origjinës dhe bashkëpunimit në administrimin doganor

1. Përveç se kur parashikohet ndryshe në këtë marrëveshje, aneksi 4 përcakton rregullat e origjinës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe metodave për bashkëpunimin

administrativ në çështjet e doganave. Komiteti I Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e aneksit 4.

2. Aneksi 5 përcakton rregullat e përbashkëta për asistencën e reciproke administrative në çështjet e doganave.

3. Palët do të marrin masat e përshtatshme, duke përfshirë shqyrtime të rregullta nga Komiteti i Përbashkët, për të siguruar zbatimin me efektivitet dhe të harmonizuar të anekseve 4 dhe 5 dhe të neneve përkatës të kësaj marrëveshjeje.

4. Palët do të thjeshtojnë dhe lehtësojnë procedurat e doganore dhe reduktojnë, me sa të jetë e mundur, formalitetet e vendosura në tregti. Ato do të zgjidhin çdo vështirësi që lindin nga zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me dispozitat e nenit 42.

Neni 15

Diskriminimi Fiskal

1. Palët nuk do të zbatojnë asnjë masë apo praktikë të një natyre të brendshme fiskale që vendos, drejtpërdrejt ose indirekt, diskriminimin ndërmjet produkteve origjinuese tek Palët dhe do të eliminojnë këto masa, nëse ekzistojnë, me hyrjen në fuqi e kësaj marrëveshjeje.

2. Produktet e eksportuara në territorin e një prej Palëve mund të mos të përfitojnë nga rimbursimi i taksave të brendshme përtej shumës së taksave indirekte të vendosura mbi to.

Neni 16

Pagesat

1. Pagesat në monedhat lehtësisht të konvertueshme në lidhje me tregtinë në mallrat ndërmjet palëve dhe transferimin e këtyre pagesave në territorin e palës, ku kreditori është rezident janë të lira nga çdo kufizim.

2. Palët nuk do të vendosin asnjë kufizim administrativ ose kufizim të shkëmbimit valutor për donacionet, rimbursimet ose pranimin e kredive afatshkurtra dhe afatmesme në tregtinë e mallrave në të cilën merr pjesë një rezident.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, të gjitha masat në lidhje me pagesat korrente që janë të lidhura me lëvizjen e mallrave do të jenë në përputhje me kushtet e përcaktuara sipas nenit VIII-të të Neneve të marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe do të zbatohen në baza jo-diskriminuese.

Neni 17

Përjashtime të përgjithshme

Kjo Marrëveshje nuk do të pengojë ndalimin ose kufizimin e importeve, eksporteve apo mallrat në transit të justifikuar mbi bazën e moralit publik, politikën publike ose sigurinë publike,

mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve ose bimëve, mbrojtjen e pasurive kombëtare që kanë vlerë artistike, historike ose arkeologjike, mbrojtjen e pasurisë intelektuale ose rregullat në lidhje me arin ose argjendin ose konservimin e burimeve natyrore në shterim, nëse këto masa janë të efektshme kur lidhen me kufizimet mbi prodhimin ose konsumin e brendshëm. Këto ndalime ose kufizime nuk do të përbëjnë një mjet të diskriminimit arbitrar ose një kufizim të fshehtë të tregtisë ndërmjet palëve.

Neni 18

Përfundimet e sigurisë

Asgjë në këtë marrëveshje nuk e pengon një palë nga marrja e një mase që ajo e konsideron të nevojshme për:

1. parandalimin e përhapjes së informacionit në kundërshtim me interesat e tij esenciale të sigurisë;
2. mbrojtjen e interesave të tij esenciale të sigurisë ose për zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare ose politikave të brendshme:
 - a. në lidhje me trafikun e armëve, municionit dhe pajisjeve luftarake, me kusht që këto masa nuk cenojnë kushtet e konkurrencës në lidhje me produktet që nuk janë destinuar për qëllime specifike ushtarake, dhe trafikut të mallrave të tjera, materialeve dhe shërbimeve që kryhen drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt për qëllime të furnizimit të një baze ushtarake; ose
 - b. në lidhje me kufizimin e armëve biologjike ose kimike, armëve bërthamore ose mjete të tjera për shpërthime bërthamore; ose
 - c. të marra në kohë lufte ose tensioni serioz ndërkombëtar që përbën kërcënim për luftë.

B.— Rregullat e konkurrencës

Neni 19

Monopolet shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore të tregtisë

1. Palët do të përshtatin çdo monopol shtetëror me karakter tregtar ose ndërmarrjet shtetërore tregtare për të siguruar që, në përputhje me dispozitat e OBT-së, nuk ekziston asnjë diskriminim ndërmjet ndërmarrjeve të palëve në lidhje me kushtet sipas të cilave tregtohen produktet. Palët do të informojnë Komitetin e Përbashkët në lidhje me masat që ato miratojnë për të zbatuar këtë dispozitë.
2. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 të këtij neni zbatohen për çdo organ nëpërmjet të cilit autoritetet kompetente të palëve, ligjërish ose faktikisht, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, mbikëqyrin, përcaktojnë ose ndikojnë në masë të konsiderueshme importet ose eksportet ndërmjet palëve. Këto dispozita zbatohet gjithashtu për monopolet e deleguara të tjerëve nga shteti.
3. Palët nuk do të prezantojnë asnjë masë të re që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ose që kufizon fushën e zbatimit të neneve që trajtojnë ndalimin tarifave doganore dhe kufizimeve sasiore ndërmjet palëve.

Neni 20

Rregullat e konkurrencës për sipërmarrjet

1. Sa më poshtë janë të kundërshtim me funksionimin e përshtatshëm të kësaj marrëveshjeje në masën që ato ndikojnë në tregtinë ndërmjet Palëve:

a.të gjitha marrëveshjet ndërmjet sipërmarrjeve, vendimet e shoqatave të sipërmarrjeve dhe praktikatat e bashkërenduara ndërmjet sipërmarrjeve që kanë si objekt të tyre ose ndikojnë në parandalimin, kufizimin ose deformimin e konkurrencës në territoret e palëve si një i tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre;

b.abuzimi nga një o se më shumë sipërmarrje i një pozicioni dominues në territoret e palëve si një i tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të tyre.

2. Çdo praktikë në kundërshtim me këtë nen vlerësohet mbi bazën e parimeve të rregullave të konkurrencës të zbatueshme në Komunitetin Evropian, veçanërisht nenet 81, 82, dhe 86 të marrëveshjes që themeloi Komunitetin Evropian.

3. Më 1 maj 2010 dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 do të zbatohen për të gjitha aktivitetet e të gjitha sipërmarrjeve, duke përfshirë sipërmarrjet publike dhe sipërmarrjet në të cilat palët japin të drejta të veçanta ose ekskluzive. Sipërmarrjet që ngarkohen me operimin e shërbimeve të një interesi të gjerë ekonomik ose që kanë karakter monopoli në krijimin e të ardhurave, do t'u nënshtrohen dispozitave të paragrafëve

1 dhe 2 deri në atë masë që zbatimi i këtyre dispozitave nuk cenon kryerjen, ligjërisht ose faktikisht, të detyrave publike të caktuara që u janë ngarkuar.

4. Në lidhje me produktet që përmenden në kapitullin III, dispozitat e paragrafit 1(a) nuk zbatohen për këto marrëveshje, vendime dhe praktika që formojnë një pjesë integrale të një organizmi të tregut të brendshëm.

5. Palët marrin përsipër të zbatojnë ligjet e tyre përkatëse të konkurrencës me qëllim heqjen e praktikave referuar paragrafit 1.

6. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për aktivitetet përkatëse të zbatimit dhe do të shkëmbejnë informacion. Asnjë palë nuk do t'i kërkohet të përhapë informacion që është konfidencial në bazë të legjislacionit të saj të brendshëm. Me kërkesë, autoritetet e konkurrencës dhe/ose autoritetet e tjera përkatëse të palëve të interesuara do të fillojnë konsultime me qëllim që të lehtësojnë heqjen e praktikave referuar paragrafëve 1 dhe 2. Pala e adresuar do t'i kushtojë vëmendje të plote kësaj kërkesë. Ky bashkëpunim nuk i pengon palët të marrin vendime autonome.

7. Nëse një palë është e mendimit që një praktikë e dhënë nuk është në përputhje me paragrafët 1–4 të këtij neni dhe një praktikë e tillë shkakton ose kërcënon shkaktimin e dëmeve serioze të interesave të asaj palë ose dëm material në industrinë e saj të brendshme, ajo mund të

marrë masat e përshtatshme në bazë të kushteve dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 24.

Neni 21

Ndihma Shtetërore

1. Çdo ndihmë e dhënë nga një palë ose nëpërmjet burimeve shtetërore në çfarëdo lloj forme që deformon ose kërcënon të deformojë konkurrencën duke favorizuar mallra të caktuara, në masën që kjo mund të ndikojë në tregtinë ndërmjet palës së interesuar dhe palëve të tjera në këtë marrëveshje, është në kundërshtim me funksionimin e rregullt të kësaj marrëveshjeje.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen për produktet referuar kapitullit

III.

3. Palët marrin përsipër të zbatojnë ligjet e tyre përkatës me qëllim sigurimin e zbatimit të parimeve referuar paragrafit 1.

4. Çdo praktikë në kundërshtim me këtë Nen vlerësohet mbi bazën e parimeve të rregullave të ndihmës shtetërore të zbatueshme në Komunitetin Evropian, veçanërisht nga neni 87 i marrëveshjes që themeloi Komunitetin Evropian.

5. Nëse një palë është e mendimit se një praktikë e caktuar është në kundërshtim me termat e paragrafit 1 dhe shkakton ose kërcënon t'i shkaktojë dëm serioz interesit të asaj pale ose dëm material industrisë së saj të brendshme, ajo mund të marrë masa të përshtatshme në kushtet dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 24.

6. Asgjë në këtë nen nuk do të paragjykojë ose ndikojë në ndonjë mënyrë marrjen nga një palë të masave kundër-balancuese në përputhje me nenet përkatës të GATT-it dhe të marrëveshjes së OBT- së mbi subvencionet dhe masat kundër-balancuese ose me legjislacionin përkatës të brendshëm.

7. Secila palë siguron transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, *inter alia*, duke raportuar çdo vit tek Komiteti i Përbashkët mbi shumën e përgjithshme dhe shpërndarjen e ndihmës së dhënë dhe duke u dhënë palëve të tjera, sipas kërkesës, informacion mbi skemat e ndihmës dhe rastet e veçanta individuale të ndihmës shtetërore.

C.— Rregullat e mbrojtjes sipas rastit

Neni 22

Masat anti-Dumping

1. Nëse një palë konstaton se në tregtinë me një palë tjetër po ndodh dumping në kuptimin e nenit VI-të të GATT-it, ai mund të marrë masat e përshtatshme kundër praktikës në pajtim me marrëveshjen e OBT-së për zbatimin e nenit VI-të të GATT-it dhe në kushtet e përcaktuara në deklaratën e përbashkët në lidhje me këtë nen.

2. Pala njofton menjëherë çdo palë të interesuar dhe Komitetin e Përbashkët për veprimet dhe masat që ajo merr dhe jep menjëherë të gjithë informacionin përkatës.

Neni 23

Masat mbrojtëse të përgjithshme

1. Palët konfirmojnë të drejtat e tyre për marrjen e një mase mbrojtëse në përputhje me nenin XIX-të të GATT-it dhe marrëveshjen e OBT-së për masat mbrojtëse sipas kushteve të përcaktuara në deklaratën e përbashkët në lidhje me këtë nen.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, nëse si rezultat i detyrimeve që rrjedhin për një palë në këtë marrëveshje, çdo produkt i importuar në sasi të tilla të rritura dhe në kushtet të tilla, nga një palë në këtë marrëveshje, që shkakton ose rrezikon të shkaktojë:

a. dëme serioze prodhuesve të brendshëm të produkteve të ngjashme ose drejtpërdrejt të konkurueshëm në territorin e palës importuese, ose

b. shqetësime serioze në një sektor të ekonomisë që mund të shkaktojë deformim serioz të gjendjes ekonomike të palës importuese, Pala importuese mund të marrë masat e përshtatshme mbrojtëse dypalëshe ndaj palës tjetër në këtë Marrëveshje sipas kushteve dhe në përputhje me procedurat përkatëse të përcaktuara në nenin 24.

Neni 23

Pavarësisht nga dispozitat e tjera të kësaj marrëveshjeje dhe në veçanti nenit 23, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e veçantë të tregjeve të bujqësisë, në rast se importet e produkteve që e kanë origjinën në një palë, të cilat janë subjekt i koncesioneve të dhëna në aneksin 3, shkaktojnë çrregullime serioze në tregjet ose mekanizmat rregullatorë të brendshëm në palën tjetër, të dyja palët do të fillojnë menjëherë konsultimet për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme. Në pritje të kësaj zgjidhjeje, pala përkatëse mund të marrë masat që ajo i konsideron si të nevojshme.

Neni 24

Kushtet dhe procedurat për marrjen e masave

1. Para fillimit të procedurës për aplikimin e masave të parashikuara në nenet 20, 21 dhe 23, Palët përpiqen të zgjidhin mosmarrëveshjet ndërmjet tyre me anë të konsultimeve të drejtpërdrejta.

2. Nëse një Palë e kanalizon importin e produkteve të cilat sjellin situatën e referuar në nenin 23 drejt një procedure administrative që ka si qëllim dhënien e menjëhershme të këtij informacioni mbi tendencën e flukseve tregtare, ajo do të informojë menjëherë palët e interesuara.

3. Pa paragjykuar paragrafin 7 të këtij neni, një palë, që konsideron marrjen e masave të parashikuara në nenet 20, 21 dhe 23, njofton menjëherë çdo Palë të interesuar dhe Komitetin e

Përbashkët dhe jep të gjithë informacionin përkatës. Komiteti i Përbashkët shqyrton çështjen pa vonesë dhe mund të bëjë çdo rekomandim të nevojshëm për të përfunduar vështirësitë e njoftuara. Në mungesë të një rekomandimi të tillë brenda 30 ditëve kalendarike që kur çështja i është referuar Komitetit të Përbashkët, apo nëse praktika e kundërshtuar nuk eliminohet brenda periudhës së përcaktuar nga Komiteti i Përbashkët, dhe nëse problemi vazhdon, pala ankimuese mund të marrë masat duhura të nevojshme për të rregulluar situatën.

4. Masat siç janë parashikuar në nenet 21, 23, dhe 42 do të kufizohen në lidhje me shtrirjen dhe kohëzgjatjen e tyre për sa është tepër e nevojshme me qëllim për të korrigjuar problemin dhe nu do të tejkalojë dëmin e shkaktuar nga praktika. Prioritet u jepet atyre masave që shtrembërojnë më pak funksionimin e kësaj marrëveshjeje.

5. Masat dypalëshe mbrojtëse sipas nenit 23, paragrafi 2 do të konsistojnë në një rritje korresponduese të tarifës doganore të zbatueshme sipas kësaj marrëveshjeje. Niveli rezultues i tarifës nuk do të kalojë më të voglën e:

a. nivelit të tarifës doganore MFN që është në fuqi në momentin që është marrë veprimi, ose
b. masës së tarifës doganore MFN në fuqi në ditën menjëherë para datës së hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Masat dypalëshe mbrojtëse do të përmbajnë elementë të qartë që çojnë gradualisht në eliminimin e tyre dhe nuk merren për një periudhë që kalon një vit. Ato nuk mund të rinovohen më shumë se dy herë. Asnjë mase nuk aplikohet për importin e një produkti që i është nënshtuar më parë një mase të tillë për një periudhë prej dy vjetësh qysh prej skadimit të masës.

6. Masat e marra në pajtim me nenet referuar paragrafëve 4 dhe 5 u njoftohen menjëherë palëve të tjera dhe Komitetit të Përbashkët. Komiteti i Përbashkët monitoron zbatimin e këtyre masave, veçanërisht me qëllim zbutjen ose heqjen e tyre sa më herët të jetë e mundur.

7. Nëse rrethana të veçanta dhe kritike që kërkojnë veprim të menjëhershëm e bëjnë shqyrtimin ose informimin paraprak, sipas rastit, të pamundur, pala e interesuar, në rastin e nenit 23, paragrafi

2, mund të zbatojë menjëherë masat provizore që janë tepër të nevojshme për të korrigjuar situatën. Këto masa provizore mund të zbatohen për jo më shumë 200 ditë kalendarike. Masat provizore njoftohen pa vonesë dhe ndërmjet Palëve zhvillohen konsultime sa me shpejt të jetë e mundur në Komitetin të Përbashkët dhe në përputhje me paragrafët përkatës të këtij neni.

Neni 25

Vështirësitë në bilancin e pagesave

Nëse njëra prej palëve është në një vështirësi serioze të bilancit të pagesave, ose në rrezik të menjëhershëm, pala e interesuar mund të miratojë masa kufizuese për importin mbi një bazë *erga omnes* në përputhje me dispozitat e OBT-së. Këto masa, veçanërisht, do të jene me kohëzgjatje të kufizuar dhe nuk mund të shkojnë tej asaj që është e nevojshme për të korrigjuar situatën e bilancit të pagesave. Masat zbuten në mënyrë graduale me përmirësimin e kushteve

të bilancit të pagesave dhe mund të eliminohen kur kushtet nuk e justifikojnë mbajtjen e tyre. Pala informon menjëherë palët e tjera për prezantimin e tyre dhe, sipas rastit, për afatin kohor për heqjen e tyre.

KAPITULLI VI ÇËSHTJE TË REJA TREGTARE

A. — Shërbimet

Neni 26

Fusha dhe përkufizime

3. Produktet, origjinuese në një nga palët PSA ose Komunitetin Evropian, të cilat nuk do të kalojnë ndonjë punim ose përpunim në këtë palë PSA, do të ruajnë origjinën e tyre nëse eksportohen në ndonjërin nga këto palë PSA.

4. Kumulimi i përftuar në këtë nen mund të zbatohet vetëm nëse sigurohet që :

a. një marrëveshje tregtare preferenciale në përputhje me nenin XXIV të marrëveshjes së përgjithshme të tregtisë dhe të tarifave, GATT është e zbatueshme ndërmjet Komuniteti Evropian, një palë PSA të përfshira në sigurimin e statusit të origjinës dhe në palën PSA të destinacionit.

b. materialet dhe produktet kanë siguruar statusin origjinues duke zbatuar rregullat e origjinës, të njëjta me ato që jepen në këtë protokoll dhe ;

c. njoftimet që tregojnë plotësimet e kërkesave të veçanta për të zbatuar kumulimin e publikuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian (Seritë C) dhe tek palët PSA, referuar paragrafit 1 sipas procedurave të tyre.

Kumulimi i siguruar në këtë nen do të zbatohet nga data e treguar në njoftimin e publikuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian. (Seritë C)

Neni 5

Produkte tërësisht të përfthuara

1. Produktet e mëposhtme konsiderohen tërësisht të përfthuara në një palë:

- a) produkte minerale të nxjerra nga toka e tyre ose shtrati i detit të tyre;
- b) produktet bimore të vjela atje;
- c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura atje;
- d) produkte nga kafshët e gjalla të rritura atje;
- e) produkte të përfthuara nga gjuetia apo peshkimi të kryera atje;
- f) produkte të peshkimit detar ose produkte të tjera të marra nga deti jashtë ujërave territoriale të një Pale nga mjetet e tyre të lundrimit;
- g) produkte të prodhuara në bordet e anijeve të tyre fabrikë ekskluzivisht nga produktet e përmendura në nënparagrafin (f);
- h) artikujt e përdorur, të mbledhur atje, për rikuperimin e lëndëve të para, duke përfshirë gomat e përdorura të përshtatshme vetëm për rikuperim ose përdorim si mbetje;
- i) mbetje dhe skrape që rrjedhin nga operacionet e përpunimit të kryera atje;
- j) produkte të nxjerra nga shtresat ose nënshtresat tokësore detare jashtë

- ujërave të tyre territoriale, me kusht që ato kanë të vetme të drejtën për të punuar këto shtresa apo nënshtresa;
- k) mallra të prodhuara atje ekskluzivisht nga produktet e specifikuara në nënparagrafin (a) deri (j).
2. Termi “mjetet e tyre të lundrimit” dhe “anijet e tyre fabrike” në paragrafin 1(f) dhe (g) zbatohet vetëm për mjetet e tyre të lundrimit dhe anijet fabrikë:
- a) të cilat janë të regjistruara në një palë;
 - b) të cilat lundrojnë nën flamurin e kësaj palë;
 - c) të cilat janë në pronësi të të paktën 50 për qind nga nënshtetasit e këtyre palëve, ose nga një shoqëri me zyrat e saj kryesore në një nga këto palë, menaxheri apo menaxheret e të cilës, Kryetari i Bordit të Drejtoresve ose Bordi Supërvizor dhe shumica e anëtarëve të bordeve të tilla janë nënshtetas të këtyre palëve dhe të cilët, përveç kësaj, në rastin e ortakërisë ose kompanive të kufizuara, të paktën gjysma e kapitalit i përket këtyre Palëve ose institucioneve publike apo shtetasve të këtyre palëve;
 - d) pronarët dhe zyrtarët e të cilëve janë shtetas të këtyre palëve;
dhe
 - e) të paktën 75 për qind e ekuipazhit e të cilëve janë shtetas të këtyre palëve.

Neni 6

Produkte të punuara ose përpunuara plotësisht

1. Për qëllime të nenit 2, produktet të cilat nuk janë tërësisht të përfuara konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme nëse plotësohen kushtet e caktuara në listën e aneksit II.

Kushtet e përmendura më sipër, për të gjithë produktet që mbulon kjo marrëveshje, punimi ose përpunimi që duhet të kryhet në materialet jo të origjinës të përdorura për prodhim dhe zbatohen vetëm në lidhje me materiale të tilla. Përkatësisht nëse një produkt i cili ka marrë statusin e origjinës duke plotësuar kushtet e caktuara në listë, është përdorur në prodhimin e një produkti tjetër, kushtet e zbatueshme ndaj produktit në të cilin ai është bashkuar nuk zbatohen mbi të, dhe nuk do të merren parasysh materialet jo të origjinës të cilat mund të jenë përdorur në prodhimin e tij.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, materialet jo të origjinës të cilat, sipas kushteve të caktuara në listë, nuk do të përdoren në prodhimin e një produkti, mund të përdoren, me kusht që:

- a) vlera e tyre totale nuk i kalon 10 për qind të çmimit të para punimit të produktit;
- b) asnjë nga përqindjet e dhëna në listë për maksimumin e vlerës së materialeve jo të origjinës nuk tejkalohen nëpërmjet zbatimit të këtij paragrafi.

Ky paragraf nuk zbatohet për produktet që përfshihen në kapitullin 50 deri 63 të Sistemit të Harmonizuar.

3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen në pajtim me dispozitat e nenit 7.

Neni 7

Punim ose përpunim i pamjaftueshëm

1. Pa cenuar paragrafin 2, operacionet e mëposhtëm konsiderohen si punime ose përpunime të pamjaftueshme për t'i dhënë statusin e origjinës së produktit, pavarësisht nëse janë plotësuar ose jo kërkesat e Nenit 6:

- a) operacionet ruajtëse për të siguruar që produkti mbahet në kushte të mira gjatë transportit dhe magazinimit;
- b) ndarjet dhe bashkimet e paketimeve;
- c) larja, pastrimi, heqja e pluhurit, oksideve, vajit, bojës apo mbulesave të tjera;
- d) hekurosja ose presimi i tekstileve;
- e) operacionet e thjeshta të lyerjeve apo lustrimit;
- f) zhvoshkja, zbardhimi i pjesshëm ose i plotë, lustrimi dhe shkëlqimi irithit dhe orizit;
- g) operacionet e ngjyrosjes së sheqerit ose dhënia e formave të ndryshme sheqerit;
- h) qërimi, heqja e bërthamës dhe gujavës së frutave, arrave dhe perimeve;
- i) mprehja, bluarjet ose prerjet e thjeshta;
- j) sitja, kontrolli, ndarja, klasifikimi, kategorizimi, bashkimi (duke përfshirë krijimin e paketave të artikujve);
- k) vendosja e thjeshtë në shishe, kënaçe, epruveta, çanta, valixhe, kuti, vendosja në kartonë ose dërrasa dhe të gjithë operacionet e tjera të paketimit të thjeshtë;
- i) ngjitja ose printimi i markave, etiketave, logove si dhe i shenjave të tjera dalluese mbi produkte ose mbi paketimin e tyre;
- m) përzierje e thjeshtë e produkteve, qoftë i llojeve të ndryshme ose jo;
- n) montimi i thjeshtë i pjesëve të artikujve për të përfunduar një material të plotë ose ndarja e produktit në pjesë;
- o) kombinimi i dy ose më shumë operacioneve të specifikuara në nënparagrafët nga (a) në (n);
- p) therja e kafshëve.

2. Të gjitha operacionet që kryhen në një palë në një produkt të caktuar do të konsiderohen së bashku, në rastet kur përcaktohet se punimet ose përpunimet mbi të cilat ka kaluar produkti, janë të pamjaftueshme brenda kuptimit të paragrafit 1.

Neni 8

Njësia e Kualifikimit

1. Njësia e kualifikimit për aplikimin e dispozitave të këtij protokollit është produkti i veçantë i cili konsiderohet si njësi bazë kur për përcaktimin e klasifikimit përdoret nomenklatura e sistemit të harmonizuar.

Përkatesisht, procedohet si më poshtë:

a) kur një produkt i përbërë nga një grup ose bashkim artikujsh është i klasifikuar nën termat e sistemit të harmonizuar në një kre të vetëm, i tëri përbën njësinë e klasifikimit;

b) kur një dërgesë përfaqëson një numër produktesh identike të klasifikuara nën të njëjtin kre të sistemit të harmonizuar, çdo produkt duhet të merret individualisht në rastin e aplikimit të dispozitave të këtij protokollit.

2. Kur, në bazë të rregullit të përgjithshëm 5 të sistemit të harmonizuar, paketimi përfshihet bashkë me produktin për qëllime klasifikimi, ai përfshihet me qëllimin e përcaktimit të origjinës.

Neni 9

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet

Aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet të lidhura me një pjesë pajisjeje, makine, aparati apo mjeti, të cilat janë pjesë e një pajisjeje normale dhe përfshihen në çmim të saj ose nuk janë faturuar veçmas, konsiderohen si një me pjesën e pajisjes, makinës, aparatit ose mjetit në fjalë.

Neni 10

Kompletet

Kompletet, sipas përcaktimit në rregullin e përgjithshëm 3 të sistemit të harmonizuar, konsiderohen me origjinë kur të gjithë produktet përbërës janë me origjinë. Megjithatë, kur një komplet përbëhet nga produkte me dhe pa origjinë, kompleti si i tërë konsiderohet me origjinë, me kusht që vlera e produkteve pa origjinë të mos kalojë 15 për qind të çmimit ex-works së kompletit.

Neni 11

Elementët neutrale

Me qëllim që të përcaktohet nëse një produkt është me origjinë, nuk është e nevojshme të përcaktohet origjina e zërave të mëposhtme të cilët mund të përdoren gjatë prodhimit të tij:

- a) energjia elektrike dhe karburanti;
- b) fabrika dhe pajisjet;
- c) makineritë dhe veglat;
- d) mallrat të cilat nuk hyjnë dhe të cilat nuk synohen të përfshihen në përbërjen finale të produktit.

TITULLI III

KËRKESAT TERRITORIALE

Neni 12

Parimi i territorialitetit

1. Përveç çfarë parashikohet ne nenet 3, 4 dhe paragrafin 3 të këtij neni, kushtet për përftimin e statusit të origjinës përcaktuar në titullin II, duhet të plotësohen pa ndërprerje në palët.

2. Përveç çfarë parashikohet ne nenet 3, 4 kur mallrat e eksportuara me origjinë nga njëra nga palët në një vend tjetër që një palë e kthehen, ato duhet të konsiderohen si pa origjinë, përveç kur tregohet duke bindur autoritetet doganore se:

- a) mallrat e kthyera janë të njëjta me ato që janë eksportuar; dhe
- b) ato nuk kanë kaluar në ndonjë proces tjetër përtej atyre të nevojshme për t'i ruajtur ato në kushte të mira gjatë kohës që kanë ndenjur në atë vend ose gjatë eksportimit.

3. Përftimi i statusit të origjinës në përputhje me kushtet e përcaktuara në titullin II nuk do të ndikohen nga punime apo përpunime të kryera jashtë palëve ndaj materialeve të eksportuara nga njëra nga palët dhe ri-importuar më vonë atje, duke siguruar që:

a) materialet në fjalë janë plotësisht të përfutuara në palët ose mbi to janë kryer punime apo përpunime përtej operacioneve të përmendura në nenin 7 përpara se të jenë të eksportuara; dhe

b) mund të demonstrohet për të bindur autoritetet doganore që:

(i) mallrat e ri-importuara kanë qenë përftuar nga punime apo përpunime të materialeve të eksportuara; dhe

(ii) vlera totale e shtuar e përftuar jashtë palëve sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk kalon 10 % të çmimit ex-ëorks të produktit përfundimtar për të cilin është kërkuar statusi i origjinës.

4. Për qëllime të paragrafit 3, kushtet për përftimin e statusit të origjinës përcaktuar në titullin II nuk do të zbatohen për punime apo përpunime të bëra jashtë palëve. Në rastet kur, në listën e aneksit II, rregulli i përcaktuar që ka të bëjë me vlerën maksimale të të gjithë materialeve të përfshira pa origjinë, zbatohet në përcaktimin e statusit të origjinës së produktit përfundimtar, vlera totale e materialeve pa origjinë të përfshira në territorin e palës së interesuar, marrë së bashku me vlerën totale të shtuar të përftuar jashtë Palëve sipas zbatimit të dispozitave të këtij neni, nuk e tejkalon përqindjen e përcaktuar.

5. Për qëllime të zbatimit të dispozitave të paragrafit 3 dhe 4, “vlera totale e shtuar” merret në kuptimin e të gjithë shpenzimeve të bëra jashtë palëve, duke përfshirë edhe vlerën e materialeve të përfshira atje.
6. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen ndaj produkteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në listën e aneksit II ose të cilat mund të konsiderohen të punuara ose përpunuara në masë të mjaftueshme vetëm nëse zbatohet toleranca e përgjithshme e përcaktuar në nenin 6 (2).
7. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 nuk zbatohen për produktet e kapitujve 50 deri 63 të sistemit të harmonizuar.
8. Për çdo lloj punimi apo përpunimi i llojit që është objekt i dispozitave të këtij Neni dhe është kryer jashtë palëve, bëhet në bazë të marrëveshjeve të përpunimit të jashtëm ose marrëveshje të ngjashme.

Neni 13

Transporti i drejtpërdrejtë

1. Trajtimi preferencial i parashikuar në këtë marrëveshje zbatohet vetëm për produktet, që plotësojnë kërkesat e këtij protokollit, të cilat janë transportuar drejtpërdrejt ndërmjet palëve ose ndërmjet territoreve të Bashkimit Evropian ose territoreve referuar nenit 3, në të cilat kumulimi është i zbatueshëm. Sidoqoftë, produktet që përbëhen nga një dërgesë e vetme mund të transportohen nëpërmjet territoreve të tjerë dhe, sipas rastit, lëvizje transit ose magazinim i përkohshëm në këto territore, me kusht që ato të mbeten nën vëzhgimin e autoriteteve doganore të vendit transit ose të magazinimit dhe nuk kryejnë operacione të tjera veç atyre të ngarkim-shkarkimit, ose ndonjë operacion tjetër me synim për ti mbajtur ato në kushte të mira.

Produktet me origjinë mund të transportohen me tubacione përmes një territori tjetër nga ai i palëve.

2. Të dhënat që vërtetojnë se kushtet e vendosura në paragrafin 1 janë plotësuar duhet t’u jepen autoriteteve doganore të palës importuese, duke paraqitur:

- a) një dokument të vetëm transporti që tregon kalimin nga vendi eksportues përmes vendit transit; ose
- b) një certifikatë të lëshuar nga autoritetet doganore të vendit transit: (i) që bën një përshkrim të saktë të produkteve; (ii) që paraqet datat e shkarkimit dhe ringarkimit të produkteve dhe, sipas rastit, emrat e anijeve, ose llojet e tjera të transportit të përdorur; si dhe (iii) që vërteton kushtet në të cilat ka qëndruar produkti në vendin transit; ose
- c) nëse nuk mundësohen këto dokumente, ndonjë dokument tjetër provues.

Neni 14

Ekspozitat

1. Produktet me origjinë, të dërguara për ekspozita në një vend tjetër jashtë palëve, në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet referuar nenit 3 në të cilat kumulimi është i

zbatueshëm dhe të shitura pas ekspozitës për importim në një palë përfitojnë në lidhje me këtë importim nga dispozitat e marrëveshjes, pasi të ketë siguruar autoritetet doganore që:

a) një eksportues i ka dërguar këto produkte nga njëra nga palët në vendin në të cilin bëhet ekspozita dhe i ka ekspozuar ato atje;

b) produktet janë shitur ose në të kundërt i janë vënë në dispozicion nga ky eksportues personit në palën tjetër;

c) produktet janë dorëzuar gjatë ekspozitës ose menjëherë pas tij në shtetin në të cilin ato janë dërguar për ekspozim;

dhe

d) produktet nuk janë përdorur, që nga momenti kur ato u dërguan në ekspozitë, për ndonjë qëllim tjetër veçse atij të ekspozimit.

2. Vërtetimi i origjinës duhet të jetë lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V dhe të jetë paraqitur pranë autoriteteve doganore të vendit importues në formë normale. Emri dhe adresa e ekspozitës duhet të jenë të shprehura qartë në të. Kur paraqitet e nevojshme, mund të kërkohen të dhëna shtesë dokumentare në lidhje me kushtet e ekspozimit të produkteve.

3. Paragrafi 1 do të aplikohet për çdo lloj ekspozimi, prezantimi të thjeshtë apo panairi publik tregtar, industrial, bujqësor, ose për mjete udhëtimi apo transportimi, i vili nuk duhet të jetë organizuar për qëllime private në dyqane apo biznese me synimin e shitjes së mallrave nga jashtë, dhe gjatë të cilëve produktet i nënshtrohen kontrollit doganor. TITULLI IV TËRHEQJA OSE PËRJASHTIMI

Neni 15

Ndalimi i tërheqjes prej, ose përjashtimeve nga, tarifatat doganore

1. Materialet pa origjinë të përdorura në prodhimin e një produkti me origjinë në një palë, në Bashkimin Evropian, ose në një nga vendet referuar nenit 3 në të cilët kumulimi është i zbatueshëm he për të cilat vërtetimi i origjinës është lëshuar ose bërë në përputhje me dispozitat e titullit V nuk i nënshtrohet në ndonjë Palë, tërheqjes prej, ose përjashtimit nga, detyrimet doganore të çdo lloji.

2. Ndalimi në paragrafin 1 zbatohet për çdo lloj rregullimi për rimbursim, pakësim ose mospagesë, pjesërisht ose tërësisht, të detyrimeve doganore ose detyrimeve të tjera me të njëjtin efekt, të zbatueshme në një palë, për materialet e përdorura në prodhim, ku zbatohet ky rimbursim, pakësim ose mos-pagim, shprehimisht ose në fuqi, kur produktet e përftuara nga materialet e mësipërme janë eksportuar dhe jo kur ato mbahen për përdorim në atë vend.

3. Eksportuesi i produkteve mbuluar nga vërtetimi i origjinës duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë me kërkesën e autoriteteve doganore, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë se nuk është bërë asnjë tërheqje në lidhje me materialet pa origjinë të përdorura në prodhimin e produkteve në fjalë dhe se të gjitha detyrimet doganore ose detyrimet e tjera njëlloj të zbatueshme në të tilla materiale aktualisht kanë qenë paguar.

4. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 3, zbatohen gjithashtu në përputhje me paketimin sipas kuptimit të nenit 8(2), aksesorët, pjesët e këmbimit dhe instrumentet, në kuptimin të nenit 9 dhe produktet në një komplet, sipas kuptimit të nenit 9, kur përbërës të tillë janë pa origjinë.

5. Dispozitat e paragrafëve nga 1 në 4, zbatohen vetëm për materialet të cilat janë të llojit për të cilat aplikohet marrëveshja. Për më tepër, nuk përjashtohet aplikimi i ndonjë sistemi të rimbursimit të eksporteve për produktet bujqësore, të aplikueshme për eksportet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes.

TITULLI V VËRTETIMI I ORIGJINËS

Neni 16 Kërkesa të përgjithshme

1. Produktet me origjinë në një palë gjatë importimit në palën tjetër, përfitojnë nga kjo marrëveshje me paraqitjen të:

a) një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, një ekzemplar i së cilës tregohet në aneksin III; ose

b) në rastet e specifikuara në nenin 21(1), të një deklaratë, që këtu do të quhet: “Deklaratë faturë” dhënë nga eksportues për një faturë, një shënim furnizimi apo një dokument tjetër tregtar ku të përshkruhen produktet në detaje të mjaftueshme për tu identifikuar; teksti i deklaramit të faturës paraqitet në aneksin IV.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, produktet me origjinë në kuptimin e këtij protokollit, për sa u takon rasteve të specifikuara në nenin 26, përfitojnë nga kjo marrëveshje, pa qenë e nevojshme të depozitojnë ndonjë nga dokumentet e përmendur më sipër.

Neni 17

Procedurat për lëshimin e një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1

1. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të vendit eksportues mbështetur në kërkesën e bërë me shkrim nga eksportuesi ose, nën përgjegjësinë e eksportuesit, nga përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Për këtë qëllim, eksportuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar plotëson sicertifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 ashtu dhe formën e aplikimit, ekzemplarët e të cilëve tregohet në aneksin III. Këta formularë plotësohen në një nga gjuhët e palëve ose në anglisht dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të brendshëm të vendit eksportues. Nëse ato janë të shkruara me dorë, ato do të plotësohen me bojë me germa kapitale. Përshkrimi i produkteve duhet të jepet në një katror të rezervuar për këtë qëllim pa lënë asnjë rresht bosh. Kur katrori nuk është e plotësuar tërësisht, një vijë horizontale

duhet të hiqet poshtë vijës së fundit së përshkrimit, përmes hapësirës boshe.

3. Eksportuesi që bën kërkesë për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 përgatitet për të depozituar në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të palës eksportuese ku certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 është lëshuar, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin e origjinës së produktit në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit.

4. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore të një pale nëse produktet në fjalë mund të konsiderohen me origjinë në këtë palë ose në Bashkimin Evropian ose në një vend tjetër referuar nenit 3 dhe plotëson kërkesat e tjera të këtij protokollit.

5. Autoritetet doganore që lëshojnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 marrin çdo masë të nevojshme për të verifikuar statusin e origjinës së produkteve dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit. Për këtë qëllim, ato kanë të drejtë të kërkojnë çdo provë apo të ndërmarrin çdo inspektim të llogarive financiare të eksportuesit ose ndonjë kontroll tjetër që ata e konsiderojnë të nevojshëm. Ato sigurojnë që formularët referuar paragrafit 2 janë të plotësuar rregullisht. Në veçanti, ata kontrollojnë nëse hapësira e rezervuar për përshkrimin e produkteve është plotësuar në mënyrë të tillë që përjashton të gjitha mundësitë për shtesa mashtruese.

6. Një certifikatë EUR.1 do të përmbajë një nga formulimet emëposhtme në anglisht, në katorin 7:

- nëqoftëse origjina është përfituar nga zbatimi i kumulimit nga materiale origjinuese në një Palë, në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet, referuar nenit 3 :

“Kumulimi zbatuar nga .” (Emri i vendit(eve) ose teritorit(eve))

- nëqoftëse origjina është përfituar jo nga zbatimi i kumulimit nga materiale origjinuese në një Palë, në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet referuar nenit 3 :

“Kumulimi nuk është zbatuar.”

7.Data e lëshimit të një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 do të tregohet në katorin 11 të certifikatës.

8. Një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 lëshohet nga autoritetet doganore dhe i jepet eksportuesit sa më shpejt që eksportimi përkatës të jetë kryer ose siguruar.

Neni 18

Certifikatat e qarkullimit të mallrave EUR.1 të lëshuara retrospektivisht

1. Pavarësisht nga neni 17(7), një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 përjashtimish mund të lëshohet pas eksportimit të produkteve të cilëve iu referohet, nëse:

a) ajo nuk është lëshuar në kohën e eksportimit për shkak të gabimeve ose mungesave të pavullnetshme ose rrethanave të veçanta; ose

b) është treguar duke bindur autoritetet doganore që një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 është lëshuar po nuk është pranuar gjatë importimit për arsye teknike.

2. Për zbatimin e paragrafit 1, eksportuesi duhet të tregojë në aplikimin e tij vendin dhe datën e eksportimit të produkteve për të cilat certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshohet, dhe të tregojë arsyet për këtë kërkesë.

3. Autoritetet doganore mund të lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 aposteriori vetëm pasi të jetë verifikuar se informacioni i dhënë nga eksportuesi në aplikim është i njëjtë me atë të dosjeve korresponduese.

4. Certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 lëshuar aposteriori duhet të pajiset me frazën e mëposhtme në anglisht: "Issued retrospectively",

5. Shënimi i përmendur në paragrafit 4 do të vendoset në katrorin 7 të certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1.

Neni 19

Lëshimi i dublikatës të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1

1. Në rast vjedhjeje, humbjeje apo shkatërrimi të një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1, eksportuesi mund të aplikojë tek autoritetet doganore të cilat e kanë lëshuar atë për një dublikatë që bëhet në bazë të dokumenteve të eksportit në zotërim të tyre.

2. Dublikata e lëshuar në këtë mënyrë duhet të përmbajë një nga fjalët e mëposhtme, në anglisht:

"Duplicate"

3. Shënimi i referuar në paragrafin 2 do të vendoset në katrorin 7 të dublikatës të certifikatës të qarkullimit të mallrave EUR.1.

4. Dublikata e cila duhet të tregojë dhe datën e lëshimit të certifikatës origjinaletë qarkullimit të mallrave EUR, do të ketë fuqi që nga ajo datë.

Neni 20

Lëshimi i certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 mbi bazën e vërtetimit të origjinës të lëshuar ose bërë më parë

Kur produktet me origjinë janë vendosur nën kontrollin e një zyre doganore në një Palë, është e mundur të zëvendësohet vërtetimi origjinal i origjinës me një ose më shumë certifikata të qarkullimit të mallrave EUR.1 për qëllime të dërgimit të të gjitha ose disa nga këto produkte diku në brënda Palës. Zëvendësimi i certifikatës/ave të qarkullimit

të mallrave EUR.1 lëshohet nga zyra doganore nën kontrollin e së cilës janë të vendosura këto produkte.

Neni 21

Llogari Likujdimi

1. Në momentin që kostoja e konsiderueshme ose vështirësitë e materielave arrijnë të mbajnë të ndarë kapitalin e materialeve origjinuese nga ato jo- origjinuese, të cilat janë të njëjta dhe të këmbyeshme, autoritetet doganore mundet, me një kërkesë me shkrim, të ngrejnë këto shqetësime, të autorizojnë të ashtuquajturat metoda "likujdim llogarie" (këtej e tutje referuar si "metoda") të përdoren për të manaxhuar të tillë kapitale.

2. Kjo metodë mund të jetë e aftë të sigurojë që për një periudhë reference të specifikuar, munrin e produkteve të sigurura i cili do të konsiderohet si "origjinues" të jetë i njëjtë me atë që është siguruar nëse ata kanë patur likujdim fizik të kapitaleve.

3. Autoritetet doganore mund të japin një autorizim të tillë referuar paragrafit 1, subjekt i çdo lloji kushti të menduar më parë.

4. Kjo metodë është rregjistruar dhe zbatuar në bazë të parimeve të përgjithshme të kontabilitetit të zbatuara tek palët ku produkti është prodhuar.

5. Përfituesit e këtij lehtësimi mund të nxjerrin ose të zbatojnë deshminë e origjinës, në rast se kërkohet, për sasinë e produktit i cili mund të konsiderohet si origjinues. Sipas kërkesës së autoriteve doganore, përfituesit mund të sigurojnë një raport për mënyrën se si janë manaxhuar sasinë.

6. Autoritetet doganore do të monitorojnë përdorimin e autorizimit dhe mund ta tërheqin atë në çdo kohë, kur përfituesit bëjnë një përdorim të pasaktë të autorizimit në ndonjë mënyrë ose dështojnë në përmbushjen e një kushti të deklaruar në këtë Protokoll.

Neni 22

Kushtet për lëshimin e një Deklarate Faturë

1. Një deklaratë fature, siç përmendet në nenin 16(1) (b) mund të përgatitet:

- a) nga një eksportues i aprovuar në kuptimin e Nenit 23, ose
- b) nga një eksportues i ndonjë dërgese të përbërë nga një ose më shumë paketime që përmbajnë produkte me origjinë vlera totale e të cilave nuk i kalon Euro 6 000.

2. Një deklaratë fature mund të lëshohet nëse produktet në fjalë konsiderohen si produkte me origjinë në një palë, në Bashkimin Evropian ose në një vendet referuar nenit 3 dhe plotëson të gjitha kërkesat e tjera të këtij protokollit.

3. Një deklaratë faturë do të përmbajë një nga formulimet e mëposhtme, në anglisht:

- nëqoftëse origjina është përfituar nga zbatimi i kumulimit nga materiale origjinuese në një palë, në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet referuar nenit 3: “Kumulimi zbatuar nga” (Emri i vendit(eve) ose teriitorit(eve))

-nëqoftëse origjina është përfituar jo nga zbatimi i kumulimit nga materiale origjinuese në një palë, në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet referuar nenit 3: “Kumulimi nuk është zbatuar.”

4 Eksportuesi që përgatit një deklaratë faturë duhet të përgatitet të paraqesë në çdo kohë, me kërkesën e autoriteteve doganore të vendit eksportues, të gjitha dokumentet e nevojshme që provojnë statusin origjinës të produkteve në fjalë si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit.

5. Një deklaratë faturë duhet të lëshohet nga eksportuesi duke shtypur, stampuar, ose printuar mbi faturën, notën shpërndarëse ose ndonjë dokument tjetër tregtar, deklaratën, teksti i së cilës jepet në aneksin IV, duke përdorur një nga versionet gjuhësore të përcaktuara në atë aneks dhe në përputhje me dispozitat e ligjit të brendshëm të vendit eksportues. Nëse deklarata është e shkruar me dorë, duhet të shkruhet me bojë me germa kapitale.

6. Një deklaratë fature duhet të ketë firmën origjinale të eksportuesit të shkruar me dorë. Sidoqoftë, një eksportuesi të aprovuar në kuptimin e nenit 23, nuk do t'i kërkohej të nënshkruajë deklarata të tilla, me kusht që ai u paraqet autoriteteve doganore të vendit eksportues një deklaratë me shkrim ku ai pranon të gjitha përgjegjësitë për një deklaratë fature e cila e identifikon atë sikur të jetë nënshkruar me shkrim dore prej tij.

7. Një deklaratë faturë mund të bëhet nga një eksportues kur produktet të cilave ajo u përket eksportohen, ose pas eksportimit me kusht që ajo të paraqitet në vendin importues jo më vonë se dy vjet pas importimit të produkteve të cilave ajo u referohet.

Neni 23

Eksportuesi i aprovuar

1. Autoritetet doganore të vendit eksportues mund të autorizojnë çdo eksportues, këtu quhet “eksportues i aprovuar”, që bën dërgesa të shpeshta të mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje, të lëshoje deklaratë fature, pavarësisht nga vlera e produkteve në fjalë. Një eksportues që kërkon një autorizim të tillë, duhet të paraqesë, sipas kërkesave të autoriteteve doganore, të gjitha garancitë e nevojshme për të vërtetuar statusin e origjinës së produkteve si dhe plotësimin e kërkesave të tjera të këtij protokollit.

2. Autoritetet doganore mund të japin statusin e eksportuesit të aprovuar sipas një kushti që ata e gjykojnë të përshtatshme.

3. Autoritetet doganore i japin eksportuesit të aprovuar një numër autorizimi doganor i cili shfaqet në deklaratën faturë.

4. Autoritetet doganore kontrollojnë përdorimin e autorizimeve nga eksportuesi i aprovuar.

5. Autoritetet doganore mund ta tërheqin autorizimin në çdo kohë. Ata e bëjnë këtë kur eksportuesi i aprovuar nuk ofron më garancitë e përmendura në paragrafin 1, si dhe nuk plotëson më kërkesat e përmendura në paragrafin 2, ose kryen përdorim jo korrekt të autorizimit.

Neni 23

Vlefshmëria e vërtetimit të origjinës

1. Vërtetimi i origjinës është i vlefshëm për katër muaj nga data e lëshimit në palën eksportuese, dhe duhet depozituar brenda kësaj periudhe tek autoritetet doganore të palës importuese.

2. Vërtetimet i origjinës të cilat janë depozituar pranë autoriteteve doganore të palës importuese pas datës së fundit për paraqitje të specifikuar në paragrafin 1, mund të pranohen me qëllim zbatimin e trajtimit preferencial, nëse depozitimi i këtyre dokumenteve deri në datën përfundimtare, nuk është bërë për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme.

3. Në rastet e tjera të depozitimeve të vonuara, autoritetet doganore të palës importuese mund ta pranojnë vërtetimin e origjinës kur produktet janë paraqitur përpara datës përfundimtare.

Neni 25

Paraqitja e vërtetimit të origjinës

Vërtetimi i origjinës duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore të vendit importues në pajtim me procedurat që aplikohen në atë palë. Autoritetet e mësipërme mund të kërkojnë një përkthim të vërtetimit të origjinës dhe gjithashtu mund të kërkojnë që deklarata e importit të shoqërohet nga një deklaram nga importuesi që vërteton se produktet plotësojnë kushtet e kërkuara për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Neni 26

Importi me këste

Nëse me kërkesë të importuesit dhe me kushtet e caktuara nga autoritetet doganore të palës importuese, produktet e ndara ose jo të montuara në kuptimin e rregullit të përgjithshëm 2(a) të sistemit të harmonizuar, brenda seksionit XVI dhe XVII apo në kërkerët Nr. 7308 dhe 9406 të sistemit të harmonizuar, importohen me këste, vetëm një vërtetim i origjinës për të tilla produkte duhet të paraqitet pranë autoriteteve doganore gjatë importimit të këstit të parë.

Neni 27

Përfashtimet nga vërtetimi i origjinës

1. Produktet e dërguara në paketime të vogla nga persona privat tek personat privat ose që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve do të pranohen si produkte me origjinë pa kërkuar paraqitjen e vërtetimit të origjinës, me kusht që këto produkte nuk janë importuar për qëllime tregtie dhe janë deklaruar se plotësojnë kërkesat e këtij protokollit dhe aty ku nuk ka dyshim të vërtetësia e një deklarimi të tillë. Në rastin e produkteve të dërguara me postë, kjo deklaratë mund të bëhet në deklarinimin doganor CN22/CN23 ose në një fletë të veçantë letre bashkangjitur atij dokumenti.
2. Importet të cilat janë të rastësishme dhe përbëjnë vetëm produkte për përdorim personal nga marrësi ose udhëtari ose familjarët e tyre nuk konsiderohen si importe për qëllime tregtie nëse nisur nga pikëpamja e natyrës dhe sasisë së produkteve është e evidente që nuk ka qëllime tregtie për to.
3. Për më tepër, vlera totale e këtyre produkteve nuk duhet të kalojnë 500 Euro në rastin e pakove të vogla ose 1 200 Euro në rastin e produkteve që janë pjesë e bagazheve personale të udhëtareve.

Neni 28

Dokumentet Mbështetëse

Dokumentet referuar në neneve 17(3) dhe 21(3) që përdoren për qëllime vërtetimi që produktet e shoqëruara me një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 ose një deklaratë fature, mund të konsiderohen si produkte me origjinë në një palë, në Bashkimin Evropian ose në vendet e tjera referuar nenit 3 dhe që plotësojnë të gjitha kërkesat e tjera të këtij protokollit, si dhe mund të përbëhen inter alia si të më poshtë:

- a) Prova të drejtpërdrejta e proceseve të kryera nga eksportuesi ose furnitori për të përfituar produktet në fjalë, që mbahen për shembull në llogaritë ose në librat e kontabilitetit të tij të brendshëm;
- b) dokumentet që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në një palë ku këto dokumente përdoren në përputhje me ligjin vendas;
- c) dokumentet që vërtetojnë punimet ose proceset e prodhimit të materialeve në një nga palët, të lëshuara ose të bëra në një palë, ku këto dokumente janë përdorur në përputhje me ligjin vendas;
- d) certifikata e qarkullimit të mallrave EUR.1 ose deklarata fature që vërtetojnë statusin e origjinës së materialeve të përdorura, të lëshuara ose të bëra në palët në përputhje me këtë protokoll, ose në Bashkimin Evropian ose në një nga vendet referuar nenit 3,

në përputhje me rregullat e origjinës të cilat janë të njëjta me rregullat e këtij protokolli;

e) evidencat e duhura në lidhje me punën ose procesin që kalojnë jashtë një pale nga aplikimet e nenit 12, duke siguruar që kërkesat e këtij neni të përmbushen.

Neni 29

Ruajtja e vërtetimit të origjinës dhe e dokumenteve mbështetëse

1. Eksportuesi që aplikon për lëshimin e një certifikate qarkullimi mallrash EUR.1 duhet t'i mbajë dokumentet e referuar në nenin 17 (3) për të paktën tre vjet.

2. Eksportuesi që bën një deklaratë fature duhet të mbajë për të paktën tre vjet një kopje të kësaj deklarate si dhe dokumentet e referuar në nenin 22 (4).

3. Autoritetet doganore të palës eksportuese që lëshojnë një certifikatë qarkullimi mallrash EUR.1 duhet të mbajnë për të paktën tre vjet formularin e aplikimit të referuar në nenin 17(2).

4. Autoritetet doganore të palës importuese duhet të mbajnë për të paktën tre vjet certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë që iu paraqiten atyre.

Neni 30

Mospërputhjet dhe gabimet formale

1. Në rast se gjenden mospërputhje të vogla në deklaratimet e bëra në vërtetimin e origjinës dhe ato të bëra në dokumentet e paraqitura në zyrën doganore për qëllime të kryerjes së formaliteteve për importimin e produkteve, kjo nuk sjell ipso facto pavlefshmërinë e vërtetimit të origjinës nëse provohet si duhet se ky dokument u korespondon produkteve të paraqitura.

2. Gabimet formale të dukshme të tilla si gabime ortografike në vërtetimin e origjinës nuk do të bëhen shkas që ky dokument të refuzohet, nëse këto gabime nuk janë të tilla që të krijojnë dyshime në lidhje me korrektësinë e deklaratimit të bërë në atë dokument.

Neni 32

Shumat e shprehura në Euro

1. Në zbatim të dispozitave të nenit 22(1)(b) dhe nenit 27(3) në rastet kur produktet faturohen në një monedhë tjetër veç euros, shumata në monedhën kombëtare palëve, ekuivalente me shumata e shprehura në euro, duhet të fiksohet çdo vit nga secili prej palëve të interesuara.

2. Një dërgesë malli duhet të përfitojë nga dispozitat e nenit 22(1)(b) dhe nenit 27(3), duke ju referuar monedhës në të cilën është përgatitur fatura, sipas shumës së fiksuar nga pala e interesuar.

3. Shumat për t'u përdorur në çdo lloj monedhe kombëtare të dhënë duhet të jenë të barabarta në këtë monedhë me shumën e shprehur në euro si në ditën e parë të punës së muajit tetor dhe zbatohen nga 1 janari i vitit në vazhdim. Palët i komunikojnë shumata njëra-tjetrës brenda rreth 15 tetorit

4. Një palë mund të rrumbullakosë shumën që rezulton nga konvertimi në monedhën e vet kombëtare të një shume të shprehur në euro. Sasia e rrumbullakosur nuk duhet të ndryshojë nga sasia e rezultuar prej konvertimit me më shumë se 5%. Një palë mund të mbajë të pandryshuar ekuivalentin e monedhës së tij kombëtare të një shume të shprehur në euro, në rast se gjatë kohës së rregullimeve vjetore, sipas paragrafit 3, konvertimi i kësaj shume, përpara rrumbullakosjes, rezulton me një rritje më pak se 15% në ekuivalentin e monedhës kombëtare. Ekuivalenti i monedhës kombëtare mund të mbahet i pandryshuar në rast se konvertimi do të rezultonte në një pakësim në këtë vlerë ekuivalente.

5. Shumat e shprehura në euro duhet të rishikohen nga Komiteti i Përbashkët me kërkesë të një pale. Gjatë këtij rishikimi, Komiteti i Përbashkët duhet të konsiderojë dëshirën e palëve për tu mbrojtur nga pasojat e efekteve të kufizimeve në terma reale. Për këtë qëllim, ai mund të vendosë për të modifikuar shumata e shprehura në euro.

TITULLI VI

RREGULLIME PËR BASHKËPUNIMIN ADMINISTRATIV

Neni 32

Asistenca reciproke

1. Autoritetet doganore të palëve duhet t'i sigurojnë njëra-tjetrës kopje të llojit të vulave të përdorura në zyrat e tyre doganore për lëshimin e certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 dhe adresat e autoriteteve përgjegjëse doganore për të vërtetuar këto certifikata dhe deklarata faturë.

2. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i duhur i këtij protokoll, palët duhet të ndihmojnë

njëra-tjetrën, nëpërmjet administratave doganore kompetente, në kontrollin e origjinalitetit të certifikatave të qarkullimit të mallrave EUR.1 ose të deklaratave fature, si dhe korrektësinë e informacionit të dhënë në këto dokumente.

Neni 33

Verifikimi i vërtetimit të origjinës

1. Verifikimet e duhura të vërtetimit të origjinës duhet të kryhen me metodën zgjedhjes së rastit ose sa herë që autoritetet doganore të palës importuese kanë dyshime të arsyeshme për origjinalitetin e dokumenteve të tillë, për statusin e origjinës së produkteve përkatëse ose për përmbushjen e kërkesave të tjera të këtij protokollit.
2. Për qëllimet e zbatimit të dispozitave të paragrafit 1, autoritetet doganore të vendit importues duhet t'ia kthejnë certifikatën e qarkullimit të mallrave EUR.1 si dhe deklaratën faturë, në rast se është paraqitur, ose një kopje të këtyre dokumenteve, autoriteteve doganore të palës eksportuese, duke u dhënë, sipas rastit, arsytet për hetimin. Çdo dokument dhe informacion i marrë, i cili thotë se informacioni i dhënë mbi vërtetimin e origjinës është jo korrekt, paraqitet në mbështetje të kërkesës për verifikim.
3. Verifikimi duhet të kryhet nga autoritetet doganore të palës eksportuese. Për këtë qëllim, ato duhet të kenë të drejtën të kërkojnë çdo dokument dhe të kryejnë çdo inspektim të llogarive të eksportuesit ose çdo lloj kontrolli që konsiderohet i nevojshëm.
4. Në rast se autoritetet doganore të palës importuese vendosin të pezullojnë përkohësisht dhënien e trajtimit preferencial për produktet përkatës, ndërkohë që presin rezultatet e verifikimit, importuesit duhet t'i ofrohet mundësia për të mos i bllokuar produktet, sipas ndonjë mase parandaluese që mendohet e nevojshme.
5. Autoritetet doganore që kërkojnë verifikimin duhet të informohen për rezultatet e këtij verifikimi sa më shpejtë që të jetë e mundur. Këto rezultate duhet të tregojnë qartë kur dokumentet janë autentikë dhe kur produktet përkatëse mund të konsiderohen si produkte që janë me origjinë në një palë si dhe që plotësojnë kërkesat e tjera të këtij protokollit.
6. Në rast se për një dyshim të arsyeshëm, nuk ka përgjigje brenda 10 muajve nga data e kërkesës së verifikimit, ose në qoftë se përgjigjja nuk përmban informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar origjinalitetin e dokumentit në fjalë ose origjinën e vërtetë të produkteve, autoritetet doganore kërkuese të hetimit, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, duhet të refuzojnë të drejtën e preferencave.

Neni 34

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Kur ka mosmarrëveshje lidhur me verifikimin e procedurave të nenit 33, të cilat nuk mund të zgjidhen mes autoriteteve doganore që kërkojnë një verifikim dhe autoriteteve doganore përgjegjëse për kryerjen e këtij verifikimi, ose kur ato ngrenë një çështje lidhur me interpretimin e këtij Protokolli, ato duhet t'i paraqiten Komitetit të Përbashkët.

Në të gjitha rastet, zgjidhjet e mosmarrëveshjeve ndërmjet importuesit dhe autoriteteve doganore të palës mportuese duhet të respektojnë legjislacionin e vendit importues.

Neni 35

Gjobat

Gjobat duhet të vendosen mbi çdo person që harton apo shkakton hartimin e një dokumenti që përmban informacion jo të saktë për qëllimin e marrjes së trajtimit preferencial për produktet.

Neni 36

Zonat e lira

1. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që produktet e tregtuara që janë objekt i vërtetimit të origjinës, dhe që gjatë transportit përdorin një zonë të lirë që është në territorin e tyre, të mos zëvendësohen nga mallra të tjera dhe të mos pësojnë përpunim tjetër veç veprimeve normale që parandalojnë përkeqësimin e gjendjes së mallrave.

2. Nëpërmjet një përjashtimi nga dispozitat që përmban paragrafi 1, kur produktet me origjinë në një palë importohen në një zonë të lirë me një vërtetim origjine dhe pësojnë trajtim ose përpunim, autoritetet përkatëse duhet të lëshojnë një certifikatë të re EUR.1 me kërkesë të eksportuesit, në rast se trajtimi dhe përpunimi i pësuar është në përputhje me dispozitat e këtij protokolli.

TITULLI VIII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 37

Dispozitat kalimtare per mallrat ne tranzit ose magazinimi

Dispozitat e marreveshjes mund të zbatohen mbi mallrat të cilat pajtohen me dispozitat në këtë protokoll dhe të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit janë tashmë në tranzit ose janë në një magazinim të përkohshëm tek pala në magazinat e doganave ose ne zonat e lira, subjekt i paraqitjes ne autoritetet doganore të palës importuese, brënda katër muajve nga data e përmendur, ta certifikatas sa lëvizjes së mallrave EUR1. të lëshuar nga autoritetet doganore, sipas parashikimeve të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dypalëshe, të paraqitur në aneksin 11 të kësaj marrëveshjeje, për Palën eksportuese së bashku me dokumentat që tregojnë se mallrat janë transportuar drejtëpërsdrejti në përputhje me nenin 13.

Neni 38

Amendamentet e Protokollit

Komiteti i Përbashkët mund të vendosë të ndryshojë dispozitat e këtij protokollit.

Neni 39

Nën-Komiteti i Doganave

1. Një nënkomitet i doganave mund të ngrihet, të ngarkohet me përgjegjësitë e bashkëpunimit administrativ, me qëllim të zbatimit korrekt dhe të njëjtë të këtij protokollit dhe për të zbatuar çdo lloj detyrimi në fushën e doganave, të cilat mund tu besohen.

2. Nënkomitet do të përbehen nga eksperte të palëve të cilat do të jenë përgjegjës për çështjet doganore.

Neni 40

Anekset

Anekset I – IV të këtij protokollit do të formojnë një pjesë integrale të tij

PROTOKOLLIT

SHËNIME PREZANTUESE TË LISTËS NË ANEKSIN II

Shënim 1:

Lista vendos kushtet e kërkuara për të gjitha produktet për t'u konsideruar si të punuara ose përpunuara mjaftueshëm brenda kuptimit të nenit 6 të protokollit.

Shënim 2:

2.1. Dy kolonat e para në listë përshkruajnë produktin e përfutur. Kolona e parë jep numrin e kreut ose numrin e kapitullit, të përdorur në sistemin e harmonizuar dhe kolona e dytë jep përshkrimin e mallrave të përdorura në atë sistem për atë kre apo kapitull. Për secilën hyrje në dy kolonat e para specifikohet një rregull në kolonën 3 ose 4. Kur, në disa raste, hyrja në kolonën e parë parapritet nga një "ex" kjo nënkupton se rregullat në kolonën 3 ose 4 aplikohen vetëm për pjesën e atij kreu sikurse është përshkruar në kolonën 2.

2.2. Kur shumë numra krerësh grupohen së bashku në kolonën 1 ose jepet një numër kapitulli dhe kështu përshkrimi i produkteve në kolonën 2 jepet në terma të përgjithshëm, rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4 aplikohen për të gjitha produktet, të cilat, nën sistemin e harmonizuar klasifikohen në krerët e kapitullit ose në çdo kre të grupuar së bashku në kolonën 1.

2.3. Kur ka rregulla të ndryshme në listën që aplikohet për produkte të ndryshme brenda një kreu, secila pikë përmban përshkrimin e asaj pjese të kreut të rregulluar nga rregullat e afërta në kolonën 3 ose 4.

2.4. Kur, për një hyrje në dy kolonat e para, një rregull specifikohet në të dyja kolonat 3 dhe 4, eksportuesi mund të zgjedhë, si alternativë, që të aplikojë rregullin e vendosur në kolonën 3, ose atë të vendosur në kolonën 4. Në rast se nuk jepet ndonjë rregull origjine në kolonën 4, duhet të aplikohet rregulli i vendosur në kolonën 3.

Shënim 3:

3.1. Dispozitat e nenit 6 të protokollit, për sa u përket produkteve që kanë marrë statusin e origjinës, të cilat janë përdorur në prodhimin e produkteve të tjera, zbatohen, pavarësisht nëse ky status është marrë brenda fabrikës ku këto produkte po përdoren ose në një tjetër fabrike në një palë.

Shembull:

Një motor i kreut 8407, për të cilin rregulli thotë se vlera e materialeve pa origjinë të cilat mund të përfshihen në të nuk mund të kalojë 40% të çmimit ex-ëorks është bërë nga "aliazh tjetër prej çeliku i formatuar për kudhër" të kreut ex 7224.

Në rast se ky çelik i temperuar është temperuar në një palë nga një lëndë e parë pa origjinë, ky çelik ka marrë tashmë statusin me origjinë sipas rregullit për kreun ex 7224 në listë. Temperimi mund të llogaritet atëherë si me origjinë në vlerën e llogaritur për motorin, pavarësisht nëse çeliku u prodhua në të njëjtën fabrikë ose në një fabrikë tjetër në palën. Vlera e lëndës së parë pa origjinë në këtë mënyrë nuk merret parasysh kur shtohet vlera e materialeve pa origjinë të përdorura.

3.2. Rregulli në listë përfaqëson sasinë minimale të kërkuar të punës ose përpunimit, si dhe kryerja e më shumë pune apo përpunimi gjithashtu i jep statusin e origjinës; në të kundërt, kryerja e më pak pune apo përpunimi nuk mund t'i japë statusin e origjinës. Kështu, në rast se një rregull thotë se një material pa origjinë, në një nivel të dhënë të prodhimit mund të përdoret, atëherë përdorimi i këtij materiali në një stad të hershëm të prodhimit lejohet dhe përdorimi i tij në një stad të mëvonshëm nuk lejohet

3.3. Pa cenuar shënimin 3.2, kur një rregull përdor shprehjen se “Prodhimi nga materialet e çdo kreu” mund të përdoret, materialet e të njëjtit kre/krekë (edhe materialet e të njëjtit përshkrim dhe kre si produkti), megjithatë duke iu nënshtruar kufizimeve specifike që mund të parashikohen nga rregulli.

Sidoqoftë, shprehja “Prodhim nga materiale të çdo kreu, duke përfshirë materiale të tjera të kreut ...” ose “Prodhim nga materialet e [do kreu duke përfshirë materiale të tjera të të njëjtit kre si produkti]” do të thotë që mund të përdoren vetëm materiale të çdo kreu, përveç atyre të të njëjtit përshkrim si produkti i dhënë në kolonën 2 të listës.

3.4. Kur një rregull në listë specifikon se një produkt mund të prodhohet nga më shumë se një material, kjo do të thotë që mund të përdoren një ose më shumë materiale. Ai nuk kërkon që të përdoren të gjitha materialet.

Shembull:

(1) Nëqoftëse mallrat nuk janë të paketuar, vendosni numrin e artikujve ose deklaroni «në total» në mënyrë të përshtatëshme

DEKLARATA E EKSPORTUESIT

Unë, i nënshkruari, eksportuesi i mallrave të përshkruara në faqen prapa,

Deklaroj që mallrat plotësojnë kushtet e kërkuara për lëshimin e

çertifikatës
bashkëlidhur.

Specifikoj sa më poshtë rrethanat që kanë mundësuar që këto produkte të plotësojnë kushtet e mësipërme:

.....
....
.....
....
.....
....

Paraqes dokumentat mbështetëse të mëposhtëme
(1) :

.....
....
.....
....
.....
....

Marr përsipër të paraqes, me kërkesë të autoriteteve të ngarkuara, çdo evidencë mbështetëse që këto autoritete mund të kërkojnë për qëllim të lëshimit të çertifikatës bashkëlidhur, dhe marr përsipër, nëse kërkohet, të bie dakort me çdo verifikim të llogarisë time financiare dhe të çdo kontrolli në procesin e prodhimit të mallrave të mësipërme, të kryera nga këto autoritete;

Kërkoj lëshimin e çertifikatës bashkëlidhur, për këto mallra:

.....

(vëndi dhe data)

.....

.....

. (firma)

- (1) Për shëmbull, dokumenta importi, çertifikata qarkullimi mallrash, fatura, deklaratë prodhuese, të tjera, referuar produkteve të përdorura në prodhim ose mallrave të rieskportuara në të njëjtin shtet.

ANEKSI IV I PROTOKOLLIT

Teksti i deklaratë faturë

Deklarata faturë, teksti i të cilës jepet më poshtë, duhet të bëhet në përputhje me shënimet në fund të faqes. Sidoqoftë, shënimet në fund të faqes nuk kanë nevojë që të riprodhohen.

Versioni

Shqip:

Eksportuesi i produkteve të përfshira në këtë dokument (autorizim doganor Nr..... (1)) deklaron që përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe, këto produkte janë me origjinë preferenciale (2).

- kumulimi i zbatuar me (emri i shtetit(eve) ose territorit(eve))
- jo kumulim i zbatuar
(³).

Bosnia and Herzegovina
versions:

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlaštenje br.....(1)) izjavljuje da su, osim ako je drukčije izričito navedeno, ovi proizvodi.....(2) preferencijalnog porijekla.

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlaštenje br.....(1)) izjavljuje da su, osim ako je drukčije izričito navedeno, ovi proizvodi.....(2) preferencijalnog podrijetla.

Извозник производа обухваћених овом исправом (царинско овлашћење бр.....(1)) изјављује да су, осим ако је то другачије изричито наведено, ови производи(2) преференцијалног поријекла.

- cumulation applied either (name of the country(s) or territory(s))
- no cumulation applied
(3)

Bulgarian
version:

Износителят на продуктите, обхванати от този документ (митническо разрешение №(1)) декларира, че освен където ясно е отбелязано друго, тези продукти са с (2) преференциален произход.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

Croatian
version:

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlaštenje br.(1)) izjavljuje da su, osim ako je to drugačije izričito navedeno, ovi proizvodi(2) preferencijalnog podrijetla.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

German
version:

Der Ausführer (Ermächtigter Ausführer; Beëilligungs-Nr.(1)) der Ęaren, auf die sich dieses handelspapier bezieht, erklärt, dass diese Ęaren, soëeit nicht anderes angegeben, präferenzbegünstigte(2) Ursprungsëaren sind.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

French
version:

L'exportateur des produits couverts par le présent document (autorisation douanière no.(1)) déclare que, sauf indication claire du contraire, ces produits ont l'origine préférentielle(2).

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

English
version:

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No(1)) declares that, except where otherwise clearly indicated, these products are of (2) preferential origin.

- cumulation applied either (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

Macedonian version:

Извозникот на производите што ги покрива овој документ (царинско одобрение бр. (1)) изјавува дека, освен ако тоа не е јасно поинаку назначено, овие производи се со(2) преференцијално потекло.

- cumulation applied either (name of the country(s) or territory(s))
 - no cumulation applied
- (3)

Moldovan version:

Exportatorul produselor ce fac obiectul acestui document (autorizația vamală nr.(1)) declară că, exceptând cazul în care în mod expres este indicat altfel, aceste produse sunt de origine preferențială(2).

- cumulation applied either (name of the country(s) or territory(s))
- no cumulation applied (3)

Romanian version:

Exportatorul produselor ce fac obiectul acestui document (autorizația vamală nr.(1)) declară că, exceptând cazul în care în mod expres este indicat altfel, aceste produse sunt de origine preferențială(2).

- cumulation applied either (name of the country(s) or territory(s))
- no cumulation applied (3)

Serbian version:

Извозник производа обухваћених овом исправом (царинско овлашћење бр. (1)) изјављује да су, осим ако је другачије изричито наведено, ови производи (2) преференцијалног порекла.

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlašćenje

br..... (1) izjavljuje da su, osim ako je drugačije izričito navedeno, ovi proizvodi

..... (2) preferencijalnog porekla.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))

- no cumulation applied (3)

Montenegro version:

Извозник производа обухваћених овом исправом (царинско овлашћење бр.

..... (1) изјављује да су, осим ако је другачије изричито наведено,

ови производи (2) преференцијалног поријекла.

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlašćenje

br..... (1) izjavljuje da su, osim ako je drugačije izričito navedeno,

ovi proizvodi

..... (2) preferencijalnog porijekla.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))

- no cumulation applied (3)

UNMIK version:

Eksportuesi i produkteve të mbuluara nga ky dokument (autorizim doganor Nr.

.....(1)) deklaron që përveç rasteve kur tregohet qartësisht ndryshe,

këto produkte janë me origjinë preferenciale..... (2)

Извозник производа обухваћених овом исправом (царинско овлашћење бр.

..... (1) изјављује да су, осим ако је другачије изричито наведено,

ови производи (2) преференцијалнога порекла.

Izvoznik proizvoda obuhvaćenih ovom ispravom (carinsko ovlašćenje

br..... (1) izjavljuje da su, osim ako je drugačije izričito navedeno,

ovi proizvodi

..... (2) preferencijalnoga porekla.

The exporter of the products covered by this document (customs authorization No

.....(1)) declares that, except ěhere otherěise clearly indicated, these

products are of (2) preferential origin.

- cumulation applied ěith (name of the country(s) or territory(s))

- no cumulation applied (3)

.....
(Firma e eksportuesit, e shoqëruar me emrin i personit i cili nënshkruan deklaratën të shkruar me gërma të qarta)

-
- (1) Kur deklarimi i faturës është bërë nga një eksportues i aprovuar, numri i autorizimit të eksportuesit të aprovuar duhet të shkruhet në këtë vend. Kur deklarimi i faturës nuk është bërë nga një eksportues i autorizuar, fjalët në kllapa nuk janë të nevojshme të vendosen ose hapësira duhet të lihet bosh.
- (2) Duhet të përcaktohet origjina e mallit.
- (3) Plotësohet dhe fshihet kur është e nevojshme
- (4) Këto të dhëna nuk janë të nevojshme të vendosen në rast se ky informacion përcaktohet në vetë dokumentin.
- (5) Shiko nenin 22(5) të këtij protokolli. Në rastet kur eksportuesit nuk i kërkohet që të nënshkruajë, perjashtimi i firmës përfshin gjithashtu edhe perjashtimin e shkruajtjes së emrit të vetë nënshkruarit.

ANEKSI 5

MBI AISTENCEN RECIPROKE ADMINISTRATIVE NË ÇËSHTJET DOGANORE referuar nenit 14, paragrafi 2 dhe 3

Neni 1 **Përkufizime**

Për qëllime të këtij aneksi:

- (a) ‘legjislacion doganor’ është çdo dispozitë ligjore ose nënligjore që zbatohet në territoret e Palëve, që rregullon importin, eksportin ose transitin e mallrave dhe vendosjen e tyre në një tjetër regjim ose procedurë doganore, duke përfshirë masat e ndalimit, kufizimit ose kontrollit;
- (b) ‘autoriteti aplikues’ është një autoritet kompetent i doganave që është caktuar nga një Palë për këtë qëllim dhe që bën një kërkesë për asistencë në bazë të këtij aneksi;
- (c) ‘autoriteti pritës’ është një autoritet kompetent doganor që është caktuar nga një Palë për këtë qëllim dhe që merr një kërkesë për asistencë në bazë të këtij aneksi;
- (d) ‘të dhëna personale’ janë i gjithë informacioni në lidhje me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm;
- (e) ‘operacion i shkeljes së legjislacionit doganor’ është çdo shkelje ose shkelje e tentuar e legjislacionit doganor.

Neni 2 **Fusha**

1. Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën, në fushat brenda kompetencës së tyre, në mënyrën dhe në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë aneks, për të siguruar zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, veçanërisht duke parandaluar, hetuar dhe luftuar kundër operacioneve të shkeljes së këtij legjislacioni.
2. Asistenca në çështjet doganore, siç është parashikuar në këtë aneks, do të zbatohet për çdo autoritet doganor të Palëve që është kompetent për zbatimin e këtij Aneksi. Kjo nuk do të paragjykojë rregullat që rregullojnë asistencën reciproke në çështjet penale. Kjo nuk do të mbulojë as informacionin e përfutur në bazë të kompetencave të ushtruara me kërkesë të një autoriteti gjyqësor, përveç kur komunikimi i këtij informacioni është i autorizuar nga ky autoritet.
3. Asistenca në mbledhjen e tarifave doganore, taksave ose gjobave nuk mbulohet nga ky aneks.

Neni 3

Asistenca me kërkesë

1. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti pritës i jep atij të gjithë informacionin përkatës që mund t'i krijojë mundësi atij të sigurojë që legjislacioni doganor zbatohet me korrektësi, duke përfshirë informacionin në lidhje me aktivitetin e caktuar ose planifikuar që janë ose mund të jenë operacione për shkeljen e legjislacionit doganor.

2. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti pritës e informon atë:

(a) nëse mallrat e eksportuara nga territori i një prej Palëve janë importuar në mënyrë të rregullt në territorin e Palës tjetër, duke përcaktuar, sipas rastit, procedurën e zbatuar për mallrat;

(b) nëse mallrat e importuar në territorin e një prej Palëve janë eksportuar në mënyrë të rregullt nga territori i Palës tjetër, duke përcaktuar, sipas rastit, procedurën e doganës të zbatuar për mallrat.

3. Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti pritës, brenda kuadrit të dispozitave të tij ligjore dhe nënligjore, merr masat e nevojshme për të siguruar mbikëqyrjen e veçantë për:

(a) personat fizikë dhe juridikë në lidhje me të cilët ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ata janë ose kanë qenë përfshirë në operacione për shkeljen e legjislacionit doganor;

(b) vendet ku stoqet e mallrave janë ose mund të montohen në një mënyrë të tillë që të ketë shkaqe të arsyeshme për të besuar që këto mallra janë të destinuar për t'u përdorur në operacione që shkelin legjislacionin doganor;

(c) mallrat që janë ose mund të transportohen në mënyrë të tillë që krijojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar që ata janë të destinuar për t'u përdorur në operacione që shkelin legjislacionin doganor;

(d) mjetet e transportit që janë ose mund të përdoren në mënyrë të tillë që ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ata janë të destinuar të përdoren në operacione që shkelin legjislacionin doganor.

Neni 4

Asistenca spontane

Palët ndihmojnë njëra-tjetrën, me iniciativë të tyre dhe në pajtim me dispozitat e tyre ligjore dhe nënligjore, nëse ato e konsiderojnë të nevojshme për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, veçanërisht duke dhënë informacionin e marrë në lidhje me:

a. aktivitetet që janë ose duken se janë operacione që shkelin legjislacionin doganor dhe që mund të jenë me interes për Palën tjetër të CEFTA-s;

- b. mjete dhe metoda të reja të zbatuara për kryerjen e operacioneve që shkelin legjislacionin doganor;
- c. mallrat që dihet që u janë nënshtruar operacioneve që shkelin legjislacionin doganor;
- d. personat fizikë dhe juridikë në lidhje me të cilët ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ata janë ose janë përfshirë në operacione që shkelin legjislacionin doganor;
- e. mjetet e transportit në lidhje me të cilët ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ata kanë qenë, janë ose mund të përdoren në operacionet që shkelin legjislacionin doganor.

Neni 5

Dorëzimi, njoftimi

Me kërkesë të autoritetit aplikues, autoriteti pritës, në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të zbatueshme për këtë të fundit, merr të gjitha masat e nevojshme për të:

- a. dorëzuar çdo dokument, ose b.

njoftuar çdo vendim,

që vjen nga autoriteti aplikues dhe përfshihet në fushën e këtij aneksi, drejtuar një të adresuari rezident ose të themeluar në territorin e autoritetit pritës.

Kërkesat për dorëzimin e dokumenteve ose njoftimin e vendimeve bëhet me shkrim në një gjuhë zyrtare të autoritetit pritës ose në anglisht.

Neni 6

Forma dhe përmbajtja e kërkesave për asistencë

1. Kërkesat në pajtim me këtë aneks bëhen me shkrim. Ato shoqërohen nga dokumentet e nevojshëm për të mundësuar përmbushjen e kërkesës. Nëse kërkohet për shkak të urgjencës së situatës, kërkesat gojore mund të pranohen, por duhet të konfirmohet menjëherë me shkrim.

2. Kërkesat në pajtim me paragrafin 1 përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

- (a) autoritetin aplikues;
- (b) masën e kërkuar;
- (c) objektin dhe shkakun e kërkesës;
- (d) dispozitat ligjore dhe nënligjore dhe elementët e tjerë ligjorë të përfshirë;
- (e) treguesit sa më të saktë dhe të plotë që të jetë e mundur mbi personat fizikë dhe juridike që janë objekt i hetimeve;
- (f) një përmbledhje të fakteve përkatës dhe të hetimeve të kryera.

3. Kërkesat paraqiten në një gjuhë zyrtare të autoritetit pritës ose në anglisht. Kjo kërkesë nuk zbatohet për asnjë dokument që shoqëron kërkesën sipas paragrafit 1.

4. Nëse një kërkesë nuk përmbush kërkesat formale të parashikuara më sipër, mund të kërkohe korrigjimi ose plotësimi i saj; ndërkohe mund të caktohen masat e përkohshme.

Neni 7

Ekzekutimi i kërkesave

1. Me qëllim që të përmbushet kërkesa për ndihmë, autoriteti pritës procedon, brenda kufijve të kompetencës së tij dhe burimeve në dispozicion, sikur të vepronte në emër të vet ose me kërkesë të autoriteteve të tjera të së njëjtës palë, duke dhënë informacionin e zotëruar, duke kryer hetimet e përshtatshme ose duke marrë masat që ato të kryhen. Kjo dispozitë zbatohet edhe për çdo autoritet tjetër që i është dërguar kërkesa nga autoriteti pritës nëse ky i fundit nuk vepron dot vetë.

2. Kërkesat për asistencë do të zbatohet sa më shpejt të jetë e mundur me kërkesë në pajtim me dispozitat ligjore ose nënligjore të palës pritëse.

3. Nëpunësit e autorizuar rregullisht të një palë, me pëlqimin e palës tjetër të përfshirë dhe në pajtim me kushtet e parashikuara nga e fundit, mund të jenë të pranishëm për të marrë në zyrat e autoritetit pritës ose çdo autoriteti tjetër të interesuar në pajtim me paragrafin 1, informacion në lidhje me aktivitete që janë ose mund të jenë operacione që shkelin legjislacionin doganor që autoritetit aplikues i duhet për qëllimet e këtij aneksi.

4. Nëpunësit e autorizuar rregullisht të një pale, me pëlqimin e palës tjetër të përfshirë dhe në pajtim me kushtet e përcaktuara nga kjo e fundit, mund të jenë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin e këtij të fundit.

Neni 8

Forma në të cilën duhet të komunikohet informacioni

1. Autoriteti pritës i komunikon rezultatet e hetimeve autoritetit aplikues me shkrim së bashku me dokumentet përkatës, kopjet e vërtetuara ose sende të tjera.

2. Ky informacion mund të jetë në formë të kompjuterizuar.

3. Dokumentet origjinale transmetohen vetëm me kërkesë në rastet kur kopjet e certifikuara do të ishin të pamjaftueshme. Këto origjinale kthehen në rastin më të parë.

Neni 9

Përfundime të detyrimit për dhënien e asistencës

1. Asistenca mund të refuzohet ose mund t'i nënshtrohet përmbushjes së kushteve ose kërkesave të caktuara në rastet kur një palë është e mendimit që asistenca në bazë të këtij aneksi do të:

(a) mund të cenonte sovranitetin e palëve që u është kërkuar të japin asistencë në bazë të aneksit;

(b) mund të cenonte politikën publike, sigurinë publike apo interesa të tjera thelbësore, veçanërisht në rastet referuar Nenit 10, paragrafi 2, ose

(c) cenonte një sekret industrial, tregtar ose profesional.

2. Asistenca mund të shtyhet nga autoriteti pritës me shkakun që ai do të ndërhyjë në një hetim në proces, ndjekje penale apo procedim të papërfunduar. Në një rast të tillë, autoriteti pritës konsultohet me autoritetin aplikues për të përcaktuar nëse ndihma mund të jepet në pajtim me këto terma dhe kushte siç mund të kërkohen nga autoriteti pritës.

3. Nëse autoriteti aplikues kërkon sistencë që ai vetë nuk do të ishte në gjendje ta jepte nëse i kërkohet, ai e vë në dukje një gjë të tillë në kërkesë. Pastaj i mbetet autoritetit kërkues të vendosë si do të përgjigjet ndaj një kërkesë të tillë.

4. Për çështjet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2, vendimi i autoritetit pritës dhe arsyet për të duhet t'i komunikohen autoritetit aplikues pa vonesë.

Neni 10

Shkëmbimi i informacionit dhe konfidencialiteti

1. Çdo informacion i komunikuar në çfarëdolloj forme në pajtim me këtë aneks është i një natyre konfidenciale dhe të kufizuar, në varësi të rregullave të zbatueshme për secilën palë. Ai mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe gëzon mbrojtjen e dhënë për informacion të ngjashëm në bazë të ligjeve përkatës të palës që e ka marrë atë dhe dispozitat përkatëse që zbatohen për autoritetet.

2. Të dhënat personale mund të shkëmbehen vetëm nëse pala që mund t'i marrë ato merr përsipër të ruajë të dhënat e tilla të paktën në një mënyrë të njëjtë me atë që zbatohet për atë çështje të veçantë në palën që mund t'i japë ato. Për këtë qëllim, palët i komunikojnë njëra-tjetrës informacion për rregullat e tyre të zbatueshme, duke përfshirë, sipas rastit, dispozitat ligjore në fuqi tek palët.

3. Përdorimi, në të gjitha proceset gjyqësore dhe administrative të filluara në lidhje me operacionet në shkelje të legjisllacionit doganor, ose informacionit të marrë në bazë të këtij aneksi, konsiderohet të jetë për qëllimet e këtij aneksi. Kështu, palët, në regjistrat e tyre të provave, raporteve dhe deklarimeve dhe proceset dhe paditë e ngritura në gjykata, mund të përdorin si provë informacionin e marrë dhe dokumentet e konsultuara në pajtim me dispozitat e këtij aneksi. Autoriteti kompetent që ka dhënë këtë informacion ose ka krijuar mundësinë për këto dokumente njoftohet për këtë përdorim.

4. Informacioni i marrë përdoret vetëm për qëllimet e këtij aneksi. Nëse një prej palëve dëshiron të përdorë këtë informacion për qëllime të tjera, ajo merr informacionin. Ky përdorim u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara nga ky autoritet.

Neni 11

Ekspertët dhe dëshmitarët

Një nëpunës i një autoriteti pritës mund të autorizohet të dalë, brenda kufijve të autorizimit të dhënë, si ekspert ose dëshmitar në procese administrative ose gjyqësore në lidhje me çështjet që mbulohen nga ky aneks, dhe të paraqesë ato objekte, dokumente ose kopje të vërtetuara të tyre, që mund të jenë të nevojshme për procedimet. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë me saktësi se para cilit autoritet gjyqësor ose administrativ do të dalë nëpunësi, për cilat çështje dhe në sajë të cilës cilësi apo kualifikim do të pyetet ai.

Neni 12

Shpenzimet e asistencës

Palët heqin dorë nga të gjitha pretendimet ndaj njëra-tjetrës për rimbursimet e shpenzimeve që shkaktohet në pajtim me këtë aneks, përveç kur, sipas rastit, për shpenzimet e ekspertët dhe dëshmitarët, dhe ata interpretë ose përkthyes që nuk janë punonjës të shërbimit publik.

Neni 13

Zbatimi

1. Zbatimi i këtij aneksi u ngarkohet autoriteteve doganore të palëve. Ata vendosin për të gjitha masat praktike të nevojshme për zbatimin e tij, duke marrë parasysh rregullat në fuqi veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Ata mund t'u rekomandojnë autoriteteve kompetente amendimet që ata mendojnë se duhet t'i bëhen këtij aneksi.
2. Palët konsultohen me njëra-tjetrën dhe e mbajnë njëra-tjetrën të informuar për rregullat e detajuara për zbatimin që miratohen në pajtim me dispozitat e këtij aneksi.

Neni 14

Marrëveshje të Tjera

1. Duke marrë parasysh kompetencat përkatëse të palëve, dispozitat e këtij aneksi:
 - a. nuk do të prekin detyrimet e palëve të CEFTA-s në bazë të një marrëveshjeje ose konvente tjetër ndërkombëtare
 - b. konsiderohen plotësuese për marrëveshjet e ndihmës së ndërsjellë që janë ose mund të lidhen ndërmjet palëve individuale të CEFTA-s.
2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, dispozitat e këtij aneksi do të mbizotërojnë mbi dispozitat e çdo marrëveshjeje dypalëshe mbi asistencën reciproke që është ose mund të lidhet ndërmjet palëve individuale në masën që dispozitat e kësaj të fundit nuk përputhen me ato të aneksit.
3. Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë e aneksit, palët

konsultohen me njëra tjetrën për zgjidhjen e çështjes në kuadrin e Komitetit të Përbashkët të ngritur në bazë të nenit 40 të versionit të konsoliduar të marrëveshjes për tregtinë e lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006).

ANEKSI 6
MARREVESHJET EKZISTUESE DYPALESHE TE INVESTIMEVE
NDERMJET PALEVE
referuar nenit 30 , paragrafët 1, 2 dhe 3

| | EMRI I MARREVESHJES DYPALESHE TE | DATA E NENSHIZRI | HYRJA NE |
|-------------------|---|---|-----------------|
| SHQIPERI | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 27 prill 1994 | 28 janar 1996 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve | 10 maj 1993 | 16 prill 1994 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Macedonase nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 04 dhjetor 1997 | 03 prill 1998 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve | 11 qershor 2004 | 23 dhjetor 2004 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe | 11 maj 1994 | 02 shtator 1995 |
| | Protokoll i përfunduar nëpërmjet Notave Verbale shkëmbyer ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rumanisë, në emër të Këshillit të Ministrave | 26 maj 2005 në Bukuresht dhe 15 korrik 2005 në Tiranë | 16 maj 2006 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Serbisë dhe Malit të Zi për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 26 nentor 2002 | 06 korrik 2004 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Misionit të Administratë së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Institucioneve të Përkohshme Vetë- Qeverisëse të Kosovës | 19 shkurt 2004 | 07 shkurt 2005 |
| DHE BOSNJA | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Bosnje dhe Herzegovinës the Qeverisë së Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të Investimeve | 26 shkurt 1996 | 04 gusht 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Bosnje dhe Herzegovinës dhe Republikës së Kroacisë për amendimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë të Republikës së Bosnje dhe Herzegovinës dhe Qeverisë të Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 23 korrik 2002 | 03 janar 2005 |
| | Marrëveshje ndërmjet Bosnje dhe Herzegovinës the Rumanisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 20 shkurt 2001 | 03 dhjetor 2001 |
| | Marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet | 16 shkurt 2001 | 15 mars 2002 |
| | Marrëveshje ndërmjet Bosnje dhe Herzegovinës dhe Republikës së Moldavisë për nxitjen mbrojtjen reciproke të investimeve | 09 prill 2003 | |

| | | | |
|----------|--|-----------------|-----------------|
| | Marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet | 18 dhjetor 2001 | 25 gusht 2004 |
| BULLGAR | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë the Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 27 prill 1994 | 28 janar 1996 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe | 25 qershor 1996 | 20 shkurt 1998 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë the Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 22 shkurt 1999 | 05 qershor 1999 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë the Qeverisë së Republikës së Moldavisë për | 17 prill 1996 | 11 qeshor 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë së Rumanisë për nxitjen e | 01 qershor 1994 | 23 maj 1995 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Bullgarisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 13 shkurt 1996 | 09 janar 1997 |
| KROAC | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republic së Shqipërisë për inkurajimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 10 maj 1993 | 16 prill 1994 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë the Qeverisë së Bosnje dhe Herzegovinës për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 26 shkurt 1996 | 04 gusht 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Kroacisë the Bosnje dhe Herzegovinës për amendimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë të Republikës së Kroacisë the Qeverisë të Republikës së Bosnje dhe Herzegovinës për nxitjen dhe | 23 korrik 2002 | 03 janar 2005 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë the Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për | 25 qershor 1996 | 20 shkurt 1998 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në lidhje me inkurajimin dhe mbrojtjen reciproke të | 06 korrik 1994 | 06 tetor 1995 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Kroacisë dhe | 05 dhjetor 2001 | |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë së Rumanisë në lidhje me inkurajimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 08 qershor 1994 | 30 prill 1998 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kroacisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të | 18 gusht 1998 | 31 janar 2002 |
| MOLDAVIA | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Moldavisë dhe Bosnje dhe Herzegovinës për nxitjen dhe mbrojtjen | 09 prill 2003 | |

| | | | |
|---------|--|--|-----------------|
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Moldavisë the Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për | 11 qershor 2004 | 23 dhjetor 2004 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Moldavisë dhe | 16 prill 1996 | 12 qershor 2006 |
| | Marrëveshje ndërmjet Republikës së Moldavisë dhe Republikës të Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 05 dhjetor 2001 ratifikuar nga Moldavia, ligji No 973 - XV nga | |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Moldavisë the Qeverisë së Rumanisë për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 14 gusht 1992 | 15 qershor 1997 |
| MAQEDON | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Shqiptare për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 04 dhjetor 1997 | 03 prill 1998 |
| | Marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet | 16 shkurt 2001 | 15 mars 2002 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë | 22 shkurt 1999 | 05 qershor 1999 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë the Qeverisë së Republikës së Kroacisë në lidhje me inkurajimin dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 06 korrik 1994 | 06 tetor 1995 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Maqedonase dhe Qeverisë Rumune për nxitjen e ndërsjelltë dhe mbrojtjen e investimeve | 20 qershor 2000 | 13 shkurt 2002 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qeverisë Federale të Republikës Federale të | 04 shtator 1996 | 22 korrik 1997 |
| MALI I | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 26 nëntor 2002 | 06 korrik 2004 |
| | Marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Shqipërisë | 18 dhjetor 2001 | 25 gusht 2004 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë the Qeverisë të Republikës së Bullgarisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 13 shkurt 1996 | 13 shtator 1996 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë të Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 18 gusht 1998 | 16 nëntor 2001 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë the Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 04 shtator 1996 | 22 korrik 1997 |

| | | | |
|--------|--|-----------------|-----------------|
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë së Rumanisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 28 nëntor 1995 | 13 shtator 1996 |
| RUMANI | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Rumanisë dhe Qeverisë së Shqipërisë në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 11 maj 2004 | 02 shtator 1995 |
| | Protokoll i përfunduar nëpërmjet Notave Verbale shkëmbyer ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rumanisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, në emër të Qeverisë së Rumanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Bukuresht më 26 maj 2005 dhe në Tiranë më 15 korrik 2005, për amendimin e | 11 maj 2004 | 16 maj 2006 |
| | Marrëveshje ndërmjet Rumanisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 20 shkurt 2001 | 03 dhjetor 2001 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Rumanisë dhe Qeverisë të Republikës së Bullgarisë në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 01 qershor 1994 | 23-May-95 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Rumanisë dhe Qeverisë të Republikës së Kroacisë në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 08 qershor 1994 | 30 prill 1998 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Rumune dhe Qeverisë Maqedonase në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 20 qershor 2000 | 13 shkurt 2002 |
| | Marrëveshje në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve ndërmjet Qeverisë së Rumanisë dhe Qeverisë të Republikës së Moldavisë | 14 gusht 1992 | 15 qershor 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Rumanisë dhe Qeverisë të Republikës së Federale të Jugosllavisë në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 29 nëntor 1995 | 16 maj 1997 |
| SERBI | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 26 nëntor 2002 | 06 korrik 2004 |
| | Marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve ndërmjet Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës | 18 dhjetor 2001 | 25 gusht 2004 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë të Republikës së Bullgarisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 13 shkurt 1996 | 09 janar 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë të Republikës së Kroacisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 18 gusht 1998 | 31 janar 2002 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Federale të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë të Republikës së Maqedonisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve | 04 shtator 1996 | 22 korrik 1997 |
| | Marrëveshje ndërmjet Qeverisë të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Qeverisë të Rumanisë në lidhje me nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve | 29 nëntor 1995 | 16 maj 1997 |

Marrëveshje ndërmjet Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në emër të Institucioneve të Përkohshme Vet-Qeverisëse të Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve

19 shkurt 2004 07 shkurt 2005

*Në përputhje me vendimin e shpalljes ë pavarësisë të Republikës së Malit të Zi, miratuar më 3 qershor 2006 nga Parlamenti i Republikës së Malit të Zi, i cili përcakton qartë marrjen përsipër dhe zbatimin e traktave ndërkombëtare të cilat kanë qenë përfunduar ose lidhur nga Bashkimi i Shteteve të Serbisë dhe Malit të Zi dhe lidhur me Malin e Zi, të cilat janë në përputhje të plotë me legjislacionin e Malit të Zi, Mali i Zi i zbaton këto marrëveshje dhe konventa.

ANEKSI 7
MARREVESHJET DHE KONVENTAT NE LIDHJE ME
MBROJTJEN E TE DREJTAVE TE PRONESISE INTELEKTUALE
referuar nenit 39, paragrafi 2
dhe
nenit 38, paragrafet 2 dhe 3

| No | MARREVESHJE/KONVENTE | SHQIPERIA | BOSNJA DHE | BULLGARIA | KROACIA | MALIZIA | MOLDAVI | MAqedoni | RUMANIA | SERBIA | UNMIK/Kosova |
|----|--|-----------|---------------|-----------|---------|---------|---------|----------|---------|--------|--------------|
| 1 | Konventa që themeloi Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (Konventa WIPO, 1967, amenduar në vitin 1979) | √ * | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — ** |
| 2 | Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave artistike dhe letrare e vitit 1886 (Akti i Parisit i vitit 1971) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 3 | Traktati i të drejtës së autorit WIPO (Gjenevë, 1996) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 4 | Traktati i performances dhe fonogrameve e IPO (Gjenevë, 1996) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 5 | Marrëveshja e Madrid në lidhje regjistrimin ndërkombëtar të markave | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 6 | Marrëveshja e Nices në lidhje me klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve me çështje regjistrimit të markave (1957) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 7 | Traktati për bashkëpunimin në fushën e patentave (PCT Uashington 1970) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 8 | Marrëveshja për tregtinë në lidhje me aspekte të të drejtave të pronësisë intelektuale (Marreveshja e Gjenevës për TRIPS) | √ | — | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 9 | Konventa universale për mbrojtjen e të drejtave (Teksti i Gjenevës, 1952) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 10 | Konventa universale për mbrojtjen e të drejtave (Teksti i Parisit 1971) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 11 | Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave të radiodifuzionit (Konventa e Romës, 1961) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 12 | Konventa për mbrojtjen e prodhuesve të fonogrameve kundër duplikimit të paautorizuar të fëmijëve fonogrameve të tyre (Konventa e fonogrameve, Gjenevë, 1971) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 13 | Konventa në lidhje me shpërndarjen e sinjaleve të programeve në distancë të transmetuara nga sateliti (Konventa e Satelitit Drukkel, 1974) | √ | √ | — | √ | √ | — | √ | √ | √ | — |

| | | | | | | | | | | | |
|-----------|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | Paris Convention for the Protection of Industrial Property (1883) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 15 | Marreveshja e Locarnos për krijimin e klasifikimit ndërkombëtar të dizenjove | — | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 16 | Marrëveshja e Strasburgut për sa i përket klasifikimit ndërkombëtar të patentave (1971) | √ | √ | √ | √ | — | √ | √ | √ | — | — |
| 17 | Marreveshja e Vienës për krijimin e klasifikimit ndërkombëtar të elementëve të figurave të markave | — | √ | √ | √ | — | √ | — | √ | — | — |
| 18 | Traktati i Budapestit Treaty për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave për qëllime të procedurave në fushën e patentave (1977) | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 19 | Protokoll në lidhje me marreveshjen e Madridit për sa i përket regjistrimit ndërkombëtar të markave (Protokoll i Madridit, 1989) | √ | √ | √ | √ | — | √ | √ | √ | √ | — |
| *** 20 | Marrëveshja e Hagës për depozitimin ndërkombëtar të dizenjove, e datës 6 nëntor, 1925, e rishikuar në Hagë më 28 nëntor, 1960 (Akti i Hagës, 1960), dhe amenduar në Stokholm, më datë 14 korrik, 1967, me amendamente në 28 shtator, 1979 (Akti plotësues i Stokholmit, 1967) | — | — | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 21 *** | Akti i Gjenezës për marrëveshjen e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të dizenjove industriale, e adoptuar në Gjenevë më 2 korrik, 1999 | — | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | √ | — |
| 22 | Traktati i ligjit të patentave (PLT) | — | √ | — | √ | — | √ | — | √ | — | — |
| 23 | Traktati i ligjit të markave tregtare (TLT) | — | √ | — | √ | √ | √ | — | √ | √ | — |
| 24 | Traktati i Nairobit për mbrojtjen simboleve olimpike të pjesëmarrësve | — | √ | √ | √ | √ | √ | — | √ | √ | — |
| 25 | Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e varieteteve të bimëve (UPOV) | √ | √ | √ | √ | — | √ | — | √ | — | — |

* Pjesëmarrës në marrëveshje/konventa

** Jo pjesëmarrës në marrëveshje/konventa
Protokoll i aktit të Hagës (1960) nuk është në fuqi deri më tani. Ai është ratifikuar nga ose është pranuar nga shtetet e mëposhtëme: Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Litenshteini, Monako, Moroku, Holanda, Svicra.

** Akti i Gjenezës (1999) i marrëveshjes së Hagës për sa i përket regjistrimit ndërkombëtar të dizenjove industriale që është adoptuar më

* 2 korrik 1999. Akti i Gjenezës hyrë në fuqi më 23 dhjetor, 2003.

**

*

*

ANEKSI 8

EMËRIMI I NJË NDËRMJETËSI

referuar nenit 42, paragrafi 3

1. Përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë aneks, rregullat e ndërmjetësimit UNICITRAL që janë në fuqi në momentin që kryhen konsultimet do të rregullojnë procedurën e ndërmjetësimit.

2. Nëse palët e interesuara nuk bien dakord për një ndërmjetës brenda dhjetë ditëve nga marrja e kërkesës fillestare për ndërmjetësim, kryetari i Komitetit të Përbashkët u jep palëve të interesuara emrat e pesë personave nga lista e ndërmjetësve që është përpiluar në pajtim me Nenin 41, paragrafi 6. Secila palë i numëron emrat në rendin e preferencës. Nën dritën e preferencave të shprehura të palëve, kryetari i Komiteti të Përbashkët do të emërojë ndërmjetësin.

3. Në raportin e tij përfundimtar, ndërmjetësi do t'i komunikojë veçanërisht Komitetit të Përbashkët rezultatin e ndërmjetësimit sipas parashikimit të nenit 15 të rregullave të ndërmjetësimit UNICITRAL.

ANEKSI 9

PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT

referuar nenit 43, paragrafi 3

1. Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre anëtarë.
 2. Në njoftimin e saj me shkrim në pajtim me nenin 43, paragrafi 1, pala që ia paraqet mosmarrëveshjen arbitrazhit do të caktojë një anëtar, që mund të jetë shtetas ose rezident i saj.
 3. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të përmendur në nenin 43, paragrafi 1, pala që i drejtohet cakton nga ana e vet një anëtar, që mund të jetë shtetas ose rezident i saj.
 4. Brenda 60 ditëve nga marrja e njoftimit referuar nenit 43, paragrafi 1, të dy anëtarët e emëruar do të bien dakord për caktimin e një anëtari të tretë që do të konfirmohet nga palët në mosmarrëveshje brenda 15 ditëve. Anëtari i tretë nuk është shtetas i asnjë pale në mosmarrëveshje, dhe as rezident i përhershëm në territorin e asnjë pale. Anëtari i emëruar në këtë mënyrë është Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit.
-
5. Nëse të tre anëtarët nuk janë caktuar apo emëruar brenda 75 ditëve nga marrja e njoftimit referuar nenit 43, paragrafi 1, secila palë mund t'i kërkojë sekretarit të Përgjithshëm të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit në Hagë të caktojë një autoritet emërues.
 6. Do të zbatohen rregullat opsionale të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për arbitrimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet dy shteteve, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë aneks.
 7. Vendimi i arbitrazhit jepet brenda gjashtë muajve nga data në të cilën është emëruar Kryetari i Gjykatës së Arbitrazhit. Me kërkesë të Gjykatës së Arbitrazhit, Komiteti i Përbashkët mund të lejojë zgjatjen e këtij afati deri në gjashtë muaj të tjera. Në rastin e një mosmarrëveshjeje në lidhje me kuptimin dhe fushën e vendimit, secila palë në mosmarrëveshje, brenda 60 ditëve nga komunikimi i vendimit të arbitrazhit mund të kërkojë sqarime nga Gjykata e Arbitrazhit. Gjykata e Arbitrazhit i jep sqarimet e saj brenda 60 ditëve nga dita që çështja është sjellë para saj.
